



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



# PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I PRISHTINËS 2012-2022



*“PRISHTINA KRYEQYTET I NJË SHTETI TË RI”*



*Gusht 2013*



**Përmbajtja e shkurtër**

**PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I PRISHTINËS**

**2012- 2022**

**HYRJE**

- A. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR DHE ANALIZA E GJENDJES (Sinteza)**
- B. VIZIONI, PARIMET DHE QËLLIMET**
- C. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR E KOMUNËS**
- D. ZBATIMI I STRATEGJIVE DHE VEPRIMEVE**
- E. ZBATIMI I DISPOZITAVE**

**FJALORI**

**PARAMETRAT E RRUGËVE DHE ZHVILLIMI I TYRE**

**ANEKSI I: KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR E KOMUNËS - HARTAT**

**1. TERRITORI**

**2. KRYEQYTET I SAPOLINDUR**

**3. ZONAT PËR RRITJEN E VENDBANIMEVE RURALE**

**4.1 HAPËSIRAT EKZISTUESE URBANE DHE ZONAT E NDËRTIMIT: QYTETI**

**4.2 HAPËSIRAT EKZISTUESE URBANE DHE ZONAT E NDËRTIMIT: FSHATRAT**

**PRISHTINA**  
**PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL**  
**2012- 2022**

## Përmbajtja

Hyrje.....	8
1. Profili i zhvillimit hapësinor & analiza e situatës.....	10
1.1. Profili i gjendjes.....	10
<u>1.1.1. Informata përmbajtëse mbi situatën gjeografike, fizike, mjedisore dhe socio-ekonomike.....</u>	<u>10</u>
<u>1.1.2. Pozita, rëndësia dhe çështjet specifike për territorin e komunës në kontekst të Planit Hapësinor të Kosovës.....</u>	<u>37</u>
1.2. Vlerësimi i gjendjes në Komunën e Prishtinës .....	39
1.2.1. SWOT Analiza.....	39
Prishtina si kryeqendër administrative .....	43
<u>1.2.2.1. Funksionimi administrativ i Komunës së Prishtinës.....</u>	<u>43</u>
<u>1.2.2.2. Departamentet e komunës.....</u>	<u>43</u>
<u>1.2.2.3. Kompetencat e komunës .....</u>	<u>44</u>
<u>1.2.2.4. Kompetencat e deleguara të Komunës së Prishtinës.....</u>	<u>44</u>
<u>1.2.2.5. Organet e komunës .....</u>	<u>45</u>
<u>1.2.2.6. POLITIKAT DHE PROGRAMET.....</u>	<u>45</u>
<u>Legjislacioni, Plani Hapësinor i Kosovës dhe detyrimet që dalin nga planet dhe dokumentet e tjera .....</u>	<u>45</u>
<u>1.2.2.7. Legjislacioni.....</u>	<u>45</u>
<u>1.2.2.8. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+.....</u>	<u>48</u>
<u>1.2.2.9. Planifikimi në Komunën e Prishtinës deri më sot.....</u>	<u>49</u>
1.3. VLERËSIMI I KAPACITETEVE INVESTIVE KOMUNALE.....	54
1.4. Sfidat kryesore të zhvillimit.....	56
2. VIZIONI, PARIMET dhe qëllimet .....	58
.....	58
2.1. Një vizion për të ardhmen e komunës.....	58
2.2. Parimet e përgjithshme për zhvillim/mbrojtje.....	61
2.3. Caqet e zhvillimit afatgjatë .....	65
2.4. Prioritetet strategjike .....	67
3. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL.....	68
3.1. Konceptet kryesore të zhvillimit hapësinor: 7 objektivat .....	68
<i>Objektivat për rritjen e qëndrueshme urbane.....</i>	<i>68</i>
1. Përforcimi i boshtit kryesor urban për rolin e kryeqytetit.....	68
2. Një qytet i këndshëm për të gjithë qytetarët.....	68

3.	Një zhvillim policentrik urban hapësinor.....	68
	Politikat sektoriale për t'i mbështetur këto strategji: .....	68
a)	Një lëvizshmëri të qëndrueshme për të mbështetur rritjen urbane .....	68
b)	Madhësia dhe dendësia e popullsisë urbane .....	68
	<i>Objektivat për zhvillimin e zgjuar (rritjen e vlerave)</i> .....	68
3.1.1.	<u>Përforcimi i boshtit kryesor urban për rolin e kryeqytetit</u> .....	69
3.2.	<u>Një qytet i këndshëm për të gjithë qytetarët – Çështjet kritike</u> .....	72
3.2.1.	<u>Një zhvillim policentrik urban hapësinor</u> .....	78
	<u>Transporti publik</u> .....	82
	<u>Rrugët</u> .....	83
	<u>Lidhja në mes të kryeqytetit dhe rrjetit (ndër) kombëtar</u> .....	85
	<u>Vlerësimi i stacionit të madh intermodal për kryeqytetin</u> .....	90
a.2	<u>Platforma për shpërndarjen e transportit të mallrave (HUB)</u> .....	91
3.2.3.	<u>Popullsia, banimi, vendbanimet, çështjet sociale dhe trashëgimia kulturore</u> .....	94
	<u>Roli i PZHU-së</u> .....	97
	<u>Përmirësimi dhe vlerësimi i identitetit nëpërmjet vlerave kulturore dhe natyrore</u> .....	100
	<u>Rritja e vendbanimeve rurale model për një zhvillim të ri bujqësor</u> .....	104
3.2.4.	<u>Mjedisi, trashëgimia natyrore dhe resurset, peizazhet, etj.</u> .....	108
	<u>Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban dhe rural</u> .....	108
	<u>Stimulimi i krijimit të ndërmarrjeve të reja</u> .....	110
3.3.	<u>Tregues të zonave urbane dhe zonave ndërtimore</u> .....	112
3.5.	<u>Vlerësimi socio-ekonomik dhe ndikimet në mjedis</u> .....	114
	<u>Parathënie</u> .....	114
	<u>Kategoritë mjedisore (dhe socio-ekonomike) të përfshira në fushën e vlerësimit</u> .....	115
	<u>Afatet kohore të shkurtra, të mesme dhe të gjata</u> .....	116
	<u>Parashikimi dhe vlerësimi i efekteve: teknikat</u> .....	116
	<u>Vlerësimi i ndikimit</u> .....	119
	<u>Propozimet e monitorimit</u> .....	130
4.	<u>STRATEGJITË E ZBATIMIT DHE VEPRIMET</u> .....	132
4.1.	<u>Strategjitë e zbatimit dhe planet e veprimit</u> .....	132
4.2.	<u>Vlerësimi i strategjive</u> .....	149
4.3.	<u>Afatet kohore, implikimet financiare dhe korniza institucionale</u> .....	150
	<u>Korniza kohore</u> .....	150

<u>Korniza institucionale financiare .....</u>	<u>153</u>
5. Dispozitat e zbatimit .....	158
5.1. Udhëzimet dhe kushtet .....	158
5.2. Kushtet e përcaktuara nga Qeveria lokale .....	158
<u>5.2.1. Kushtet për përcaktimin e zonave në territorin e komunës .....</u>	<u>158</u>
<u>5.2.2. Kushtet për rregullimin e hapësirës .....</u>	<u>160</u>
5.2.2.a. Ndërtesat me rëndësi për Kosovën.....	160
5.2.2.b. Zonat e ndërtimit për vendbanime .....	161
5.2.2.c. Strukturat e ndërtuara jashtë vendbanimeve.....	165
<u>5.2.3. Kushtet për krijimin e aktiviteteve ekonomike.....</u>	<u>166</u>
<u>5.2.4. Kushtet për vendosjen e aktiviteteve publike.....</u>	<u>166</u>
<u>5.2.5. Kushtet për vendosjen e korridoreve, zonave të komunikimit dhe sistemeve të tjera të infrastrukturës .....</u>	<u>167</u>
<u>5.2.6. Masat për mbrojtjen e peizazhit, vlerave natyrore dhe tërësive kulturore-historike</u>	<u>169</u>
<u>5.2.7. Mjetet që do të merren me mbeturina.....</u>	<u>171</u>
<u>5.2.8. Masat për parandalimin e dëmtimit të ndikimeve të mjedisit .....</u>	<u>171</u>
<u>5.2.9. Masat për parandalimin e ndikimeve negative social .....</u>	<u>173</u>
<u>5.2.10. Masat për zbatimin e planit.....</u>	<u>173</u>
5.2.10.a. Obligimet për hartimin e planit .....	173
5.2.10.b. Aplikim i masave të zhvillimit dhe masave të tjera.....	174
5.2.10.c. Rindërtimi i ndërtesave të destinacioneve që janë në kundërshtim me destinacionet e planifikuara .....	175
5.3. Dispozitat në lidhje me bashkëpunimin .....	179
5.4. Dispozitat mbi rendin kronologjik ose fazat e zbatimit .....	179
5.5. Elementet dhe udhëzimet për hulumtime të mëtejme.....	180
A. Fjalor.....	181
<b>1. Objektivat.....</b>	<b>184</b>
ANEKSI I:.....	205
ANEKSI II:.....	209

## Hyrje

Plani Zhvillimor Komunal (PZhK) është një nga instrumentet e planifikimit që është paraparë në Kosovë (Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 2003/14 dhe Ligji për Ndryshimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 03/L-106). Ky është një plan multisektorial, i cili i përcakton qëllimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror-social dhe hapësinor. Ky lloj sistemi i planifikimit bazohet në modele të planifikimit, të cilat tashmë janë aplikuar në vendet evropiane dhe më gjerë.

Territori është faktori kyç për krijimin e një vlere ekonomike dhe për të ndjekur një model zhvillimi të qëndrueshëm,. Prandaj, është e natyrshme që të konsiderohet si çështje kryesore në çfarëdo lloj politike të zhvillimit. Ky territor siguron bazën racionale ku takohen të gjitha strategjitë sektoriale, duke e përmirësuar cilësinë dhe duke rritur kohezionin social dhe qëndrueshmërinë e mjedisit.

Përgatitja e PZhK-së kërkon një qasje të integruar dhe shumëdisiplinare, në mënyrë që të rishqyrtohen çështjet që kanë të bëjnë me qarkullimin e njerëzve, trafikut dhe mallrave në qytet dhe më gjerë, mbrojtjes së burimeve të natyrës dhe peizazhin, si dhe të krijohen parakushtet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

PZhK-ja shtrihet në të gjithë komunën (zonën urbane dhe rurale) dhe zhvillohet me ndihmën e palëve të interesuara, si dhe autoriteteve të ndryshme lokale dhe shtetërore.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (Nr. 33 Pro. 29/03), përmbajtja dhe sekuenca e përgatitjes së PZhK-së është si më poshtë:

- A. Profili i zhvillimit hapësinor dhe analiza e situatës,
- B. Vizioni, parimet dhe qëllimet,
- C. Korniza e zhvillimit hapësinor komunal,
- D. Zbatimi i strategjive dhe veprimeve,
- E. Dispozitat e zbatimit.

Bazuar në kushtet e tenderit për përgatitjen e PZHk-së, të shpallur nga komuna e Prishtinës, më 19 qershor 2012, është angazhuar konsorciumi "Politecnica" nga Modena e Italisë dhe "A Design" nga Prishtina (në tekstin e mëtejshëm 'konsorciumi P&AD').

Nga sektori A "*Profili i zhvillimit hapësinor dhe analiza e situatës*", në këtë dokument do të prezantohet vetëm një sintezë. I gjithë procesi i hartimit të PZhK-së është bërë në konsultim me mbikëqyrësit e projektit dhe stafin komunal, si dhe me ekspertë lokalë kombëtarë.



Investues:	<b>KK Prishtinë</b>
Menaxhues:	<b>Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe e Mbrojtjes së Mjedisit</b>
Drejtor i DUNMM:	<b>Behxhet Musliu</b>
Kryesues i Kuvendit:	<b>Sami Hamiti</b>
Kryetar i Komunës:	<b>Prof.Dr. Isa Mustafa</b>
Hartues:	Konsorciumi Politecnica dhe <b>N.SH. A Design,</b>

Në Komisionin mbikëqyrës nga komuna kanë qenë të angazhuar:

- Muhamet Morina, menaxher,
- Besa Orana, mbikëqyrëse,
- Florije Mazreku, mbikëqyrëse.

Nga konsorciumi P&AD kanë qenë të angazhuar

- Fatima Alagna Menaxhere e projektit
- Bujar Demjaha Zv. menaxher i projektit
- Thorsten Lang Arkitekt
- Luljeta Demjaha Koordinatore e projektit
- Shkurta Pacolli Arkitekte
- M.Cristina Fregni Arkitekte
- Sandra Zoboli Eksperte e GIS
- Daniele Pini Profesor i planifikimit
- Giuseppe Imbesi Profesor i planifikimit
- Renzo Pavignani Ekspert i qëndrueshmërisë së mjedisit
- Micaela Goldoni Ekspert i trashëgimisë kulturore
- Paola Imbesi Arkitekt
- Richard Sansom Menaxhimi i burimeve ujore
- Shkëlqim Zeqo Ekspert i infrastrukturës
- Edgardo Tobino Implikimet financiare
- Marcello Gusso Energji
- Muhamet Sadiku Ekspert i ekonomisë
- Raif Bytyçi Ekspert i natyrës dhe mjedisit
- Jetmir Berisha Ekspert i infrastrukturës
- Skënder Bublaku Ekspert i ujit dhe kanalizimeve
- Vehbi Bresilla Ekspert i elektrikës
- Milot Berisha Ekspert i trashëgimisë kulturore
- Alisa Cangonja Asistente e projektit
- Blertë Bytyçi Arkitekte
- Valmira Ajeti Pasha Arkitekte

## 1. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR & ANALIZA E SITUATËS

---

### 1.1. Profili i gjendjes

#### 1.1.1. Informata përmbajtjesore mbi situatën gjeografike, fizike, mjedisore dhe socio-ekonomike

##### 1.1.1.1. Të dhënat bazë

Republika e Kosovës ndodhet në pjesën juglindore të Evropës, në qendër të Ballkanit me një sipërfaqe prej 10,908 km<sup>2</sup>. Në mungesë të regjistrimit të plotë të popullsisë që nga viti 1981, nuk ka vlerësime të sakta për popullsisë. Institucione të ndryshme, si Banka Botërore, e vlerësojnë popullsinë e Kosovës diku mes 1,9 dhe 2,2 milionë banorë me etni dhe përkatësi fetare të ndryshme. Në regjistrimin e vitit 2011, i kryer nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, ka rezultuar se popullsia rezidente e Kosovës është rreth 1,7 milion banorë. Por, për shkak se këtë regjistrim e ka refuzuar komuniteti serb si dhe të problemeve teknike në realizimin e këtij regjistrimi, të dhënat nga ky regjistrim duhet marrë me kujdes. Shumë subjekte kombëtare dhe ndërkombëtare kanë vënë në pikëpyetje besueshmërinë e këtij regjistrimi. Sipas Bankës Botërore, në një raport të përgatitur në lidhje me vlerësimin mjedisor të Kosovës, vlerëson se të dhënat nga ky regjistrim nuk janë mjaft reprezentative të gjendjes reale. Për shkak të ndryshimeve të mëdha të demografisë gjatë luftës në vitet 1998-1999, në Kosovë ka pasur zhvendosje të mëdha të popullsisë. Në rastin e Komunës së Prishtinës, nga regjistrimi del se Komuna e Prishtinës ka 198,897 banorë, ndërsa studimi i Bankës Botërore e nxjerr Komunën e Prishtinës me 471,630 banorë. Po ashtu, bazuar në të dhënat për shfrytëzimin e ujit të pijshëm, në vëllimin e mbeturinave urbane që krijohen në Prishtinë, pastaj numrin e orëve të energjisë elektrike, regjistrimet në listën e tatimit në pronë, etj., rezulton se Komuna e Prishtinës ka rreth 450 mijë banorë. Kjo rezulton se të gjitha planifikimet duhet të bëhen për këtë numër të banorëve, por edhe më shumë. Në fund të fundit fakti se trendi i rritjes së numrit të banorëve do të vazhdojë dhe se roli i Prishtinës të qenit Kryeqytet bën që procesin e planifikimit të bayohet në numrin e sipërpërmendur.

Kosova ka qenë një zonë ku kanë ndodhur shumë konflikte, gjë që është reflektuar në shkatërrimin e aseteve të vlefshme, profane dhe të shenjta. Megjithatë, ka një sërë lokalitetesh dhe monumentesh, të cilat duhet trajtuar dhe kujdesur në mënyrë adekuate.

Prishtina është kryeqyteti, dhe qyteti më i madh në Kosovë. Gjithashtu, është edhe qendra administrative e Komunës së njëjtë. Prishtina është e vendosur në koordinatat 42 ° 40 '0 "Veri dhe 21 ° 10' 0" Lindje. Sipërfaqja e Komunës së Prishtinës është rreth 523 km<sup>2</sup>. Shtrihet në planin morfologjik të Kosovës dhe përfaqëson një plan aluvial të mbuluar me sedimente të liqeneve, dhe nga ana gjeologjike është një depresion tektonik, i cili është ngritur gjatë ndryshimeve të Oligo-Miocene. Klima është kontinentale, me dimra të ftohtë dhe verëra të nxehta, me mesatare të reshjeve prej 600 mm për vit.

Prishtina është gjithashtu qendra më e madhe ekonomike, administrative, edukative dhe kulturore në Kosovë. Ndodhet pranë aeroportit, hekurudhës, dhe pothuajse të gjitha rrugëve kryesore që kalojnë nga Komuna e Prishtinës. Autoudha "Ibrahim Rugova" e planifikuar, kalon përgjatë territorit të Prishtinës.

Në terma administrativë, komuna i ka 33 vetëqeverisje lokale, duke përfshirë edhe qytetin e Prishtinës. (Sipas Statutit të Komunës)

Shumë lokalitete arkeologjike në rajonin e Prishtinës vërtetojnë ekzistencën e vendbanimeve prej kohëve parahistorike. Në kohën e Perandorisë Romake, Prishtina ishte një kryqëzim i rrugëve të rëndësishme që lidhnin Evropën Qendrore me Ballkanin Jugor, Juglindor dhe Jugperëndimor.

Ashtu si edhe qendrat e tjera urbane të Perandorisë Romake, Prishtina kishte një infrastrukturë urbane, sistem të ujësjellësit, sistem të kanalizimit, infrastrukturë rrugore, sheshe, monumente, teatër, bazilikat<sup>1</sup>, etj. Gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, Evila Çelebiu konfirmon se në vitin 1660, "Qyteti ka 2060 shtëpi të ndërtuara me material të fortë dhe të mbuluara me qeramikë. Këto janë shtëpi të mëdha me oborre, vreshta dhe dru frutor". Prej asaj kohe, qyteti gradualisht u zhvillua pavarësisht rënieve e ngritjeve të herëpashershme. Prishtina shënon një rritje domethënëse në shekullin XIX, kur kishte 12,000 banorë dhe krahasohej me banorët e tjerë në rajon. Zhvillimet vazhduan edhe në gjysmën e dytë të shekullit XIX, pavarësisht nga zjarret apo lufta kundër Perandorisë Osmane (1877-78). Fundi i shekullit XIX shënoi një zhvillim të veçantë, ku erdhi influenca e kulturës evropiane, kryesisht nga Italia dhe Austria. Hekurudha, shtypshkronja, dhe aktivitete të tjera sociale e ekonomike, e bënë Prishtinën një qytet të rëndësishëm në Kosovë dhe rajon, edhe në fillim të shekullit XX.

Ndryshimet politike dhe administrative pas Luftës së Dytë Botërore krijuan një bazë solide për zhvillimet sociale-ekonomike që u reflektua në përkufizimin urban të Prishtinës. Zhvillimet e viteve të 50-a e 60-a, u bazuan në paradigmen e rritjes së diferencës rurale-urbane, që shkaktoi migrim domethënës të popullsisë nga zonat rurale dhe qytetet e tjera të Kosovës në Prishtinë. Ky proces pothuajse kurrë nuk u ndal, duke u intensifikuar pas luftës së viteve 1998-99.

Zhvillimi ekonomik, industria bazike dhe ajo përpunuese (energji elektrike, gërmimet, industria e tekstit, përpunimi i ushqimit, etj.) dhe zhvillimet e përgjithshme socio-ekonomike e pozicionuan Prishtinën mes qendrave më të rëndësishme në Kosovë dhe pothuajse në çdo aspekt, duke e kthyer atë në një vend tërheqës dhe dinamik për të jetuar e punuar, jo vetëm për kosovarët por edhe për njerëzit e tjerë në rajon.

### **1.1.1.2. EKONOMIA DHE SHOQËRIA**

#### ***Struktura demografike dhe karakteristika të përgjithshme***

Dyshimi rreth të dhënave dhe mungesa e informacioneve më të detajuara nuk na lejon që të prezantojmë strukturën demografike përmes grup-moshave, aktiviteteve ekonomike, duke përfshirë rritjen natyrore, lindshmërinë dhe shkallën e mortalitetit. Megjithatë, mund të bëhen disa komente.

Me shkatërrimin e shumë shtëpive gjatë luftës së fundit, popullsia e Prishtinës u rrit për shkak të zhvendosjes së banorëve nga këto vende të ndryshme në Prishtinë. Kjo lëvizje demografike shkaktoi presion dhe ngarkoi infrastrukturën sociale, e cila edhe ashtu ishte e shkatërruar nga mungesa e investimeve për shumë vite. Rritja e popullsisë shkaktoi vështirësi në ofrimin e shërbimeve publike, si në shëndetësi, furnizimi me ujë dhe energji, etj. Sipas rezultateve preliminare të popullsisë<sup>2</sup>, vendbanimeve, dhe regjistrimeve të ekonomisë, Kosova ka 1.739.825 banorë, 293.070 ekonomi familjare dhe 403.459 njësi të banimit. Ndërkaq, në territorin e Komunës së Prishtinës janë regjistruar 198.897 banorë, 40.292 ekonomi familjare dhe 58.849 njësi të banimit. Prej këtyre, vetëm në pjesën rurale të Prishtinës janë 55.000 banorë, 9.700 ekonomi

<sup>1</sup> Këshilli Ekzekutiv i Asamblesë së Komunës së Prishtinës (1987) Plani i Përgjithshëm Urban 2000, (f.15)

<sup>2</sup> REKOS 2010, Rezultatet përfundimtare, shtator 2012

familjare dhe 15.300 njësi të banimit. Nga pikëpamja e madhësisë së vendbanimeve, ka një përqendrim në disa fshatra më të mëdha (Çagllavicë, Kolovicë, Barilevë, Nëntë Jugoviçët dhe Prugovc), në të cilat jeton gjysma e popullatës rurale të Komunës së Prishtinës. Nga numri i përgjithshëm i popullsisë në Prishtinë, në bazë të regjistrimit të fundit, gjithsej janë 198.897 banorë, prej tyre 49.8% janë meshkuj dhe 50.2% femra.

Megjithatë, ky regjistrim besohet se nuk është i saktë për disa arsye. Sipas regjistrimit të fundit valid, që është bërë në vitin 1981, Prishtina kishte rreth 182,000 banorë, dhe në atë kohë Prishtina kishte sipërfaqe – vendbanime gati sa gjysma e sipërfaqes aktuale.

Në Komunën e Prishtinës jetojnë më shumë se 30,000 banorë të komunave të tjera që punojnë në institucione publike, ku shumica e tyre banon në Prishtinë, së paku gjatë ditëve të punës dhe si rezultat krijojnë ngarkesë për shërbimet publike të Prishtinës. Fëmijët e tyre ndjekin shkollat në Prishtinë. Gjithashtu, qendrat e mjekësisë familjare ofrojnë shërbime primare shëndetësore.

Të dhënat nga ky regjistrim nuk përputhen me të dhënat e energjisë së shpenzuar, furnizimit të ujit, regjistrimin e veturave dhe të mbledhjes së mbeturinave, të cilat sugjerojnë që numri i banorëve të Prishtinës të jetë rreth 450 mijë.

Nëse krahasohet ky numër prej rreth 450 mijë banorëve dhe numri i dalë nga regjistrimi i popullsisë prej 198 mijë banorëve, atëherë rezultojnë se një numër i madh i banorëve punon dhe jeton në Prishtinë, por nuk janë të regjistruar.

Me një rritje mesatare vjetore prej 1.5% në vit, rezultojnë se, Prishtina në vitin 2022 do të ketë, vetëm nga shtimi natyror i popullsisë, edhe rreth 72 mijë banorë të tjerë. Me trendin aktual të migrimit, bazuar në rritjen e popullsisë në Prishtinë pas vitit 1999 duke përjashtuar shtimin natyror, rezultojnë se deri në vitin 2022 do të ketë edhe rreth 100 mijë banorë që do të migrojnë në Prishtinë. Kështu që në total, në vitin 2022 Prishtina pritet të ketë rreth 622 mijë banorë.

Një fenomen i rëndësishëm i lidhur me popullsinë është migrimi nga zonat rurale në ato urbane brenda territorit të Komunës së Prishtinës. Kjo lëvizje mendohet se vjen kryesisht për shkak të mundësive më të mëdha për punësim në zonat urbane, si qasje më e mirë në shërbimet publike në përgjithësi. Ky lloj urbanizimi që ka përfshirë jo vetëm Prishtinën, por të gjitha qytetet e Kosovës, është një sfidë për ofrimin e shërbimeve publike adekuate.

Me këtë fenomen ose me të njëjtin problem lidhur me numrin më të madh të banorëve në raport me regjistrimin, merren të gjitha kryeqytetet në rajon dhe më gjerë.

Sipas instituteve të vlerësimit, në Kosovë grup-mosha dominante është 15-64 vjeç (60%) dhe 0-14 vjeç (33%)<sup>3</sup>. Sipas këtyre shënimeve, Kosova e ka popullsinë më të re në Evropë.

Ndryshimet demografike dhe shoqërore që kanë ndodhur në Kosovë në vitet e fundit, mendohet se kanë rezultuar në dobësimin e lidhjeve tradicionale familjare. Shpërndarja e ekonomive familjare është si në vijim: 18.5%, janë ekonomi familjare me më shumë se 7 anëtarë, 34.9% janë me nga 5-6 anëtarë, 42.4% janë me 2-4 anëtarë, dhe pjesa e mbetur prej 4.2%, janë me një anëtar të vetëm.

3 Ministria e Shëndetësisë, (2009), Strategjia sektorale e Shëndetësisë 2010-2014, Prishtina.

## **Çështjet e zhvillimit social**

Papunësia mbetet sfida më e madhe për zhvillimin e Kosovës. Niveli i papunësisë në Kosovë, sipas shumicës së studimeve të bëra deri më sot, është rreth 45%. Edhe komuna e Prishtinës ka një numër të lartë të të papunëve. Papunësia e Prishtinës përbën 7% të papunësisë së Kosovës. Është një disproporcion domethënës mes ofertës dhe kërkesës në tregun e punës në nivel kombëtar. Ekziston një kërkesë e lartë për punësim nga punëtorë të pakualifikuar (60% deri në 69%) dhe nga ata që kanë përfunduar vetëm shkollimin e mesëm të lartë. Kjo e bën gjendjen akoma më të brishtë për një periudhë të gjatë kohore. Grup-mosha 25-39 vjet përbën rreth 60% të të papunëve në Komunën e Prishtinës.

Element tjetër i vlerësimit të situatës është mungesa e politikave aktive të punës si dhe mospërputhja mes kërkesës për punë, të krijuar nga institucionet edukative dhe kërkesat për punë, të gjeneruara nga bizneset vendore dhe të huaja. Gjeneratat e reja, meqë nuk po arrijnë të integrohen në tregun e punës, detyrohen të merren me aktivitete joformale ekonomike apo të emigrojnë.

Gjendja e vështirë sociale tregohet edhe nëpërmjet indikatorit të varfërisë dhe varfërisë ekstreme. Niveli i varfërisë mbetet i lartë dhe konstant për një kohë të gjatë. Nga pikëpamja e pjesëmarrjes/kontributit të komunës së Prishtinës në nivelin e varfërisë shtetërore, ka një rënie në pjesëmarrje prej 23.1% (2002/03) në 19,8% (2005/06). Sipas raportit të Bankës Botërore mbi vlerësimin e varfërisë në 2009, varfëria në rajonin e Prishtinës ishte 21.8%, varfëria ekstreme 9.0% dhe në nivelin kombëtar 34.5%, përkatësisht 12.1%. Në këtë gjendje të brishtë sociale, Komuna e Prishtinës e ndjen detyrimin për të ofruar ndihmë sociale. Në 2011/2012 më shumë se 2,700<sup>4</sup> familje janë përfshirë në skemën<sup>5</sup> e ndihmës sociale (ose 7.7% e të gjitha familjeve që marrin ndihmë sociale në Kosovë).

### **Trendet e sektorit të ekonomisë**

Përveç se një qendër administrative e Kosovës, Prishtina mbetet qendra më e fuqishme e biznesit në Kosovë, me 24.6% të bizneseve të regjistruara. Në 2011-n, Komuna e Prishtinës kishte rreth 28.000<sup>6</sup> biznese të regjistruara, që tregon një shpirt domethënës të ndërmarrësisë, prej të cilave 2.545 në zonat rurale, përkatësisht 10% e totalit.

Si rezultat i vonësës gjatë tranzicionit, edhe Prishtina është përballur me fenomenin e de-industrializimit. Në periudhën e pasluftës, si rezultat i vonësës së privatizimit të këtyre ndërmarrjeve shoqërore, shumica e tyre pësuan humbje të tregjeve dhe zvogëlim të punësimit ose bankrotim total. Aktualisht, te bizneset e regjistruara ka një pjesëmarrje të vogël të kompanive nga sektori i industrisë së prodhimit (9.1% deri në 7.1%). Pjesëmarrja e agrikulturës është 1.2%, gjë që është e ulët, duke pasur parasysh pyjet dhe potencialin rural dhe të tokës që ka komuna. Kjo gjendje e zhvillimit rural reflektohet në nivelin e ulët të turizmit rural. Kohëve të fundit është një lëvizje në organizimin e turizmit rural. Kjo do të ndikojë në përmirësimin e infrastrukturës rurale në përgjithësi.


<sup>4</sup> Në Kosovë në 2011-n u përfshinë më shumë se 35,000 familje me 182,000 anëtarë të familjes në skemën e asistencës sociale.

<sup>5</sup> Raporti vjetor për Prishtinën, Komuna e Prishtinës, 2012

<sup>6</sup> Sipas informatave të MTI-së

### 1.1.1.3. NATYRA DHE MJEDISI

Në territorin e Komunës së Prishtinës dominon një peizazh malor që përfshin lindjen, verilindjen dhe juglindjen, ndërsa territori perëndimor i komunës shtrihet në rrafshin e Kosovës. Ujërat që e karakterizojnë këtë rajon janë: Liqeni i Badovcit, Lumi Llap, Prishtevka, dhe Vellusha. Por edhe Liqeni i Badovcit, pyjet, mineralet dhe tokat bujqësore duhet të konsiderohen si burime natyrore me potencial për zhvillim.



Harta.1. Shfrytëzimi i tokës

Në përgjithësi, gjendja e natyrës dhe e mjedisit në zonën rurale të Kosovës, por edhe e Prishtinës, vlerësohet më e mirë sesa ajo urbane. Edhe në këtë zonë sistemi i menaxhimit të mjedisit si uji, ajri, toka, mbeturinat dhe përgjithësisht kujdesi për natyrën, ka nevojë të përmirësohet duke përcjell përvojat evropiane.

#### **Gjendja e mjedisit**

Kosova, si edhe shtetet e tjera në rajon, përballet me ndotje mjedisore dhe degradim të mjedisit. Rëndësia e kësaj çështjeje trajtohet në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr. 2003/1), në Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe në shume dokumente të tjera obligative, strategji të ndryshme, etj.

Gjendja e keqe e Termocentraleve A dhe B paraqet rrezikun më të madh për ndotjen e mjedisit të Komunës së Prishtinës, edhe pse këto termocentrale nuk ndodhen në territorin e saj. Duke u bazuar në të dhënat meteorologjike të marra nga Instituti Hidrometeorologjik në Prishtinë, era dominuese është ajo që fryn nga drejtimi veriperëndim-juglindje. Për këtë arsye shpërndarja e ndotjes bëhet 90% në drejtim të verilindjes dhe jo drejtpërdrejt në qytetin e Prishtinës.




Fig.1. Trëndafili i erërave

**Cilësia e ajrit** monitorohet në Kosovë (Prishtinë) nga institucionet shtetërore (HIK, NIPH, dhe INKOS) dhe nga operatorët ekonomikë me impakt në cilësinë e ajrit. Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë nuk është akoma i plotë. Një stacion automatik për monitorimin e cilësisë së ajrit është i vendosur në oborrin e HIK-së në Prishtinë. Me këtë aparat analizohen nivelet për: SO<sub>2</sub>, PM<sub>10</sub>, NO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, CO dhe O<sub>3</sub>. Ndotja e ajrit, siç raportohet nga Komuna e Prishtinës, është kryesisht prezente në zonën urbane të qytetit dhe pjesërisht në atë rurale në drejtim të Obiliqit dhe Fushë-Kosovës, ku ndikimi i KEK-ut është më se i dukshëm. Zona rurale dominohet kryesisht nga kodra malore, prandaj edhe cilësia e ajrit është më e mirë. Një çështje specifike e ndotjes së ajrit në zonën jurbane është tymi që vjen nga oxhaqet, djegia e mbeturinave për shkak të papërgjegjësisë së individëve, tymi nga automjetet e vjetra dhe tymi që lirohet nga djegia e sipërfaqeve bujqësore pas korrjes së të lashtave.




Harta 2. Rrjeti i kanalizimit

Qasja në ujë të pijshëm është e pjesshme. Ndotja e ujit është një çështje shqetësuese në tërë Kosovën, e në vendbanimet rurale në veçanti, ku përfshihen vetëm 25% e fshatrave. Ndotja e ujit si pasojë e mungesës së infrastrukturës së përshtatshme, është problem sidomos në lagjet e reja të paplanifikuara. Kanalizimet derdhen drejtpërdrejt nga vendbanimet në mjedis në ndonjë gropë, për të kaluar pastaj në ndonjë përroskë apo lumë.

Disa sisteme të kanalizimit në disa fshatra janë ndërtuar nga vetë banorët dhe shpesh derdhen pa ndonjë mbikëqyrje dhe larg standardeve të dëshiruara. Ndotja e ujit shkon përtej vlerave

maksimale të lejuara dhe disa lumenj si Prishtevka, janë transformuar në mbledhës të ujërave të ndotura.



Harta 3. Degradimi i tokës

Faktorët kryesorë që shkaktojnë humbje të tokës në Kosovë dhe në Komunën e Prishtinës janë:

- Zgjerime të përhershme të vendbanimeve -ndërtime
- Zhvillime të industrisë dhe mbeturina të krijuara nga këto lloj zhvillimesh, gërmime, etj.
- Ndërtime të rrugëve dhe autoudhave,
- Mbeturinat e ekonomive familjare dhe gropat e mbushura me mbeturina,
- Erozioni,
- Gërmime të pakontrolluara.

Tokat bujqësore në periferi të Prishtinës po transformohen në tokë ndërtimore. Në zonat me ndotje të ajrit, pritet që kjo ndotje të transformohet nga ajri në tokë, pasi reshjet tretin ndotjen e ajrit dhe e depozitojnë në tokë. Në këtë rast pluhuri (që përmban acid), SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub>, e kthejnë shiun në shi acid. Shumica e shirave kanë një nivel mesatar të aciditetit për shkak të CO<sub>2</sub> në atmosferë.

**Zhurma** është një ndodhi tjetër shumë e zakonshme në zonat urbane, ndërsa në ato rurale është më pak prezente, përveç aty ku kalojnë rrugët. Sipas matjeve të bëra nga INKOS, në Prishtinë janë gjithsej 3 vende ku tregohet se niveli i zhurmës është më i lartë sesa limiti i lejuar.

**Menaxhimi i mbeturinave** bëhet nga Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A., që mbulon zonën urbane dhe 12 fshatra të komunës. Nuk ka ndarje të mbeturinave mes zonave urbane dhe rurale të Prishtinës. Nuk ka mbledhje të selektuar të mbeturinave, megjithëse kohëve të fundit po bëhen përpjekje që të implementohet ky sistem në disa zona të caktuara të qytetit. Sasia vjetore e mbeturinave që mbledhet nga Kompania Rajonale “Pastrimi” Sh.A. është 1478.80 tonë/vit (mbeturina sanitare) dhe 4,604 tonë/vit (mbeturina josanitare), të cilat përbëjnë një total prej 87,267 tonë/vit (duke iu referuar vitit 2012). Një problem specifik mjedisor paraqitet nga gropat




josanitare, si ajo Marec 1 dhe Marec 2 deri te Përroi i Djaloshit – miniera e Artanës, që janë gropa të mbushura me metale të rënda në sipërfaqe prej 2,38 ha<sup>7</sup>.

## Natyra

Në Komunën e Prishtinës dominon relievi kodrinor-malor që përfshin lindjen, verilindjen dhe juglindjen e komunës, ndërsa në pjesën perëndimore është një rrafsh me nivel mbidetar 535-580 metra dhe shtrihet në Rrafshin e Kosovës. Kodrat janë me pjerrtësi më të ulët, përveç lindjes ku pjerrtësia është relativisht më e madhe.

Peizazhi natyror i territorit është i ndryshueshëm dhe i paeksploruar. Prerja dhe djegia e drurëve, dëmtimi i shtretërve të lumenjve për gjermimin e rërës, hedhja e mbeturinave si dhe fenomeni i erozionit, rrezikojnë këto burime nga degradimi i resurseve natyrore. Liqeni i Badovcit, i cili shtrihet pjesërisht në juglindje të Prishtinës, u ndërtua në vitin 1960 me qëllimin e ofrimit të ujit të pijshëm për Prishtinën, si dhe ujë për Minierën e Kishnicës. Liqeni përdoret gjithashtu edhe për peshkim.

Vlerë e veçantë natyrore e Komunës së Prishtinës konsiderohet Parku rajonal natyror Gërmia. E vendosur në verilindje të Kosovës, Prishtina mbulon një sipërfaqe prej 111.05 km<sup>2</sup>. Gjeomorfologjia e kësaj zone është e strukturuar nga kodra me lartësi të ndryshme.



Harta 4. Burimet natyrore

Kompleksiteti i biotopeve natyrore të Gërmisë ofron kushte të mira për një sërë specimesh. Kuvendi Komunal i Prishtinës, vendosi të marrë nën mbrojtje Parkun e Gërmisë, si një park natyral. Me këtë vendim e mbron zonën që ka një sipërfaqe prej 1.126.01.00 ha. Parku menaxhohet nga NPL "Hortikultura" Sh.A., ndërsa monitorimi profesional është bërë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Për shkak të bukurive natyrore, vlerave burimore dhe estetike natyrore të cilat janë me rëndësi kulturore – arsimore, shkencore dhe turistike – rekreative kësaj zone i është kushtuar përkujdesje ligjore qysh më herët. Territori i Gërmisë me vendimin nr 01-12035 të datës 31 maj 1966 (GZK nr.32/66) përcaktohet si zonë me destinim të veçantë "Pyje dhe Piknik" për të krijuar kushte të volitshme për pushim dhe zhvillim të turizmit, duke përfshirë pjesë të maleve në krahun e djathtë të liqenit të Badovcit (malet nga rajonet e Zonave Kadastrale si Novo Sele, Zllatar, Ajvali, Mramor dhe Komunën e Gracanices).

Masivi i Gërmisë si tërësi ngërthen në vete vlera natyrore, peizazhore të biodiversitetit etj. gati të ngjashme me pjesën tjetër të mbrojtur të Parkut të Gërmisë dhe si e tillë në të ardhmen duhet të merret nën mbrojtje e tërë sipërfaqja e saj së bashku me liqenin e Badovcit.

Në Planin Hapësinor të Kosovës 1980-2000 territori i Gërmisë në kuptim të gjerë me liqenin e Badovcit është paraparë vend i përshtatshëm për pushim dhe vikend.

<sup>7</sup> Burimi: Kompania "Pastrimi" Veprimet dhe biznesi plani 2012

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës Nr. 01.330-659 të datës 29.12.2005 dhe statutit të ndërmarrjes Publike Komunale "Hortikultura" në Prishtinë të aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës nr. 110-267 të datës 30.05.2006 autorizohet Ndermarrja Publike Komunale "Hortikultura" në mirëmbajtjen, qeverisjen dhe sigurimin e parkmaleve si: Parku Rajonal Natyror "Gërmia", Kompleksi i park maleve "Kerpa – Kravrice si dhe Kompleksi "Katundi i ri" (Novo Sellë), të cilat janë vënë në mbrojtje të posaqme nga Komuna e Prishtinës në vitin 1966.

Me qëllim të ruajtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të vlerave të natyrës dhe biodiversitetit në masivin e Gërmisë dhe më gjerë, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës propozon zgjerimin e sipërfaqes së Parkut të Gërmisë duke përfshirë gjithë masivin e Gërmisë dhe Liqenin e Badovcit, ndërrimin e kategorisë së zonës së mbrojtur nga Park Regjional, e cila si e tillë nuk ekziston në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, në Park të Natyrës dhe hartimin e Planit Hapësinor dhe Planin e Menagjimit për Parkun e Gërmisë.

Duke qenë se Parku i Natyrës sipas IUCN-it i takon kategorisë së V-të të mbrojtjes e cila synon një menagjim të kujdesshëm në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e ekosistemeve dhe peisazheve, IKMN-ja vlerëson se kjo do të ishte zgjedhje adekuate për ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të kësaj zone me vlera të veçanta natyrore jo vetëm për Komunën e Prishtinës.

Potencial natyror për zhvillim janë edhe tokat bujqësore, pyjet dhe mineralet. Pyjet ekzistuese mund të merren në konsideratë për të qenë në funksion të mjedisit njerëzor, por nuk janë të gjitha të vlefshme për industrinë e drurit. Për më tepër, eksploatimi sistematik i pyjeve për djegie i ka dëmtuar seriozisht ato.

Sa i përket rreziqeve të natyrës, nuk ka ndonjë rrezik për t'u theksuar. Era, bora, akulli dhe elementet e tjera kanë impakt të kufizuar për jetën e qytetit, dhe pak më shumë në zonat rurale dhe malore. Më shumë problematike duket se është thatësia, një kërcënim për të mbjellat bujqësore dhe furnizimit me ujë gjatë sezonit të verës, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht, kur temperaturat janë më të larta dhe reshjet e shiut janë të rralla. Përmbytjet janë një fenomen bazik, i cili kërkon vëmendje të veçantë. Përmbytjet ndodhin në sezonat e vjeshtës dhe pranverës në lokacionet e lumenjëve dhe përroskave dhe ato shkaktojnë dëme të konsiderueshme ekonomike, sëmundje, ndotje të mjedisit, etj.

#### **1.1.1.4. TRASHËGIMIA KULTURORE**

Deri tani janë identifikuar 45 lokalitete arkeologjike dhe monumente, që për momentin ndodhen në listën e përkohshme të lokaliteteve dhe monumenteve arkeologjike që janë nën mbrojtjen e shtetit. Kjo listë përfaqëson vetëm një pjesë të vogël të trashëgimisë së pasur kulturore që gjendet gjatë gërmimeve që bëhen në të gjithë vendin.

Punët e mëparshme arkeologjike sugjerojnë se kjo është një zonë me domethënie të madhe arkeologjike. Puna në terren e bërë në rajonin e Prishtinës tregon shenja të okupimit neolitik, të dhëna të cilat janë regjistruar dhe listuar në vendet përkatëse kompetente.

Duke marr parasysh të gjitha dokumentet dhe të dhënat, shihet që rreth Komunës së Prishtinës ka burime arkeologjike..

Zhvillimet e kohëve të fundit dhe ato të së ardhmes bashkë me industrializimin e Komunës së Prishtinës, mund të kërcënojnë në mënyrë direkte ose indirekte lokalitete të panjohura, monumente, struktura e elemente të cilat mund të ndryshojnë të ardhmen e burimeve arkeologjike të këtij rajoni. Për më tepër, është shumë e mundur që zhvillimi do të ndikojë në burimet e

mundshme arkeologjike, prandaj rekomandohet që të merren veprime parandaluese për ruajtjen e materialeve me vlerë arkeologjike që zbulohen gjatë gërmimeve për ndërtimet e reja. Këto masa mbrojtëse janë të domosdoshme sidomos kur kemi të bëjmë me lokalitete të ndjeshme parahistorike dhe materiale të brishta arkeologjike.

Data baza e trashëgimisë kulturore të Kosovës në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ofron një listë të lokaliteteve, si dhe jep njohuri mbi kronologjinë e këtyre lokaliteteve, modeleve të vendbanimeve, dhe përdorimit të tokës prej kohëve parahistorike deri në periudhën e Mesjetës.

Për sa i përket zonës urbane, bërthama historike e Prishtinës ka një numër ndërtesash interesante dhe monumente historike (të shenjta, profane dhe të kategorisë utalitare) të një përzierje mes influencës osmane veçanërisht në formë, përbërje dhe dekorim, dhe nga ana tjetër karakteristikat e stilit që është një përzierje e arkitekturës lokale. Mund të themi se “Ndërtesat përmbajnë po aq evidencë e informacion sa dokumentet”.

Të dhënat ekzistuese të vlerave të trashëgimisë kulturore janë mbledhur dhe shënuar nga puna e mëparshme, hulumtimet që janë bërë nga institucionet kompetente dhe specialistët e Muzeut të Kosovës, Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, Institutit Rajonal të Prishtinës për Mbrojtjen e Monumenteve si dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës.

#### **1.1.1.5. VENDBANIMET DHE CILËSIA E JETËS**

##### ***Karakteristikat e vendbanimeve***

Sipërfaqja e komunës është rreth 523 km<sup>2</sup>, prej të cilave 60 km<sup>2</sup> i takojnë zonës urbane të komunës. Nga i gjithë territori i komunës, 20.358 ha janë tokë bujqësore, prej të cilave 14.000 ha janë tokë e kultivuar, ndërsa pjesa tjetër kullosë. Rreth 30.000 ha janë përcaktuar si pyje.

Sipas regjistrimit të fundit në Kosovë, numri i përgjithshëm i njësive të banimit në Komunën e Prishtinës është 59,503 njësi. Dendësia e strukturës urbane mund të llogaritet në bazë të fotografive satelitore të gjeoreferencuara dhe të dhënave të regjistrimit. Të dyja janë prodhuar në 2010-n, prandaj mund të konsiderohen si koherente. Implementimi i planeve të deritanishme është realizuar shumë ngadalë ose fare, por mund të konstatohet që kapacitetet momentale sillen rreth 301.000 banorë.


#### Analiza e kapaciteteve te banimit ne Komunen e Prishtines

	Banim kolektiv	500ba/ha
	Banim individual	150ba/ha
Lagjet	Banim kolektiv	Banim individual
Lakrishte	7000	
Ulpiana	19000	300
Dardani	25000	
Kalabri	2000	18000
Pejton	2000	1500
Muhaxhere	3000	7500
Arberia	4000	3000
Sofali		20000
Medrese		10000
Dodona	2200	2500
Mati 1	4000	20000
Tjera	10000	140000
<b>TOTALI</b>	<b>78200</b>	<b>222800</b>
	<b>Totali - banim kolektiv dhe banim individual</b>	<b>301000</b>


Në zonat rurale në periferi të pjesës urbane (Matiçan, Hajvali, Çagllavicë, Kolovicë, Sofali, Zllatar, etj.) dendësia është rreth 7 njësi banimi për hektar, dhe një dendësi të popullsisë prej 35 banorë për hektar. Zona kadastrale më e madhe e komunës është ajo e Prishtinës dhe ndodhet në sipërfaqet e konsoliduara dhe ato në transformim e sipër.

Disa nga këta indikatorë ndryshojnë shumë nga standardet e qyteteve të tjera. Mesatarja e sipërfaqes për jetesë në shumë qytete është 11 m<sup>2</sup> për person. Kryeqytetet baltike e kanë mesataren nga 23 deri në 18, Lubjana 26, Zagreb 23 m<sup>2</sup>.


Duke u bazuar në zhvillimin historik të Prishtinës, mund të shohim se qyteti është zgjeruar në të katër anët, me një theksim më të fortë në pjesën jugperëndimore dhe veriore të komunës.



1914-1936




1937-1952



1952 – 1980



1980-2000



*Harta 5. Rritja urbane e Prishtinës*

Në territorin e Komunës së Prishtinës mund t'i vërejmë tri struktura të vendbanimeve: pjesa e vjetër e qytetit, e ndërtuar deri në Luftën e Dytë Botërore, kur qyteti kishte pamjen e një “kasabajë”, pjesa e “re” nga viti 1945 deri 1989, gjatë periudhës së socializmit, dhe vendbanimet e shpërndara pas 1999-s, kur Prishtina pati transformime në proporcione të jashtëzakonshme. Derisa disa lagje ekzistuese të Prishtinës janë menaxhuar në mënyrë të tillë që mbajnë strukturat volumetrike që i kanë, disa të tjera janë ndryshuar në mënyrë drastike nga ndërtimet e paplanifikuara dhe pa kriter, që e kanë shkatërruar peizazhin. Disa burime tjera për ndryshimin e peizazhit kanë qenë shkatërrimi i një pjese të qendrës historike dhe procesi i mbulimit të pjesëshëm të lumenjve Prishtevka dhe Vellusha, që u shndërruan në mbledhës të kanalizimeve. Zhvillimet spontane kanë rezultuar me hyrje (porta) jo mjaft të definuara në qytet. Në veçanti hyrja në pjesën veriore duhet të trajtohet me kujdes, qoftë me konsolidimin e fasadave në rrugën “Vëllezërit Fazliu” apo në gjithë pjesën e Prishtinës-VERI.

Lagjet e urbanizuara janë kursyer nga presioni i ndërtesave (Ulpiana, Dardania, Lakërishtja dhe Bregu i Diellit). Pavarësisht disa mangësive, në vitet e fundit kemi parë zhvillime pozitive në disa lagje si, Arbëria dhe Emshiri, të cilat janë duke u zhvilluar sipas planit të destinimit – ndërtesa për banim kolektiv dhe biznes. Lagjet si Taslixhe, Arbëria 1 dhe Arbëria 3, e kanë ruajtur strukturën e banimit dhe kryesisht mbizotërojnë shtëpitë individuale.

Lagjet si Kodra e Trimave, Lagjja e Muhaxherëve, Kolovica, Tophana, etj., kanë qenë vazhdimisht në kushte të vështira infrastrukture dhe ekonomike. Rrugë të ngushta dhe disa vende të parregulluara, me linja të energjisë elektrike të mbingarkuara, materiale të dobëta ndërtimi, dendësia e shtëpive (shtëpi të vogla me shumë banorë), mungesa e infrastrukturës sociale, etj, kanë bërë që këto lagje të ngecin në përmirësimin e standardit të jetës. Planet rregulluese që janë përgatitur ose janë në përgatitje e sipër për këto lagje, pritet të ndikojnë në përmirësimin e standardit të jetës në këto lagje.



Çfarë densiteti do të ketë Prishtina në të ardhmen?  
Vendbanimet dhe standardi i jetës

Trendë domethënës për zhvillimin urban mund të gjenden veçanërisht në pjesën jugore të Prishtinës, ku komuna po zhvillon planet rregulluese për “Prishtinën e Re”. Zhvillimet spontane të zonës ekonomike, “Fshati Ndërkombëtar”, disa ndërtesa të tjera (Presidenca, Pallati i Drejtësisë, etj.), si dhe ndërtesat e tjera me leje, janë karakteristikë e kësaj pjese të qytetit. Gjithnjë e më shumë banorë kërkojnë objekte luksoze, me sipërfaqe më të mëdha dhe me oborr. Investitorët dhe ndërtimtarët janë duke iu përgjigjur pozitivisht këtyre kërkesave.

Në zonat rurale, vendbanimet karakterizohen me shkollë, objekte fetare, ambulancë, disa dyqane dhe varreza në periferi. Në shumicën e rasteve këto përmbajtje përfaqësojnë elementet e siluetës dominante në arkitekturë.

Zonat urbane kanë një dendësi më të lartë të banesave kolektive, ndërsa në zonat rurale ka kryesisht banesa individuale. Në dekadën e fundit kanë ndodhur lëvizje të shpejta të ndërtimeve të banesave kolektive, që pothuajse e kanë dyfishuar numrin e banorëve që jetojnë në ndërtesa shumëkatëshe. Mungesa e planeve rregulluese në disa lagje, dhe sidomos presioni nga kërkesa e qytetarëve për të zgjidhur çështjen e banimit, shpesh ka rezultuar me ndërtime të paplanifikuara dhe pa leje si dhe me cilësi të dobët.

### **Standardet jetësore dhe objektet**

Zhvillimi njerëzor varet nga tre faktorë kryesorë që ndryshojnë në proporcion me ndryshimin e nevojave njerëzore, që janë arsimit, shëndeti dhe qasja në burimet publike dhe private, të cilat janë të domosdoshme për të bërë një jetë normale. Në Kosovë prej vitit 2000 ka filluar të aplikohet një sistem i ri i edukimit sipas ISCED 97, duke e bërë Kosovën të përshtatshme me vendet e BE-së. Megjithatë, ka diferenca të mëdha në nivelin e edukimit mes zonave urbane dhe rurale si dhe mes gjinive e grupeve etnike. Mësimi zhvillohet në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe turqisht. Në arsimin parafillor, ka një rrjet të zhvilluar të instituteve parashkollore (8 institucione publike dhe 1 publiko-privat), ndërsa 40 janë institucione parashkollore private të palicencuara. Shkollat fillore në Komunën e Prishtinës janë: 43 shkolla amë dhe 18 paralele të ndara fizike, pra gjithsej 61 objekte shkollore. Në fshatin Bërnice, mësimi zhvillohet në gjuhën serbe. Shkolla të mesme të larta dhe gjimnaze janë gjithsej 12. Shkollat në Prishtinë pranojnë edhe një numër të madh nxënësish nga komunat e tjera, për shkak të mungesës së profileve të ndryshme në shkollat e komunave të tyre. Megjithatë, shkollat në qytet ballafaqohen me ngarkesa më të mëdha nxënësish sesa në zonat rurale dhe për këtë mësimi organizohet në dy ndërrime, vetëm një prej shkollave fillore punon ende në ndërrimin e tretë.

Komuna e Prishtinës ka bërë përpjekje që rrjeti i shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, të organizohen në atë mënyrë që nxënësit ta kenë shkollën sa më afër shtëpisë. Por, për shkak të dyndjeve të mëdha në periudhën pas vitit 1999 dhe ndërtimeve të reja, lagje të tëra kanë nevojë për objekte të reja shkollore. Momentalisht, për secilin nxënës janë në dispozicion 3.15 m<sup>2</sup> të hapësirës shkollore, ndërsa brenda kufijve të qytetit kjo hapësirë është më e vogël, 2.66 m<sup>2</sup> për nxënës.<sup>8</sup>



*Harta 6. Arsimi në komunë*

**Objektet shëndetësore** publike dhe private në Komunën e Prishtinës, në sajë të pozicionit që ka, janë të organizuara në tri nivele: kujdesi parësor shëndetësor, kujdesi dytësor dhe kujdesi terciar, prej të cilave vetëm kujdesi primar është në përgjegjësi të komunës. Të gjitha institucionet shëndetësore kryesore janë të vendosura në Prishtinë, ku ofrojnë shërbime për qytetarët e Prishtinës dhe gjithë popullsinë e vendit: Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Instituti për Transfuzionit të Gjakut, Qendra Diagnostike, shërbimet mjekësore të emergjencës, etj.

<sup>8</sup> Sipas Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës




<b>Nr.rend</b>	<b>Qendrat</b>	<b>Adresa</b>	<b>Shërbimet</b>	<b>Numri I personelit</b>
1	<b>QKMF-</b> Objekti është I mbajtur mirë dhe I renovuar	<u>Rr. Fehmim Agani</u>  <u>Nr. 20 -</u>	<b>Mjekësia familjare</b>  <b>Ro kabineti</b>  <b>Laboratoriumi</b> <b>Shërbimi Antituberkular</b> <b>Shërbimi specialistik</b> <b>Mjekësia e punës</b> <b>Shërbimi i pediatriisë</b> <b>Shërbimi Gjinekologjisë</b> <b>Shërbimi i vaksinimit</b> <b>Administrata</b> <b>Shërbimi teknik</b> <b>Autoparku</b> <b>Barnatorja</b>	
				234 - puntorë
2	<b>QMF - I</b> Objekti nuk I plotëson standardet dhe është i paraparë të ndërtohet objekt I ri	<u>Rr. Ilir Konushevc</u>	<b>Mjekësia familjare</b>  <b>Shërbimi i pediatriisë</b>  <b>Laboratori</b>  <b>Shërbimi i stomatologjisë</b> <b>Shërbimi I vaksinimit</b>	
				30 - puntorë
3	<b>QMF - II -</b> Objekti është I ri dhe I plotëson standardet	<u>Kodra e Trimave</u>	<b>Mjekësia familjare</b>  <b>Laboratori</b>  <b>Shërbimi i stomatologjisë</b> <b>Shërbimi i vaksinimit</b>	
				23 - puntorë
4	<b>QMF - III -</b> I plotëson standardet	<u>Rr. Xheladin Kurbaliu</u>	<b>Mjekësia familjare</b>  <b>Shërbimi i pediatriisë</b> <b>Laboratori</b> <b>Shërbimi i dermatologjisë</b> <b>Shërbimi i vaksinimit</b>	
				28 - puntorë

5	<b>QMF - IV -</b> Ndërtim e sipër	<u>Rr. Xhemajl Ibishi</u>	<b>Mjekësia familjare</b> <b>Shërbimi i pediatriisë</b> <b>Laboratori</b> <b>Shërbimi i dermatologjisë</b> <b>Shërbimi i vaksinimit</b> <b>Shërbimi i stomatologjisë</b>	
				48 - puntorë
6	<b>QMF - V -</b> I plotëson standardet	<u>Rr. Nëna Terez</u>  <u>"Dardania"</u>	<b>Mjekësia familjare</b> <b>Shërbimi i pediatriisë</b> <b>Laboratori</b> <b>Shërbimi kronik</b> <b>Shërbimi i dermatologjisë</b> <b>Shërbimi i vaksinimit</b> <b>Shërbimi i stomatologjisë</b> <b>Shërbimi internistik</b> <b>Shërbimi i ginekologjisë</b> <b>RO - kabineti</b>	
				108 puntorë
7	<b>QMF - VI -</b> I plotëson standazrdet	<u>"Kodra e Diellit"</u>  <u>Rr. Hyzri Talla</u>	<b>Mjekësia familjare</b> <b>Shërbimi i pediatriisë</b> <b>Laboratori</b> <b>Shërbimi i dermatologjisë</b> <b>Shërbimi i vaksinimit</b> <b>Shërbimi i stomatologjisë</b> <b>Shërbimi i gjinekologjisë</b>	
				54 - puntorë
8	<b>QMF - VII -</b> I plotëson standardet	<u>Laxha "Kalabria - Emshir"</u>	<b>Mjekësia familjare</b>  <b>Laboratori</b> <b>Shërbimi i stomatologjisë</b> <b>Shërbimi i vaksinimit</b>	
				22 - puntorë
9	<b>QMF - VIII -</b> I plotëson standardet	<u>"Arbëria"</u>	<b>Mjekësia familjare</b>	
				12 puntorë
10	<b>QMF - IX -</b> I plotëson	<u>Rr. Xhavit Ahmeti</u> <u>Laxha e vneshtave</u>	<b>Mjekësia familjare</b>	

	<i>standardet</i>			13 <i>puntorë</i>
11	<b>QMF - X -</b> <i>I plotëson</i> <i>standardet</i>	<u>"Velania"</u>	<b>Mjekësia familjare</b>	
				14 <i>puntorë</i>
12	<b>QMF - Hajvalia</b> <i>I plotëson</i> <i>standardet</i>	<u>"Hajvali"</u>	<b>Mjekësia familjare</b>  <b>Laboratori</b> <b>Shërbimi i stomatologjisë</b> <b>Shërbimi i vaksinimit</b>	
				27 <i>puntorë</i>
13	<b>QMF - Besi</b> <i>Procedurë për</i> <i>ndërtim</i> <i>të objektit të ri</i>	<u>"Besi"</u>	<b>Mjekësia familjare</b>  <b>Laboratori</b> <b>Shërbimi i stomatologjisë</b> <b>Shërbimi I vaksinimit</b>	
				19 <i>puntorë</i>
14	<b>QMF - Mat</b> <i>I plotëson</i> <i>standardet</i>	<u>"Mat"</u>	<b>Mjekësia familjare</b>  <b>Laboratori</b> <b>Shërbimi i stomatologjisë</b> <b>Shërbimi I vaksinimit</b>	
				17 <i>puntorë</i>
15	<b>QMF - Mat - 1</b> <i>I plotëson</i> <i>standardet</i>	<u>"Laxha e Spitalit"</u>	<b>Mjekësia familjare</b>	
				10 <i>puntorë</i>
	<b>Poliklinika</b> <b>Stomatologjike</b> <i>I plotëson</i> <i>standardet</i>	<u>Te pallati I rinisë</u>  <u>Rr. Luan Haradinaj</u>	<b>Shërbimet stomatologjike</b>	
				59 <i>puntorë</i>
<b>AMBULLANTAT</b>				
1	<b>Llukar</b> <i>I plotëson</i> <i>standardet</i>	Llukar	<b>Mjekësia familjare</b>  <b>Shërbimi i vaksinimit</b>	4 <i>puntorë</i>
2	<b>Keqekollë</b> <i>Duhet të</i>	Keqekollë	<b>Mjekësia familjare</b>	4 <i>puntorë</i>

	<i>ndërtiohet</i>			
3	<b>Koliq</b> <i>I plotëson standardet</i>	<i>Koliq</i>	<b>Mjekësia familjare</b>	
				1 punëtor
4	<b>Dabishevc</b> <i>I plotëson standardet</i>	<i>Dabishevc</i>	<b>Mjekësia familjare</b>	
5	<b>Shkabaj</b> <i>I plotëson standardet</i>	<i>Shkabaj</i>	<b>Mjekësia familjare</b>	
				5 punëtorë
6	<b>Barilevë</b> <i>Objekti I ri duhet ndërtohet</i>	<i>Barilevë</i>	<b>Mjekësia familjare</b> <b>Shërbimi i vaksinimit</b>	4 punëtorë
7	<b>Bardhoshë</b> <i>Objekti I ri duhet ndërtohet</i>	<i>Bardhoshë</i>	<b>Mjekësia familjare</b>	4 punëtorë
8	<b>Rimanisht</b> <i>I plotëson standardet</i>	<i>Rimanisht</i>	<b>Mjekësia familjare</b>	2 punëtorë
9	<b>Sharban</b> <i>I plotëson standardet</i>	<i>Sharban</i>	<b>Mjekësia familjare</b>	4 punëtorë
10	<b>Slivovë</b> <i>I plotëson standardet</i>	<i>Slivovë</i>	<b>Mjekësia familjare</b>	2 punëtorë
11	<b>Viti</b> <i>I plotëson standardet</i>	<i>Viti</i>	<b>Mjekësia familjare</b>	1 punëtor
	<i>I plotëson standardet</i>			1 punëtor
13	<b>Mramor</b> <i>I plotëson standardet</i>	<i>Mramor</i>	<b>Mjekësia familjare</b> <b>Shërbimi i vaksinimit</b>	4 punëtorë



Harta 7. Objektet shëndetësore


Vendi i parë ku drejtohen qytetarët për ndihmë mjekësore janë qendrat e mjekësisë familjare. Kujdesi primar shëndetësor ofrohet përmes qendrave të mjekësisë familjare, ku kemi një QKMF (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare) dhe 14 QMF (Qendra të mjekësisë familjare) të shtrira në të gjitha lagjet e qytetit dhe në disa zona rurale/vendbanime më të mëdha, si në Hajvali dhe në Besi. Në zonat rurale ekzistojnë ambulancat mjekësore. Shërbimet e emergjencës paraspitalore ofrohen në Qendrën e Mjekësisë Urgjente (QMU). Ekziston edhe Poliklinika e Stomatologjisë, e cila më tepër i takon kujdesit dytësor shëndetësor. Ndërsa sa u përket spitaleve/klinikave/ordinancave, Ministria e Shëndetësisë është autoriteti, i cili i licencon ato dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre shëndetësore.

Për sa u përket objekteve kulturore, Prishtina ka 2 teatro publike, Bibliotekën Kombëtare Universitare dhe Bibliotekën e Qytetit "Hivzi Sylejmani" me 13 degë, Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Muzeun e Prishtinës, Arkivin e Prishtinës, Shtëpinë e Kulturës në Hajvali, Keqekollë, Llukar, Marec dhe Nëntë Jugoviq, qendra kulturore të fëmijëve, radiot dhe televizionet publike dhe private, Filarmonia – Opera e Kosovës, Baleti i Kosovës, etj. Megjithatë, Prishtina ka nevojë për objekte të tjera kulturore. Teatri i Operës "Dr. Ibrahim Rugova" dhe Muzeu i Arteve Bashkëkohore presin të implementohen nga niveli qendror. Me objektet ekzistuese sportive, Prishtina nuk i plotëson nevojat e qytetarëve. Ka ende nevojë për asete të reja sportive, si palestra, pishina dhe stadium olimpik me shtigje të atletikës.

Qasja fetare në popullatën e Komunës së Prishtinës dominohet nga besimi mysliman, gjë që reflektohet edhe nga objektet fetare. Janë identifikuar xhami në Barilevë, Bërnice, Hajvali, Keqekollë, Koliq, Makoc, Marec, Matiçan, Mramor, Nëntë Jugoviq, Shkabaj, Prapashticë, Prugovc,

Rimanishtë, Siqevë. Xhamitë dominojnë edhe në pjesën urbane të qytetit të Prishtinës. Ndërkohë, janë evidentuar kisha në Bërrnicë të Epërme, Bërrnicë të Poshtme dhe në Prishtinë.

Nr. i Vendb.	VENDBANIMI	Objektet relegjioze	
		Xhamia	Kisha
1	Ballaban		
2	Barilevë	○	
3	Bërrnic e epërme		○
4	Bërrnic e poshtme		○
5	Besi	○	
6	Busi		
7	Çagllavicë		
8	Dabishec		
9	Dragoc		
10	Drenoc		
11	Gllagicë		
12	Grashticë		
13	Hajkobilë		
14	Hajvali	○	
15	Keqekollë	○	
16	Koliq	○	
17	Kolovicë		
18	Kukavicë		
19	Lebanë		
20	Llukar		
21	Makoc	○	
22	Marec	○	
23	Matiçan	○	
24	Mramor	○	
25	Bardhosh	○	
26	Nishec		
27	Orlloviq - Shkabaj	○	
28	Prapashticë	○	
29	Prishtinë	○	○
30	Prugoc	○	
31	Radashec		
32	Rimanisht	○	
33	Bërrnic e epërme		
34	Siqevë	○	
35	Slivovë		
36	Sofali		
37	Sharban		
38	Shashkoc		
39	Teneshdoll		
40	Trudë		
41	Vranidoll		
42	Zllash (Mramor)		
43	Zllatar		



Harta 8. Objektet fetare

#### 1.1.1.6. MOBILITETI

##### **Infrastruktura e rrjetit të transportit**

Duke marrë parasysh pozitën gjeografike të Prishtinës në Kosovë e më gjerë, si dhe rolin e saj si kryeqytet i Republikës së Kosovës, gjatë viteve të fundit sidomos pas luftës, ka bërë që të rritet migrimi i popullsisë së Prishtinës. Sot në këtë qytet kemi një trafik të dendur në pjesën e hyrjes nga rrugët kryesore të Kosovës, rajonale dhe rrugë tjera lokale. Zhvillimet e kohëve të fundit në zonat pranë qytetit të Prishtinës, janë përqendruar kryesisht me rrugët kryesore të cilat të çojnë në Prishtinë. Ndërsa ndërtimet e objekteve janë kryesisht komerciale, biznese të vogla ose banesore. Zhvillimi dhe rritja e përqendrimit të këtyre lloj objektiv, si dhe rritja e shpejtë e zhvillimeve të ndryshme, ka bërë që gjendja momentale e trafikut të jetë e ngarkuar, sidomos përgjatë rrjetit kryesor të rrugëve.

Gjithsej janë dy lloj mjete transporti që përdoren në territorin e Prishtinës: transporti rrugor dhe transporti hekurudhor. Transporti rrugor e ka rolin kryesor në transportin e udhtarëve dhe të mallrave. Prishtina është e lidhur me rrugë jo vetëm në linja interurbane, por edhe ndërkombëtare që lidhen me shtetet fqinje. Të gjitha këto linja rrugore çojnë te stacioni kryesor - Stacioni i Autobusëve të Prishtinës. Ndërmodaliteti mes rrugëve dhe hekurudhave duhet të shtyjë drejt ndërtimit të rrugëve dhe terminaleve të hekurudhave pranë njëra-tjetrës, sepse deri tani ndodhen larg dhe lidhen nëpërmjet rrugës Prishtinë-Fushë Kosovë.

Niveli i motorizimit ka ndryshuar në mënyrë drastike përpara dhe pas vitit 1999. Rrjeti rrugor duhet të rritet me më shumë rrugë, kushtet e të cilave duhet të jenë më të mira për t'u përballur me numrin e tanishëm të automjeteve që kalojnë aty. Shtigjet për biçikleta mungojnë. Në disa raste sistemi i sinjalizimit të rrugëve nuk është i harmonizuar me standardet evropiane në forma, ngjyra dhe dimensione.

Rrjeti i hekurudhës vepron nga stacioni kryesor në Fushë-Kosovë në dy shtete fqinje (Maqedoni dhe Serbi). Linjat hekurudhore janë rreth 333 km, duke mos përfshirë linjat industriale që janë gjithsej 103 km. Këto linja, lokomotivat dhe vagonët e tyre nuk janë në kushte të mira dhe kërkojnë investime të mëdha. Gjendja momentale duhet të përmirësohet sa më shpejt që është e mundur.

Aeroporti është jashtë territorit të Prishtinës dhe lidhet nëpërmjet Fushë-Kosovës dhe Lipjanit me kryeqytetin, me një distancë prej 16 km. Terminali i autobusëve ndodhet në zonën urbane në Prishtinë. Stacioni hekurudhor ndodhet në Fushë-Kosovë, 6 km larg Prishtinës.

### ***Rrugët kryesore ekzistuese dhe ato rajonale***

Ligji mbi Rrugët jep një ndarje të rrugëve duke i klasifikuar ato si magjistrale, regjionale, lokale dhe rrugët përgjatë vendbanimeve. Ligji i jep Ministrisë së Infrastrukturës përgjegjësinë për rrugët kryesore dhe rajonale, ndërsa përgjegjësinë për rrugët lokale e mban komuna. Të gjitha këto rrugë kalojnë gjithashtu nëpërmjet territorit të Komunës së Prishtinës.

Rrugët kryesore që kalojnë në territorin e Komunës së Prishtinës janë:

- Prishtinë-Podujevë M25 (Rrugë magjistrale), tranzit mes zonave kadastrale: Bërnice e Epërme, Nëntë Jugoviq, Trudë, Lebanë, Prugovc, Vranidoll dhe Teneshdoll.
- Prishtinë-Mutivodë (kufiri me Serbinë), M9 (Rrugë kryesore), që kalon përmes zonave kadastrale: Llukar, Makoc, Grashticë, Keqekollë, Prapashticë, Dabishec.
- Prishtinë-Gjilan, M25.2 (Rrugë magjistrale), tranzit nëpër zonat kadastrale: Çagllavicë, Hajvali, pastaj përmes zonës kadastrale Novosellë, Busi, Slivovë dhe Dragoc,
- Prishtinë-Prizren/Prishtinë-Ferizaj, M2 (Rrugë magjistrale), tranzit nëpër Çagllavicë dhe vazhdon pastaj për në Ferizaj dhe Prizren.
- Prishtinë-Pejë, nga zona M9 (Rrugë magjistrale) kadastra e Prishtinës lidhet me Fushë-Kosovën, dhe
- Prishtinë-Mitrovicë, M2 (Rrugë magjistrale), që kalon përmes fshatit Shkabaj dhe qytetit të Mitrovicës në kufi me Serbinë në veri.

Rrugët rajonale që kalojnë nëpër territorin e Prishtinës janë:

- R123a (Rrugë rajonale), që fillon nga kryqëzimi i M9 (Prishtinë-Mutivodë) në zonën kadastrale të Prapashticës, dhe pastaj vazhdon në Dabishec dhe Gillogovicë, duke u lidhur me Komunën e Prishtinës nëpërmjet Komunës së Kamenicës.
- R120 (Rrugë rajonale), që fillon nga kryqëzimi me rrugën kryesore M25 (Prishtinë-Podujevë), dhe kalon në zonën kadastrale të Prugovcit, duke lidhur Komunën e Prishtinës me atë të Obiliqit, dhe rruga e njëjtë rajonale vazhdon nga Obiliqi për në Prishtinë, nëpërmjet zonës kadastrale Shkabaj dhe lidhet duke formuar kryqëzimin me rrugën magjistrale M2 (Prishtinë-Mitrovicë)

Ka edhe rrugë të tjera vendore, por nuk ka ndonjë të dhënë rreth këtyre rrugëve, me përjashtim të shtrirjes së tyre. Që nga viti 2011, Ministria e Infrastrukturës është duke punuar për krijimin e një dokumenti që do të përfshijë rrugët vendore në nivel komunal, me qëllim të krijimit të një pasqyre më të qartë për gjendjen e këtyre rrugëve. Disa prej tyre janë aktualisht nën administrimin e



komunave, ndërsa ministria po punon shumë për t'i transferuar ato në nivelin rajonal, sepse investimet e bëra nga Ministria për shtrimin e këtyre rrugëve janë bërë të papërbalueshme për mirëmbajtje nga ana e komunave.

### ***Unaza e jashtme dhe e brendshme (e propozuar nga Plani Strategjik Zhvillimor Urban i Prishtinës 2004-2020), autoudha dhe hekurudha***

Projekti për unazën e brendshme ekziston dhe është i kompletuar, por nuk ka filluar akoma të ndërtohet. Deri tani është i njohur edhe një projekt për lidhjen e autostradës me veriun e Prishtinës, veçanërisht në rrugën kryesore Prishtinë-Podujevë (M25), në fshatin Trudë.

### ***Infrastruktura rrugore në zonat kadastrale, fshatrat e komunës së Prishtinës***

Vlerësimi i gjendjes së rrugëve nëpër zonat kadastrale dhe vendbanime është bërë në bazë të të dhënave në drejtoritë e Komunës së Prishtinës dhe vëzhgimet në terren. Shtrirja e vendbanimeve në zonat kadastrale është bërë pa ndonjë plan zhvillimor, prandaj përqendrimi i vendbanimeve kolektive është bërë sipas nevojave të banorëve pa ndonjë plan paraprak.

Viteve të fundit Komuna e Prishtinës ka bërë disa investime të mira në përmirësimin e rrugëve nëpër fshatra, duke investuar në asfaltimin e disa rrugëve dhe shtrimin e zhavorrit në disa të tjera. Këto investime janë bërë fillimisht në rrugët kryesore që lidhin fshatrat me njëra-tjetrën dhe mund të konsiderohen si rrugë lokale.

Përqendrimi më i madh i vendbanimeve është në cepin e rrugëve magjistrale dhe rajonale, ndërsa një fenomen i tillë ndodh kryesisht për shkak të ndërtimeve të bizneseve individuale, me qëllim punësimi dhe gjenerimit të të ardhurave për nevojat familjare. Rritja e numrit të banorëve në këto rrugë dhe mungesa e infrastrukturës së duhur kanë krijuar nevojën për zhvendosje dhe për përmirësim të rrugëve, trotuareve dhe shtigjeve të biçikletave.

Fshatrat të cilat nuk kalojnë nëpër rrugët kryesore dhe rajonale, i kanë lidhjet nëpërmjet rrugëve që i drejtojnë andej (që mund të konsiderohen si rrugë lokale), por nuk kanë përqendrimin e nevojshëm të vendbanimeve siç duhet të jetë përgjatë rrugëve magjistrale dhe rajonale. Një pjesë e rrugëve lokale që lidhin fshatrat me rrugët kryesore janë të asfaltuara kryesisht në brendësi të fshatrave, ndërsa rrugët mes objekteve të banimit mbesin të paasfaltuara. Këto investime janë bërë gjatë viteve të fundit nga Komuna e Prishtinës, dhe ky fakt e ka lehtësuar trafikun për automjetet rrugore dhe vërehet përmirësimi i shërbimit dhe komunikimit mes këtyre fshatrave.

Një çështje kryesore në zgjerimin e infrastrukturës rrugore mbetet shpërndarja në distancën mes vendbanimeve nëpër fshatra. Sigurisht, një ndarje e tillë e zonave të populluara na ka orientuar drejt formimit të shumë rrugëve që deri tani kanë mbetur të patrajtuara, gjatë viteve nuk janë mirëmbajtur dhe ndonjëherë gjatë dimrit është e vështirë që edhe të kalohen nga bora. Shpërndarjet e tilla të vendbanimeve kanë bërë që të jetë e vështirë edhe të investohet në këto rrugë për përmirësimin e shpejtë të gjendjes së tyre, për shkak të buxhetit të limituar të komunës, pavarësisht investimeve që janë bërë deri tani.

Mirëmbajtja e këtyre rrugëve nga Komuna e Prishtinës nuk është në nivelin e duhur, për shkak të buxhetit të limituar dhe zgjerimit të rrugëve të tilla. Mirëmbajtja dimërore bëhet kryesisht në pastrimin e borës dhe përmirësimin e pjesëshëm të kushteve të tyre. Zakonisht kërkesat më të

mëdha për asfaltim apo rregullim të rrugëve vijnë nga fshatrat që ndodhen sa më larg zonës urbane. Kërkesat domethënëse akoma mbeten rregullimi i investimeve në rrjetin e rrugëve të lagjeve nëpër zonat rurale. Investimi në ndërtimin e rrugëve të shtruara bëhet kryesisht në fshatrat më të dendura ku janë përqendruar vendbanimet, veçanërisht në fshatrat që ndodhen më pranë zonës urbane.

Siguria në trafik pranë rrugëve magjistrale nuk është në nivelin e duhur për shkak të përqendrimit të lartë të banesave përgjatë këtyre rrugëve. Qasjet e njëjta të banimit direkt në rrugët kryesore dhe rrugët apo zonat rurale të cilat afrohen përgjatë këtyre akseve janë të shpeshta. Edhe në segmente të caktuara të rrugëve kryesore, intensiteti i mjeteve të trafikut dhe këmbësorëve është mbi nivelin ekzistues të kapaciteteve të rrugëve, edhe pse në disa segmente janë bërë përmirësime.

Shtigjet e veçanta për këmbësorë dhe shtigjet e ndara për biçikleta mungojnë në shumicën e rasteve. Shkollat të cilat janë të vendosura në afërsi të rrugëve kryesore, i marrin nxënësit në anë të rrugëve, duke përdorur anët e rrugëve në mungesë të trotuareve në disa pjesë të rrugës, pa anët e mbrojtjes së rrugës dhe me asnjë gjerësi të mjaftueshme për lëvizjen e sigurt. Duke konsideruar sigurinë e lëvizjes së këmbësorëve, ndihet mungesa e nënkalimeve dhe mbikalimeve për këmbësorë, në lidhje me kërkesat e rrugëve kryesore të kalimit nga njëra anë në tjetrën. Edhe në ato zona ku gjenden, disa prej tyre nuk janë të arritshme për shkak të mospajtueshmërisë nga vetë këmbësorët dhe niveli i pamjaftueshëm për mirëmbajtjen e tyre nga organet kompetente.

Projektet e rrugëve të shpërndara nëpër zonat kadastrale të Prishtinës përfshijnë një gjatësi prej 65 km (rreth 10% e rrjetit të rrugëve në territorin e Komunës së Prishtinës), ndërsa rrugët e tjera janë të patrajtuara për sa i përket dizajnit inxhinierik të metodave moderne.

### ***Transporti ndërrurban dhe linjat urbane në Komunën e Prishtinës***

Në vitin 2006, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Tokës Ndërtimore, ka hartuar rregulla "për përcaktimin e linjave rrugore dhe transportin urban të udhëtarëve me autobusë në Komunën e Prishtinës". Kjo rregullore përcakton rrugën që duhet t'i përdorin autobusët në linjat e transportit publik në vendbanimet e Komunës së Prishtinës dhe lidhjet me komunat fqinje, si Fushë-Kosova dhe Obiliqi. Gjithashtu, është një hartë e thjeshtë me strukturën e këtyre linjave pa dimensione, ku janë prezantuar disa nga rrugët që përdorin autobusët nëpër komunë. Ndërsa në 2010-n, Kuvendi Komunal aprovoi "Rregullat për përcaktimin e rrjetit të linjave rrugore, transportit urban dhe pasagjerët urbanë në Komunën e Prishtinës". Ky dokument gjithashtu cakton rrjetin rrugor të linjave të transportit urban me autobusë në Komunën e Prishtinës. Gjithsej janë 34 linja, 10 urbane dhe 24 periferike.<sup>9</sup>

#### **1.1.1.7. RRJETI I SHËRBIMEVE**

##### ***Energjia elektrike***

Kufijtë administrativë të Komunës së Prishtinës nuk janë kufij që përcaktojnë kërkesën dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Kjo do të thotë se prej trafo-stacioneve kryesore në territorin e komunës, përveç konsumatorëve të komunës, furnizohen edhe konsumatorë të komunave të tjera dhe anasjelltas (konsumatorët e Prishtinës furnizohen nga komuna të tjera). E gjithë Komuna e

<sup>9</sup> Sipas Rregullores për përcaktimin e linjave rrugore

Prishtinës furnizohet nga një trafo-stacion 220/110 kV, një trafo-stacion 110/35 kV, tri trafo-stacione 110/20(10) kV dhe shtatë trafo-stacione 35/10 kV. Nga këto 35/10 kV, tri prej tyre nuk janë të vendosura në territorin e Prishtinës. Në territorin e Komunës së Prishtinës, që përfshin këtë plan, ka linja me tension të lartë 400kv, 220kv, 110kv, 35kv, 10kv dhe 0.4kv. Për shkak të linjave të gjata në fshatra të largëta, ka një rënie të voltazhit dhe si rezultat edhe humbje të energjisë. Energjia që dërgohet te konsumatori i fundit duket qartë që është nën nivelet teknike minimale.

E gjithë komuna ka një total prej **65836** konsumatorëve të regjistruar në sektorin e ekonomive familjare. Të gjitha këto lidhen në rrjetin prej 0.4 kV. Në këtë rrjet janë të lidhura **13864** metra elektrike si konsumatorë biznesi. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë elektrike janë të lidhur me rrjetin 10 kV ose 35 kV. Këta janë të njohur gjithashtu si konsumatorë industrialë. Në Prishtinë janë **276** të tillë.

Në Komunën e Prishtinës nuk ka ndonjë prodhim të energjisë elektrike, as nga nafta dhe as nga derivatet e saj, as nga burimet e ripërtëritshme (uji, era, energjia diellore, etj.). Gjithashtu nuk shihet ndonjë shenjë e një energjie të tillë për momentin. Nuk ka asnjë zonë rurale në Prishtinë që nuk është plotësisht i pajisur me drita. Por, disa zona rurale janë pjesërisht të ndriçuara si: Hajvalia, Matiqani, Mramori, Barileva, Busia, Shkabaj, Bërnica e Poshtme, Bërnica e Epërme, Kolovica, Sofalia, Truda, Lebana, Llukari dhe Makoci.

### ***Telekomunikimi***

Gjendja e rrjetit të telekomunikacionit në Prishtinë është e dobët. Gjithsej janë 11 zona rurale të mbuluara me rrjet të telekomunikacionit. Në total janë vetëm 6 pika që shpërndajnë rrjet të telekomunikacionit (me tel). Ato kryesisht shpërndajnë linjën në fshatin ku janë të vendosura, por ekzistojnë edhe rrjete të tjera që shpërndajnë linjën në fshatrat përreth.

### ***Sistemi I furnizimit me ujë dhe kanalizimet***

Komuna e Prishtinës ka sasi të kufizuara të ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor, kryesisht që shpërndahen në pjesët rurale të komunës ndërsa si burim kryesor i furnizimit me ujë shërbejnë Liqeni i Batllavës dhe ai i Badovcit. Liqeni i Batllavës ka një volum prej 38 milionë m<sup>3</sup> ujë, dhe ndodhet në Komunën fqinje të Podujevës që furnizon 65% të Prishtinës si dhe komunat e Podujevës, Obiliqit, dhe Fushë-Kosovës. Është ndërtuar në vitet 1960-1963 për të furnizuar me ujë, si fillim Obiliqin, dhe pastaj u shndërrua në furnizues të ujit për Komunën e Prishtinës. Në Shajkovc (Alabanik) u ndërtua Fabrika për përpunimin e ujit të pijshëm me kapacitetin maksimal prej 900 l/sek. Sikur në tërë Kosovën dhe më gjerë, sistemi i kanalizimit ekzistues nevojitet të transformohet në dy linja (ujërat e zeza dhe ujërat atmosferike) me qëllim të racionalizimit në fazën e trajtimit të ujërave të zeza.




Fig.2. Furnizimi me ujë

LEGJENDA:

- 1 - Burimet e ujit
- 2 - Fabrikat e ujit
- 3 - Rezervuarët
- 4 - Stacionet e pompave
- 5 - Gypat primar
- 6 - Gypat sekundarë
- 7 - Nyjet në rrethin e ujit
- 8 - Valvulat

Liçeni i **Badovcit** me një vëllim prej 26.4 milionë m<sup>3</sup>, që gjendet në Komunën e Prishtinës dhe Graçanicës, furnizon me ujë rreth 35% të Komunës së Prishtinës dhe Graçanicës. Ky liçen është ndërtuar në vitin 1960 dhe në të njëjtin vend është ndërtuar edhe Fabrika për përpunimin e ujit të pijshëm me kapacitet 400 l/sek. Liçeni i Badovcit karakterizohet nga cilësia e mirë e ujit dhe në të ardhmen do të jetë një nga burimet kryesore të furnizimit me ujë.

**Ujërat nëntokësore të Kolovicës** përfaqësojnë burime natyrore që e kanë furnizuar Prishtinën në vitet 1950-1970. Ato janë të vendosura në pjesën veriore të Prishtinës me një kapacitet prej 50 l/sek dhe janë shfrytëzuar deri në vitin 1982. Pas kësaj u ndërtua Liçeni i Batllavës dhe kontaminimi i këtyre burimeve u rrit. Propozohet që në të ardhmen këto ujëra të përdoren si ujë teknik.

**Burimi i Gërmisë** shtrihet në fillim të Parkut të Gërmisë dhe njihet si burimi më i vjetër i ujit. Ai është përdorur që nga koha e Perandorisë Osmane dhe ka një shpejtësi prej 15 l/sek. Sot ky burim përdoret si furnizuesi kryesor për pishinën e Gërmisë. Furnizimi i ujit nuk i përmbush kërkesat për ujë që rritet vazhdimisht për shkak të rritjes së popullsisë. Prandaj ekziston sistemi i reduktimit që përfshin zonën urbane dhe rurale me ndërprerje të ujit për 8-10 orë.

Sistemin e menaxhimit të ujit me ujë të pijshëm dhe kanalizimit e bën Kompania Ujësjellësi Rajonal "Prishtina", që është një kompani publike dhe ofron ujë dhe kanalizim për 8 komuna.

Sistemi i furnizimit me ujë kërkon vendosjen e pompave për të siguruar ngritjen maksimale të ujit. Këto pompa kushtojnë shumë dhe kanë vështirësi në funksionim. Kjo ndodh për shkak të nivelit të ujit në të dy liçenet. Investimet që janë në proces e sipër (rehabilitimi i sistemit të ujit dhe ndërtimi i fabrikës së re të ujit në Shkabaj-që furnizohet nga Liçeni i Gazivodës) kanë si qëllim përfshirjen e më shumë banorëve në sistemin e furnizimit me ujë, dhe eliminimin e sistemit të ndaljes së ujit.

Prishtina ka sistem të largimit të ujërave të ndotura për rreth 80% të popullatës, por nuk ka sistem të trajtimit të ujërave të zeza. Sistemi i largimit të ujërave të ndotura në qytet komplementohet me sistemet e ngjajshme në zona rurale, të cilat sisteme përdoren vetëm largimit të këtyre ujërave përdoret vetëm për largimin e ujërave sanitare. Ky kanalizim i lë vendbanimet për tu zhvilluar në drejtim të liçeneve. Dy lumenjtë kryesorë janë Sitnica dhe Llapi. Sitnica është pranuesi kryesor i kanalizimeve nga të gjitha vendbanimet e Prishtinës. Prandaj, shkalla e ndotjes është goxha e lartë. Vetëm tri fshatra kanë një sistem primar të trajtimit të ujit, ndërsa qyteti dhe pjesët e tjera nuk e trajtojnë fare ujërat e zeza. Konfiguracioni i terrenit bën të mundur që kanalizimi të shkojë në dy qytetet fqinje, Fushë Kosovë dhe Obiliq. Largimi i kanalizimeve në Prishtinë bëhet në mënyrë gravitacionale dhe dy mbledhësit kryesorë janë lumenjtë Prishtina dhe Vellusha. Një pjesë e zonës urbane shkarkon kanalizimin nëpërmjet "Kodrës së Trimave" që drejtohet për në fshatin Shkabaj.

### **1.1.2. Pozita, rëndësia dhe çështjet specifike për territorin e komunës në kontekst të Planit Hapësinor të Kosovës**

Nga koncepti i planifikimit hapësinor për të ardhmen, Plani Hapësinor i Kosovës e ndan shtetin në katër zona, të cilat janë të planifikuara duke u bazuar në karakteristika të kësaj zone. Këto karakteristika përfaqësojnë diversitet dhe në të njëjtën kohë janë unike. Këto karakteristika që bëjnë dallimet janë: zhvillimi i mundshëm i këtyre zonave, karakteristikat e tyre gjeografike dhe aktivitetet ekonomike në këto zona. Këto janë të dizajnuara nga emra që përfaqësojnë një formë të identitetit të këtyre zonave si dhe disa prej karakteristikave të tyre.

Prishtina, kryeqyteti, është i përfshirë në zonën e kaltër, dhe përcaktohet kështu: Porti i Kosovës – administratë, shërbime dhe shkëmbime, industria bujqësore, turizmi – përfshin pjesën veriore të Kosovës, e përbërë nga komunat: Prishtina – qendra kryesore dhe kryeqytet i Kosovës, Obiliqi, Podujeva, F.Kosova, Lipjani, Drenasi dhe Shtimja, që të gjitha gravitojnë në qytetin e Prishtinës.

Vizioni për zonën e kaltër është i strukturuar si më poshtë:

- Një zonë e gjallë dhe me perspektivë, ku qytetet kanë si qëllim zhvillimin e vazhdueshëm modern dhe të planifikuar, dhe në të njëjtën kohë t'u bashkohen qyteteve fqinjë dhe të rajonit më të gjerë, një cilësi të lartë të jetesës dhe dëshirë për të jetuar dhe punuar në këtë qytet, rritje e të ardhurave, shërbimeve dhe ekonomisë së Kosovës.
- Zona e kaltër, me Prishtinën – zona metropolitane, kryeqyteti, vendi ku gjenden objektet e Qeverisë dhe zyrat e huaja diplomatike, qasje në qytetet fqinje të Kosovës e më tej, nëpërmjet një rrjeti fizik të infrastrukturës (rrugë, tren, ajër, energji) dhe institucionet administrative dhe institucionale.

Duke u kyçur brenda rrjetit, ata do të krijonin kushte të favorshme dhe objekte për veprimtari ekonomike, industriale, tregtare dhe të shërbimit. Në qendër të Zonës së kaltër, një trekëndësh i Zhvillimit ekonomik të Kosovës (ZHEK) është paraparë të jetë e ashtuquajtura shpinë e zhvillimit ekonomik të një interesi kombëtar, burim i të ardhurave për ekonominë kosovare, dhe një vend potencial për investim të kompanive multinacionale.

### **1.1.3. Informatat kyçe të raporteve dhe strategjive sektoriale**

Kompleksiteti i Komunës së Prishtinës si kryeqytet i Republikës së Kosovës, qendër administrative, ekonomike, kulturore, sportive dhe mbi të gjitha arsimore (qytet universitar) e bënë PZhK-në dokument më të ndërlikuar, në të cilin informatat kyçe të raporteve dhe strategjive sektoriale duhet të përfshihen në fushat specifike tematike veç e veç.

### **1.1.4. Çështje kyçe të kontekstit më të gjerë hapësinor**

Prishtina gjendet në pjesën e Rrafshit të Kosovës. Paraqet qendrën më të madhe administrative, arsimore, kulturore, universitare në vend me një Teatër Kombëtar dhe dy teatro private, kinema komplekse, palestra sportive dhe Klinikë Universitare. Prishtina është vendi ku kryqëzohen rrugët kryesore ndërkombëtare, ka afër Aeroportin ndërkombëtar, linjën hekurudhore Beograd-Shkup, dhe pothuajse të gjitha rrugët e tjera më kryesore kalojnë nëpër qytet. Autoudha "Ibrahim Rugova", me mundësi të vazhdimit deri në Nish, po ashtu do të kalojë nëpër Komunën e Prishtinës. Aktualisht kjo autoudhë është e realizuar prej Malishevës - Suharekë - Prizren -Tiranë.

Komuna e Prishtinës rrethohet me komunat tjera: me Podujevën në veri, me Kastriotin (Obiliqin) në perëndim, Fushë-Kosovën në pjesën jugperëndimore, Graçanicën dhe Lipjanin në jug, me Novobërdën në juglindje dhe me Komunën e Kamenicës në perëndim. Në pjesën verilindore Komuna e Prishtinës kufizohet me Republikën e Serbisë me një gjatësi të vijës kufitare prej rreth 12km.

## 1.2. Vlerësimi i gjendjes në Komunën e Prishtinës

### 1.2.1. SWOT Analiza

Për të ndërtuar një vizion si “deklaratë për të ardhmen”, duke u bazuar në gjendjen momentale, është bërë një analizë SWOT, që përfshin aspektet kryesore që duhet kushtuar vëmendje dhe që merr parasysh Planin Hapësinor të Kosovës (PHK).

Identifikimi i përparësive dhe dobësive, mundësive dhe rreziqeve ofron një skemë logjike për t'i identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, bashkë me mundësitë dhe rreziqet që lidhen me një territor të caktuar. Këto duhet të identifikohen dhe analizohen për të dhënë informacion të vlefshëm për dizajnimin e një sipërfaqeje, si një kornizë që mund të ndihmojë për të bërë një analizë të balancuar. Kjo është një nga teknikat më të përhapura në planifikimin strategjik.

Pikat e dobëta dhe të forta iu referohen attributeve të brendshme të një qyteti apo territori, duke marrë parasysh, përveç kontekstit, edhe referimin ndaj gjendjes momentale. Nga ana tjetër, mundësitë dhe rreziqet fokusohen në kontekstin e jashtëm dhe prandaj kërkojnë një analizë të një shkalle më të lartë të kontekstit territorial, ekonomik, social dhe institucional, të cilit i përket dhe me të cilin bashkëvepron. Kjo fazë e analizës, ndryshe nga ato parapraket, ka si qëllim të ardhmen.

Të bërit e këtyre elementeve eksplicite është primare për të arritur objektivat e mëposhtme:

- Të vlerësohen përparësitë e kontekstit lokal,
- Të minimizohen pikat e dobëta,
- Të përfitohet nga mundësitë e prezantuara,
- Të tentohet kundërshtimi i rreziqeve të ardhshme.

Në lidhje me sugjerimet e Planit Hapësinor të Kosovës, analiza SWOT bazohet në tri elemente kryesore:

1. Prishtina, kryeqyteti: një cilësi e lartë jetese, tërheqëse për të jetuar dhe punuar
2. Qasje e mirë nëpërmjet rrjetit të infrastrukturës, materiale ose jo
3. Një ambient i favorshëm për një zhvillim inovativ dhe konkurrues

N g a S W O T A n a l i z a t e v i z i o n i	
+	-
Përparësitë	Dobësitë
<p><b>Prishtina, kryeqyteti: cilësi e lartë jetese, tërheqëse për të jetuar dhe punuar</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lagje të ndryshme të karakterizuara në mënyrë të qartë i jep identitetin e qytetit,</li> <li>• Rritje e vazhdueshme e shërbimeve publike në disa vendbanime,</li> <li>• Prania e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe institucioneve të tjera kryesore shëndetësore.</li> <li>• Prania e bibliotekës, Pallatit të Rinisë, teatrove dhe qendrave multimediale.</li> <li>• Një numër i madh dhe diversitet i monumenteve dhe ndërtesave kulturore,</li> <li>• Prania e zonave natyrore të mbyllura, prania e qytetit me Parkun Natyror Rajonal të Gërmisë, i pasur me bimësi, florë dhe faunë,</li> <li>• Peizazhi i lartë dhe potencial mjedisor.</li> </ul> <p><b>Qasje e mirë nëpërmjet rrjetit material dhe jomaterial të infrastrukturës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pozita qendrore e Kosovës në Evropën Lindore, dhe nyja lidhëse për linjat e trafikut kombëtar dhe rajonal (rrugë, tren, ajër, energji)</li> <li>• Realizimi i autostradës së re të planifikuar dhe infrastruktura tjera të qarkullimit</li> <li>• Prishtina është e vendosur në kryqëzim të dy koridoreve të transportit me rëndësi ndërkombëtare (rruga 6 dhe 7)</li> </ul>	<p><b>Prishtina, kryeqyteti: cilësi e lartë jetese, tërheqëse për të jetuar dhe punuar</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtime intensive, veçanërisht që nga 2000-a, prezenca e ndërtimeve të paplanifikuara dhe joformale</li> <li>• Në përgjithësi vendbanimet paraqesin një dendësi tepër të ulët për të garantuar shërbimet bazë</li> <li>• Gjendje e vështirë për këmbësorët dhe çiklistët</li> <li>• Perceptim i dobët në hyrje të qytetit për shkak të mungesës së planit adekuat</li> <li>• Termocentralet ekzistuese dhe ato të planifikuara si dhe ndikimi i tyre në mjedis</li> <li>• Një pjesë relevante e shtëpive të saponëduara nuk i arrijnë standardet teknike ose mbesin të papërfunduara</li> <li>• mungesa e spitalit të qytetit</li> <li>• Infrastrukturë e pamjaftueshme për aktivitete arsimore</li> <li>• Sistemi i furnizimit me ujë i pamjaftueshëm</li> <li>• Nuk ka sistem të trajtimit të ujërave të zeza</li> <li>• Mungesë e mbrojtjes dhe promovimit më të mirë të trashëgimisë kulturore dhe mbrojtjes së mjedisit (PHK 2010)</li> <li>• Mundësitë për përmbytje nga ujërat atmosferike në disa zona të komunës gjatë sezoneve të shirave</li> </ul> <p><b>Qasje e mirë nëpërmjet rrjetit material dhe jomaterial të infrastrukturës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka lidhje të mirë me koridoret ndërkombëtare</li> <li>• Standard i ulët i rrugëve dhe mungesë e hierarkisë</li> <li>• Standard i ulët i Stacionit hekurudhor jashtë qendrës së qytetit</li> <li>• Sistemi i transportit me dimensione të vogla dhe jo i pajisur siç duhet</li> <li>• Mundësi të pakta për parkimin e veturave nëpër qytet</li> <li>• Aeroporti, Stacioni i Trenit, dhe Stacioni i Autobusëve në Prishtinë janë larg njëra-tjetrës</li> </ul>



<p><b>Një mjedis i favorshëm për zhvillimet inovative dhe konkurruese</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlera historike dhe kulturore të cilat mund të kontribuojnë në zhvillimin e kësaj zone dhe mund të mbështesin ekonominë e dijeve</li> <li>• Ekzistenca e universiteteve, si bazë për zgjerim të mëtutjeshëm të institucioneve shkencore</li> <li>• Përqendrim i fuqisë njerëzore të punës dhe kapitalit intelektual, i lidhur me qasje të fortë të ndërmarrësisë</li> <li>• Popullata sot përbëhet kryesisht nga të rinjtë, të orientuar drejt BE-së dhe aftësi për të marrë shpejt njohuritë e teknologjisë informative.</li> <li>• Prezencë e koncentritimit të institucioneve të edukimit të lartë në Prishtinë</li> <li>• Prezencë e organizatave ndërkombëtare që janë të gatshme të ndihmojnë Kosovën gjatë periudhës së zhvillimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shenjat e rrugëve nuk janë në harmoni me standardet evropiane.</li> </ul> <p><b>Një mjedis i favorshëm për zhvillimet inovative dhe konkurruese</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesë e partneritetit të fortë publiko-privat.</li> <li>• Nivel i lartë i të papunëve (69% të pakualifikuar &amp; 60% grup-mosha 25-39) dhe varfëri</li> <li>• Cilësi e dobët e energjisë elektrike që u ofrohet konsumatorëve, ndërprerje të energjisë dhe mjete elektrike me voltazh të ulët dhe të paqëndrueshëm</li> <li>• Prezencë e fortë e mikrondërmarrjeve, kryesisht aktive në shkëmbim mallrash</li> <li>• Mungesë e tregut të punës dhe policave aktive të punës si dhe mospërputhje mes ofertës së punës të krijuar nga institucionet edukative dhe kërkesat për punë të gjeneruara nga bizneset vendore dhe të huaja</li> </ul>
<p><b>Mundësitë</b></p>	<p><b>Rreziqet</b></p>
<p><b>Prishtina, kryeqyteti: cilësi e lartë jetese, tërheqëse për të jetuar dhe punuar</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një ligj për “Prishtinën kryeqytet”, për momentin është në diskutim e sipër</li> <li>• Subvencione të Qeverisë për strehim të denjë</li> <li>• Zhvillimi i strehimit social nga grupet e specializuara jofitimprurëse ose të ulët</li> <li>• Kërkesa e fortë e objekteve kulturore dhe mundësitë e tjera sociale.</li> <li>• Krijimi i pellgjeve (për ruajtjen e ujit nga shirat) dhe trajtimi i mbeturinave.</li> <li>• Ndërtimi i kanalit për kanalet nëntokësore për infrastrukturë të elektrikes, energjisë dhe telekomunikacionit me qasje të plotë të ekipeve të mirëmbajtjes.</li> <li>• Donacionet e mundshme për promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të identifikuar në të gjitha zonat hapësinore..</li> <li>• Rritja e interesit për produktet tradicionale dhe historinë lokale.</li> <li>• Ndërtimi i paneleve diellore për energji elektrike ose prodhim të ngrohtë me ujë në</li> </ul>	<p><b>Prishtina, kryeqyteti: cilësi e lartë jetese, tërheqëse për të jetuar dhe punuar</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e presionit për banim në qytet dhe zvogëlim i madhësisë së familjes (një familje = një strehim)</li> <li>• Mungesa e mirëmbajtjes adekuate të monumenteve</li> <li>• Sasi të kufizuara të ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor</li> </ul>

shtëpitë individuale.

- Rehabilitimi i rrjedhave të ujit
- Hapja e lumenjve të mbuluar në të ardhmen

#### **Qasje e mirë nëpërmjet rrjetit material dhe jomaterial të infrastrukturës**

- Pozita gjeografike krijon mundësi të mëdha për lidhjen me korridoret rajonale dhe ndërkombëtare (e përforcuar me realizimin e Rrugës së Kombit)
- Autoudha dhe projekte të tjera janë në ndërtim e sipër ose në planifikim
- Modernizimi i linjës 10 të hekurudhës
- Pjesëmarrja e sektorit privat në të gjitha mënyrat e transportit është në rritje

#### **Një mjedis i favorshëm për zhvillimet inovative dhe konkurruese**

- Mundësitë për të orientuar kapitalin privat drejt investimeve të rëndësishme nga planet zhvillimore.
- Zbatimi i Planit Hapësinor me sipërfaqen e kaltër.
- Qasja për të fituar kapital nëpërmjet mekanizmave të stabilitetit të BE-së dhe bashkëpunimit me asistencën financiare dhe teknike.
- Lidhja në Ngrohtoren e Qytetit në Prishtinë (rrjeti ekzistues) me Termocentralin "Kosova B" (sistemi bashkëprodhim) me tarifatat më të favorshme (Plani i Veprimit i Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014).
- Ekzistenca e një Plani Zhvillimor të Arsimit të Komunës me objektiva të matshme si një integrim më të fortë të sistemit të arsimit në proceset rajonale dhe evropiane të arsimit
- Krijimi i qendrave të komunitetit në zonat rurale
- Krijimi i hapësirave për aktivitete kulturore
- Decentralizimi i objekteve dhe aktiviteteve kulturore nëpër lagje

#### **Qasje e mirë nëpërmjet rrjetit material dhe jomaterial të infrastrukturës**

- Rritja e trafikut të motorizuar në mungesë të zhvillimit të mirëfilltë të transportit publik dhe vështirësitë në sistemin rrugor bën që këto kapacitete të jenë të pamjaftueshme për transport efikas.
- Mungesë e burimeve alternative financiare.

#### **Një mjedis i favorshëm për zhvillimet inovative dhe konkurruese**

- Rritja e ekonomisë jonformale
- Largimi/ikja e personave me arsimim të lartë
- Rritja e varësisë të burimi i energjisë mono sektorial.
- Rritja e çmimeve të energjisë elektrike pas privatizimit të KEK-ut

## **1.2.2. Analizë e ndërlidhjeve në mes të çështjeve, politikave dhe programeve**

### **QEVERISJA NË KOMUNËN E PRISHTINËS**

#### **Prishtina si kryeqendër administrative**

Prishtina është kryeqendër administrative, politike, ekonomike, shëndetësore, arsimore, kulturore të parapara me ligjet e Kosovës me rol metropolitan, që veçohet për zhvillimin ekonomik, me urbanizëm bashkëkohor dhe shërbime efikase e cilësore.

Komuna e Prishtinës qeveriset sipas Statutit të Komunës së Prishtinës. Sipas këtij Statuti, Komuna është njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale, në të cilën qytetarët e saj realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet e tjera në fuqi dhe me Statutin e Komunës. Territori dhe kufijtë e komunës janë përcaktuar me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave.

#### **1.2.2.1. Funkcionimi administrativ i Komunës së Prishtinës**

Funkcionimi administrativ i Komunës së Prishtinës është i organizuar në 33 vetëqeverisje lokale, në të cilat përfshihen 43 vendbanime. 20 prej këtyre bashkësive lokale janë të vendosura në zonën urbane të Komunës së Prishtinës dhe 13 prej tyre në zonën rurale. Secila prej këtyre bashkësive lokale e ka kryetarin përkatës.

#### **1.2.2.2. Departamentet e komunës**

Shërbimet e komunës janë të organizuara në këto departamente:

- Administratë  
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Arsim
- Kulturë, Rini dhe Sport
- Financa dhe Pronë  
Ekonomi dhe Zhvillim Lokal
- Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Infrastrukturë Lokale
- Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
- Kadastra
- Inspekcioni

Kryetari i Komunës emëron Këshillin e Drejtorëve, i cili përbëhet nga drejtorët e departamenteve përkatëse.

### 1.2.2.3. Kompetencat e komunës

Me statutin e vet, komuna ka kompetenca vetjake në këto fusha:

- a) Zhvillimin lokal ekonomik;
- b) Planifikimin urban dhe rural;
- c) Shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- d) Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollin e ndërtimit;
- e) Mbrojtjen e mjedisit lokal;
- f) Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë: furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale;
- g) Përgjigjet për rastet emergjente lokale;
- h) Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- i) Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- j) Ofrimin e përkujdesjes publike parësore shëndetësore;
- k) Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç janë: përkujdesja ndaj të rrezikuarve socialë, strehimi familjar, përkujdesja ndaj fëmijëve, përkujdesja ndaj të moshuarve, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave të përkujdesjes, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- l) Banimin publik;
- m) Shëndetësinë publike;
- n) Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportin lokal publik dhe taksitë;
- o) Emërtimin e shesheve, rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- p) Ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;
- q) Turizmin;
- r) Aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive dhe aktivitet të lira;
- s) Çështje të tjera, të cilat, me ligj ose akte nënligjore, janë paraparë si kompetenca vetjake të komunës.

### 1.2.2.4. Kompetencat e deleguara të Komunës së Prishtinës

Komuna ushtron kompetenca të deleguara nga autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës në pajtim me ligjin, në fushat në vijim:

- a) Shënimet kadastrale;
- b) Regjistrimin civil;
- c) Regjistrimin e votuesve;
- d) Regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
- e) Distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);

f) Mbrojtjen e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës, në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drurëve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria.

Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës mund t'i delegojnë komunës përgjegjësi shtesë, që janë në kuadër të kompetencave të tyre, me kusht që komunës t'i sigurohen burimet financiare.

Në Komunën e Prishtinës qytetarët, në pajtim me Statutin, mund t'i iniciojnë për shqyrtim çështjet me interes publik në komunë.

Komuna organizon takime publike periodike me qytetarë, së paku dy herë në vit. Në takimet me qytetarë, përfaqësuesit komunalë i informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale. Takimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik. Takimet e tilla mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara urbane.

#### **1.2.2.5. Organet e komunës**

Organet e komunës janë: Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës si dhe Nënkryetari.

Kuvendi i Komunës ka këto komitete të përhershme:

- Komitetin për Politikë dhe Financa
- Komitetin për Komunitete dhe
- Komitetin Konsultativ.

Kuvendi i Komunës themelon edhe komitete të tjera: Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komitetin për Zhvillim Ekonomik dhe Rural, Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komitetin për Shërbime Publike dhe Komitetin për Pronë.

#### **1.2.2.6. POLITIKAT DHE PROGRAMET**

##### **Legjislacioni, Plani Hapësinor i Kosovës dhe detyrimet që dalin nga planet dhe dokumentet e tjera**

Duke marrë parasysh se Kosova është një shtet i ri, legjislacioni i saj është ende në formim e sipër. Autoriteti më i lartë legjislativ është Kuvendi i Kosovës, kurse ekzekutiv është Qeveria e Kosovës. Për momentin nuk ka ndonjë prezantim grafik të strukturës qeveritare-organogram, por organizimi i strukturave më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, mjaft qartë është prezantuar në Rregulloren e Punës së Qeverisë Nr 02/11, të shpallur më 18 prill 2011.

#### **1.2.2.7. Legjislacioni**

Legjislacioni në Kosovë është në formim e sipër. Shumë ligje, me githë mangësitë eventuale, janë aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës e disa janë ende në proces të aprovimit. Aprovimi i pakos së fundit të ligjeve pritet të bëhet së shpejti.

Ligjet e aprovuara në këtë pako që interferojnë në planifikim janë:

- 1.3. Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- 1.4. Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale;
- 1.14. Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme;
- 1.16. Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave;
- 1.19. Ligji Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave;

Kjo pako dhe revidimi i disa ligjeve kohëve të fundit në një mënyrë e kanë kompletuar infrastrukturën ligjore dhe mund të konstatohet se, në parim, Kosova ka bazë të definuar ligjore në lëmin e planifikimit.

Ligji	Trashëgimia Kulturore	VITI
	Mjedisi dhe Planifikimi Hapësinor	
	Bujqësia dhe Pylltaria	
	Turizmi	
Ligji për Pyjet në Kosovë		2003
Ligji për Planifikimin Hapësinor		2003
Ligji për Ndryshimin e Ligjit nr 2003 / 3 mbi Pyjet e Kosovës		2004
Ligji për Ujë		2004
Ligji për Mbrojtjen e Natyrës		2006
Ligji për Mbeturina		2006
Ligji mbi Tokat Bujqësore		2006
Ligji i Trashëgimisë Kulturore		2006
Ligji për Kimikale		2008
Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma		2008
Ligji për Zonat e Mbrojtura të Veçanta		2008
Rregullore Nr. 01/2008 mbi Procedurat për Gërmime / Kërkime		2008
"Rregullore Nr. 02/2008 mbi Qasjen Publike në Trashëgiminë Kulturore në Pronat Private		2008
"Rregullore Nr. 03/2008 mbi Aktivitetet e Ruajtjes dhe Restaurimit të Trashëgimisë Kulturore		2008
"Rregullore Nr. 04/2008 mbi Autorizimet dhe Kompetencat Inspektuese të Trashëgimisë Kulturore		2008
"Rregullore Nr. 05/2008 mbi Regjistrimin, Dokumentimin, Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje"		2008
Rregullore Nr. 06/2008 mbi Masat e Sigurisë për		2008

Trashëgiminë Mobile	
Rregullore Nr. 07/2008 mbi Procedurat e Licencimit për Tregtarët e Trashëgimisë Mobile	2008
Amendamenti i Ligjit në Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor nr. 2003/14	2008
Ligji për Taksën e Akomodimit në Hotele dhe Objekte Turistike	2009
Ligji për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit	2009
Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	2009
"Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, që të zëvendësojë Ligjin e mëparshëm homogjen të 2003-s"	2009(2003)
Ligji për Parandalimin e Integruar të Kontrollit të Ndotjes	2009
Ligji për Produktet Biocide	2009
Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural	2009
"ProjektLigji për Mbrojtjen nga Pa-Jonizimi, Rrezatimi i Jonizuar dhe Siguria Bërthamore"	2008
"Projektligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, që lidhet me Ligjin e mëparshëm për Mbrojtjen e Ajrit (2004)"	2009(2004)
Projektligji për Organizmat e Modifikuar Gjenetikiisht	2008
Projektligji për ndryshimin e Ligjit nr. 2003 / 3 mbi Pyjet e Kosovës	2009
Projektligji mbi Turizmin dhe Shërbimet e Turizmit, që sapo të miratohet do të shfuqizojë Ligjin e mëparshëm mbi Hotelet dhe Aktivitetet Turistike (2004)	2009(2004)

*Tabela nr. 29 Ligjet në lëmin e planifikimit*

Ligji i posa aprovuar i Ndërtimit (Nr. 04/L – 110), Ligji për Planifikim Hapësinor dhe Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, të cilët janë në rishikim e sipër, janë ligje që do të kenë një ndikim të konsiderueshëm në rregullimin e hapësirës në Kosovë dhe Prishtinë gjithashtu.

Sfidë e veçantë për rregullimin e hapësirës, po ashtu, është edhe Ligji në pritje për aprovimin e Ligjit për Qytetin e Prishtinës.

### 1.2.2.8. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+

Ky plan paraqet dokumentin e parë të ngjeshur dhe gjithëpërfshirës në lëmin e planifikimit hapësinor në Kosovën e re të pavarur. Me gjithë zvarritjet procedurale disavjeçare deri në aprovimin e tij, ky plan me karakter obligativ është dokumenti bazik dhe paraqet pikënisje në hartimin e të gjitha planeve zhvillimore në Kosovë.




Fig. 3. Plani Hapësinor i Kosovës



### 1.2.2.9. Planifikimi në Komunën e Prishtinës deri më sot

#### Plani i Përgjithshëm Urbanistik i Prishtinës deri në vitin 2000


Plani i Përgjithshëm Urbanistik i Prishtinës, me gjithë faktin që është punuar sipas rregullave ligjore të Jugosllavisë së fundit, paraqet dokumentin e parë të kompletuar dhe cilësor, me të cilin Prishtina definohet si komunë me perspektivë të zhvillimit industrial dhe bujqësor, kurse qytetit i përcaktohet korniza e një qyteti bashkëkohor. Fatkeqësisht, në kohën kur është hartuar ky plan (1987) kanë filluar konfliktet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve dhe ky plan pak ka pasur mundësi që të implementohet.



Harta 8. Plani i Përgjithshëm Urbanistik i Prishtinës deri në vitin 2000

#### Plani Strategjik i Zhvillimit Urban të Prishtinës 2004-2020

Plani i parë në periudhën e Kosovës së re, është edhe Plani Strategjik i Zhvillimit Urban të Prishtinës 2004-2020, i cili nuk është i formatit të përcaktuar me Ligjin për Planifikim Hapësinor, që është aprovuar më vonë. Por duhet të theksohet se, përveç që ka qenë plani i parë i kësaj natyre në Kosovë, ky plan ka qenë një bazë shumë e mirë e zhvillimit të qytetit të Prishtinës, në bazë të së cilës janë hartuar planet e gjertanishme rregulluese.



Harta 9. Planet strategjike të zhvillimit të Prishtinës


## Strategjia Afatmesme Zhvillimore e Prishtinës

Strategjia Afatmesme Zhvillimore e Prishtinës (2007) trajton temat thelbësore të zhvillimit të Prishtinës siç janë: Korniza institucionale, Ekonomia dhe financat, Ambienti biznesor, Menaxhimi i zhvillimit ekonomik dhe qëndrueshmëria urbane, Shërbimet publike, Arsimi, Kultura, Rinia dhe Sporti, Shëndeti publik dhe mirëqenia sociale dhe Zhvillimi rural. Në këtë dokument gjejmë edhe SWOT Analizën dhe vizionin për zhvillimin e Prishtinës që vazhdojnë të jenë aktuale edhe sot.

## Planet rregulluese të aprovuara në territorin e Prishtinës

Prishtina është në fazën e kompletimit të planeve rregulluese për zonën urbane. Deri më tani janë aprovuar 15 plane rregulluese dhe në hartim e sipër janë edhe 3 plane rregulluese urbane për pjesën jugore të qytetit.

Lagjet të cilat tashmë i kanë planet rregulluese janë: Arbëria 3, Lakrishtë, Mati 1, Dardania, Qyteza Pejton, Muhaxherët, Medrese-Çamëri, Qendra 1, Qendra 2, Ulpiana, Sofalia, Tophane, Vellusha, Dodona dhe Kalabria.



*Harta 10. Planet rregulluese të hartuara për zonën urbane të Prishtinës*

## **PLANET DHE PROJEKTET**

Lidhur me investimet dhe kapacitetet e tyre në komunë, kemi një numër të vogël të informatave.

### **Planet**

Planet rregulluese për Prishtinën e Re (Zona Lindje, Qendër dhe Perëndim)

Plani rregullues për lagjen Kodra e Trimave 1 (në proces)

Plani rregullues për lagjen Kodra e Trimave 2 (në proces të tenderimit)

### **Projektet**

Më poshtë janë të listuar projektet e planifikuara, planet e filluara, dhe ato të nevojshmet, sipas çështjeve tematike:

## **ENERGJIA**

- Komuna e Prishtinës planifikon që të ndriçohen të gjitha rrugët e asfaltuara që kalojnë nëpër vendbanime,

## **INFRASTRUKTURA**

- Unaza e brendshme, projekti detal,
- Unaza e jashtme, projekti ideor, i cili domosdo duhet të pësojë ndryshime-të korrigohet traseja
- Autoudha Morinë-Merdarë, traseja nëpër territorin e Komunës së Prishtinës
- Studimi i fizibilitetit për trenin Prishtinë-Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
- Projekt-rregullorja për caktimin e rrjetit të linjave dhe itinerarit të transportit urban dhe urbano-periferik të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Prishtinës.

## **NATYRA DHE MJEDISI**

- Hartimi i projektit për deponinë e mbeturinave të ngurta (inert) – Hajvali,
- Mbyllja e deponisë së mbeturinave “Fusha e Pajtimit”, donacion nga Komisioni Evropian,
- Pastrimi i Liqenit të Badovcit në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

## **UJËSJELLËSI DHE UJËRAT E ZEZA**

- Rehabilitimi i sistemit të ujit dhe kanalizimit në Prishtinë - Faza I (në procesin final)
- Rehabilitimi i sistemit të ujit dhe kanalizimit në Prishtinë-Faza II (në procesin e fillimit)
- Fabrika për trajtimin e ujit në Shkabaj Prishtinë – (në procesin e fillimit)
- Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës 2004-2020
- Studim i fizibilitetit për zhvillimin e burimeve të reja të ujit – 2009
- Studim i fizibilitetit për ujërat e ndotura – 2011
  - Plani urban i drenazimit për Prishtinën, Fushë-Kosovën dhe Kastriotin – 2006
  - Raporti final për misionin e gjetjes së fakteve, nëntor 2007
  - Plani zhvillimor për burimet e ujit, Liqeni i Batllavës, Liqeni i Badovcit – 2010
  - Plani afatgjatë i investimeve – 2010
  - Plani i Biznesit 2011-2015 RWCP
  - Ofrimi i një burimi të ujit të ri për Prishtinën dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujit Shkabaj -2011

## NGROHTORJA E QYTETIT

Projekti për lidhjen e Termokosit me Termocentralin 'Kosova B' – donator i së cilës është Banka Gjermane. Me këtë projekt parashikohet që të rriten kapaciteti, kontinuiteti, dhe cilësia e ngrohjes në pjesën urbane të Prishtinës.

## SINTEZA E AUDITIMIT TË AKTORËVE LOKALË

Në këtë pjesë të dokumentit janë të paraqitura disa nga mendimet e personave të intervistuar gjatë procesit të mbledhjes së informatave për fazën e parë të projektit.

Në takimet me akterët lokalë në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në Komunë, kemi marrë informata se komuna është duke ndërtuar e fusha sportive nëpër lagje, shkolla, parqe të qytetit dhe nëpër zonat rurale. por këto ende nuk plotësojnë të gjitha nevojat. Për këtë arsye një propozim ishte që të planifikohen edhe në të ardhmen ndërtimi i fushave sportive në qytet dhe fshatra.

Gjatë takimeve me Drejtorinë e Shëndetësisë në Komunë, mësuam se në qytetin e Prishtinës nuk ka spital të qytetit, dhe si pasojë e kësaj banorët e shfrytëzojnë Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Prandaj, si prioritet është planifikimi i një spitali të qytetit të Prishtinës. Gjithashtu nga akterët lokalë janë dhënë komente lidhur me spitalet private që janë në territorin e komunës apo në komunat fqinje, duke theksuar se në një shtrirje të vogël të sipërfaqes veprojnë një numër spitalesh të specializuara në fusha të ngjashme, përderisa ka fusha që duhet përkujdesur me shërbimet specifike shëndetësore qoftë në sektorin publik ashtu edhe në ate privat. Është propozuar që ndërtimi i spitaleve dhe institucioneve tjera shëndetsore të bëhet më shumë në bazë të analizës së nevojave dhe jo vetëm sipas dëshirës së pronarëve/investitorëve. Ideja është që një spital që ndërtohet të jetë i specializuar në një fushë të caktuar dhe në këtë mënyrë e formon një klientelë me shtrirje rajonale. Edhe farmacitë janë duke funksionuar pa ndonjë plan paraprak, duke mos e lejuar asnjërin të ketë fitim të mirëfilltë, apo të mbulojnë nevojat e banorëve. Në shëndetësi primare është cilësia e shërbimeve, gjë që mungon në rrjetin ekzistues të shërbimeve shëndetësore.

Gjatë takimeve me Drejtorinë për Agrikulturë dhe Pylltari kemi informata se në Komunën e Prishtinës nuk ka evidencë të saktë për tokat bujqësore dhe ndërtimore. Për këtë arsye janë duke u bërë ndërtime gjithandej, pa pasur leje dhe duke prishur planin e qytetit. Propozimi i akterëve nga kjo drejtori ishte që të bëhet një studim rreth tokave në Komunën e Prishtinës, të caktohet cilat janë tokat bujqësore dhe ndërtimore në mënyrë që sa më parë të pengohen ndërtimet pa leje. Nga i njëjti burim u informuam edhe për shoqatat e fermerëve të cilat nuk janë shumë funksionale. Propozimi ishte që këto shoqata të jenë më funksionale për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe punës së fermerëve. Një shembull është përdorimi i pesticideve, që nuk kontrollohet nga askush mirëpo përdorimi i tepërt i tyre mund të jetë i dëmshëm për produktet.

Akterët nga konsumi i ngrohtores "Termokos", japin informata lidhur me gjendjen e ngrohtores së qytetit të Prishtinës. Thuhet se Termokosi mezi që arrin t'i mbulojë nevojat e ngushta të qytetit.

Ekziston një projektplan i financuar nga Banka Gjermane, që për qëllim ka lidhjen e ngrohtores me Termocentralin 'Kosova B'.

Në takimin me akterët në udhëheqje të Komunës së Prishtinës, kuptuam se udhëheqja e Komunës ka një vizion të qartë për qytetin e Prishtinës si qendër metropolitane, e cila ofron kushte të zhvillimit të integruar me komunat e tjera, bashkëpunim ekonomik, urban, arsimor e kulturor me kryeqytetet dhe qytetet e vendeve tjera. Po ashtu ceket se ngritja e kapaciteteve zhvillimore duhet të theksohet në koridoret dhe zonat ekonomike, komerciale me Fushë-Kosovën, Lipjanin, Podujevën, Obiliqin dhe Graçanicën. Aty u theksua se duhet të krijohen kushte për zhvillimin e bizneseve për të krijuar vende pune për të rinjtë e komunës dhe më gjerë. U propozua që të ofrohen shërbime efikase për biznese, zona të mëdha industriale, parqe dhe inkubatorë të biznesit, nëpërmjet partneritetit publiko- privat dhe koncesionimit.

Kryetarët e bashkësive lokale kanë disa propozime lidhur me zhvillimet në vendbanimet e tyre. Konkretisht kryetari i Bashkësisë Lokale të Llukarit thotë se ka nevojë për asfaltimin e rrugës Sharban-Llukar, e cila do t'ua shkurtonte rrugën banorëve të Sharbanit dhe të gjitha vendbanimeve përreth në mënyrë të konsiderueshme. I njëjti ka disa ide për furnizimin me ujë. Si mundësi e parë, thotë se mund të dërgohet gypi kryesor nga shiriti i Batllavës deri në shkollën e Siqevës, pastaj mund të vendoset një pompë në kodër të Sharbanit ku përmes rënies së lirë do të furnizohej e gjithë Bashkësia lokale. Ideja e dytë është hulumtimi i liqeneve nëntokësore të rrjedhshme si burime alternative të furnizimit me ujë. Dhe ideja e tretë është propozimi për përdorimin e dy grykave në Radashevc dhe Sharban, po ashtu, me rënie të lirë për të furnizuar me ujë të gjitha fshatrat që i përkasin kësaj Bashkësie lokale.

### **1.3. VLERËSIMI I KAPACITETEVE INVESTIVE KOMUNALE**

Edhe Komuna e Prishtinës, sikurse edhe Kosova, pas përfundimit të luftës ishte përfituese e shumë programeve dhe projekteve të mbështetura nga donatorët. Në kuadër të kësaj ndihme ishin përfshirë projektet e infrastrukturës bazike, rindërtimi i shtëpive, sektori i arsimit, shëndetësisë dhe i asistencës sociale. Krahas këtyre përpjekjeve të donatorëve, ishte zhvilluar edhe sistemi fiskal dhe buxhetor i servisuar nga instrumentet e grumbullimit të të hyrave komunale dhe qendrore. Konsolidimi i të hyrave dhe shpenzimeve publike në Komunën e Prishtinës mbështetej nga të hyrat vetanake dhe nga grantet qeveritare.

## Struktura dhe dinamika e krijimit të buxhetit të Komunës së Prishtinës, në ooo Euro

Vitet	Buxheti	Të hyrat vetanake	Grantet qeveritare	% mjeteve vetanake	% granteve qeveritare
2008	39.176.359	17.383.517	21.792.842	44.4	55.6
2009	43.302.523	14.000.000	29.302.523	32.3	67.7
2010	50.940.816	19.555.125	31.385.691	38.4	61.6
2011 (Plani)	59.487.719	20.175.922	39.311.797	33.9	66.1
2012 (Vlerësimi)	61.741.684	21.752.189	39.989.495	35.2	64.8
2013 (Vlerësimi)	63.371.731	21.757.920	41.613.811	34.3	65.7

Burimi; Buxheti i Republikës së Kosovës, vitet përkatëse

Në periudhën 2008 – 2012, të hyrat buxhetore të Komunës së Prishtinës kanë treguar tendencë të rritjes së vazhduar për 61.7 %, si rezultat i rritjes së kontributit të granteve qeveritare dhe të të hyrave vetanake. Rreth 1/3 e të hyrave buxhetore mbështeten nga burimet vetanake, përdërisa ¾ kanë mbështetje nga grantet qeveritare. Një tendencë e kësaj pjesëmarrje do të ruhet kryesisht edhe në periudhën e ardhshme. Të hyrat buxhetore të Komunës së Prishtinës kanë treguar pjesëmarrje prej 3.8 % (2009) në 4.6 % në të hyrat buxhetore në nivel të vendit. Kjo rritje e pjesëmarrjes tregon për fuqinë biznese, investuese dhe konsumuese të Komunës së Prishtinës në raport me vendin.

Nën presionin e rritjes dhe migrimit të popullsisë nga viset e tjera të Kosovës, Komuna e Prishtinës nga viti 2008 filloi të implementojë projekte të rëndësishme të infrastrukturës bazike, arsimit, shëndetësisë dhe të shërbimeve sociale. Kjo është mbështetur me ndarje të konsideruara nga të hyrat buxhetore për financimin e projekteve publike. Kështu pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale ka lëvizur nga 44.4 % (2008) në 54.3 % (vlerësim për vitin 2012).

Investimet publike, në mil. Euro

Vitet	Kosova	Komuna e Prishtinës	% e Prishtinës
2008		17.4	
2009	400	20.8	5.0
2010	455	28.9	6.4
2011	572	31.2	5.4
2012	587	29.9	5.1
2013	605	35.0	5.8
2014	550		

Korniza afatmesme e shpenzimeve, MEF, vitet përkatëse

Pjesëmarrja e investimeve kapitale të Komunës së Prishtinës në ato të vendit është joproporionale në krahasim me pjesëmarrjen në indikatorët demografikë. Kështu kjo pjesëmarrje lëviz nga 5.0 % (2009) në vetëm 5.1 % (2012), me tendencë të një përmirësimi në vitin 2013 - 2014. Kjo është reflektuar edhe në strukturën e financimit të projekteve kapitale të komunës, me pjesëmarrje dominante të mjeteve buxhetore dhe më pak me projekte të ministrive të linjës dhe të donacioneve ndërkombëtare. Në periudhën e ardhshme nuk duhet pritur ndryshime të mëdha në strukturën e financimit. Vlerësojmë se një rritje më të madhe do të shënojë mjetet nga donacionet e jashtme dhe aprovimi i Ligjit mbi Prishtinën mund t'i shtojë kapacitetet investuese.

Edhe në strukturën e investimeve të sektorit privat pjesëmarrje më të lartë kanë mjetet e ndërmarrësve dhe kreditë komerciale. Mundësitë për rritjen e kapaciteteve investuese në sektorin privat duhet kërkuar në rritjen e investimeve të jashtme, shfrytëzimin e mjeteve dhe granteve të Bankës Botërore dhe të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim me fokusim në financimin e projekteve të infrastrukturës, mjedisit, efikasitetit energjetik dhe të ndërmarrjeve private. Nga kjo mund të konkludojmë se në periudhën e ardhshme do të kemi një strukturë më diversive të financimit të prioritetëve zhvillimore të Komunës së Prishtinës. Duhet pritur se do të rritet roli i partneritetit publiko–privat në realizimin e disa projekteve kapitale, si dhe përfshirja më e theksuar e investimeve të sektorit privat në projektet e arsimit, shëndetësisë, hotelierisë dhe të sportit.

#### **1.4. Sfidat kryesore të zhvillimit**

Duke u bazuar në kornizën e draftit të gjendjes aktuale dhe Analizës SWOT, janë identifikuar 5 sfida kryesore të zhvillimit, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin hapësinor.

##### ***Sfidat e identifikuar***

#### **I. Ekonomia dhe punësimi**

Prishtina është qendra e biznesit më e fuqishme në Kosovë, por ka një numër të lartë të personave të papunë; në mungesë të tregut të punës dhe politikave aktive të punësimit, gjeneratat e reja nuk po arrijnë të integrohen në tregun e punës.

*Si mund të promovojmë ndërmarrësi inovative duke u bazuar në ekonominë e njohurisë dhe t'i lidhim njerëzit me rrjetet vendore dhe botërore?*

#### **II. Trashëgimia dhe zhvillimi i qëndrueshëm**

Në kundërshtim me pasurinë në trashëgimi, është e nevojshme të nënvizohet mungesa e vetëdijes mbi trashëgiminë kulturore dhe mbrojtjen e mjedisit

*A do t'i respektojë dhe vlerësojë zhvillimi urban burimet natyrore dhe kulturore si mundësi për zhvillim?*



### III. Përdorim joracional i hapësirës/territorit

Në 20 vjet zona urbane e Prishtinës është rritur me 1000 ha me një dendësi të popullsisë shumë të ulët, ku ka shumë vendbanime të paplanifikara. Gjithashtu ka tendencë për ndërtime të objekteve të larta në veçanti në lagjet Lakrishtë dhe Pejton (42 katëshi) e që në të ardhmen është e nevojshme që me planet e reja të ritrajtohet në aspektin e infrastrukturës në përgjithësi.

*A do të jetë i mundur promovimi i procesit të “densifikimit” i shoqëruar me forcimin e shërbimeve publike dhe përmirësimin e rrjetit të qëndrueshëm të qarkullimit?*

### IV. Mjedisi i jetesës

Cilësia (niveli) i mjedisit të jetesës në zonën urbane dhe në zonat rurale është i ulët (shërbimet publike, hapësirat për ndërveprim social, shërbimet e rrjetit).

*Si të përmirësojmë cilësinë e jetesës në zonat urbane dhe në fshatra? Si të lejojmë përforcimin e rolit të kryeqytetit të një Shteti të ri?*

### V. Standarde ndërkombëtare

*Si mund të planifikojmë zhvillimin në mënyrë që t'i arrijmë standardet ndërkombëtare?*

---

## 2. VIZIONI, PARIMET DHE QËLLIMET

PZhK zotëron vizionin që ndodhet tek dokumenti "Strategjia afatmesme e zhvillimit për Prishtinën 2008-2011":

**"Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, me një rol metropolitan, i njohur për zhvillimin ekonomik, urbanizmin modern dhe efikas, shërbimet cilësore, i integruar mirë në proceset rajonale dhe internacionale, qendër e pasur kulturore, edukative dhe sportive, me shërbime të fuqishme intelektuale dhe financiare, si dhe jetë cilësore për të gjithë qytetarët e saj".**


### 2.1. Një vizion për të ardhmen e komunës

Vizioni është një deklaratë mbi të ardhmen e dëshiruar, skenari afatmesëm/afatgjatë i Komunës së Prishtinës dhe komunitetit të cilit i drejtohen idetë, projektet, akterët dhe burimet.

Duke marrë parasysh:

- Karakteristikat dhe potencialin e territorit të Prishtinës, duke u bazuar në analizë;
- Propozimet e Planit Hapësinor të Kosovës: Zona e kaltër, me Prishtinën – Zona Metropolitane, Kryeqyteti, vendndodhja e objekteve qeveritare dhe zyrat e huaja diplomatike, qasje e mirë në qytetet fqinje përbrenda Kosovës dhe jashtë, nëpërmjet një rrjeti të infrastrukturës fizike (Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020)
- Propozim i "Strategjisë zhvillimore afatmesme/afatgjatë për Prishtinën 2008-2011": "Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, me rol metropolitan, i mirënjohur për zhvillimin ekonomik, urbanizmin modern dhe lehtësira efikase dhe cilësore, i integruar mirë në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, qendër e pasur kulturore, edukative dhe sportive, me lehtësira të forta intelektuale dhe financiare si dhe jetë cilësore për të gjithë qytetarët e saj".

PZhK sugjeron një vizion për Prishtinën 2012-2022, i paraqitur në diagramin e mëposhtëm:



### 2.1.1. Kryeqytet i një shteti të ri

#### **Koncepti**

Kjo pamje bazohet në objektivat e arritjes së statusit dhe etiketimit të një kryeqyteti evropian, në linjë me parashikimet e Planit Hapësinor, duke krijuar një atmosferë të favorshme për të bërë biznes, punuar, jetuar; një mjedis ndërkombëtar, ndërsa në të njëjtën kohë forcon identitetin, përmirëson lehtësirat e ndryshme (administrative, edukative, shëndetësore, sportive, kulturore, etj.), duke siguruar një shpërndarje të përshtatshme, duke e bërë transportin (publik dhe privat) më efikas dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar në përgjithësi të jetuarit në këtë qytet dhe territor.

Për të përmbushur rolin e “kryeqytetit”, është e nevojshme të rriten qasja dhe atraktiviteti i territorit; të shtohen marrëdhëniet ndërkombëtare nëpërmjet zbatimit të rrjeteve materiale (infrastruktura e transportit dhe komunikimit) dhe të mirat e paprekshme (qarqet dhe rrjetet e bashkëpunimit mes qyteteve) dhe duke përmirësuar “imazhin” e qytetit të prezantuar në botën e jashtme.

#### **Sfidat kryesore:**

- Përfaqësimi i identitetit të një vendi nëpërmjet vlerësimit të trashëgimisë dhe krijimit të elementeve simbolike
- Ndryshimi i funksioneve: qytetit do t'i duhet që t'i mirëpresë institucionet përfaqësuese të vendeve të ndryshme; dhe si pasojë do t'i duhet që të ofrojë strehim cilësor dhe hapësirë cilësore. Do t'i duhet të ofrojë funksione të shkëlqyera të nivelit kombëtar (institucione, kulturë, muze)
- Do t'i nevojiten pajisje për mikpritje dhe kongrese, për udhëtarë biznesi (si dhe turistë)
- Do t'i duhet të transformohet në një qytet ndërkombëtar duke shprehur cilësinë dhe efikasitetin urban
- Do t'i duhet nivel i lartë i qasjes dhe lidhjeve me rrjetet botërore

### 2.1.2. Prishtina qytet për të rinjtë (NEWBORN- NEW PRISHTINA)

#### **Koncepti**

Bazuar në potencialet që i ka, Prishtina e shikon të ardhmen me shpresë dhe optimizëm. Për ta realizuar këtë nevojitet gatishmëria e të rinjve, besimi se kreativiteti dhe potenciali që ata kanë mund të jenë mjete determinuese të zhvillimit.

Të rinjtë do të jenë protagonistët e zhvillimit dhe të aktiviteteve sociale dhe ekonomike të Komunitetit të Prishtinës në të ardhmen e afërt. Të rinjtë përfaqësojnë një pjesë shumë të rëndësishme të shoqërisë vendore dhe japin kontributin e tyre në krijimin e një klime të hapur për eksperiencat, kulturat, idetë dhe kreativitetin që e karakterizon Prishtinën dhe përbëjnë një avantazh në ripozicionimin e qytetit.

Potenciali i diversitetit socio-ekonomik, kulturor, etnik dhe i gjeneratave të Prishtinës duhet të përdoret si burim i inovacionit. Qyteti i të nesërme duhet të jetë një vend i përshtatshëm për të gjithë - të moshuarit dhe familjarët, dhe gjithashtu një vend tolerance dhe respekti.

Prishtina duhet të bëhet një realitet ideal ku të rinjtë kanë mundësitë për të krijuar biznese të reja, rrjete të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të cilat mund të konkurojnë në tregun botëror duke pasur parasysh masën dhe prirjen e tyre, shkathtësinë dhe zgjuarsinë. Kreativiteti i të rinjve është një burim inovacioni i ripërtëritur dhe i palodhshëm, dhe ka kapacitetin më të lartë për rritje dhe

zhvillim ekonomik. Prandaj, të rinjtë janë subjekte të privileguara për të drejtuar mbështetjen sociale për ndryshimet urbane dhe territoriale që do të ndikojnë në ndryshimin e qytetit në të ardhmen e afërt.

### **Sfidat kryesore:**

- ➔ Forcimi dhe rritja e cilësisë së arsimit, sistemit parauniversitar dhe universitetit: dija duhet të luajë një rol kryesor në krijimin e vlerave, jo vetëm në teknologjitë më të avancuara që janë të orientuara drejt prodhimit në masë, por në një prodhim më tradicional dhe të afërt për blerësit
- ➔ Krijimi i strukturave për lehtësimin e themelimit të bizneseve të reja: inkubatorë të biznesit dhe qendra teknologjike të ofruara nga universitetet dhe bizneset
- ➔ Eliminimi i përjashtimit digjital që është akoma i pranishëm (të bëhen rrjete të arritshme për të gjithë dhe me një kosto të ulët);
- ➔ Përmirësimi i ofrimit të hapësirës dhe mjeteve për të rinjtë: kulturore (libra dhe qendra të mësimin, etj..), sportive (qendra sportive në ndërtesat e shkollave fillore, etj..), sociale.

### **2.1.3. Prishtina: një territor me cilësi**

#### **Koncepti**

Në vitet në vijim Prishtina, ndryshe nga kryeqytetet e tjera evropiane, akoma përballet me presione të mëdha të zhvillimit që shkaktohen nga faktorët e mëposhtëm<sup>10</sup>:

- Rritje e paparashikuar e popullsisë për shkak të shtimit të jetëgjatësisë, numri mesatar i anëtarëve të familjes është në rritje, kushte të përmirësuara, migrimi nga zonat rurale, që e konsiderojnë Prishtinën si pikë referuese për zgjidhjen e vështirësive ekonomike dhe kthimin e migruesve për shkak të krizës ekonomike në Evropë;
- Duhet të priten kërkesa të larta për banime në të ardhmen...(dhe hapësira për funksione tjera);
- Rritje e kërkesës për shërbime (hapësira publike, parking, dhe rrjete të shërbimeve)

Nga ana tjetër, Prishtina ka burime natyrore (mbi 50% e territorit), sipërfaqe urbane dhe rurale, tokë bujqësore me cilësi të lartë, e cila paraqet një identitet territorial. Ky territor vlerësohet si një kompensim ekologjik, rezervë e prodhimit të ushqimit, edhe si rezervuar që përdoret nga popullsia, edhe si ofruar i të mirave dhe shërbimeve të ekosistemit.

Komuna e Prishtinës nuk mund të përballojë t'i përsërisë gabimet që kanë qënë si pasojë e shtrirjes së ciklit urban në shumë qytete të tjera (veçanërisht në Evropën Jugore), përkundrazi, duhet t'i shikojë modelet e reja të zhvillimit urban, që tashmë janë zbatuar në shumë vende të Evropës Veriore<sup>11</sup>. Si fillim duhet të japë një përgjigje ndaj asaj që identifikohet si pyetje kryesore:

<sup>10</sup> Disa indikatorë ndryshojnë shumë nga stadardet e qyteteve të tjera: masa e familjes (mes. 4,9) shumë e lartë por në zbritje (BE max. 3,0 dhe është duke shkuar drejt 2,0) (REKOS, BE: Auditimi Urban); sip mes e jetesës 11 m<sup>2</sup> për person (SPUDoP 2004), mesatarja e kryeqyteteve baltike nga 23 deri në 18, Ljubljana 26, Zagrebi 23.

<sup>11</sup> Dy vizione konkurruese me njëra-tjetrën i japin formë ekonomisë dhe shoqërive bashkëkohore (Qytetet e së nesërme-sfidat, vizioni, dhe rruga për të ecur përpara, Komisioni Evropian, 2011):

- 1) Vizioni i ekonomisë me më pak karbon në kontekstin e debateve të gjera rreth ndryshimit të klimës dhe zhvillimit të qëndrueshëm

## si ta kënaqim kërkesën në rritje për zhvillim urban, ndërsa ta ruajmë territorin dhe t'i përmirësojmë shërbimet për banorë (që janë të papërshtatshme)?

**Sfidat kryesore** që duhet të përballen, për të arritur këtë janë:

- ➔ Përmirësimi i rrjeteve të transportit publik (në hekurudha urbane të lehta nëpër qytet dhe periferinë që rrethon qytetin, në korsi të dedikuara për autobusë dhe shtigje për biçikleta) mund t'u mundësojë njerëzit që të punojnë në kryeqytet, ndërsa vazhdojnë të jetojnë në vende tjera dhe anasjelltas (ndoshta në ndonjë qytet më të vogël që ofron shërbimet bazë);
- ➔ Shmangia dhe zgjidhja e shtrirjes urbane<sup>12</sup> duke promovuar procesin e "densifikimit", ku do të duhet t'i kushtohet vëmendje ndjeshmërisë së zonave të ndryshme urbane, dhe do të shoqërohet me strukturimin e mobilitetit dhe rrjeteve të shërbimeve, forcimin e hapësirave të qytetit publik (shërbimet, parqet urbane, sheshet, vendparkimet, garazhet, etj);
- ➔ T'u japë një rol hapësirave periferike-urbane duke gjetur lidhje të reja mes qytetit dhe peizazhit bujqësor shumëfunktional, duke përcaktuar kufijtë e rritjes urbane për të mbështetur stabilitetin afatgjatë të rritjes së qytetit;
- ➔ Të fillojë një proces të hollësishëm të rinovimit të pjesës urbane të qytetit ekzistues me një qasje të integruar dhe me pjesëmarrjen e burimeve publike dhe kapitalit vetanak. Evropa që disa vjet ofron instrumente të financimit për t'i promovuar këto procese.
- ➔ Të ruajë efikasitetin e ekosistemeve të siguruara nga trashëgimia natyrore bujqësore, të ruajë tokën që të mbetet e paprekur si një aset që duhet vlerësuar; të promovojë një lidhje të re mes multifunksionalitetit të bujqësisë, cilësisë së mjedisit, eko-turizmit dhe turizmit familjar.

### 2.2. Parimet e përgjithshme për zhvillim/mbrojtje

PZhK është zhvilluar duke u bazuar në parimet e mëposhtme. Ato janë parime të përgjithshme që duhet të ndërmerren nga PZhK-ja, duke u ngritur nga korniza legjislative e një niveli më të lartë dhe Planin Hapësinor të Kosovës (zhvillim i qëndrueshëm dhe kohezion social).

Prishtina, si shumica e qyteteve të tjera, përballlet me një sërë problemesh mjedisore, si p.sh. cilësi e dobët e ajrit, nivel i lartë i trafikut, nivel i lartë i zhurmës së ambientit, mjedis i ndërtuar me cilësi të ulët, toka të braktisura, emetime të gazrave, shtrirje të gjerë urbane, dhe trajtimi i mbeturinave e kanalizimeve, etj. Këto probleme lidhen me një zhvillim urban që nuk është i orientuar drejt mjedisit.

Parimet e përgjithshme për zhvillimin dhe mbrojtjen ofrojnë një kornizë direktivash, të cilat vijnë nga një planifikim i rëndësishëm dhe dokumente zhvillimore në nivelin vendor, evropian dhe botëror:

---

2) Vizioni i një shoqërie post-Fordiste të bazuar në njohuri, në të cilën njohuritë dhe aftësitë shihen si faktorë kyçë për konkurrencë dhe gjeneratorë të pasurisë.

<sup>12</sup> Shtrirja urbane është sinonim me zhvillimin e paplanifikuar urban, i karakterizuar nga një përzjerje e përdorimit të tokës urbane me atë rurale. Zhvillimi është si i shpërbërë, me një tendencë për të mos avancuar. Kjo i kapërcen disa zona, duke zënë hapësira bujqësore, ndërsa në qytet ka hapësira boshe. Ky lloj i zhvillimit ad-hoc krijon humbje dhe ka tendenca të ketë ndikim negativ në mjedis (përdorim i lartë i energjisë nëpër shtëpi individuale, lidhje të shtrenjta, dhe përdorim i madh i energjisë për shkak të lëvizshmërisë, meqenëse puna dhe jetesa kanë tendenca të jenë larg njëra-tjetrës (BE: PSUD)

- Ligjet dhe udhëzimet administrative në Planifikimin Hapësinor dhe Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020;
- Parimet udhëzuese për zhvillim të qëndrueshëm BE (nga strategjia tematike për direktivat mjedisore urbane për qytetet e së nesërme)
- Parimet për zhvillim të qëndrueshëm – Agjenda 21

Për t'i kundërshtuar aspektet negative të cekura më lart, më poshtë janë cekur disa parime të rëndësishme për Planin Zhvillimor Komunal të Prishtinës.

### ***Një zhvillim hapësinor kompakt***

Për të ruajtur tokën bujqësore dhe për një përdorim më racional të territorit dhe mbrojtjes së burimeve, Plani Zhvillimor Hapësinor duhet të synojë për një zhvillim më kompakt me dendësi më të lartë të zënies së tokave.

Përdorimi më i përzier, densifikimi dhe kontrollimi i shtrirjes urbane janë tri çështjet kyçe që duhet të frymëzojnë PZhK-në: më shumë ndërtesa, banorë, dyqane, dhe shërbime pranë njëra-tjetrës që e lehtësojnë qarkullimin, për të mundësuar një përdorim më efikas të shërbimeve dhe burimeve, dhe për të krijuar një vend më të përshtatshëm dhe kënaqshëm për të jetuar. Një qytet më kompakt, është një qytet që konsumon më pak burime dhe mund të zbatojë sisteme të transportit në mënyrë më efektive me një kosto më të ulët.

### ***Kriteret e zonimit të orientuara nga mbrojtja e mjedisit dhe kohezionit social***

Përcaktimi i hapësirave të caktuara duhet t'i përmbushë kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, duke ngritur cilësinë e jetesës dhe shëndetin publik në këtë zonë, dhe përdorimin racional të burimeve natyrore (p.sh.: hapësirat për banim, sport dhe argëtim nuk mund të jenë pranë kapaciteteve industriale; hapësirat për banim dhe për të gjitha qëllimet e tjera, përveç agrikulturës, nuk mund të jenë në kategoritë e tokave bujqësore, I deri IV, etj.).

### ***Krijimi dhe sigurimi i hapësirave publike me cilësi të lartë***

Sasia dhe cilësia e hapësirave publike luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e kushteve të jetesës së popullsisë urbane. Si një faktor vendor, cilësia e hapësirës urbane është e rëndësishme për të tërhequr investimin industrial, burime njerëzore të afta dhe kreative, dhe për të rritur turizmin.

Cilësia dhe dukja e pejsazhit urban dhe hapësirave publike janë faktorë të rëndësishëm që bëjnë qytetin joshës. Hapësira publike tërheqëse, funksionale dhe mjedisi i dizajnuar si duhet, mund të shndërrohen në simbole të një qyteti dhe simbole të tërbashkëjetesës. Kjo i jep banorëve ndjenjë e përkatësisë së këtij qyteti. E më e mira do të ishte që hapësirat publike të jenë shumë funksionale, përshtatshme për të moshuarit, të mund t'i akomodojnë fëmijët, të jenë vend takim për të gjithë dhe njëherit të shërbejnë për aktivitete specifike.

***Të bëhet qarkullimi i qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe i shëndetshëm, një qytet që arrihet dhe udhëtohet lehtë***

Zhvillimi i qarkullimit të qëndrueshëm është një sfidë kyçe për qytetet e së nesërme. Mobiliteti i qëndrueshëm përfshin dimensione dhe përbërës të ndryshëm: sistem transporti i qëndrueshëm, efikas në harxhimin e energjisë dhe i përbalueshëm; një ambient miqësor për mënyrat e transportit me biçikletë dhe në këmbë; qasje e lehtë në të gjitha lagjet në këmbë, biçikletë apo transport publik; rrjete urbane që duhen planifikuar në kontekstin e përdorimit gjithëpërfshirës të tokës dhe zhvillimit hapësinor; dhe nyje transporti që duhet të integrohen mirë me aktivitetet sociale, kulturore dhe ekonomike, duke përfshirë argëtimin. Infrastruktura e qarkullimit duhet të zhvillohet me një perspektivë afatgjatë në të cilën merren parasysh nevojat për të ardhmen, zhvillimet urbane, hapësinore dhe teknologjike.

### ***Një balancë mes natyrës dhe traditës***

Territori i Komunës së Prishtinës duhet të zhvillohet në mënyrë të balancuar, për aq sa është e mundur.

Një balancë e zhvillimit me natyrën thekson se ka një nivel të intensitetit të banimit, ku burimet që konsumohen do të zëvendësohen nëpërmjet cikleve natyrore të stinëve, duke krijuar kështu një ekuilibër mjedisor. Një balancë mes zhvillimit e natyrës ka si qëllim përdorimin racional të burimeve natyrore dhe një balancë më e mirë mes zhvillimit social, ekonomik, dhe mjedisor.

Balanca me traditën ka si qëllim t'i integrojë ndërhyrjet e planifikuara me asetet kulturore ekzistuese, duke respektuar praktikat tradicionale. Ky parim i planifikimit urban kërkon të respektohet trashëgimia kulturore e vendit. Planet hapësinore, planet rregulluese dhe planet e menaxhimit përmbajnë masa gjithëpërfshirëse për t'i mbrojtur vlerat natyrore dhe kulturore, si dhe integritetin historik.

### ***Rëndësia në rritje e planifikimit të periferisë urbane***

Realiteti i ri urban në Prishtinë është i karakterizuar nga zhvillimi urban periferik. Lidhjet e reja mes qytetit dhe rrethinave janë duke u zhvilluar, bashkë me rritjen e lëvizshmërisë individuale: njerëzit jetojnë në zona rurale, bëjnë jetë urbane dhe përdorin shërbime urbane; banorët urbanë përdorin shërbimet rurale të mira publike, si natyra; shkollat dhe shërbimet e tjera nuk zgjedhen në bazë të afërsisë por në bazë të cilësisë; modelet e përditshme të lëvizshmërisë shtrihen në sipërfaqe gjithmonë në rritje.

Në Prishtinë, si dhe në zonat e rritjes së BE-së, periferia është shpesh një zonë e shtrirjes së shpejtë dhe kaotike urbane. Është e qartë se periferia nuk është thjesht një zonë diku në mes, por është një lloj i ri i territorit shumë funksional. Shpesh është një vend që përdoret për aeroport, park biznesi dhe banim me vlera të larta, të cilat janë esenciale për zhvillimin urban/rajonat. Gjithashtu është si vendndodhje për probleme: shtrirja urbane; fonde publike të humbura; bllokime të transportit; humbje e tokës bujqësore; dëmtim i peizazhit dhe biodiversitetit; komunitete të fragmentuara; dhe mungesë e planifikimit hapësinor.

PZhK duhet të përfshijë udhëzime, rregulla dhe instrumente për të rimodeluar këtë hapësinë.

## ***Një përdorim shumë funksional i territorit rural***

Në shekullin e fundit, zhvillimi i me qytetit dhe pjesës rurale e ka humbur baraypeshën. Fshati është parë kryesisht si vend suburbanpotencial i mundshëm i zhvillimit të bujqësisë industriale. Kjo gjendje duhet të ndryshojë nëpërmjet të një zhvillim të qëndrueshëm: zonat e gjëra të peizazhit ofrojnë hapësirë për instalimin e turbinave të erës dhe prodhimit të biomasës; fshati, një furnizues bazë i ushqimit, mund të ofrojë edhe energji të gjelbër. Fshati mund të ofrojë edhe turizëm, rekreacion, jetë sportive dhe ambient të qetë e të pastër.

## ***Drejt një 'Smart City' ('qytet i mençur')***

Performanca urbane varet jo vetëm nga përmbajtja e qytetit me infrastrukturë të rëndë (aset fizik), por gjithashtu nga gjindshmëria, cilësia e komunikimit të dijës, dhe kapitali intelektual e social. Kjo formë vendos për konkurrencën urbane. Koncepti i "smart city" është prezantuar si një mjet strategjik për të rrethuar faktorët modernë urbanë të prodhimit në një kornizë të përbashkët dhe për të nënvizuar rëndësinë në rritje të teknologjisë informative dhe të komunikimit, kapitalit social dhe intelektual në profilizimin e konkurrencës së qyteteve.<sup>13</sup> Një "smart city" është një qytet që investon në kapitalin njerëzor dhe proceset sociale të pjesëmarrjes, edukimit, kulturës dhe infrastrukturës për komunikimet e reja. Një "smart city" duhet të ofrojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, të sigurojë cilësi të lartë të jetesës për të gjithë qytetarët, dhe të ofrojë menaxhim të përgjegjshëm të burimeve natyrore dhe sociale, me anë të qeverisjes nëpërmjet pjesëmarrjes. PZhK duhet të shtyjë përpara shndërrimin e Prishtinës në një "smart city".

## ***Qasja e integruar si një vlerë e shtuar***

Sfida e zhvillimit të integruar urban është që të promovojë konkurrencën dhe përfshirjen sociale, derisa përmirëson ambientin e ndërtuar dhe atë natyror, në mënyrë që të përmirësohen kushtet e jetesës. Ky është një përcaktues kryesor në cilësinë e jetës në zonat urbane dhe një faktor vendimmarrës për tërheqjen e bizneseve. PZhK-ja duhet të bazohet në një qasje të integruar. Për të arritur konkurrencën dhe kohezionin social brenda zhvillimit urban dhe strategjive e programeve rigjeneruese, duhet të përfshihen një sërë tiparësh. Këto tipare përfshijnë rritjen ekonomike dhe punësimin, aspektin mjedisor si efikasiteti i energjisë dhe ndryshimi i klimës, varfërinë, krimin, integrimin e emigrantëve dhe minoriteteve etnike, barazinë gjinore, ndryshimin demografik, shtrirjen urbane, arkitekturën, kulturën dhe qeverisjen e mirë.

## ***Rëndësia e qytetit të Prishtinës (në rritje e sipër) dhe zhvillimi i tij në harmoni me kryeqytetet (metropolet) në rajon***

Bashkëveprimi mes qendrave urbane dhe rrethinave me hapësirë rurale është një sfidë serioze, bashkë me rezistencën dhe rrezikueshmërinë e burimeve natyrore në periferi. Qytetet e mëdha kanë nevojë për rrethina të mëdha, dhe mund të lindin konflikte me qytetet e tjera apo përdoruesit e bujqësisë rreth burimeve dhe përdorimit të tyre. Qeverisja me shumë nivele është jetësore për zhvillimin e qyteteve rajonale për sa i përket konkurrencës dhe kohezionit.

<sup>13</sup> Bruksel, 10.07.2012 c(2012) 4701 "Komunikimi nga komisioni i smart cities – partneriteti evropian për inovacion"



### 2.3. Caqet e zhvillimit afatgjatë

**Qëllimet** janë shprehjet më të gjëra të dëshirave të komunitetit. Qëllimet i japin drejtim planit në tërësi. Qëllimet janë të lidhura me afat gjatësinë, dhe shpesh përshkruajnë situatën ideale që do të rezultonte nëse realizohen plotësisht të gjitha synimet. Meqë qëllimet vlerësohen në bazë të vlerave, është e vështirë të matet arritja e tyre.

#### **QËLLIMI 1: Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm dhe rritje e punësimit në një qytet tërheqës dhe kreativ**

- Objektivi I. Vlerësimi i Universitetit publik dhe institucioneve të tjera të edukimit publik dhe privat, hulumtimeve<sup>14</sup>, dhe lidhjet me sektorin ekonomik; të ulët distanca mes trajnimeve profesionale dhe tregut të punës
- Objektivi II. Krijimi i kushteve për të tërhequr kapitalin/investimet e huaja
- Objektivi III. Themelimi i parqeve të biznesit dhe zonave industriale; zhvillimi i një nyjelloreje për mallra (HUB)
- Objektivi IV. Përmirësimi i efikasitetit të sektorit publik në furnizimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset;
- Objektivi V. Zhvillimi i projekteve të mëdha të investimeve nëpërmjet partneritetit publiko-privat.

#### **QËLLIMI 2 : Prishtina në rrjetet botërore**

- Objektivi I. Rritja e qasjes në rrjetet ndërkombëtare të transportit (lidhje me korridoret evropiane, duke pasur si qëllim lidhjen veçanërisht me korridoret V, VI, VIII, dhe X);
- Objektivi II. Krijimi i kushteve dhe mjeteve kulturore që kërkohen, e po ashtu i një edukimi që u mundëson të rinjve që t'i rrisin njohuritë e tyre drejt një standardi botëror, duke u bërë kështu konkurrencë kolegëve të tyre në Evropë dhe në botë (Prishtina drejt "smart city", krijimi i zonave të lira të internetit etj.);
- Objektivi III. Pjesëmarrja në rrjete ku ka ndërveprim të njohurive midis qyteteve ndërkombëtare.

#### **QËLLIMI 3 Qytetarëve t'u sigurohet një sistem efektiv dhe cilësor i shërbimeve publike dhe një mjedis i rehatshëm urban**

- Objektivi I. Të ofrohet edukim cilësor dhe gjithëpërfshirës: Krijimi i një rrjeti të shkollave që i përmbushin nevojat e qytetarëve me qasje të duhur dhe objekte të përshtatshme: laboratorë, salla sporti, rrjet kompjuterik dhe internet; zgjerimi i rrjetit të institucioneve parashkollore dhe shkollave në zonat rurale;
- Objektivi II. Të ofrohen shërbime cilësore shëndetësore dhe të mirëqenies sociale, duke rritur kapacitetet fizike dhe njerëzore të institucioneve të shëndetit, ndërtimi i spitalit të qytetit, të ofrohen shërbime shëndetësore të përshtatshme në lidhje me standardet e shëndetit;
- Objektivi III. Të promovohen kultura dhe sporti për të rinjtë dhe të tjerët;
- Objektivi IV. Të zhvillohet dhe modernizohet Administrata komunale për qytetarët
- Objektivi V. Të ofrohet infrastrukturë e përshtatshme për shëndet dhe higjienë nëpër qytet dhe fshatra (furnizim me ujë, hedhja e mbeturinave, energjia, menaxhimi i mbeturinave, zona të gjelbërta).

<sup>14</sup> Përqendrimi i institucioneve të edukimit të lartë në Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, universitetet private, Klinika Universitare, hulumtimet dhe institutet e zhvillimit bashkë me agjencitë, mund të shërbejnë si një ndërmarrje për aktivitetet e njohurisë së ekonomisë, një grupim i krijuar për zgjerim dhe zbatim në aktivitetet e prodhimit ekonomik dhe ndërsjelltas.

#### **QËLLIMI 4 Zhvendosja e njerëzve dhe mallrave në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme**

- Objektivi I. Krijimi dhe kompletimi i një sistemi efektiv të komunikacionit, për qytetin dhe Zonën e gjerë urbane, mënjanimi i komunikacionit tranzit; implementimi i tri “unazave” për organizimin e sistemit të transportit;
- Objektivi II. Krijimi i një sistemi efikas i parkimit për automjetet në qytet dhe një shkëmbim me parkingjet të cilat gjinden në periferi, me qëllim të mënjanimi apo zvogëlimit të numrit të automjeteve në qendrën e qytetit (brenda unazës qendrore, qendrës historike);
- Objektivi III. Mirëmbajtja e vazhdueshme dhe përmirësimi i sistemit të rrugëve të vjetra, në përputhshmëri me standardet në bazë të klasifikimit hierarkik dhe ndërtimi i atyre të reja për një transport më efektiv (sidomos në zonat rurale);
- Objektivi IV. Zhvillimi i rregullt dhe i besueshëm i linjave të transportit publik, duke përfshirë linja të reja të lehta të transportit hekurudhor dhe modernizimi i mjeteve të transportit publik;
- Objektivi V. Ruajtja dhe forcimi i linjave hekurudhore (apo tramvajet) me polaritete të ndryshme urbane (aeroporti, stacioni i autobusëve, qendra e qytetit, etj.);
- Objektivi VI. Zhvillimi i një rrjeti për shtigje të çiklistëve, përmirësimin e sigurisë së këmbësorëve dhe rrugëve me pengesë të lirë;
- Objektivi VII. Organizimi i transportit të mallrave brenda qytetit (kufizon kohën e qasjes, më pak shkarkime të automjeteve etj.).

#### **QËLLIMI 5 Forcimi i identitetit duke vlerësuar peizazhin historik dhe kulturor**

- Objektivi I. Vlerësimi i trashëgimisë historike (Hartimi i planeve rregulluese për qendrën e qytetit dhe zonën historike; rehabilitimi i objekteve fetare dhe historike, etj);
- Objektivi II. Promovimi dhe zhvillimi i formave të ndryshme të turizmit: turizmi arkeologjik, eko-turizmi ose turizmi i gjelbër, duke shfrytëzuar natyrën dhe peizazhin e bukur; turizmi kulturor i kombinuar me turizmin rural;
- Objektivi III. Zgjerimi i atraksioneve turistike (të kualifikohen muzetë, etj);
- Objektivi IV. Mirëmbajtja dhe krijimi i infrastrukturës turistike;

#### **QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore**

- Objektivi I. Vlerësimi i tokës pjellore bujqësore (përdorimi efikas i tokës bujqësore dhe mbështetja për produktivitet ekologjik, multi-funksionalitetit, tregut të fermerëve, shërbimet e sigurta për fshatrat rurale);
- Objektivi II. Mbështetja e fermerëve me mjete teknike ose financiare në ndërtimin e serrave, rregullimin dhe ndërtimin e fermave të vogla. Nxitjen e investimeve në pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e lumenjve nga abuzimet dhe përdorimi joefikas;
- Objektivi III. Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe ofrimi i shërbimeve publike në zonat rurale, duke i shërbyer edhe zhvillimit të turizmit në peizazhin e bukur të Kosovës;
- Objektivi IV. Zhvillimi i një parku të madh natyror për rekreacion dhe aktivitete për argëtim;
- Objektivi V. Ruajtja e biodiversitetit: zhvillimi i rrjetit ekologjik brenda në qytet; zhvillimi i zonave të gjelbërta, të pasura me biotope.
- Objektivi VI. Ruajtja e pyjeve, ndihmesa për qasjen dhe përdorimin rekreativ, nxitja për mirëmbajtjen e duhur.

#### **QËLLIMI 7 Drejt një modeli të ri të zhvillimit hapësinor urban**

- Objektivi I. Bashkëpunim i përhershëm me komunat fqinje (Zona të mëdha urbane dhe Zona e kaltër të PHK) dhe agjencitë qendrore (Politikat duhet të reflektojnë realitetin aty ku njerëzit jetojnë dhe punojnë, ashtu siç bëjnë institucionet të cilat projektojnë apo dizajnojnë

politika të tilla). Ndërlidhja e qyteteve dhe hapësirës rrethuese ndikojnë në rritjen e performancës kombëtare dhe të kualitetit të jetës. Prishtina duhet të jetë e lidhur ngushtë me Zonën e saj të gjerë urbane (TEK, Aeroporti, Stacioni hekurudhor F.) dhe të qyteteve me hapësirë të kaltër;

- Objektivi II. Shmangia e shpërndarjes urbane, të ndalohen ndërtimet e paligjshme dhe të përkrahët zhvillimi i rregullt i qytetit 15;
- Objektivi III. Fillimi i një procesi të plotë të renovimit (apo rregullimit) urban të qytetit ekzistues;
- Objektivi IV. Në lidhje me zhvillimin dhe rregullimin urban; Promovimi i partneritetit publik dhe privat; organizatave joqeveritare të specializuara në banim; stimulimi i bashkëpunimit në mes grupeve të njerëzve në pritje të ndërtimit të shtëpive të tyre;
- Objektivi V. Themelimi i institucionit të planifikimit nga Komuna e Prishtinës dhe plotësimi i planeve të bazuara në ligje; themelimi i një mekanizmit efektiv të administrimit urban.

## 2.4. Prioritetet strategjike

Në lidhje me vizionin, PZhK zbulon 6 prioritetet strategjike:

1. Arritja e një sistemi të transportit publik, duke rritur edhe dendësinë urbane
2. Përmirësimi i qasjes së territorit dhe qytetit nëpërmjet riorganizimit të sistemit të rrugëve
3. Ruajtja dhe vlerësimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore
4. Krijimi i një mjedisi më përfshirës, duke përmirësuar vendbanimet ekzistuese dhe duke iu ofruar shërbime, zona të gjelbërta dhe vende të ndërveprimit social si dhe krijimi i shtigjeve për të ecur në këmbë dhe biçikletë në mënyrë të sigurt
5. Identifikimi i strategjive zhvillimore për zonat rurale dhe ofrimi i shërbimeve pranë vendbanimeve.
6. Ofrimi i një sistemi të trajtimit të kanalizimeve për qytetin, një sistem për mbledhjen e mbeturinave, përmirësimi i ofrimit të energjisë elektrike, përmirësimi i ofrimit të ujit të pijshëm dhe zhvillimi i strategjive për rritjen e efikasitetit të energjisë.
7. Ndërtimi i deponisë për mbeturinat nga konstruksioni dhe demolimi, përkatësisht riciklimi i tyre.

---

<sup>15</sup> Të përcaktohen udhëzimet e reja për zhvillim urban: të përcaktohet zonat kryesore për publikun ku do të vendosen funksionet primare; të ruhen hapësirat e lira brenda qytetit për krijimin e qendrave të shërbimeve publike; të përcaktohet infrastruktura (rrugët, shtigjet për çiklistë, transporti publik, rrjeti i shërbimeve); të rregullohet hedhja e paautorizuar e mbeturinave si dhe çështja e ndërtimeve të paligjshme; të përcaktohen kufijtë e rritjes urbane për të ndihmuar qëndrueshmërinë afatgjatë të rritjes së qytetit, etj.

### 3. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL

---

#### 3.1. Konceptet kryesore të zhvillimit hapësinor: 7 objektivat

Komponentët e Kornizës për Zhvillim Hapësinor janë të ndërlidhura fuqishëm dhe duhet të zbatohen përmes **objektivave të integruara dhe shumëfaktoriale**, të cilat mund t'i rrisin sinergjitë e mundshme dhe të maksimizojnë ndikimin e veprimeve të ndryshme sektoriale.

Bazuar në vizionin dhe qëllimet afatgjata strategjike të PZHK-së, janë identifikuar 7 objektiva të paraqitura në vijim. Objektivat drejtpërdrejt të ndërlidhura me rritjen urbane (n° 1,2 dhe 3), kërkojnë rregulla sektoriale për një sistem më të qëndrueshëm të lëvizshmërisë dhe rritjen e dendësisë së vendbanimeve.

#### ***Objektivat për rritjen e qëndrueshme urbane***

1. Përforcimi i boshtit kryesore urban për rolin e kryeqytetit
2. Një qytet i këndshëm për të gjithë qytetarët
3. Një zhvillim policentrik urban hapësinor

#### **Politikat sektoriale për t'i mbështetur këto strategji:**

- a) Një lëvizshmëri të qëndrueshme për të mbështetur rritjen urbane
- b) Madhësia dhe dendësia e popullsisë urbane

#### ***Objektivat për zhvillimin e zgjuar (rritjen e vlerave)***

4. Vlerat kulturore dhe natyrore: ruajtjen e identitetit, përmirësimin dhe vlerësimin
5. Rritja e vendbanimeve rurale, model për një zhvillim të ri bujqësor
6. Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban
7. Përkrahja e 'Start Up' për ndërmarrjet e reja




Fig.4. Korniza e zhvillimit hapësinor komunal

### 3.1.1. Përforcimi i boshtit kryesor urban për rolin e kryeqytetit

#### Çështjet kritike

Prishtinës i duhet një strukturë shumë më e avancuar për të qenë një kryeqytet evropian. Në veçanti, mund të identifikohen dobësitë sikur:

- Mungesa e infrastrukturës përkatëse krahasuar me atë në nivel ndërkombëtar
- Pejsazh i debalansuar urban.

#### Qëllimet dhe synimet

Qëllimi kryesor është **përforcimi i rolit funksional dhe imazhit urban të Qendrës së qytetit me organizimin e një aksi të fortë urban të zhvilluar përgjatë linjës hekurudhore.**

Duhet organizuar një sistem efikas intermodal për të siguruar qasje në Qendrën e qytetit në kontekst më të gjerë kombëtar/rajonar:

- Lidhjet në autostradë dhe në unaza
- Krijimi i një sistemi masiv tranzitor rajonal/urban nëpërmjet përmirësimit të linjës hekurudhore ekzistuese që lidh pjesë të ndryshme të zonës urbane, zona "trekëndësh" (ZHEK), aeroporti.

Stacionet duhet të bëhen "shpërndarës", të cilat lidhin distanca të gjata të transportit (kombëtar/rajonar) me ato lokale dhe "pikat kryesore" për organizimin e mundshëm të zonave të gjera të këmbësorëve.

"Boshti urban" duhet menduar si një sekuencë (një sistem linear) i "polaritetit" urban, të cilat do të përfshijnë pajisje të nivelit të lartë të lidhura me rolin ndërkombëtar dhe kombëtar të qytetit.

## **Koncepti**

### **Hierarkia funksionale:**

Stacionet tranzit në masë si "nyjë" të intermodalitetit dhe vendeve "kryesore" për ndërhyrje të rinovimit urban, përmirësimit dhe ndërhyrjet që synojnë krijimin e ri - ose rritjen e "polaritetit" ekzistues me një identitet të fortë funksional dhe një imazh tërheqës urban.

### **Përdorimi i përzier:**

Polaritetet përgjatë aksit duhet të përfshijnë komplekset institucionale/qeveritare dhe administrative, si dhe ato kulturore, rekreative dhe turistike të kualitetit të lartë, duke përfituar nga niveli i lartë i qasjes.

Vëmendje duhet t'i kushtohet integritet të funksioneve të reja dhe ekzistuese në mënyrë që të sigurohen zonat urbane të gjalla multifunksionale.

Një raport i caktuar i përdoruesve urban (d.m.th. të paktën 30% të sipërfaqes së bazës) duhet të sigurohet në çdo polarizim nga mbajtja e sipërfaqeve ekzistuese ose krijimin e sipërfaqeve të reja.

### **Qarkullimi:**

Automjetet që kalojnë përmes trafikut në zonën qendrore, duhet të rregullohet përmes një riorganizimi progresiv të sistemit të qarkullimit. Rruga e qasjes nga autoudha dhe unaza duhet të përcjellë hapësirë urbanistike rajonale më të gjerë të trafikut urban për hapësira të parkimit/të përforcuara në lidhje me stacionet e tranzitit në masë.

Këto do të bëhen "nyjat" e një sistemit të transportit difuzionar, për të shërbyer në pjesën tjetër të zonave urbane dhe në zonat rurale.

Brenda zonave urbane ngjitur me aksin dhe "nyjat" e tij duhet të pranohet vetëm ngadalësimi i trafikut lokal të banorëve. Rrjeti i rrugëve dhe hapësirat publike duhet të ridizajnohen, duke siguruar një dallim të qartë mes automjeteve dhe hapësirës për këmbësorë.

Një linjë veprimi progresiv për këmbësorë në zonën qendrore duhet të ndërmerret paralelisht me sigurimin e parkingjeve të reja dhe shtigjeve për çiklistë: ky është një parakusht për përmirësimin e mjedisit urban.


Lidhjet e këmbësorëve të "polaritetit" me "korridorin e mjedisit" dhe "qytetin historik", duhet të sigurohen përmes një projektimi të saktë dhe të ndjeshëm të rrjetit rrugor dhe hapësirave publike.

### **Veprimet duhet të përmbajnë:**

- Përmirësimin teknologjik dhe infrastrukturor të linjës hekurudhore, të përshtatur me kërkesat e një sistemi të rregullt masiv tranzitor;
- Krijimi i një "korridori mjedisor" të një peizazhi të cilësisë së lartë, integrimin e sipërfaqeve të gjelbërta dhe hapësira tjera publike për të formuar një sistem të vazhdueshëm urban;

- Forcimi dhe krijimi i kulturës dhe hulumtimeve të institucioneve me rëndësi kombëtare (muze, teatro, salla për ekspozita, universitete dhe institucione të ngjashme);
- Forcimi apo krijimi i qendrave të kongreseve, pajisjeve për panaire dhe aktivitetet e tjera të ngjashme të orientuara për një biznes me klientelë diplomatike kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Kompletimi/renovimi i cilësive ekzistuese urbane me ndërhyrje të përdorimeve të përziera (p.sh. banim + afarizëm dhe/ose aktivitete të tjera të pajtueshme) me dizajn të ndjeshëm që synon rritjen e vazhdimësisë dhe koherencën e hapësirës urbane, me hapësira të mjaftueshme publike për këmbësorë, hapësira të gjelbërta dhe lehtësirave të afërsisë.

Ndërhyrjet e mësipërme duhet të jenë të vendosura në kuadrin e planifikimit të duhur dhe të detajuar nëpërmjet projekteve urbane (Hartimi i një plani urbanistik arkitektonik që mbulon të gjitha fushat që kanë lidhje me "boshtin" duhet të konsiderohet si një prioritet kryesor, së bashku me vendosjen e sistemeve të menaxhimit të përshtatshëm, në mënyrë që të sigurojë koordinimin e nevojshëm të ndërhyrjeve të ndryshme përkatëse të iniciativës private dhe publike dhe rishikimin ekzistues PRrU për koherencë).



Harta 11. Konsolidimi i zonës urbane

### 3.2. Një qytet i këndshëm për të gjithë qytetarët – Çështjet kritike

Çështjet e mëposhtme kritike të identifikuara:

- Zhvillimet e paplanifikuara me mungesën konsekuente të shërbimeve dhe hapësirave të gjelbërta publike,
- Qasja e dobët nga vendbanimet periferike.
- Situatat e mundshme të rrezikut (p.sh. struktura e dobët gjeologjike apo afërsia e industrisë ndotëse).

Zgjerimet me densitet të ulët konsumojnë dhe copëtojnë kualitetin e tokës bujqësore më shumë se që është e arsyeshme me të njëjtën popullsi të caktuar. Zhvillimet e tilla gjithashtu kërkojnë një rritje në përdorimin e veturave dhe bëjnë të përealizueshëm një mjedis urban të pasur, shërbime efikase dhe aktivitete të suksesshme ekonomike.

#### Popullsia dhe dendësia e vendbanimeve në qytet

Dendësia e strukturave urbane mund të llogaritet në bazë të gjeo-referencave të cekura satelitore dhe të dhënave të regjistrimit. Këto referenca janë prodhuar në vitin 2010 dhe për këtë arsye mund të supozohen si koherente.

Duke interpretuar analizën e përdorimit të tokës nga PZHU, në fakt gjatë draftit, si dhe nga fotografitë satelitore konturat e zonës së urbanizuar janë gjurmuar. Të përfshira në zonën e urbanizuar janë parqet urbane dhe hapësirat e gjelbërta në mjedisin e ndërtuar, por jo toka e ndjekur ose zonat e gjelbërta jashtë strukturave ndërtimore.

Ky lexim përfshin zonat "rurale" në periferi, si pjesë përbërëse e strukturave urbane: Matiçan; Hajvali; Çagllavicë; Kolovicë; Sofali; Zllatar. Këto zona lejojnë një llogaritje mjaft të saktë të dendësisë urbane, mesatarisht 7 banesa për hektar, dhe dendësi të popullsisë prej 23 banorëve për hektar.

Zona më e madhe kadastrale e Prishtinës është artikuluar në fusha të konsoliduara dhe në fusha të transformimit. Duke supozuar një dendësi banimi prej 8/ha. dhe dendësi të popullsisë prej 30/ha, bazuar në llogaritjet për zonat përreth, densiteti i pjesës së konsoliduar të qytetit janë gjetur popullsi prej 125/ha, dhe të njëjstive banesore 39/ha

170 ba/ha janë parametër ideal i densitetit për të kufizuar përdorimin e makinave. Shih Newman P., Hogan T. (1987) "Dendësia urbane dhe transportimi: një model i thjeshtë i bazuar në tri lloje të qyteteve"



## Objektivat dhe qëllimet

Në mënyrë që të sigurohet një ofertë e një qyteti cilësor për qytetarët, duhet të lidhen rritja e popullsisë me ofrimin e shërbimeve të përshtatshme dhe të infrastrukturës përkatëse.

Situata aktuale e strehimit, në të ardhmen e afërt do të gjenerojë një kërkesë të përhapur për përmirësimin e cilësisë së fondit ekzistues banesor; për më tepër pjesa tjetër e kërkesës për strehim të ri do të gjenerohet nga rritja e numrit të familjeve, të lidhura me zvogëlimin e numrit të anëtarëve të çdo familje dhe në karakter të ri të popullsisë. Roli i vërtetë i kryeqytetit, pa politikat adekuate, bëhet një tjetër faktor tërheqës i popullsisë urbane, që ndikojnë në migrimin e brendshëm të kryeqytetit.

Shtrirja e proceseve të fundit në një anë anon në boshtin qendror historik të lidhur me rrugët dhe hekurudhat, por nga ana tjetër kanë tendencë për të pushtuar mjedisin rrethues përderisa zonat e pyllëzuara dhe të vlefshme rrethojnë qytetin. Ekziston rreziku i humbjes së perceptimit të formës origjinale urbane dhe të marrëdhënieve të tij me mjedisin natyror përreth qytetit; një tjetër rrezik është dhe rritja e dendësisë së zonave qendrore, me pasoja të ndotjes së mjedisit. Ekziston rreziku i zhvillimit të periferive të zgjeruara, ku është e vështirë për të siguruar komoditet dhe cilësi jetësore.

Për t'i adresuar këto çështje, propozohet një strategji e bazuar në shtrirje të plotësishme të kualitetit urban "bazë" në aspektin e komoditetit dhe hapësirave publike;

- përshtatja me standardet evropiane të rrugëve, me ndërtimin e shtigjeve të këmbësorëve, çiklistëve dhe parkingjeve të automjeteve;
- rritjen e rrjeteve teknologjike;
- rritja selektive e vendbanimeve, të vendosura në mënyrë për të rritur dhe ruajtur trashëgiminë natyrore dhe kulturore dhe gjithmonë duke u mbështetur në zhvillimin e infrastrukturës, komoditetin dhe hapësirave publike, mobilitetit të qëndrueshëm, rrjetet teknologjike.

## Koncepti

Në mënyrë që të vlerësojmë rritjen e mundshme të vendbanimeve, kufiri i sipërm i qëndrueshmërisë së popullsisë, i krahasuar me nivelin e komoditetit dhe infrastrukturës në gjendje për të siguruar një nivel të mirë të cilësisë jetësore urbane, do të identifikohen:

- **zonat e konsoliduara urbane**, ku ndërtimet e reja janë të ndaluara, me përjashtim të vetëm për zëvendësimin e stoqeve ekzistuese; në këto fusha objektet publike, hapësira (d.m.th. sheshet) duhet të forcohen, si p.sh. parqet, pajisjet adekuate, rrjetet rrugore duhet të krijohen si për këmbësorë ashtu dhe shtigjet e çiklistëve dhe parkingje për automjete.
- **kompletimi dhe kompresimi i zonave urbane** (përmes hapësirës që gjendet në mes dy ndërtimeve ose rindërtim–ndërhyrje). Duke marrë parasysh dendësinë e ulët prezente, propozojmë lehtësimin e proceseve të densitetit, bazuar në një rritje prej 20 banesave/ha.
- **përzgjedhja e zonave të zgjeruara**, me krijimin e strukturës së re urbanistike, me densitet prej 50 banesave/ha (të përshtatshme për të mbështetur zhvillimin e transportit publik, komoditetit dhe bizneset në zonën urbane).

Kudo që të jetë e mundur, hapësirat e gjelbërta duhet të rriten si për përmirsimin e cilësisë së mjedisit dhe për të rritur biodiversitetin.

Për më tepër, qarkullimi i qëndrueshëm duhet të jetë pjesë e një qasjeje të integruar. Reduktimi i ngjeshur është i rëndësishëm nëse e shikojmë nga pikëvështrimi i shëndetësisë, por kjo nuk është vetëm në lidhje me reduktimin e emetimit të CO<sub>2</sub>, ndotjes dhe zhurmës – ka lidhje gjithashtu për dhënie të mundësisë së qytetarëve për ripushtim të qytetit. Rrugët me trafik të rëndë janë pengesa efektive që kalojnë nëpër qytete, ku izolojnë lagjet dhe i bëjnë të duken joatraktive.

Objektet publike, së bashku me hapësirat komerciale dhe pasuritë e tjera të strukturave urbane, duhet të vendosen në një formë të përmbledhur në mënyrë që të ndërtojnë vende të gjalla dhe tërheqëse dhe të arritshme në këmbë ose me biçikletë.

Ne duhet të inkurajojmë krijimin e modelit të përzier urban, ku funksionet e banimit mund të planifikohen me bizneset e vogla, zejtaritë, zyrat, që synojnë t'i japin vitalitet hapësirës urbane në kohë të ndryshme të ditës, për të reduktuar lëvizjet (parimi i afërsisë) dhe për të rritur sigurinë urbane.

Standardi minimal i propozuar për lehtësitë dhe pajisjet themelore është 18 banorë m<sup>2</sup>/për banues teorikë<sup>16</sup>. ("standard" do të thotë një raport minimal në mes të hapësirave të banimit dhe hapësirave për aktivitete sociale, hapësirave të gjelbërta dhe parkingjeve publike).

Shuma e këtyre kriterëve na çon në përcaktimin e pragut të përafërt rreth **400.000 banorë**<sup>2217</sup> si popullsi të qëndrueshme për një qytet me cilësi të lartë. Këta numra supozojnë dendësi të zonave ekzistuese dhe zhvillimet e reja me një dendësi të përgjithshme prej 40 banesave / ha. Në rast dështimi për të rritur densitetin do të çojë në arritjen e kufijve të qëndrueshëm më parë.

---

<sup>16</sup> Me "banorë teorikë" nënkuptojmë numrin e banorëve që vijnë nga qasja e mëposhtme: OECD jep madhësinë mesatare të shtëpive në vende të ndryshme që variojnë midis 2,2 dhe 3,1 me përjashtim të Turqisë dhe Meksikës, me varirim mbi 4. Madhësia mesatare e shtëpisë 3,0 duket supozim i arsyeshëm për një periudhë afatmesme. (Një pjesë e madhe e vendbanimeve janë aktualisht të pabanuara). Përpjekjet për të furnizuar çdo familje me një vendbanim apo strehë, në nivel të qytetit ka një mesatare prej tre banorëve në një banesë. Dendësia aktuale në zonat e konsoliduara, dendësimi i zonave të paplanifikuara, zona të pakonsoliduara dhe zgjerimi i përzgjedhur i ardhshëm na lejon për të përcaktuar kufijtë e qëndrueshëm në kuadër të unazës së planifikuar.

<sup>17</sup> Rezultat i bazuar në të dhënat e popullsisë sipas REKOS

## Përmirësimin i qasjes në kryeqytet




Fig.5. Komunikacioni

Diagrami i mësipërm përgjithëson dy objektivat e para hapësinore, d.m.th. 1) *Përforcimi i aksit kryesor urban për rolin e kapitalit dhe* 2) *Një qytet i këndshëm për të gjithë qytetarët.* Këto janë shumë të lidhura mes vete dhe kërkojnë një sistem të përbashkët të akseve infrastrukturore që sigurojnë qasje të mirë dhe pajisje transporti për banorët, vizitorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Elementet kryesore të një sistemi të tillë të përbashkët janë: hekurudha ekzistuese dhe aksi kryesor urban i propozuar me shërbimet e një qendre metropolitane; Akset e larta të transportit publik; autoudha ndërkombëtare; unaza e jashtme apo 'by-pass' dhe unaza brendshme. Këto elemente punojnë së bashku si një sistem i lëvizshëm nëse elementet janë të lidhura mirë dhe nyjat janë të organizuara për shkëmbimin intermodal<sup>18</sup> të pasagjerëve. Në këto nyja është i domosdoshëm parkimi i organizuar.

<sup>18</sup> Shkëmbimi intermodal në rastin e Prishtinës kryesisht nënkupton shkëmbimin e udhëtarëve prej një lloji të transportit në tjetrin (p.sh. prej trenit në autobus, taksit, biçikletë, etj.)



*Disa shembuj të linjave të transportit publik për aksin e ri*



*Avenida Diagonal në Barcelonë, shembull i profilit për unazën e brendshme*




Fig. 6. Një profil i mundshëm i unazës së brendshme duke akomoduar të gjithë përdoruesit


### **Unaza e brendshme**

Unaza e brendshme, e propozuar në Planin Strategjik të Zhvillimit Urban të Prishtinës, ku parashihet një bulevard i gjerë i qytetit. Me një karakter urban joperiferik, kjo rrugë duhet dalluar nga unaza e jashtme, ajo do të lejojë qasje dhe parking përgjatë një rruge paralele të shërbimit. Ajo mund të caktojë hapësirë për të gjithë përdoruesit e rrugës. Shembulli i dhënë përfshin (nga ndarësit qendrorë në të djathtë) dy korsi makinash, hapësirë për një autobus ose korsi tramvaji, një ndarës, një shteg për çiklistë për rrugë shërbimi, parkingje paralele dhe, më në fund, një trotuar të gjerë.

Kalimi nga rrugët në korsi, për lehtësimin e rrugës duhet të jetë i mundur vetëm në udhëkryqet, në mënyrë që të mos e ndërpresë trafikun.

Në zonën kadastrale të Sofalisë si dhe në zonën kadastrale të Zllatarit, ku në unazë janë paraparë urat, në ato pjesë të lihet mundësia për riprojektim.

Funksionet përgjatë një rruge të tillë mund të jenë komerciale, administrative ose të lidhura me biznes. Fasadat kërkojnë vëmendje të veçantë për izolim nga zhurma e rrugës.



- Rrugë kryesore
- Unaza qendrore
- Unaza e brendshme
- Unaza e jashtme – by pass
- Autoudha

Harta 13. Unaza e brendshme dhe e jashtme

### Unaza e jashtme

Çështja e unazës së jashtme mbetet tejet delikate. Ky projekt në një mënyrë i takon nivelit qendror, e në anën tjetër paraqet një komponent tejet të rëndësishëm për trafikun e Prishtinës. Me gjithë faktin se në Planin Strategjik të Zhvillimit të Prishtinës unazën e jashtme e parasheh të jetë e plotë, zhvillimet e deritanishme (në veçanti autoudha “Dr.Ibrahim Rugova) dhe trendët e zhvillimit në të ardhmen, e bëjnë të panevojshëm një segment të kësaj unaze. Andaj, unaza e jashtme do të jetë një ‘by-pass’ për qytetin e Prishtinës, që lidh të gjitha rrugët kryesore të Kosovës me njëra-tjetrën dhe me zonat periferike të qytetit. ‘By pass-i’ duhet t’i ketë karakteristikat e autostradës interurbane dhe duhet të përmbajë vetëm nivel të lartë të kalimeve jo të lidhura me ‘by-pass’, rrugët kryesore të Kosovës dhe rrugët kryesore të qytetit (figura lart). Në zonën veriperëndim, unaza e brendshme intersektohet me atë të jashtmen. Kjo ka ndodhur me rastin e hartimit të projektit kryesor të unazës së brendshme me ç’rast është përcjell traseja më e favorshme. Në këtë segment të dy unazat integrohen në një trase (dy unaza në një shteg).

#### 3.2.1. Një zhvillim policentrik urban hapësinor

##### Çështjet kritike

Për njëzet vjet Prishtina është rritur për 1000ha (Burimi: Vlerësimi në Planin Hapësinor të Kosovës, periudha 1980-1999). Këto zgjerime janë në një dendësi shumë të ulët, duke rënduar problemet e transportit në distancë dhe konsumin e tokës bujqësore.

Zhvillimet spontane në kohët të fundit duken jo të strukturuar, jashtë vizionit të planifikuar dhe pa ndonjë identitet të definuar të qytetit. Kjo qasje ka shkaktuar disa probleme, të njohura edhe në qytetet evropiane:

- Shtrirja dhe zgjerimet urbane janë sinonim me zhvillimet e pakontrolluara urbane, të karakterizuara me një përzierje të densitetit të ulët të përdorimit të tokës, sidomos në periferi të qytetit. Zhvillimi është i shpërndarë dhe me trend për diskontinuitet duke shndërruar zonat në “ujdhesa” bujqësore, ndërsa, në qytet, disa zona kanë mbetur të paorganizuar.

- Kjo mënyrë e zhvillimit është joracionale dhe tenton të ketë një **ndikim negativ në mjedis** (përdorim të lartë të energjisë për ngrohje në shtëpitë e shpërndara individuale, lidhjeve të shtrenjta të shërbimeve publike dhe përdorimin e konsiderueshëm të energjisë për shkak të shkëmbimeve të shpeshta – përderisa puna, akomodimi jetësor kanë tendencë të jenë larg njëra-tjetrës (BE: PSUD).




Fig.7. Rikonstruimi i rritjes së qytetit bazuar në hartat historike dhe ortofoto e 2010-s

## Qëllimet dhe synimet

Qëllimi kryesor është që të sigurojë mundësi për një **zgjerim të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm urban**, duke shmangur shtrirjen e pakontrolluar të hapësirës, duke ofruar lehtësirat e nevojshme, objektet dhe zonat e aktivitetit për të formuar lagje të integruara dhe të vlefshme për të jetuar.

## Koncepti

**Zhvillimi policentrik** është parimi i organizimit të një rajoni rreth disa qendrave politike, sociale dhe financiare. Shembuj të qyteteve policentrike përfshijnë zonën e Ruhrit në Gjermani, dhe Stokeon-Trent në Britani të Madhe. Shembuj tjerë janë Randstad në Holandë apo në Greater Boston në Shtetet e Bashkuara.

Ashtu si në PHK, "zhvillimi policentrik i propozuar është bazuar në strukturën ekzistuese dhe shpërndarjen e vendbanimeve, të karakterizuar nga përmbajtjet e tyre dhe aktivitetet në funksion. Zhvillimi i qendrave të mëdha (Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan dhe Ferizaj) do të

vazhdojë dhe për një kohë të konsiderueshme këto qendra do të jenë nën presion nga lëvizjet e popullsisë nga zonat e ndërzvilluara. Gradualisht, zhvillimi i këtyre qendrave do të sigurojë ofrimin e shërbimeve publike të mjaftueshme dhe të barabartë në pjesët tjera, që do të thotë ofrimin e shërbimit për njerëzit që nuk do të duhet të lëvizin nga mjediset e tyre. Zhvillimi i vendbanimeve të mesme (10.000 - 20.000 banorë) dhe atyre të vogla (nën 10,000 dhe fshatrat) duhet të bëhet i mundur nga politikat e investimeve në përmirësimin dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore të brendshme dhe një lidhje më funksionale në infrastrukturë të nivelit të lartë".

Sa i përket Komunës së Prishtinës, kjo strategji e zhvillimit mund të zbatohet në dy nivele të ndryshme:

**-në nivel rajonal:** Interesi në konceptin e rajonit policentrik urban hapësinor (RPU) ka qenë në rritje në mesin e planifikuesve dhe hartuesve të politikave në veriperëndim të Evropës. RPU besojnë në ofrimin e një mjeti për të nxitur konkurrencën ekonomike rajonale, duke ruajtur mjedisin dhe cilësinë e objektivave të jetës. **Zona e kaltër** e projektuar nga PHK ka një formë potenciale fizike policentrike, por kushtet për të krijuar një rajon funksional në aspektin infrastrukturor, ekonomik dhe shërbime të lehtësuara publike janë të llojlojshme. Strategjia duhet të hartojë një **model dominues të bashkëveprimit** (materiale dhe jomateriale), që duket të ketë rritur mbështetjen për zhvillimin e disa llojeve të kuadrit strategjik hapësinor, për të informuar vendimet kyçe për investime dhe për të promovuar bashkëpunimin më të ngushtë.

**-në nivelin urban:** forma policentrike urbane është një alternativë e mundshme për zhvillimin urban radial, klasifikuar me marrëdhëniet e kohëve të fundit ndërmjet qendrës së qytetit dhe rrethinave. Strategjia policentrike duhet t'i ripërcaktojë rrjedhat dhe marrëdhëniet në shkallë të ndryshme, me qëllim që të lidhë densitetin e zonës së sturkturës së lartë urbane me qendrat e vogla përreth.

Më shumë se krijimi i markave të reja të subjekteve urbane, këto kanë për qëllim **forcimin, konsolidimin dhe përmirësimin e modelit** të vendbanimeve ekzistuese, duke mundësuar sa më shumë të jetë e mundur ruajtjen e tokës bujqësore ekzistuese dhe karakteristikat e peizazhit.

Prandaj dispozitat për zhvillim të ri urban do të ofrohen kryesisht në lidhje me:

- qytetet e vogla ekzistuese periferike veriore;
- zonat periferike të planifikuara, kryesisht në sektorin juglindor;
- Zonat e paplanifikuara të shtrirjes së kohëve të fundit

Në nivelin urban një "multipolar" apo "policentrik" në modelet e vendbanimeve parashikohen në atë mënyrë që të sigurojnë një nivel të lartë të komoditetit si dhe prania e aktiviteteve të shpërndahet në një "zonë më të madhe urbane", përdërisa zvogëlohen kërkesat e lëvizshmërisë. Kjo patjetër duhet ta përmirësojë cilësinë aktuale urbane të vendbanimeve ekzistuese, e cila zakonisht është shumë e dobët.

Nga ana tjetër, ruajtja e tokës bujqësore dhe karakteristikat e peizazhit do të rrisin cilësinë e mjedisit të vendbanimeve të reja.

Në lidhje me dy nivelet territoriale, nocionet kyçe të këtij koncepti janë:

- **Lëvizshmëria:** çdo strukturë policentrike ka nevojë për një sistem efikas të lëvizshmërisë, të bazuar jo vetëm në rrugë për automjete private, por edhe në mjetet e transportit publik dhe mjetet e tjera të transportit. Në këtë mënyrë ne kemi për të rritur dhe përmirësuar lëvizshmërinë e rrjetit të transportit në Komunën e Prishtinës.



- **Hierarkia funksionale:** objektet afariste, ekonomike, zonat e gjelbërta dhe shtigjet janë të kategorizuara në lidhje me përdorimin aktual apo të ardhshëm, në kuadër të rrjetit si një tërësi.
- **Përdorimi i përzier:** Është shumë e rëndësishme që ne të ruajmë llojlojshmërinë e banesave, dyqaneve, zejtarive, dhe të mirave tjera. Është kjo përzierje e cila e bën komunitetin praktik. Ky përdorim divers është një nga aspektet më të rëndësishme të qendrës së Prishtinës, ndonëse ajo shihet rrallë në qytete të reja apo në periferitë e qyteteve evropiane;
- **Rrjeti funksional:** edhe nëse i kemi parasysh dy nivelet e propozuara, është e e domosdoshme të zbatohet një rrjet funksional në mes qendrave urbane të planifikuara për të menaxhuar terësitë dhe objektet e vecanta.

### 3.2.2. Infrastruktura - transporti

POLITIKAT SEKTORIALE PËR MBËSHTETJEN E STRATEGJIVE:

#### a. Një lëvizshmëri e qëndrueshme për të mbështetur rritjen urbane

Siç është cekur në paragrafin B3, një nga shtatë termet afatgjatë ka për qëllim shqetësimet e sistemit të lëvizshmërisë dhe propozon linjat e mëposhtme të punës:

#### QËLLIMI 4 Qarkullimi i njerëzve dhe i mallrave në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme

1. Objektivi I. Krijimi i një sistemi të plotë dhe efikas të trafikut, për qytetin dhe zonën e tij të gjerë urbane, për të mbajtur trafikun tranzit nga qyteti; implementimin e tri "unazave" për organizimin e rrjetit të transportit
2. Synimi II. Krijimi efikas i një sistemi të autoparkingut në qytet dhe një shkëmbim periferik i autoparkingjeve për të reduktuar hyrjen e automjeteve në bërthamën e qytetit (brenda unazës së qytetit, qendrës historike).
3. Synimi III. Mirëmbajtja e rregullt e rrugëve të vjetra dhe rregullimi i rrugëve të reja për transport më efikas (posaçërisht në zonat rurale);
4. Synimi IV. Zhvillimin e sigurt dhe të rregullt të linjave të transportit publik dhe modernizimin e automjeteve të transportit publik
5. Synimi V. Mbjtjen dhe ruajtjen e lidhjeve hekurudhore (ose tramvajeve) me polaritete të ndryshme urbane (aeropot, stacione të autobusëve, qendra e qytetit, etj.)
6. Synimi VI. Zhvillimin e rrjetit të shtigjeve për çiklistë dhe përmirësimin e rrugëve për këmbësorë dhe pengesat e rrugëve të lira.
7. Synimi VII. Organizimi i transportit të mallrave brenda qytetit (kyçje me kohë të kufizuar; zvogëlim si dhe emetimi i ulët i automjeteve, etj.)

Duke u bazuar në këto qëllime, Drafti i PZHK-së propozon këto veprime kryesore për të përmirësuar mobilitetin urban të njerëzve.

### Transporti publik

- Transformimin e hekurudhës ekzistuese Fushë Kosovë-Prishtinë-Podujevë në linjë të transportit urban në masë më të madhe (linjë metropolitane<sup>19</sup>), me ndalesa që ofrojnë transfer vende parkingje intermodale dhe depo në varg;
- Krijimin e akseve të forta të transportit publik të dedikuar për autobusë.




Fig. 8. Linja kryesore e transportit publik

Ndalesat përgjatë vijës metropolitane duhet të bëhen pika atraktive urbane, ku mendohet zhvillimi i hapësirave urbane të cilësisë së lartë me shërbime të nivelit të lartë dhe pajisje të lidhura me rolin ndërkombëtar dhe kombëtar të qytetit.

Linja metropolitane e përcjell boshtin urban, por për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe gjendjes ekzistuese të ndërtimeve në disa segmente, largohen apo ndërpriten mes veti.

<sup>19</sup> Linja metropolitane bazohet në linjën e transportit me shina e përcjell me transport publik me goma (trolejbus apo autobus) dhe ka për qëllim lidhjen e disa qyteteve dhe vendbanimeve nga "Zona e kaltër" dhe më gjerë.

## Stacioni intermodal,



Një tramvaj i ri dhe stacion i autobusëve në periferi të qytetit paraqet një artikulum të llojeve të ndryshme të transportit urban, të lidhura me një zonë të madhe parkingu në çati, për të lehtësuar bllokimin e trafikut në qendër të qytetit.

Koncepti i përgjithshëm në drejtim të planifikimit të parkingut të automjeteve dhe të stacionit është një nga fushat e mbivendosjes dhe linjat që thuren së bashku për të formuar një tërësi vazhdimisht të ndryshueshme.

Këto 'fusha' janë modelet e lëvizjes të shkaktuar nga veturat, tramvajet, biçikletat dhe këmbësorët. Secila ka një trajektore dhe një gjurmë, si dhe një fiksion statik. Është sikur tranzicioni në mes tipave të transportit (veturë për tramvaj, tren për tramvaj) është dhënë si material dhe tranzicion hapësinor i stacionit, peizazhit dhe kontekstit.

Stacioni duhet të përmbajë program bazik të hapësirës së pritjes, depo të biçikletave, toaleta dhe dyqane. Ky ka sens se prej vektorësh tridimensional rritet në trajtimin e hapësirës: hapësira e linjave vazhdon si vija të lehta në dysheme, apo copa mobileje apo drita në brez në tavan. Shikuar në plan, të gjitha 'vijat' bashkohen për të krijuar një tërësi të sinkronizuar. Ideja është që të krijohet një hapësirë energjetike dhe kreative që është e definuar në terme të funksionit dhe qarkullimit, që është e krijuar nga grafika tridimensionale e dritave dhe hapjeve.

### Rrugët

- Krijimi i një rrjeti rrugor me një hierarki të qartë dhe i finalizuar të devijojnë nëpërmjet trafikut nëpër qytet dhe të kufizojnë përdorimin e papërshtatshëm të rrugëve urbane.
- Sigurimi i unazës së brendshme dhe unazës së jashtme, janë një element kyç për t'u dhënë prioritet.
- Përmirësimi i shpërndarjes së rrugëve urbane, me krijimin e trotuareve dhe shtigjeve të çiklistëve.

Unaza e brendshme duhet të jetë një bulevard i gjerë i qytetit, me karakter urban joperiferik. Kjo do të lejojë qasje dhe parking përgjatë një rruge paralele të shërbimit. Ajo mund të caktojë hapësirë për të gjithë përdoruesit e rrugës (korsi veturash, një autobus i dedikuar ose korsi e tramvajit, shtigje për çiklistë, rrugë shërbyese, parkim në linjë dhe në fund një trotuar të gjerë). Kalimi nga

rrugët kryesore në rrugë shërbyese duhet të jetë i mundur vetëm në udhëkryqe, në mënyrë që të mos ndërpritet rrjedhja.

Pjesa më e madhe e unazës së brendshme qëndron në zonat ekzistuese ose të planifikuara urbane, dallimet mund të ekzistojnë, por në të ardhmen afatgjatë duhet të lejohet një uniformitet përgjatë gjithë gjatësisë së bulevardit, duke rritur njohjen e rrugës, si element i rëndësishëm i Prishtinës (një kryeqytet i ri). Vazhdimësia duhet të jetë e garantuar në pjesën për vetura dhe korsi të autobusëve, këmbësorë dhe shtigjet e çiklistëve. Jashtë zonave urbane në vendparkingje, stacionet e autobusëve duhet të planifikohen në atë mënyrë që si të tilla mund të largohen.

Parku i Gërmisë është zona kryesore e gjelbër për banorët e Prishtinës dhe për këtë arsye mund të konsiderohet si një pjesë e zonës urbane, ajo duhet të përmirësojë qasje në shumë pika, mundësi për t'u parkuar jashtë, mundësi për të arritur me autobus dhe me biçikletë.

Unaza e jashtme duhet të jetë një 'by-pass' për qytetin e Prishtinës, lidhjen e të gjitha rrugëve të Kosovës me secilën prej tyre si dhe zonat periferike të qytetit<sup>20</sup>. Pjesa në anën veriore të Liqenit të Badovcit ka një mundësi alternative më të lirë në lidhjen me rrugët ekzistuese të pjesës jugore të liqenit. Deri sa kjo kërkon bashkëpunim me Graçanicën, të dyja alternativat duhet të merren në konsideratë.




Fig.9. Rrugët kryesore që organizojnë trafikun jashtë dhe brenda qytetit të propozuar

<sup>20</sup>Rrugët e ngarkuara janë E-65/E-80 nga Prishtina drejt Mitrovicës dhe Ferizajit dhe rruga M-9 drejt Pejës. Këto rrugë dykahore kanë fluks më shumë se 10,000 automjete për çdo ditë. Këto dy rrugë takohen në një kryqëzim rrugor në jug të Prishtinës. Pika jugore e trafikut është më efikase sesa ajo veriore.

E ashtuquajtura "Unazë e jashtme" në realitet është një 'by-pass' për të parandaluar fluksin e panevojshëm të trafikut për të hyrë në qytet. Përmirësimi i pjesës lindore të unazës së jashtme nuk është konsideruar si një prioritet; shtegu mund të rishqyrtohet në perëndim, pranë autostradës dhe më tej në jug, për të krijuar më shumë distancë në mes të rrugës, vendbanimet ekzistuese dhe të planifikuara si dhe unazës së brendshme; kjo zgjidhje ofron më shumë fusha të cilat janë në dispozicion për zhvillimin urban.

### Lidhja në mes të kryeqytetit dhe rrjetit (ndër) kombëtar

Propozimi i mëposhtëm është bazuar në mundësinë për të përforcuar anën perëndimore të Prishtinës si një korridor infrastrukturor, për të riorganizuar fluksin ekstra-urban të njerëzve dhe mallrave në qytet dhe jashtë tij. Në ndërtim e sipër në anën perëndimore të qytetit është autoudha. Më larg në anën perëndimore shtrihet një linjë hekurudhore<sup>21</sup>, ku stacioni për pasagjerë (nuk i plotëson standardet ndërkombëtare) është i vendosur 8 km nga Prishtina, në jug të stacionit të udhëtarëve qëndron një stacion hekurudhor i mallrave (joadekuat). Kjo është lidhja hekurudhore, me origjinë si linjat e shërbimit për industrinë dhe minierat, të cilat janë ende ekzistuese, por shpesh të papërdorshme (një prej këtyre lidhjeve kalon në afërsi të zonës së aeroportit, e vendosur në anën jugperëndim). Lidhur me rrugët që hyjnë në qytet, një strukturë hierarkike e rrugëve nuk ekziston.



Harta 13. Linjat hekurudhore ekzistuese në Kosovë

<sup>21</sup>Linja hekurudhore ndërkombëtare nga Beogradi për në Shkup, kalon nëpër Fushë-Kosovë, 8 km. në perëndim të Prishtinës. Gjithashtu, në perëndim është një linjë hekurudhore, e cila kalon nëpër Fushë-Kosovë dhe vazhdon për në Pejë dhe në lindje të Podujevës dhe Nish)



*Hekurudhat ekzistuese në zonën e Prishtinës: linja veri-jug, lidh Serbinë, me stacionin për pasagjerë (veri) dhe staciononin e transportit të mallrave (jug) në Fushë-Kosovë, të dyja joadekuate; Linja Fushë Kosovë –Pejë përdor të dyja, për njerëz dhe transport të mallrave, linja Fushë-Kosovë-Prishtinë-Podujevë, pothuajse e shkarkuar por me rezerva të mëdha për t'u ripërdorë, linja Bardh-Magurë, shërben minierën e nikelit në Magurë dhe kalon në afërsi të aeroportit.*

PZhK konsideron disa tema në lidhje me:

- a.1 Transporti i pasagjerëve
- b.2 Një platformë për shpërndarjen e mallrave

### **a.1 Transport i pasagjerëve**

*Parimet e propozimit për përmirësimin e sistemit të transportit publik, që lidhet me kuadrin e politikave për të garantuar zhvillimin ekonomik, shëndetin publik, kohezionin shoqëror*

Shumë familje janë të gatshme të paguajnë çmime të larta për transport automobilistik. Por, në njëfarë mënyre shumica e popullsisë nuk mund të ketë një veturë ose thjesht nuk janë në gjendje të vozitin. Dhe, në njëfarë mënyre trafiku i veturave kërkon shuma të mëdha të hapësirave dhe infrastrukturës, derisa shkakton aksidente, dëmtime dhe ndotje. Transporti publik mund të sigurojë mobilitet për më shumë njerëz, me kosto më të ulët private dhe publike. Studimet tregojnë se transporti publik po fillon të luajë një rol strategjik në politikat e zhvillimit urban të Prishtinës dhe japin një pamje të studimit të politikave të transportit publik në nivel qendror, në MI dhe MMPH<sup>22</sup>. Shumë studime dhe projekte kanë hulumtuar aspektet makro-ekonomike dhe institucionale të transportit publik dhe planifikimeve hapësinore. Këto shikojnë në aspektin fizik të planifikimit të

<sup>22</sup> Brenda strategjisë dhe veprimeve të implemetimit, Plani hapësinor propozon “ përmirësimin dhe ndërtimin e një linje të re hekurudhore, promovimin e transportit hekurudhor si nga një më të përballueshmit..., zhvillimin e stacioneve hekurudhore veçanërisht në Prishtinë, Fushë-Kosovë, Podujevë, etj.

transportit publik, që është detyrë komplekse multidimensionale. Rrjetet në përpjesë të ndryshme dhe funksion të ndryshëm kanë nevojë të dizajnohen që t'u shërbejnë objektivave të tyre përkatëse. Këto rrjete gjithashtu nevojiten të rilidhen, në hapësirë dhe kohë për të formuar sistem koherent. Infrastruktura nevojitet të alokohet në atë mënyrë që të lejojë efikasitet dhe kështu të ofrojë shërbime atraktive dhe të lira. Dhe më së shumti është e rëndësishme, që rrjeti i transportit dhe struktura urbane duhet të zhvillohen në harmoni njëra me tjetrën.

Nga elementet e lartpërmendura del prioriteti i modernizimit të përgjithshëm të sistemit hekurudhor. Stacioni hekurudhor duhet të lidhet direkt me qytetin dhe me aeroportin me linjën metropolitane dhe autobus. Menjëherë ngjitur me stacionin intermodal, do të vendoset stacioni I autobusëve (kjo zgjidhje do të bëjë të mundur të pastrojë hapësirën aktuale të stacionit të autobusëve infra-regjional të Prishtinës). Stacioni intermodal kërkon këto pajisje.


- stacioni I autobusëve
- transfer parkingu i madh
- lidhje direkte me linjën hekurudhore metropolitane
- lidhje me aeroportin (me linjën metropolitane, me autobus)

Në zonën e re të stacionit intermodal mund të zënë vend edhe aktivitete të tjera, si zyrat, kabinat e biletave, informacionet turistike, dyqanet, hotelet por edhe shumë shërbime të tjera dhe pajisje, që çojnë në avantazh qasjen e mirë dhe stacioni duhet të zhvillojë sistemin e rrjetit të lidhur me skemën e re ekonomike ZHEK.

Një 'by-pass' i ri hekurudhor është i nevojshëm, për të bartur mallrat dhe udhëtarët drejt Podujevës (dhe në të ardhmen në drejtim të Serbisë) jashtë qendrës së qytetit, në mënyrë që linja ekzistuese hekurudhore që kalon përmes qytetit mund të përdoret për njerëzit në lëvizje dhe nga kryeqyteti, në të njëjtën kohë, për të lidhur pikat kryesore urbane. Përmes një studimi të fizibilitetit duhet vlerësuar mundësinë për të krijuar një hekurudhë 'by-pass', për të ruajtur vazhdimësinë e transportit hekurudhor drejt anës verilindje, dhe gjithashtu duhet të analizohet për të transformuar hekurudhën ekzistuese në një linjë metropolitane duke shërbyer qëndrueshëm qarkullimin urban (p.sh. korridori i vetëm i linjës hekurudhore ekzistuese duhet të përdoret, për të përmbushur një sistem të transportit rrugor urban). Natyrisht këto zgjidhje kanë nevojë për riorganizim global dhe përmirësimin e rrjetit hekurudhor, prandaj duhet të planifikohen në nivel kombëtar.

### **Stacion i madh intermodal për kryeqytetin**

Ky skenar është i bazuar vetëm në një element kyç-specifik: krijimin e një stacioni intermodal për pasagjerë afër qytetit. Lokacioni i stacionit përkrah pikëpamjen se një qendër transporti modale mund të formojë një pjesë integrale të skenës urbane dhe ka potencial për t'u bërë edhe një qendër me identitet. Pra stacioni i ri intermodal mund të bëhet një "portë" kryesore e Prishtinës, kryeqytetit të Kosovës.



Harta 14. Stacion i madh intermodal për kryeqytetin

Mënyra të ndryshme të udhëtimit (vajtje-ardhje) të propozuara për Prishtinën janë të bazuara në një tip të tranzitit të shpejtë, në këtë rast është menduar për trenat, ku opsionet me shpejtësi të ulët (p.sh. autobusi, tramvaji, ose biçikleta) iu bashkohet në fillim apo në fund të udhëtimit. Trenat ofrojnë tranzit të shpejtë në zonat urbane, ku udhëtarët mundën të zbarkojnë dhe të kenë qasje në opsione të tjera për të përfunduar udhëtimin e tyre. Mjetet e përziara të transportit do t'i përmbushin nevojat e ndryshme të popullatës. Si pasojë, ato do të formojnë një pjesë integrale të ambientit urban.

Një sistem i tillë kërkon një **qendër të transportimit intermodal**, si strukturë që i kombinon disa teknologji të transportit, si trenat nacionalë dhe regionalë, trenat e lehtë, linjat e autobusëve me qendra që kanë qasje në aeroporte. Për më tepër, stacionet intermodale përfaqësojnë mundësitë e krijimit të një vendi që shërbejnë më shumë se vetëm transport. Për këtë arsye, sot stacionet intermodale nuk janë vetëm infrastruktura që përkrahin transportin, por edhe qendra kryesore shoqërore të qytetit. Në shtesën e funksionit të shkëmbimit në mes të mënyrave të ndryshme të transportit, urban tren+publik transport urban, tren+autoveturë, stacioni kontemporan inter-modal përvetëson karakteristika të reja të lidhura me aktivitete rekreuese, në tregtinë me përmasa të mëdha dhe të shërbimet dhe aktivitetet produktive (zyrat). Karakteri multimodal dhe multifunksional



i stacioneve hekurudhore është vënë jo vetëm në prani të një kërkesë për shërbime publike, por edhe të një sistemi të qëndrueshëm global.

Stacioni i trenit mund të transportojë shumë njerëz të angazhuar në aktivitete që nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me transportin.

Përmes një studimi të fizibilitetit duhet përcaktuar mundësinë e krijimit të një hekurudhe 'by-pass', për të ruajtur vazhdimësinë e transportit hekurudhor drejt anës veriore-lindore, por po ashtu duhet të analizohet se si dhe ku të planifikohet linja e re, e cila vjen nga linja ekzistuese prej Shkupit për në Krlevë. Natyrisht këto zgjidhje kërkojnë riorganizim global dhe përmirësim të rrjetit hekurudhor, prandaj duhet të planifikohen në nivel kombëtar.



*Harta 15. Lokacioni i mundshëm për stacionin intermodal në Prishtinën e madhe, në pikën hyrëse në qytet*



Në këtë stacion intermodal mund të ketë linja për autobus dhe tren , dhe po ashtu një zonë të madhe komerciale. Përgjatë etazhitetit, stacioni mund të integrojë trafik urban dhe hekurudhor të gjatë, dhe linjë direkte me Aeroportin e Prishtinës, që lejon fluturime direkte, check-in për përdoruesit e hekurudhës.

### **Vlerësimi i stacionit të madh intermodal për kryeqytetin**

#### **Përparësitë**

1. Më shumë mundësi për të krijuar një qendër funksionale intermodale të nivelit të lartë (stacion i autobusëve urbanë, stacion i autobusëve ekstra-urbanë, linja hekurudhore metropolitane, parkingje transфере, afër autostradës, linja hekurudhore internacionale, te rrugët by-pass dhe tek unaza e brendshme (do të jetë e mundshme të krijohet një cikël i lidhjeve në qytet rreth lidhjeve me qytetin;
2. Shumë afër ZHEK edhe gjithashtu shumë interesante për përmirësimin e hyrjes në zonën e ZHEK-së.
3. Mundësia e ripërdorimit të zonës aktuale të stacionit të autobusëve brenda qytetit. Për arsyen se lokacioni gjendet afër qytetit, stacioni do të mund të bëhej pikë referimi e qytetit dhe mund të përmirësojë zhvillimin funksional të qendrës me qasje të fluksit të madh të njerëzve .

#### **Disavantazhet**

1. Shpenzime të larta (linjahekurudhore, realizim i ndërtesave dhe infrastrukturës së re)
2. Ndërhyrja më e fortë në tokën bujqësore.

## a.2 Platforma për shpërndarjen e transportit të mallrave (HUB)

Zona perëndimore e Prishtinës ka pozitë qendrore, e cila respekton të gjitha rrjetet e transportit nacional dhe atij internacional dhe mundet të shndërrohet në një intermodal HUB dhe të menaxhojë transportin e mallrave për Ballkan.

Disa kërkesa me rëndësi:

- Një qendër logjistike intermodale (lidhjet me rrugë, hekurudhë, trafik ajror)
- Një qendër logjistike me standard ambientalist.
- Një qendër logjistike me aktivitete inovative dhe vlera të larta (zhvillim i ICT, paketim, manipulim i të mirave, posaçërisht, shërbime inteligjente për shpërndarjen e të mallrave drejt qytetit)

Stacioni i transportimit të mallrave, aktualisht në anën jugore të Fushë-Kosovës, duhet të zhvillohet në një logjistikë efikase intermodale (HUB), ku së pari do të jetë pajisje ashtu që transporti i mallrave do të transferohet përmes mënyrave të ndryshme të transportit, p.sh. nga binarët në rrugë, nga ajri në gjurmë, dhe nga rruga në binarë.

Mund të shërbejë si funksion kritik ekonomik për regjionin, duke lejuar logjistikën, kompanitë e prodhimit dhe distribuimit që deponimet dhe distribuimet nacionale t'i centralizojnë dhe tërheqin kompanitë e huaja që janë të interesuara në bizneset në zonat nëpër Ballkan.

Prezenca e tij mundet gjithashtu të forcojë rolin e Prishtinës në korridoret e planifikuara evropiane, duke vlerësuar pozicionin qendror si udhëkryq të Gadishullit Ballkanik.

Për më tepër, logjistika HUB duhet të funksionojë si OTP (operator i transportit multimodal) duke lidhur transportin e kombinuar Terminal dhe stacionin e të mirave me një qendër për pajisje dhe shërbime që punojnë në një sinergji të plotë me njëra-tjetrën.

Operatorët mund të kontaktojnë HUB-in për të organizuar transportimet e njësisive të ngarkesave intermodale, kontejnerët e tyre, shkëmbim të marrëveshjeve, me një kontakt të vetëm të specializuar të aftë që të organizojë derë më derë dërgesa dhe grumbullim.

Trenat për transportim të mallrave duke lënë HUB, duhet të jenë trena të grupuar p.sh. trena ku mund të dërgojnë vetëm një kontejner apo diçka tjetër të ngjashme. Kjo do të thotë një shërbim i dizajnuar që matë nevojat e kompanive të vogla dhe të mesme që janë prezente vetëm në Kosovë dhe në shtetet fqinje, të cilat rrallë kanë vëllim të mjaftueshëm të të mirave materiale për të mbushur gjithë trenin.

Logjistika e HUB-it duhet të ofrojë:

1. Shërbimet e integruara logjistike, duke përfshirë trajtimin, depoimin, pranimin, sortimin e mallrave, paketimin, etj.
2. Depot e yakonshme dhe depot e ftohta (frigoriferë) për shërbime të shumëllojshme EEC vulë për mish dhe peshk.
3. Logjistika të qytetit për dërgesa të mallit duke përdorur eko-automjete (automjete që ruajnë ambientin) të distribuimit në dyqanet e gjithë qytetit.
4. Transportim i mallrave dhe konsulencë për eksport në transportet ndërkombëtare tokë-det.

5. Konsulencë doganore
6. Depot fiskale për lirimet nga TVSH, lirimet nga dogana dhe për mallra me taksa përkohësisht të suspenduara.

Përveç këtyre aktiviteteve, qendra logjistike duhet të riparojë, shesë dhe japë me qira kontejnerë të ri dhe të përdorur.

Bazuar në kushtet e sipërpërmenduara, lokacioni rkyistues i HUB-it në Fushë-Kosovë është më i miri për këto arsye:

- mundësia që të përdorë dhe të ngritë stacionin ekzistues në linjën ekzistuesehekurudhore;
- disponueshmëria e tokës për zgjerimin e ardhshëm të HUB-it për mallra;
- afërsia me rrugën rajonale (M9) dhe me autostradën e planifikuar;
- mundësia për t'u lidhur lehtë me qendër edhe me aeroport;

Një temë shumë e rëndësishme është shpërndarja e mallrave brenda qytetit, duke parandaluar rrugën në qendër të qytetit që të mos kalojnë kamionët, shpeshherë burim i ndotjes, bllokim i trafikut dhe rrezik për aksidente.

Për shpërndarjen brenda qytetit mund të përdoren automjetet elektrike, kurse me qendër logjistike duhet të sigurohet të gjitha kompanitë e transportit. Automjetet e përdorura për shërbime mund të përdorin korsi preferenciale, hyrje të lirë në qytet dhe të jenë në gjendje për të parkuar në brendësi të zonave të kufizuara të trafikut përfundimisht në çdo kohë të ditës.

Qëllimi i kësaj mënyre të shpërndarjes është për të racionalizuar shpërndarjen e mallrave në qendër të qytetit, duke ndihmuar që të mos bllokohet trafiku dhe për të reduktuar ndotjen e ajrit.

Çfarë përfitimesh do sjellë HUB-i në rajonin e Prishtinës?

Për komunitetin e përgjithshëm ajo do të:

1. Krijojë mundësi të reja punësimi.
2. Përmirësojë shpërndarjen me kohë të mallrave.

Për biznes dhe industri ajo do të:

3. Krijojë efikasitet në transportin e brendshëm dhe të jashtëm të mallrave-duke kursyer paratë e operatorëve.
4. Sigurojë një integrim më të mirë të infrastrukturës, duke e bërë punën më të lehtë.
5. Ulë koston e transportit nëpërmjet përpjesës së ekonomive.
6. Rritë besueshmërinë dhe kapacitetin e shpërndarjes.
7. Përmirësojë shërbimet e shpërndarjes dhe cilësisë
8. Japë përparësi konkurruese globale për biznes të ri me qasje në tregjet ndërkombëtare nëpërmjet rrjetit të gjerë të transportit

Për rajonin ajo do të:

9. Ofrojë mundësi të mëdha për investime për bizneset që dëshirojnë të jetë pjesë e këtij zhvillimi të rëndësishëm të infrastrukturës
10. Ofrojnë një mundësi për të zgjeruar dhe forcuar aktivitetin ekonomik
11. Tërheqë industri të reja

## Logjistika e mallrave në HUB



Bazuar në shembuj europian dhe botëror do të krijohet një platformë intermodale që integron dy mënyra të transportit: rrugor dhe hekurudhor.

Me lokacion në Zonën Industriale, të përmbajë kompani të ndryshme dhe një numer të madh të punëtorëve.

Të ketë lidhje të shkëlqyer me autostradën, situacioni është i lidhur me hekurudhën ekzistuese. Funkcionalisht hapësira e HUB duhet të ketë hapësirë të madhe, mund të përmbajë Spa, hapësirën për vendosjen e kontenjerëve, numër të madh të operatorëve të logjistikës, transportues dhe korrierë të cilët punojnë së bashku në sinergji që të bëjnë këtë një ndër qendrat më të rëndësishme.

## Transporti drejt qytetit



Cityporto është distribues i shërbimeve të të mirave urbane duke përdorur metan dhe makina elektrike, e krijuar dhe menaxhuar nga kjo qendër. Fjalë kyçe e projektit për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetit janë: transporti “ecofriendly” (që nuk ndotë ambientin), sistemi modal, reduktimi dhe modernizimi i trafikut.

Si funksionon: operatorët- transportuesit, transportojnë mallrat e tyre te platforma e logjistikës (HUB), Prej këtij stacioni intermodal në periferi të qytetit, ku me makina elektrike ngarkohen ne HUB në transportues të vogël me energji elektrike apo sisteme tjera të transportit “ecofriendly”) dhe pastaj shpërndajnë mallrat në qendër të qytetit, e ashtuquajtura “milja e fundit” e zinxhirit transportues.

### 3.2.3. Popullsia, banimi, vendbanimet, çështjet sociale dhe trashëgimia kulturore

#### b. Dendësia dhe madhësia e popullsisë urbane

Qëllimi kryesor i PZHK-së është të menaxhojë rritjen urbane, të akomodojë rritjen e popullsisë në të ardhmen, në mënyrë që të sigurojë të njëjtin nivel të lartë të cilësisë së mjedisit, efikasitetit funksional dhe vitalitetin socio-ekonomik, të dyja të parashikuara në hapësira të ndryshme urbane të aprovuara dhe në pritje të URP-së, dhe në zona të propozuara ndërtimi<sup>26</sup>. Ky objektivi është vensosur në kornizë të balancuar dhe zhvillim të qëndrueshëm të kryeqytetit dhe kërkon një qasje të re për menaxhimin e rritjes urbane për të ruajtur territorin dhe për të përmirësuar (tashmë të pamjaftueshme) shërbimet për banorët.

Konceptet e PZHK-së janë këto:

- Promovimi i procesit të "densitetit" që ka nevojë të ketë vëmendjen e sensitivitetit në kontekst të ndryshëm (p.sh. zona historike e qytetit) dhe se do të duhet të shoqërohet nga një forcim i hapësirave publike të qytetit (shërbimet, parqet urbane, sheshet, vendparkimet...)
- Definimin (e kufizuar) të zonave të reja të zgjerimit (me pushtimin e tokave jo të urbanizuara), por në një mënyrë që ruan identifikimin e vlerave të territorit, duke zgjedhur zonat në të cilat mund të përmirësohet qasja (sidomos me transport publik)
- Arritjen e standardeve të banimit dhe jetesës të ngjashme me ato të vendeve evropiane, ndërsa sigurimin e një niveli të përshtatshëm të objekteve publike dhe shërbimeve dhe mbrojtjen e nevojshme të tokës bujqësore.

Mbi këtë bazë është supozuar se prania e aktiviteteve në përputhje me përdorimin<sup>27</sup> e banimit dhe një densiteti të përshtatshëm të popullsisë janë kushtet thelbësore të një rritjeje të qëndrueshme urbane.

Këto duhet të kombinohen me provizionin e tokës për:

- 1) infrastrukturat kryesore të nevojshme për mobilitet dhe shërbime<sup>28</sup> teknike urbane
- 2) standardet themelore të sipërfaqes së tokës për banorë teorikë që të sigurohen shërbimet dhe pajisjet që lidhen me vendbanimet.  
Duke iu referuar standardeve minimale propozohet 18 m<sup>2</sup>.<sup>29</sup>

<sup>26</sup> Densitet minimal për transport publik. Bus. Min 30 vendbanime/ha; Treni min 60 vendbanime/ha; max 300 nga ndalesa e autobusit.

<sup>27</sup> Këto do të konsistojnë në shkallë të vogël komerciale dhe aktivitete artizanale, biznesit dhe zyrat, punëtori dhe shërbime, përdorime shoqërore dhe rekreacion, të cilat mund të bashkëjetojnë brenda strukturave të njëjta banimi

<sup>28</sup> Këto infrastruktura parësore përfshijnë rrjetin rrugor për të lidhur çdo zgjidhje për pjesën tjetër të zonës urbane me trotualet dhe shtigjet e çiklistave të lidhura me fusha për transportet publike, si dhe "korridoret" për impiantet teknike dhe telekomunikacionit, duke përfshirë furnizimin me ujë, ndriçimin publik, kanalizimet dhe kështu me radhë. Normalisht sipërfaqja për këto infrastruktura parësore vlen për të 20% të sipërfaqes totale të vendosjes. Këto dispozita duhet të jenë domosdoshmërisht të implementuara në tokat publike, që do të shpronësohen ose të blera nga ana e autoriteteve publike.

<sup>29</sup> Regjioni Emilia Romagna (Italy) 30 m<sup>2</sup> për banorë.



Është propozuar që çdo PRrU do të sigurojë, për të paktën 18 m<sup>2</sup> / banor të caktuar për çerdhet dhe shkollat fillore (25%); shërbimet e tjera publike dhe serviset (p.sh. kulturore, sociale, shëndetësore dhe objekteve administrative që arrin 11%); parkimin publik të automjeteve (14%); zonat e gjelbërta dhe objektet sportive (50%). Ky raport duhet të aplikohet te "banorët teorikë" të çdo zone urbane.

Në mënyrë që të përcaktohet potenciali për rritjen e popullsisë dhe rrjedhimisht sipërfaqeve të nevojshme për zhvillimin e banimit dhe shërbimeve publike të lidhura, nga PZHK janë identifikuar lloje të vendbanimeve urbane:

- Zonat urbane të konsoliduara;
- Zonat urbane të kompletuara të dendura;
- Zonat e zgjedhura të zgjeruara.

Kriteret e mëposhtme janë propozuar për llojet e mësipërme të vendbanimeve:

- **Zonat e banimit të konsoliduara**

Në këto vendbanime, procesi i zhvillimit të tokës është arritur dhe infrastrukturat parësore dhe objektet e nevojshme publike dhe pajisjet tashmë ekzistojnë. Në parim ndërtesat ekzistuese dhe dendësia e popullsisë nuk duhet të rritet; ndërhyrjet e vetme që do të pranohen janë ato që synojnë zëvendësimin, përmirësimin dhe ripërdorimin e aksioneve ekzistuese të ndërtimit, duke rritur sigurimin e objekteve publike dhe kolektive dhe zhvillimin në shkallë të vogël të përzier të përdorur për të rritur vitalitetin socio-ekonomik të lagjeve. Hapësirat e pandërtuara dhe zonat e lira duhet të përdoren kryesisht për të përmirësuar mjedisin ekzistues urban dhe jetesën, sasinë, p.sh. rritjen dhe cilësinë e hapësirave publike, duke përfshirë edhe zonat e gjelbërta, për këmbësorë dhe shtigjet për çiklistë, si dhe parking për automjete. Për zonat urbane të konsoliduara planet specifike të rikualifikimit duhet të hartohen (duke u dhënë përparësi zonave historike të identifikuara).

Është supozuar se nuk ka rritje të popullsisë - sot rreth 115,000 banorë<sup>30</sup>, me një dendësi prej 40 vendbanime/ha – që do të ndodhë në këto vendbanime në periudhë afatmesme/afatgjatë, edhe në qoftë se funksionet e reja të kryeqytetit, rritja e cilësisë urbane dhe tregu i pasurive të patundshme mund të sjellin ndoshta një ndryshim në strukturën sociale dhe përbërjen demografike të popullsisë rezidente të këtyre zonave.

<sup>30</sup> Rekos 2011

- **Zonat urbane që do të kompletohen dhe popullohen**

Në këto vendbanime, procesi i zhvillimit të tokës ka qenë i ndërmarrë, por kjo nuk është përfunduar ende. Në rastin e zhvillimeve të planifikuara nga PRrU të miratuara tashmë, ose në pritje, dispozitat e tokës për infrastrukturën parësore dhe me shpresë për objektet publike (standarde) duhet të sigurohet normalisht nëse nuk zbatohen ende. Në rastin e zhvillimit të paplanifikuar (ose të paligjshëm), PRrU-ja duhet të krijojë mënyra për të siguruar këto dispozita të tokës në raport më të lartë të mundshëm me një plan urbanistik të efektshëm, duke përfituar nga zonat e pazhvilluara dhe parcelat e zbrazëta, të pandërtuara.

Në çdo rast, zhvillimi i banimit në këto vendbanime duhet të përfundojë me ndërhyrje në zgavër të "infill" dhe "zhvillim të lokalizuar" në tokat e zbrazëta, por edhe nëpërmjet shtesave vertikale dhe horizontale apo rikonstruksionit të ndërtesave ekzistuese. Përdorimi i tokës duhet të maksimizohet duke respektuar densitetin e kufizuar që të përcaktohet për çdo aspekt, dhe për këtë qëllim tipologji të ndryshme të ndërtimit mund të propozohen që të reduktohet konsumimi i tokës, të tilla blloqe dhe kulla, por edhe shtëpitë terracore dhe llojet e tjera të densitetit të ndërtesave me ulje e ngritje të lartë.

Popullimi teoretikal për aplikimin e standardeve duhet të llogaritet mbi bazën e mesatares, pra ku rreth 50 banesa ose 200 banorë/ha për kufi, i cili do të kërkonte rreth 36% të sipërfaqes së tokës për shërbimet publike dhe shoqërore, plus një 20% për infrastrukturën parësore, kur këto nuk janë dhënë ende.

Duke marrë parasysh densitetin e ulët aktual (zonat kadastrale rreth Prishtinës kanë një mesatare 8 banesa/ha), këto vendbanime janë menduar për të absorbuar një raport të lartë të rritjes së popullsisë në të ardhmen. Ajo mund të supozohet se me të vërtetë, toka në dispozicion për ndërhyrje të reja të zhvillimit ose për dendësimin e strukturave ekzistuese mund të garantojë një rritje mesatare prej të paktën **20 banesa/ha** (të marrë një dendësi prej **28 banesave globale/ha**).




Fig.10. Rritja urbane e Prishtinës



- **Zonat e zgjedhura të zgjeruara**

Këto zhvillime të reja të propozuara nga PZHK duhet të identifikohen dhe patjetër të planifikohen në detaje nga URP, për t'u bërë vendbanime me një përdorim banimi mbizotërues, por duke përfshirë edhe biznesin dhe shërbime të aktiviteteve të ndryshme. Një dendësi mesatare prej 50 banesave/hektar ka qenë e supozuar nga PZHK, që korrespondon me 200 banorë/ha.<sup>32</sup> Megjithatë, densitete të ndryshme, duke filluar 35-70 banesa/hektar, mund të përcaktohen nga PRrU për vendbanime të ndryshme, në varësi të kontekstit urban dhe peizazhit, rrjetit infrastrukturor dhe publik i transportit, si dhe për tipologjinë e adaptuar të ndërtimit. Kudo që të jetë e mundur, hapësirat e gjelbërta duhet të rriten dhe të përmirësojnë cilësinë e mjedisit dhe biodiversitetit.

Për më tepër, lëvizja e qëndrueshme duhet të jetë pjesë e një qasjeje të integruar. Reduktimi i ngjeshur është i rëndësishëm nga një pikë e shëndetit, por kjo nuk është vetëm në lidhje me reduktimin e emetimit të CO<sub>2</sub>, ndotjes dhe zhurmës - ajo gjithashtu ka të bëjë edhe me dhënien e mundësive qytetarëve për ripushtim të qytetit. Rrugët me trafik të dendur gjithashtu janë pengesa që në mënyrë efektive ndajnë strukturën urbane, duke izoluar lagjet dhe duke i bërë ato të shëmtuara.

Objektet publike, së bashku me hapësirat komerciale dhe pasuritë e tjera duhet të planifikohen dhe të dizajnohen për të krijuar vende tërheqëse dhe të gjalla të bashkimit shoqëror të bashkëveprimit, lehtësisht të arritshme në këmbë ose me biçikletë.

Ne duhet të inkurajojmë krijimin e modeleve të përziera dhe të larmishme urbane, me synim dhënien e vitalitetit të hapësirës publike urbane në kohë të ndryshme të ditës, duke ulur kërkesën e lëvizshmërisë (përmes zbatimit të parimit të afërsisë), dhe rritjen e sigurisë.

### **Roli i PZHU-së**

Në një nivel tjetër të shkallës, PZHU duhet t'i artikulojë këto tri zona të ndryshme urbane në zona me dimensione më të ulëta, duke përcaktuar parametrat specifikë të ndërtimit, përzierje e funksionit dhe tipologjisë për secilin prej tyre lidhur me karakteristikat e vetë zonës. Implementimi duhet të vijë pas planifikimit të URP<sup>33</sup>. Në përgjithësi, të gjitha nënzonat përfundimisht duhet të identifikohen dhe të planifikohen nga URP-ja dhe planifikime tjera të detajuara dhe mjetet e implementimit (d.m.th. krijimi i partneritetit publiko-privat). Në veçanti, përveç kodeve të zakonshme të planifikimit dhe parametrave të ndërtimit (d.m.th. raporti i ngarkimit të ngastrës, raporti i sipërfaqes së tokës, maksimalja e lartësisë së objekteve, dhe të ngjashme), për secilin lloj të vendbanimit, mjetet e planifikimit duhet të sigurojnë si në vijim:

---

<sup>32</sup> Nëse supozojmë një mesatare prej 4 persona/për çdo shtëpi

<sup>33</sup> Në ligjin italian ndërtimi i një zone të rregulluar me një URP duhet të heqë dorë (ose të paguajnë) në Komunë për të lokalizuar zonat e shërbimeve (standard). Investitori realizon direkt infrastrukturën primare. Për më tepër për çdo metër katror të ndërtimit investitori paguan një grant në komunë për realizimin e kënaqësive publike. Në disa rajone takon lehtësitë publike edhe ndarja e zonave të shkojë për strehim social dhe përmirësimin e mjedisit.

- Të përcaktojnë zonat për aplikimin e densiteteve dhe standardeve, kështu duke përcaktuar numrin e "banorëve teorikë"<sup>34</sup> d.m.th. vendosja e popullatës potenciale nëpër zonë.
- Në këto zona të identifikohen zonat, të cilat do të vihen në dispozicion të autoriteteve publike për implementimin e infrastrukturës primare dhe shërbimeve tjera të kërkuara nga standardet<sup>35</sup>.




Fig.11. Rritja e balancuar dhe dendësia




Fig. 12. Tipologjitë urbane me të njëjtën dendësi të ngastrës<sup>23</sup>

<sup>34</sup> Numri i "banorëve teorikë" mund të llogaritet për çdo ambient në bazë të 30 m<sup>2</sup> të sipërfaqes bruto për banor. Duke supozuar një mesatare prej 4 persona/familje, sipërfaqja e tokës për "standardet" e shërbimeve publike korrespondon me rreth 70 m<sup>2</sup> në banesë.

<sup>35</sup> Disponueshmëria e tokës për infrastrukturën primare dhe shërbimet publike kërkon një "ad hoc" politikë të tokës që do të zbatohet përmes mjeteve të ndryshme ligjore dhe financiare: përveç metodave konvencionale të shpronësimit dhe kompensimit apo blerjen e tokës, forma të ndryshme të partneritetit publiko-privat mund të hulumtohen.

<sup>23</sup> burimi: "Urban Renaissance", Urban Taskforce, Londër 1999

## Sa banorë mund t'i strehojë Prishtina në një të ardhme?

Duke u bazuar në strukturën e zonës urbane, në tri zonat e ndryshme (zonat e konsoliduara urbane, zonat urbane të pabanuara dhe në përfundim e sipër, zonat e përzgjedhura të zgjeruara), të paraqitura shkurtimisht në hartën e mëposhtme, është e mundur të kalkulohet sasia e popullsisë e cila mund të jetojë në mënyrë të qëndrueshme brenda zonës urbane (e përcaktuar nga kufiri urban) të Prishtinës.




Fig.13. Zonat e konsoliduara dhe të pakonsoliduara urbane

Do të ishte e dobishme të rikujtojmë disa të dhëna rreth situatës aktuale:

Madhësia mesatare e shtëpive është 4,9<sup>36</sup> anëtarë për familje (prej 6,2 në 2000<sup>37</sup>)

Madhësia mesatare e njësisë së banimit ishte 67m<sup>2</sup> <sup>38</sup>; secilit person i takon një mesatare prej 11m<sup>2</sup> sipërfaqe banuese për person<sup>39</sup>

Disa shkaktarë që variojnë në sasi të madhe prej standardeve të qyteteve të tjera:

Madhësia e familjes: mesatare prej 4,9 është megjithatë shumë e madhe krahasuar me shtetet e BE-së që është 3,0 me tendencë të rënies deri 2,0<sup>40</sup>.

Zonat e banuara në Prishtinë (mesatarisht 11 m<sup>2</sup> për person) janë shumë të vogla; Kryeqytetet baltike mesatarisht kanë deri në 23 m<sup>2</sup> (min.18 m<sup>2</sup>), Lubjana 26, Zagrebi 23 m<sup>2</sup>.

<sup>36</sup> REKOS 2011

<sup>37</sup> SpudoK

<sup>38</sup> SpudoK

<sup>39</sup> SpudoK

<sup>40</sup> (REKOS, EU: Urban Audit)

Qëllimi kryesor është që të sigurohet një strehim për secilën familje, kalkulimi i numrit global të banorëve është shkurtimisht e vlerësueshme në kuptimin e dimensionit të mesëm të familjeve në dhjetë vjetët e ardhshme. Është besuar se trendi në rënie (tashmë i pranishëm sidomos në kryeqytet) është konfirmuar edhe nëse është e vështirë të parashikohet shpejtësia me të cilën ky mund të vazhdojë.

Duke u bazuar në standardet, zonat për rekreacion që u shërbejnë vendbanimeve, duhet të jenë prej 30,6 km<sup>2</sup> deri 25,2 km<sup>2</sup>.

## **Përmirësimi dhe vlerësimi i identitetit nëpërmjet vlerave kulturore dhe natyrore**

### **Çështje kritike**

**Trashëgimia kulturore** është trashëgimia e ndërtesave fizike dhe attributeve të paprekshme të një grupi apo shoqërie që janë trashëguar nga gjeneratat e kaluara, ruhen në të tashmen për të dhe japin benefite edhe për gjeneratat e ardhshme. Trashëgimia kulturore përfshin kulturën e prekshme (të tilla si ndërtesat, monumentet, peizazhet, librat dhe veprat e artit), kulturën jomateriale apo të paprekshme (të tilla si folklorin, traditat, gjuhën dhe njohuritë), dhe trashëgimia natyrore (përfshirë peizazhet kulturore të rëndësishme dhe biodiversitetin). Trashëgimia kulturore është një pasuri unike dhe e pazëvendësueshme, e cila luan një rol të rëndësishëm në imazhin e qytetit, si dhe vendos përgjegjësinë e ruajtjes në brezin e tanishëm.

Në veçanti qytetet historike dhe vendbanimet e vogla duhet të konsiderohen si komponent kryesor i trashëgimisë kulturore, jo vetëm si zona funksionale. Këto duhet të identifikohen qartë dhe të kufizohen nga mjetet e planifikimit urban dhe të dorëzohen në ruajtjen specifike dhe rregullat e përdorimit të tokës në përputhje me standardet e përcaktuara edhe ndërkombëtarisht. Struktura e tërë urbane, jo vetëm monumentet dhe ndërtesat e shënuara, duhet të mbrohen dhe vlerësohen si dëshmi për shtresa të shumta historike dhe kulturore. Kjo kërkon një analizë të detajuar dhe një dokumentacion të thellë të të gjithë komponentëve që përbëjnë morfologjinë urbane (d.m.th. modelet e rrugëve dhe sistemi i hapësirave publike) dhe duke ndërtuar mjedis (tipologji historike arkitektonike, materialet dhe teknikat e ndërtimit, duke përfshirë ato të cilat tregojnë ndikimin Osman në përbërjen, formën dhe dekorimin e ndërtesave). Kjo është e nevojshme për të zbatuar masa efektive për ruajtjen e karakteristikave të trashëgimisë, ndërsa nxitjen e një procesi rehabilitues dhe ripërdorimin adaptiv që mund të rrisin rolin funksional të qendrës historike.


Megjithatë, ruajtja e trashëgimisë kulturore nuk mund të kufizohet në qendra historike dhe në monumente por duhet t'i përfshijë të gjitha pasuritë e trashëgimisë së prekshme dhe të paprekshme që formojnë një identitet të shumtë dhe kompleks, duke mbrojtur biodiversitetin (përmes promovimit të rrjeteve ekologjike) dhe peizazheve kulturore. Territori i Prishtinës është me të vërtetë potencialisht shumë i pasur me trashëgimi kulturore dhe karakteristikat e mëposhtme duhet të shqyrtohen me kujdes:

- *Lokalitetet me rëndësi arkeologjike*
- *45 lokalitet arkeologjike dhe monumente arkitekturore të identifikuara*
- *Gjurmë të vendbanimeve neolitike*
- *Potencial i pazbuluar arkeologjik*

Problemet kyçe janë:

- Mungesa e vetëdijes për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mbrojtjen e mjedisit (PHK 2010-2020)

- Zhdukja e tërësive dhe disa monumenteve kulturore me gjithë faktin që ishin të mbrojtura
- Gjurmë jo të theksuara historike në indin e qytetit



Harta 16. Trashëgimia arkeologjike (shenja të kaltra) & arkitekturale (shenja të kuqe)




Fig. 14. Rrugët e mbijetuar të qendrës historike të Prishtinës

**Trashëgimia natyrore** është trashëgimia e të mirave natyrore dhe atributet jomateriale që përfshijnë fshatrat dhe mjedisin natyror, duke përfshirë botën bimore dhe shtazore, i njohur shkencërisht si biodiversitet, gjeologjia dhe morfologjia e terrenit apo gjeodiversiteti.

Regjioni i Prishtinës ka disa **pika të forta** të trashëgimisë natyrore:

- Ekzistenca e zonave të mëdha të paprekura dhe peizazheve natyrore.
- Rajoni i Komunës së Prishtinës është i rrethuar me pyje, të cilat kanë një hidrografi interesante, me praninë e pemëve, kryesisht drurë gjetherënës.

- Prania e Zonave të Mbrojtura Natyrore: Parku Rajonal natyror i Gërmisë, i pasur me florë, faunë dhe vegjetacionin;



	Tokë bujqësore
	Depozita të linjtit
	Pyje
	Lumenjtë
	Liqenet

Burimi:  
Plani Hapësinor i Kosovës

Harta 17. Shfrytëzimi i tokës

## Qëllimet dhe synimet

Të dy trashëgimitë fizike dhe shpirtërore mund të luajnë një rol **në zhvillimin dhe afrimin e komuniteteve lokale të Prishtinës** në mënyrat si më poshtë:

- **zbutja e tensioneve sociale.** Trashëgimia është pjesë e të kaluarës së përbashkët, ajo është burim i identitetit të komunitetit. Puna e bërë në ruajtjen e trashëgimisë kontribuon në forcimin e një ndjenje të përbashkët të identitetit brenda një komuniteti. Nëpërmjet njohjes të së kaluarës, ruajtja e trashëgimisë ndihmon në përgatitjen e një të ardhme më të mirë.
- **rritja e nivelit kulturor.** Ndikimi i trashëgimisë në bashkësitë lokale nuk është vetëm ndikim fizik, por më shumë ndikim shpirtëror: ai mund të bëhet shumë konkret sa më shpejt që banorët lokalë janë të përfshirë në ruajtjen dhe promovimin e proceseve. Trashëgimia, kur menaxhohet mirë, mund të bëhet një mjet për të ndarë përvojat, shkëmbim njohurish dhe për t'i integruar komunitetet lokale në rrjetet ndërkombëtare.

**-zhvillimi i ekonomisë lokale.** Kur ajo është e lidhur me turizmin, gjithashtu dhe me trashëgiminë mund të bëhet burim i drejtpërdrejtë i të ardhurave. Megjithatë, për t'i shmangur pasojat e zhvillimit të pakontrolluar të turizmit masiv dhe ndikimet e tij negative në faqet e ruajtjes, komunitetet lokale duhet të përfshihen direkt në qasjet kulturore dhe në turizëm rural me theks të veçantë në ekoturizëm.

Për më tepër, ruajtja dhe restaurimi ekologjik i zemrës së gjelbër të Evropës është parashikuar nga Këshilli i Evropës, si një kontribut për ngritjen e një strukture koherente hapësinore dhe mirëmbajtjen e proceseve ekologjike.

Rrjetet ekologjike janë të bazuara rreth idesë së zonave kryesore, korridoreve ekologjike, zona bufer dhe zonat e restaurimit. Ato janë të dizajnuara dhe të menaxhuara në mënyrë të tillë për të

ruajtur llojlojshmërinë biologjike apo rivendosur lehtësitë e ekosistemit nëpërmjet lidhjes së brendshme dhe elementeve të tij fizike brenda peizazhit.

Rrjeti ekologjik duhet të realizohet në mënyrë që të jetë në gjendje që të promovojë rekreacion dhe dëfrim në natyrë për banorët e qytetit, në marrëdhënie me çiklizëm dhe shtigje të rrugëve, zona të vogla të parkimit, etj.

## **Koncepti**

### **Trashëgimia kulturore**

Propozohet një qasje e integruar e mrojtjes së trashëgimisë kulturore, që lidh ruajtjen dhe vlerësimin dhe rivitalizimin duke e aktivizuar çdo monument apo lokalitet në funksion të zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit të komunitetit lokal duke promovuar turizmin kulturor.

Sipas Agjencisë Euro-Mesdhetare të Trashëgimisë Kulturore, zhvillimi është një aspekt i nevojshëm në menaxhimin e saktë të trashëgimisë kulturore. Menaxhimi korrekt i trashëgimisë kulturore bëhet avantazh për përdoruesit, për komunitetin dhe për objektet multikulturore.

Në fushën e trashëgimisë kulturore, rëndësi të caktuar ka zhvillimi nëpërmjet vlerësimit dhe të afirmimit të burimeve njerëzore si një komponentë e paanashkalueshme e zhvillimit ekonomik. Zhvillimi adekuat është çelësi që një vend me interes kulturor mund të ketë për të dalë në peizazhe konkurruese urbane-historike. Trashëgimia kulturore shikohet nga dy aspekte, aspekti i zhvillimeve të kontrolluara pran monumenteve dhe lokaliteteve arkeologjike duke u kujdesur që mos të dëmtohen apo devastohen dhe nga aspekti i vënjes së këtyre aseteve në funksion të zhvillimit ekonomik.

Parimet e zhvillimeve të Peisazhit Urban-Historik duhet tentuar të aplikohen në vecanti në “Zonën Historike” të qytetit të Prishtinës dhe qendrës së saj. Xhamiat, Hamami, Sahat kulla, ish ndërtesa e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Kompleksi i “Emin Gjiku”-ut, Muzeu i Kosovës, Parku arkeologjik, etj. paraqesin ekzemplarë që duhen trajtuar me projekte të vecanta të kësaj zone historike të qytetit të Prishtinës.


Të gjitha planet dhe projektet për trajtimin e trashëgimisë duhen bazuar në Ligjin ekzistues dhe të sinkronizohet edhe me ligjin e ri në hartim për trashëgiminë kulturore, duke respektuar konventat ndërkombëtare të dedikuara për këtë lëmi.

### **Trashëgimia natyrore**

Mbrojtja e karakteristikave natyrore ose gjysmënatyrore, pyjet, lumenjtë, liqenet, parqet edhe në qytet përbëjnë elemente kyçe për sigurimin e rrjetit ekologjik.

Trendi i rënies së biodiversitetit është trend në gjithë botën. Fragmentarizimi dhe shpërndarja e vendbanimeve, ndotja e ajrit, mbipërdorimi i zonave natyrore dhe krijimi i peizazheve artificiale rrisin shkallën e erozionit, duke reduktuar mundësinë e specieve për shpërndarje, migracion dhe shkëmbim. Rrjetet ekologjike mund të ndikojnë pozitivisht në kushtet për mbijetesën e specieve në zonat e fragmentuara dhe peizazheve natyrore njerëzore të dominuara. Përveç kësaj, ato lejojnë një përdorim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore përmes lidhjes së brendshme të elementeve të tyre fizike me peizazhin dhe strukturat ekzistuese sociale/institucionale.

Vendbanimet rurale, në vecanti në pjesën veriore të territorit të Komunës së Prishtinës që në një mënyrë shkrihen në pejsazh duhen të ruhen duke u transformuar në pika të agroturizmit dhe turizmit rural. Një qasje e tillë e bazuar në konceptin “mbroje duke e shrytëzuar” paraqet një garanci për ruajtjen e trashëgimisë natyrore.



Harta 18. Trashëgimia natyrore

## Rritja e vendbanimeve rurale model për një zhvillim të ri bujqësor Çështjet kritike

Pristina ka një territor të gjerë prej: 20.358 ha. tokë bujqësore, 14 000 ha. tokë e kultivuar, 30 000 ha pyje dhe pjesa tjetër për kullota.

- ➔ bujqësia nuk është mjaft e zhvilluar, (Programi 2008-2011)
- ➔ është në vazhdim procesi i migrimit nga zonat rurale drejt qytetit për shkak të nivelit të lartë të shërbimeve publike dhe mundësive më të mëdha të punësimit.

## Qëllimet dhe synimet

Objektivat kryesore janë:

- Mirëmbajtja e pranisë njerëzore në zona rurale ngrit nivelin e shërbimeve dhe cilësinë e jetës;
- Zhvillimi multifunksional i bujqësisë dhe pylltarisë (kujdesi për pyje, ripyllëzimi i pyjeve dhe shfrytëzimi i drurit)



## Koncepti

Organizimi i grupeve të vendbanimeve të afërta përgjatë lidhjes së infrastrukturës rrugore lejon një planifikim më efikas të shërbimeve publike.

PZHK-ja propozon ndarjen e territorit të komunës në 5 zona, për të organizuar lehtësisht grupimin në bazë të parametrave të afërsisë dhe të rrugëve ekzistuese. 5 zonat e propozuara janë:

### Zona Qendër

Si tërësi kryesore integruese e pjesëve tjera periferike është hapësira rreth së cilës gravitojnë të gjitha tërësitë e tjera territoriale.

Kufiri për përkufizimin e territorit të njësisë administrative – zona Qendër fillon nga Xhamia e Llapit, e cila vazhdon në drejtim jugor të qytetit përgjatë “unazës qendrore”, përkatësisht hekurudhës ekzistuese në rrugën e Zagrebit deri te pikëprerja e kësaj rruge me rrugën Prishtinë – Mitrovicë, për të vazhduar në anën jugore të qytetit në drejtim të kësaj rruge, e cila arrin deri te lidhja e saj me ‘Bulevardin e Dëshmorëve’ në drejtim të rrugës ‘Fehmi Lladrovci’, në lindje deri te pikëprerja me rrugën ‘Agim Ramadani’ dhe ‘Xheladin Rekaliu’, për të vazhduar më tutje në drejtim verior të qytetit përgjatë rrugës Agim Ramadani e deri te rruga ‘Ilir Konushevc’, e cila përfundon në pikënisjen te Xhamia e Llapit. Konform kësaj, tërësia territoriale Qendra përfshin hapësirën në kuadër të unazës qendrore (shih hartën e mëposhtme).

### Zona Verilindje

Kjo njësi administrative territoriale shtrihet në zonën verilindore të qytetit dhe pjesën periferike me fshatrat që gravitojnë në këtë tërësi territoriale. Pjesa verilindore e qytetit i përket kësaj njësie administrative që përkufizohet me kufijtë duke u nisur nga pika fillestare te Xhamia e Llapit, e cila vazhdon përgjatë rrugës ‘Bajram Bahtiri’ në drejtim të fshatit Llukar duke përfshirë zonat kadastrale Ballaban, Dabishevc, Glllogovicë, Grashticë, Hajkobillë, Keqekollë, Koliq, Kolovicë, Llukar, Makovc, Nishec, Prapashticë, Sharban, Radishevc, Siçevë, dhe Sofali, e cila vazhdon deri te rruga ‘Isa Kastrati’ në lindje të qytetit në drejtim të rrugës ‘Rrustem Statovci’ dhe vazhdon rrugës ‘Ardian Krasniqi’ deri në lidhjen me rrugën ‘Agim Ramadani’ në drejtim të rrugës ‘Ilir Konushevc’, deri në pikën fillestare Xhamia e Llapit.

### Zona Lindje

Territori i kësaj njësie administrative shtrihet në zonën verilindore të qytetit, zona periferike si dhe fshatrat që gravitojnë në të.

Përkufizimi i kësaj njësie administrative fillon në lidhjen e rrugëve ‘Agim Ramadani’ dhe ‘Adrian Krasniqi’, për të vazhduar në lindje të qytetit në drejtim të kësaj rruge periferike në Mat, duke përfshirë zonat kadastrale: Busi, Dragoc, Kukavicë, Marec, Mramor, Novosellë, Slivovë dhe Zllatar, e cila arrin deri te rruga magjistrale Prishtinë–Ferizaj në jug të Prishtinës, kah drejtimi verior i qytetit, përkatësisht ‘Bulevardi i Dëshmorëve’, në drejtim të rrugës ‘Fehmi Lladrovci’ dhe vazhdon në rrugën ‘Agim Ramadani’ deri te lidhja me rrugën ‘Ardian Krasniqi’, ku kjo edhe është pikënisja e kësaj tërësie territoriale.

## Zona Jug

Kjo njësi administrative shtrihet në pjesën jugperëndimore të qytetit, në pjesën periferike si dhe fshatrat që gravitojnë në të. Përkufizimi i kësaj njësie administrative fillon te pikëtakimi i rrugës 'Zagreb' me rrugën e 'Vushtrisë', vazhdon përgjatë rrugës së 'Plavës' deri te rruga 'Qemail Stafa', në drejtim të fshatit Shkabaj, ku përfshihen zonat kadastrale Badovc, Çagllavicë, Hajvali, Shkabaj, Shashkovc, për të arritur te magjistralja Prishtinë – Ferizaj nga jugu në anën veriore të qytetit deri në pikëtakimin e magjistrales me Bulevardin 'Bill Klinton' dhe hekurudhën (vazhdimi i rrugës së 'Zagreb'it), e cila vazhdon përgjatë hekurudhës deri në piken ku lidhen rruga 'Zagreb' me rrugën e 'Vushtrisë', përkatësisht pikënisja e kësaj tërësie territoriale.

## Zona Veri

Territori i kësaj njësie administrative shtrihet në pjesën veriperëndimore të qytetit, pjesës periferike si dhe fshatrat që gravitojnë në të.

Përkufizimi i kësaj njësie administrative fillon në pikëtakimin e rrugës 'Zagreb' dhe rrugës së 'Vushtrisë', e cila vazhdon përgjatë rrugës 'Bajram Bahtiri', që vazhdon paralelisht me hekurudhën ekzistuese në drejtim të fshatit Llukar si dhe duke i përfshirë zonat kadastrale Barilevë, Bërnice e Epërme, Bërnice e Poshtme, Besi, Drenoc, Lebanë, Nëntë Jugoviq, Prugovc, Rimanishtë, Teneshdoll, Trudë dhe Vranidoll, ku për të arritur në fshatin Shkabaj vazhdon në drejtim të rrugës 'Qemail Stafa', rruga 'Plava' dhe rruga 'Zagreb'.

Në lidhje me paisjet e nivelit të lartë, referencë mund të jetë vetëm qyteti dhe në të ardhmen, qyteti policentrik, mund të arrihen nëpërmjet lehtësive të transportit publik të dedikuar për zonat me kërkesë të dobët (subjekt i përmirësimeve të rrugës). Për të lehtësuar qasjen në sistemin e mesëm/të lartë arsimor, kampuse banimi me strehim për studentët mund të zhvillohen, në afërsi të qendrave të shkollës.

Lidhur me bujqësinë e re, në një kontekst të afërsisë me një qytet të madh, shprehja tregon një bujqësi multifunksionale, që nuk është e kufizuar për prodhimin e thjeshtë të lëndëve të para për ushqim, por edhe që synon të integrohet në një kuadër më të gjerë një gamë të funksioneve dhe lehtësirave fitimprurëse për të gjithë qytetarët: Kjo është, në përmbledhje, ndjenja e idesë së bujqësisë multifunksionale, e cila që prej disa vitesh po shfaqet si një referencë kryesore për zhvillimin e ardhshëm të bujqësisë. Jo vetëm në Evropë multifunksionaliteti në bujqësi është objekti të cilit duhet kushtuar vëmendje të veçantë nga ana e bujqve dhe botës institucionale, të bindur se ajo përfaqëson një mundësi të madhe për punësim dhe rritje në buxhetin e fermës.

Format multifunksionale janë kryesisht në përpunim dhe shitje të drejtpërdrejtë të produkteve të tyre, por në të njëjtën kohë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e zonave rurale, kultivimin e racave të lashta dhe racave të kafshëve si dhe në edukimin rural. Aspekti i fundit përmban një pjesë të konsiderueshme të afrimit dhe integritetit midis fshatit dhe qytetit, që në vitet e fundit ka qenë një pikë referimi si në sipërmarrjet e biznesit bujqësor, aq sa në botën e arsimit dhe në opinionin publik si një tërësi.

Ndër pasuritë që atribuohen me figurën e një "fermeri të ri: ne duhet të përmendim:

- Zhvillimin e turizmit social, turizmit për të rinj dhe turizmin për personat me nevoja të veçanta

- Nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit të produkteve ushqimore përmes “zinxhirit të shkurtër” (për shembull tregjet e fermerëve që mbahen periodikisht në qytet)
- Ofrimin e aktiviteteve arsimore (p.sh. aktivitete për edukimin e studentëve rreth fermave) dhe aktiviteteve sociale dhe komoditetet për komunitetet lokale.

Bujqësia multifunktionale mund të bëhet një element pozitiv i faktorëve të jashtëm për rigjallërimin e zonave rurale. Aktivitetet e reja të ditëve të sotme të prodhimit dhe pajisjeve kërkojnë qasje në sektorin bujqësor përbrenda funksioneve të biznesit dhe miratimin e strategjive të reja që nuk mund të jenë ato që janë përdorur tradicionalisht, por që duhet të jetë i orientuar në kërkim të një ekuilibri të ri në kushtet e dinamizmit të përhershëm.



*Shembuj të agrikulturës multifunktionale*



### 3.2.4. Mjedisi, trashëgimia natyrore dhe resurset, peizazhet, etj.

#### Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban dhe rural

##### Çështjet kritike

- Rrjeti joadekuat i monitorimit
- Ndotja e tokës dhe erozioni
- Ndotja e ajrit
- Ndotja e ujit e shkaktuar nga mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, mungesa e infrastrukturës adekuate në ndërtesa, pesticideve të përdorura në bujqësi.
- Menaxhimi i dobët i mbeturinave dhe depozitat e pakontrolluara të mbeturinave
- Mungesa e ndërgjegjësimit publik në fushën e mjedisit dhe mbrojtjes

##### Qëllimet dhe synimet

Qëllimet kryesore në përgjithësi janë:

- Përmirësimi i cilësisë së ujit
- Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave
- Rritja e efikasitetit të energjisë dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme
- Reduktimi i emetimit të gazit
- Përmirësimi i cilësisë në natyrë, ajrit
- Përmirësimi i transportit urban
- Parandalimi dhe reduktimi i zhurmës dhe mbrojtja e zonave të qeta
- Qeverisja e mirë lokale
- Përdorimi dhe planifikimi më i mirë i tokës
- Rritja e biodiversitetit dhe hapësirave të gjelbërta
- Zvogëlimi i rreziqeve mjedisore.

##### Koncepti

Cilësia mjedisore është pjesë e një qasjeje të integruar për të tërhequr edhe mirëqënien. Prishtina dhe Fushë-Kosova janë të pasura në burime, si linjit, ujë të pastër dhe toka pjellore. Një përdorim ekonomik i burimeve shtrihet në bazën e një qasjeje të qëndrueshme.

Uji do të garantohet duke e ndarë kanalizimin atmosferik nga kanalizimi fekal, duke ndarë ujin e kanalizimeve industriale dhe duke e trajtuar kanalizimin përpara se të lëshohet në ujin sipërfaqësor. Mbledhja e ujit të shirave gjatë sezonit të lagësht ndihmon zvogëlimin e ngarkesës së rrjetit të kanalizimeve dhe duhet të bëhet nga secila ndërtesë ku mund të formohen disa laguna për mbledhjen e këtyre ujërave.

Një aspekt që lidhet me këtë është konsumi i përdorimit të ujit. Shembujt tregojnë se mund të fitohet një sasi e madhe e ujit nëpërmjet edukimit të duhur, veçanërisht përdorimi i ujit me cilësi të mirë që përdoret për pastrimin e hapësirave publike.

Lëvizshmëria e pastër dhe e gjelbër duhet të marrë parasysh kërkesat e më të moshuarve ose familjeve me fëmijë të vegjël, si dhe kushtet për dyqane dhe biznese të vogla.

Zonat e gjelbërta duhet të jenë të përballueshme dhe të mundësojnë një përzierje funksionesh dhe grupesh socio-ekonomike për të shmangur ndarjen hapësinore. Një masë e nevojshme e shtëpive ekzistuese është që të reduktojnë konsumin e energjisë dhe ta përshtatin me kushtet mjedisore<sup>41</sup>.

Zhvillimi i lëvizshmërisë të qëndrueshme është sfida kryesore për Prishtinën e së nesërme. Lëvizshmëria e qëndrueshme përfshin dimensione të ndryshme dhe përbërës: qëndrueshmëri, efikasitet në energji, sistemi i transportit i përballueshëm; një ambient shoqëror për metodat e lehta të transportit siç janë të ecurit apo çiklizmi, qasje e lehtë për të gjitha lagjet, në këmbë, biçikletë, transport publik, rrjete të transportit lokal, etj. Infrastruktura e lëvizshmërisë duhet të zhvillohet me një perspektivë afatgjatë në të cilën do të merren parasysh nevojat e zhvillimeve të ardhshme teknologjike, hapësinore dhe urbane.

Prioritetet e propozuara janë:

1. Identifikimi i zonave që kanë faktorë të rrezikut (erozion, tërmet, etj), në mënyrë që të përcaktohen ndërtesat e reja dhe veprimet që duhet të merren për vendbanimet ekzistuese.
2. Fuqizimi i monitorimit të rrjeteve mjedisore
3. Fuqizimi i rrjeteve elektrike për nevojat e rrymës
4. Riorganizimi i sistemit të hedhjes së mbeturinave

Ndryshimet klimatike janë ndër faktorët që konsiderohen nga SEA dhe PZHK, efektet e tyre janë vlerësuar nga metodologjitë e propozuara sipas një shkalle të klasifikuar të kualitetit, duke marrë parasysh rëndësinë e efekteve dhe frekuencën e tyre të përkohshme. Me favorizimin e strategjisë së PZHK-së për uljen e lëvizshmërisë së motorizuar private, do të ketë efekte pozitive në uljen e gazrave së shtëpive të blerta. Ruajta e trashëgimisë kulturore dhe korridoreve ekologjike gjithashtu kontribuon në përmirësimin e mikroklimës urbane, duke zvogëluar efektin e fenomenit të TNU-së (fenomeni i temperaturës së ngritur urbane).

**Temperatura e ngritur urbane (TNU)** është hapësirë metropolitane që është dukshëm më e ngrohtë në krahasim me zonat rrethuese rurale për shkak të veprimtarive njerëzore. Diferenca në temperaturë zakonisht është më e madhe në mbrëmje sesa gjatë ditës dhe është më e dukshme kur erërat janë të dobëta. Gjatë stinëve, TNU vërehet gjatë stinës së dimrit dhe stinës së verës. Qëllimi kryesor i temperaturës së ngritur urbane është modifikimi i sipërfaqes së tokës nga zhvillimet urbane me përdorimin e materialeve që efektivisht përmbajnë nxehtësi. Nxehtësia e humbur e gjeneruar nga përdorimi i energjisë është kontribuues sekondar. Me rritjen e popullsisë qendrore, ka tendenca për zgjerimin e hapësirës dhe rritjen e temperaturave mesatare.

BE-ja i kushton vëmendje të veçantë TNU-së, si me aprovimin e projektit ndërkombëtar *“Zhvillimi dhe aplikimi i zvogëlimit dhe strategjive të adaptuara dhe masave për kundërveprimin e fenomenit të temperaturave të ngritura urbane-TNU në aspektin global”*

---

<sup>41</sup> Burimi: Qyteti i të ardhmes



## Stimulimi i krijimit të ndërmarrjeve të reja

### Çështjet kritike


Në Prishtinë, biznese të regjistruara janë 28.500 (25% të Kosovës, burimi: regjistrimi 2011), (13.000 sipas Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, 2007)

Papunësia dhe varfëria:

- Rreth 7% punëkërkes në Prishtinë (përqindje e ngjashme me atë të nivelit të Kosovës)
- 60% të të papunëve janë 25-39 vjeç
- Niveli i varfërisë në Prishtinë: 21.8%, varfëria ekstreme 9% (përqindje e ngjashme me atë të nivelit të Kosovës)

Në vitin 2003 përafërsisht të gjithë kishin 10 punëtorë dhe aktivitetet kryesore të tyre ishin:

- Tregtia me shumicë dhe pakicë 53%
- Transporti dhe depo 17%
- Hotele dhe restorante 9%



### Qëllimet dhe synimet

Ideja përqendrohet në inkurajimin e njerëzve të rinj që të fillojnë biznese, me qëllim që të sjellin më shumë kapital në treg dhe të gjallërojnë ekonominë në tërësi. Por, ajo gjithashtu sjell idenë e të menduarit inovativ, t'i motivojë të rinjtë që të rrezikojnë dhe të rrisin numrin e përgjithshëm të sipërmarrësve, si një vlerë e cila u shtohet prodhuesve në ekonomi. Kjo strategji përqendrohet në të rinjtë: studentë, hulumtues dhe sipërmarrës të rinj. Universiteti mund të ofrojë një mjedis mbështetës për transferim të dijes, që të sigurohet se janë duke u themeluar kompani produktive dhe fitimprurëse.

### Koncepti

Për të provuar në krijimin e vendeve të punës për të rinjtë në të ardhmen, ne duhet të marrim si referim ekonominë e njohur, duke forcuar kështu prezencën në territorin e biznesit dhe qendrave të reja (BQR) dhe inkubatorëve, ashtu që me lidhjen e kërkimeve me botën e korporatave mund të ndihmojë fillimin e procesit të ndërmarrjeve të reja.

Zhvillimeve inovative u duhet kombinimi i mbështetësve të bizneseve mjedisore inovative në dorë me arsimin, e çështja kyçe është që të krijojë një sistem plotësues të shkencës dhe mbështetjen e biznesit në mënyrë që të zhvillohen në një dorë dhe mbështetës në një tjetër. Për bashkëpunim të mirë në rjetet ndërkombëtare të biznesit, parakushti kryesor për ndërmarrjet është që të kemi një platformë të fortë kombëtare të shkencës themelore me dalje në biznesin e aftësive R&D. Ky është roli i BIC dhe i inkubatorëve.

Strategjia kërkon:

- Njerëz me arsimim të lartë dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse;
- Një mjedis konkurrent të biznesit;

Duke konsideruar karakteristikat e kornizave territoriale, sektorët kyçë strategjikë (ka të ngjarë të jenë ekonomia ekologjike dhe qëndrueshme dhe sektori i energjisë). Industrinë inovative, për të promovuar duhet të përfshijnë:

- Industrinë lidhur me zhvillimin e zinxhirit të drurit (për praninë e pyjeve dhe vendeve të varfëruara)
- Teknologjinë e komunikimit dhe informative (TKI)

Industritë lidhur me energjinë inovative: në veçanti, biznesi kryesor duhet të jetë ruajtja e energjisë në procesin e ndërtimit (që është konsumim më i madh i energjisë). Është e nevojshme të inkurajohet krijimi i kompanive me zhvillimin e sistemeve të certifikimit të ndërtimeve të gjelbërta;

- Industritë lidhur me pastrimin e mjedisit dhe të tokës
- Industritë lidhur me monitorimin e kualitetit të mjedisit (veçanërisht kualiteti i ujit, ajrit, dheut)
- Industritë lidhur me inovacionin në sektorin e logjistikës, ngjitur me mundësitë lokale për zhvillimin e një qendre logjistike. Inovacioni mund të jetë i adresuar në zhvillimin e sistemeve kompjuterike.

### **3.3. Tregues të zonave urbane dhe zonave ndërtimore**

#### ***Zonat urbane ekzistuese***

Ne i kuptuam zonat urbane ekzistuese si përbërës të territoreve tashmë të urbanizuara, sikur janë parë në fotografitë satelitore (2012) të siguruar nga komuna, dhe territori si subjekt për aprovimin e PRrU-së apo në procesin e aprovimit.

#### ***Zonat urbane të propozuara për të ardhmen***

Objektivat: për të limituar konsumimin e tokës ende të paprekur nga urbanizmi, për t'i ruajtur tokat e vlefshme bujqësore, zonat e mbuluara me male, Parkun e Gërmisë, majat e kodrave dhe pamjet, përrenjtë, lumenjtë dhe zonat e gjelbëruara, të cilat mund të jenë të rëndësishme për biodiversitet.

Kapaciteti i PRrU-së së miratuar apo PRrU-së ende në pritje të miratimit (por që ende nuk zbatohet) është shumë domethënës siç është treguar nga ekipi i PZHU-së. Për këtë arsye ne besojmë që në 10 vjetët e ardhshme asnjë zonë e re e ndërtimit nuk do të konsiderohet.

Do të ishte e nevojshme të rritet densiteti i ndërtimit, që i afrohet asaj ku ne duam të zhvillojmë transportin publik (hekurudhor dhe rrugor përkatës) dhe objektet atraktive publike.

Zonat e vogla për ndërtim të ri mund të jenë të paraqitura me qëllim që të sigurojnë më shumë cilësi ekzistuese të fragmentuar urbane në periferi.

Në të ardhmen, nëse është e nevojshme, ndërtimi duhet të zërë vend në vendet e mbetura brenda unzës së brendshme, gjithmonë në akordim me objektivat e lartpërmendura.

Gjithashtu, linja hekurudhore ekzistuese është transformuar në një linjë tranzite masive, qytetet që gjenden në veri të Prishtinës përgjatë kësaj linje mund të rriten për të akomoduar popullatën, strukturat atraktive.

PRrU-ja ekzistuese ende duhet të rishikohet kundrejt objektivave në vijim:

1. Mbrotjtje e sigurt e korridoreve, ku infrastruktura duhet të rritet për mobilitet të qëndrueshëm;
2. Rizhvillimi i qendrës së qytetit, ruajtja e faktorëve ekzistues të identitetit;



3. Përmirësimi i cilësisë urbane, duke respektuar strukturat atraktive dhe hapësirat publike të rrjeteve grumbulluese për mobilitet të qëndrueshëm (rrugët për çiklistë dhe këmbësorë), për të rritur zonat e gjelbërta dhe lidhur me njëri-tjetrin të rrisin kontributin në relacion me biodiversitetin.

### **Zonat rurale**

Qëllimi kryesor është të arrihet një numër i popullsisë që të mbulohet prezenca e aktiviteteve dhe strukturave atraktive të vogla e komerciale për popullatën rezidente (së paku 500 banorë, me përjashtim të zonave malore, ku limiti mund të jetë 100).

Në zonat rurale ku popullsia është e shpërndarë dhe e rralluar, synimi është të ruhet prezenca e njeriut (të shmangët shpopullimi), duke përmirësuar rrjetin rrugor me qëllim të lehtësimit të arritjes së zonave rurale më të mëdha (ose qyteteve) ku gjenden strukturat atraktive. Zonat me zgjerim të limituar për ndërtim të ri mund të jenë tregues për lehtësimin e qëndrimit të të rinjve. Nga perspektiva ekonomike objektivi është mbështetja e zhvillimit të bujqësisë multifunktionale. (Fragment nga teksti i përgatitur)

Zonat për ndërtim të ri gjithmonë duhet të jenë afër zonave të ndërtuara, gjithmonë duke respektuar karakteristikat e fshatit: Duke mos e ndërprerë linjën e ndërtimeve përgjatë rrugës, e cila gjeneron një “kontinuitet urban” dhe parandalon perceptimin e pamjes rurale, distanca në mes të ndërtimeve në rend lejon që ato të kenë identitet të veçantë dhe lejon një rrjet ekologjik kontinual. Distanca duhet të arrihet nga rrjeti ekologjik dhe një shkallë e lartë e elementeve të infrastrukturës (linja me tension të lartë, trasetë hekurudhore dhe rrugët kryesore).

### **3.4. Treguesi i projekteve të miratuara me nivel të lartë.**

Siç është thënë më parë, ekzistojnë rregulla që janë të ndërlidhura me këtë plan, e që janë:

Zona e kaltër si porta e Kosovës;

Trekëndëshi i zhvillimit ekonomik;

Zhvillimi policentrik i propozuar nga Plani Hapësinor i Kosovës;

Zona e kaltër, me Prishtinën – Zona metropolitane, kryeqyteti – Porta e Kosovës, administrata, shërbimet dhe tregu, industria e lehtë, industria bujqësore, turizmi. Në qendrën e Zonës së kaltër, një trekëndësh i zhvillimit ekonomik të Kosovës (TZHE) është parashikuar të jetë e ashtuquajtura shtylla e zhvillimit ekonomik të interesit kombëtar, burim i ardhshëm i ekonomisë kosovare dhe një lokacion potencial për kompani investuese ndërkombëtare.

Projekte dhe strategji të tjera të nivelit më të lartë, ose në çfarëdo rasti interesant për implementimin e PZHK-së janë:

Transport nga Aeroporti i Prishtinës (Plani i veprimit të vizionit ekonomik të Kosovës 2011-2014),

autoudha dhe projektet e tjera janë në planifikim apo në ndërtim e sipër: projektet e unazës së brendshme; ndërtimi i autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit (Plani i veprimit të vizionit ekonomik të Kosovës 2011 – 2014),

Modernizimi i linjës së sektorit jugor 10 të linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Ferizaj – Hani i Elezit (Plani i veprimit të vizionit ekonomik të Kosovës 2011-2014),

Plani zhvillimor komunal i arsimit me objektiva të matura si integrim i fortë i sistemit të arsimit në proceset regjionale dhe evropiane të edukimit ose një rritje e konsiderueshme e numrit të studentëve, parashkollorëve dhe numrit të nxënësve në shkolla nëpër zonat rurale;

Indikacionet për përmirësimin e kapacitetit lokal në fushat e orientimit të internetit, trajnimet e specializuara, zhvillimi i softuereve dhe konsultuesve të TI-së. (Programi shtetëror 2008-2011),

Parku industrial i inicuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, si një masë konkrete për të nxitur biznesin në Kosovë.

Lidhja e Ngrohtores së qytetit në Prishtinë (rrjeti ekzistues) me Termocentralin “Kosova B”(sistemi i bashkëprodhimit) me tarifa më të favorshme (Plani i veprimit të vizionit ekonomik të Kosovës 2011-2014).

Realizimi i autostradës së planifikuar Durrës-Kukës, Prishtinë-Merdarë, Prishtinës do t'i mundësohet hyrja e drejtpërdrejtë në Nish, Sofje dhe kështu një pjesë e trafikut mund të ketë gjetur rrugën e saj për në Kosovë e drejt porteve të Adriatikut.

Politikat e orientuara të valorizimit të bukurive natyrore të Kosovës, kryesisht të pazhvilluara për shfrytëzim turistik, siç është ekoturizmi ndërkombëtar. (Programi shtetëror 2008-2011).

### **3.5. Vlerësimi socio-ekonomik dhe ndikimet në mjedis**

#### **Parathënie**

Nëse vlerësimi për efektet e mjedisit në plan dhe program është, së paku i diskutueshëm në përvojat evropiane, një proces i konsoliduar edhe në sistemet e ndryshme të shteteve anëtare, nga Direktivat e BE-së 42/2001, është bërë, me forma të ndryshme, një procedurë standarde. Kjo nuk mund të thuhet për vlerësimin e ndikimit socio-ekonomik të planeve dhe programeve: “Raporti i mjedisit në shumicën e rasteve mund të jetë pjesë e një vlerësimi të gjerë të planit apo programit. Mund të jetë, p.sh. pjesë e një dokumenti mbi vlerësimin e qëndrueshmërisë duke mbuluar gjithashtu efektet sociale dhe ekonomike, ose vlerësimi i qëndrueshmërisë mund të jetë i integruar në plan apo në program<sup>42</sup>.”

---

<sup>42</sup> Udhëzimet e Komisionit për zbatimin e Direktivës 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis.

Në disa vende anëtare të Direktivës së BE-së 42/2001, është aplikuar në një kuptim të gjerë, duke mbuluar gjithashtu edhe aspektet e vlerësimit socio-ekonomik<sup>43</sup>: sikurse vlerësimi socio-ekonomik i efekteve të planeve dhe programeve është dukshëm i siguar për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) në Britani të Madhe, si një aspekt për t'u konsideruar kur vlerësohen implikimet kryesore të planit apo të programit në popullsi<sup>44</sup>.

Për t'i vlerësuar ndikimet e PZHK-së, pra duhet t'iu referohemi metodave dhe teknikave të VSM-së (SEA), të thjeshtëzuara aq sa duhet, për shkak të nivelit të detajimit në plan dhe informacioneve të dhëna.

### **Kategoritë mjedisore (dhe socio-ekonomike) të përfshira në fushën e vlerësimit**

Gama e efekteve të mundshme të mjedisit në konsiderim ka qenë e informuar fillimisht nga Direktiva e VSM-së. Aneksi 1 i Direktivës së VSM-së kërkon që vlerësimi të përfshijë informacione në "efektet e rëndësishme e të mundshme të mjedisit, duke përfshirë çështjet sikur: biodiversiteti; popullata; shëndeti i njeriut; bota bimore; bota shtazore; drithërat; uji; ajri; faktorët klimatikë; pasuritë materiale; trashëgimia kulturore, përfshirë edhe trashëgiminë arkeologjike dhe arkitektonike; peizazhi dhe marrëdhëniet e brendshme ndërmjet çështjeve të lartpërmendura".

Në mungesë të drejtimit të detajuar në përmbajtjen e tyre, një numër i këtyre kategorive mjedisore (p.sh.: popullsia, shëndeti i njeriut dhe pasuritë materiale) mund t'iu nënshtrohen interpretimeve të ndryshme. Në kuadër të këtij raporti:

- "popullata", përfshin të dhënat mbi demografinë dhe çështjet kryesore sociale dhe socio-ekonomike duke përfshirë çështjet e qasjes;
- "shëndeti i njeriut", përfshin të dhëna mbi mortalitetin, sëmundjet dhe mirëqenien e njeriut;
- "asete materiale", përfshijnë të dhënat mbi menaxhimin e mbeturinave

Përdorimi i tokës nuk është identifikuar në listën e 12 temave të VSM-së; megjithatë për qëllimet e këtij vlerësimi dhe në veçanti duke pasur parasysh se këto janë vlerësimet e strategjisë, objektivat e para të cilave përfshijnë përcaktimin e vendndodhjes së zhvillimit, është përshkruar në temën e tokës.

<b>Kategoritë në Direktivën VSM</b>	<b>Kategoritë e përdorura në këtë vlerësim</b>
Biodiversiteti, bota bimore dhe bota shtazore	Ruajtja e biodiversitetit dhe natyrës (që përfshin botën bimore dhe shtazore dhe funksionimin e ekosistemeve)
Popullsia	Popullsia (përfshirë efektet socio-ekonomike dhe qasja)
Shëndetësia e popullsisë	Shëndetësia e popullsisë
Toka	Toka (përfshirë shfrytëzimin e tokës, zona të rëndësishme gjeologjike, ndotja e tokës)
Uji	Burimi dhe cilësia e ujit (përfshirë ujërat e freskëta të

<sup>43</sup> Disa anëtare të shtetit tregojnë se aspektet socio-ekonomike janë të përfshira në raportin e mjedisit e.g. Belgjik (regjioni I Brukselit) dhe Rumania. Rumania specifikon aspektet socio-ekonomike aspects; i.e. ato që lidhen me rritjen ekonomike, profili socio-ekonomik i njerëzve, ekonomia e regjionit, të ardhurat familjare, papunësia, shëndeti njerëzor, përdorimi jokonvencional i energjisë dhe edukimit (Komisioni Evropian, DG ENV "Studimet rreth raportit për aplikimin dhe efektivitetin e SEA Directive (2001/42/EC)", Raporti final, prill 2009).

<sup>44</sup> Udhëzues praktik për Direktivën e Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Udhëzime praktike mbi aplikimin evropian Direktiva 2001/42/EC, shtator 2005, në Mbretërinë e Bashkuar.

	sipërfaqes dhe ujërat nëntokësorë)
Ajri	Cilësia e ajrit
Faktorët klimatikë	Ndryshim i klimës (përfshirë emetimet e gazit të serrave, efektet e parashikuara nga ndryshimi i klimës, si: përmbytjet dhe aftësitë për t'u përshtatur
Asetet materiale dhe energjia	Menaxhimi i mbeturinave, i mineraleve dhe i energjisë
Trashëgimia kulturore, përfshirë atë arkeologjike dhe arkitektonike	Trashëgimia kulturore (përfshirë trashëgiminë arkologjike dhe arkitektonike)
Peizazhi	Peizazhi dhe pamja e qytetit

### Afatet kohore të shkurtra, të mesme dhe të gjata

Kur konsiderohet koha e efekteve potenciale në plan, ajo klasifikohet si “e shkurtër”, “e mesme” ose “e gjatë”. Kjo reflekton qëllimin për të kapur ndryshimet që mund të dalin nga plani për shkak të kohës. Është gjithashtu konsekuent me drejtimin e përfshirë në Aneksin II të Direktivës VSM ku karakteristikat e efekteve duhet të kenë parasysh: probabilitetin, kohëzgjatjen, frekuencën dhe kthyeshmërinë e efekteve).

Periudha e “shkurtër” (S) përcaktohet < 5 vjet;

Periudha e “mesme” (M) përcaktohet mbi 5 vjet dhe jo më shumë se 10 vjet;

Periudha e “gjatë” (G) përcaktohet mbi 10 vjet.

### Parashikimi dhe vlerësimi i efekteve: teknikat

Procesi i vlerësimit kërkon që t'i parashikojë efektet e rëndësishme mjedisore të planit apo programit. Kjo realizohet duke identifikuar ndryshimet e mundshme në kushtet bazike, si rezultat i implementimit të planit të propozuar (ose alternativa e arsyeshme). Këto ndryshime janë përshkruar (kur është e mundshme) në aspektin e shkallës gjeografike, në periudhën kohore në të cilën ato mund të paraqiten, pa marrë parasysh nëse efektet mund të jenë të përkohshme apo të përhershme, pozitive apo negative, të mundshme apo të pamundshme, të shpeshta apo të rralla. Aty ku informacionet numerike nuk kanë qenë të mundura, vlerësimi është bazuar në gjykimin profesional dhe duke iu referuar legjislacionit përkatës, rregulloreve dhe politikave.

Vlerësimet regjistrojnë komentet e shoqëruara më poshtë:

- Identifikimi dhe përshkrimi i efekteve të mundshme;
- Kur mund të paraqiten efektet dhe sa mund të zgjasin ato (p.sh. shkurt, mesatarisht apo gjatë);
- Supozimet dhe pasiguritë që përcjellin vlerësimet (dhe ndonjë informatë e nevojshme për të adresuar pasiguritë);
- Matjet e shmangieve ose zbutjeve të mundshme për ndonjë efekt negativ të mundshëm; dhe
- Matjet për ndonjë rritje të mundshme ku ka efekte pozitive.

Strategjitë ose politikat dhe veprimet																													
Biodiversiteti, flora dhe fauna			Popullsia & shëndeti njerëzor			Toka dhe gjeologjia			Cilësia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet klimatike			Asetet materiale dhe energjia			Trashëgimia kulturore			Peizazhi					
S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L
Komentet																													
....																													

Shembulli i matricës së zhvillimit

### Klasifikimi I vlerësimeve

Legjenda	++	+	0	-	--	?
	Domethënëse pozitive	Pozitiv	Neutral (pa ndikime)	Negative	Negativ domethënës	E paqartë





NB: aty ku është prezantuar më shumë se një simbol në një kuti, tregon që VSM ka gjetur më shumë se një rezultat për kategorinë. Aty ku rezultatet janë që të dyja: pozitive dhe negative, kutitë nuk janë të ngjyrosura. Aty ku kutia është me ngjyrë dhe gjithashtu përmban pikëpyetje (?), kjo tregon pasiguri mbi atë se efekti ka qenë i vogël apo i rëndësishëm megjithëse gjykimi profesional është i shprehur.




Efekti	Përshkrimi	Udhëzuesi ilustrativ
++	Domethënës e pozitive	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Alternativa do të sigurojë një rritje të konsiderueshme në pajisjet e ndërtimit, duke siguruar një zgjedhje të gjerë të shtëpive me cilësi për komunitetin.</li> <li>➔ Alternativa do të sigurojë mundësi të konsiderueshme për të krijuar komunitete të qëndrueshme, inkluzive dhe të përziera.</li> <li>➔ Alternativa do të gjenerojë mundësi të konsiderueshme të punësimit</li> <li>➔ Alternativa do të lehtësojë dukshëm investimet afatgjate në sektorët kyçë</li> </ul>

<b>+</b>	Pozitiv	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Alternativa do të shpie në rritje të pajisjeve ndërtimore, duke siguruar një zgjidhje të gjerë të shtëpive me cilësi për komunitetin.</li> <li>➔ Alternativa do të sigurojë dukshëm mundësi për të krijuar komunitete të qëndrueshme, inkluzive dhe të përziera.</li> <li>➔ Alternativa do të gjenerojë mundësi të punësimit</li> <li>➔ Alternativa do t'i lehtësojë investimet afatgjate në sektorët kyçë</li> </ul>
<b>0</b>	Neutral (pa ndikime)	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Alternativa nuk do të ndikojë në normën aktuale të pajisjeve ndërtimore brenda komunës</li> <li>➔ Alternativa nuk do të ketë ndikim në sigurimin e mundësive për krijimin e komuniteteve të qëndrueshme, inkluzive dhe të përziera</li> <li>➔ Alternativa nuk do të ketë ndikim në krijimin e vendeve të punës brenda komunës</li> <li>➔ Alternativa nuk do të ndikojë në investimet afatgjate në sektorët kyçë</li> </ul>
<b>-</b>	Negativ	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Alternativa do të shpie drejt rënies së pajisjeve ndërtimore nën normën aktuale të komunës</li> <li>➔ Alternativa do t'i reduktojë mundësitë për të krijuar komunitete të qëndrueshme, inkluzive dhe të përziera</li> <li>➔ Alternativa do të shpie te një rritje e vogël e papunësisë</li> <li>➔ Alternativa do të reduktojë investimin afatgjatë në sektorët kyçë</li> </ul>
<b>--</b>	Negativ domethënës	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Alternativa do të shpie te një rënie e dukshme në pajisjet ndërtimore nën normën aktuale të komunës;</li> <li>➔ Alternativa dukshëm do të reduktojë mundësitë për të krijuar komunitete të qëndrueshme, inkluzive dhe të përziera</li> <li>➔ Alternativa do të shpie drejt një rritjeje të madhe papunësisë</li> <li>➔ Alternativa dukshëm do t'i reduktojë investimet afatgjate në sektorët kyçë.</li> </ul>
<b>?</b>	E paqartë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Nga niveli i informatave të ofruara, ndikimi që kjo alternativë mund të ketë pasur në këtë objektivë, është i paqartë.</li> </ul>

## Vlerësimi i ndikimit

Për qëllimet e këtij vlerësimi janë konsideruar shtatë strategjitë të përfshira në Kornizën e Zhvillimit Hapësinor Komunal: konceptet kryesore të zhvillimit

Korniza e Zhvillimit Hapësinor Komunal: konceptet kryesore të zhvillimit	Qëllimet dhe synimet
 <p><b>8. Përforcimi i akseve kryesore urbane për rolin e kryeqytetit</b></p>	<p>Qëllimi kryesor është që të përforcohet roli funksional dhe figura urbane e qendrës së qytetit me organizimin e fortë të akseve urbane, të cilat zhvillohen përgjatë linjës hekurudhore.</p>
 <p><b>9. Një qytet i këndshëm për të gjithë banorët</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Përmirësimi i përhapur “themelor” i cilësisë urbane në termet e pajisjeve dhe hapësirave publike;</li> <li>➔ Adaptim në standardet evropiane të rrugëve, me ndërtim të shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë si dhe parkingje për vetura;</li> <li>➔ Rritje të rrjetit teknologjik;</li> <li>➔ Rritje e pjesshme e vendbanimeve, të vendosura në atë mënyrë që të rritet dhe të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore dhe mbështetur gjithmonë nga zhvillimi i infrastrukturës, hapësirat publike dhe atraktive, lëvizshmëri të qëndrueshme, rrjetet teknologjike.</li> </ul>
 <p><b>10. Zhvillimi i një urbanizmi policentrik</b></p>	<p>Qëllimi kryesor është të sigurohen mundësitë për një zgjerim urbanistik të balancuar dhe të qëndrueshëm, duke iu shmangur plandosjes së pakontrolluar dhe jokonsekuente, përderisa sigurohen hapësirat atraktive të nevojshme, objektet dhe zonat e aktiviteteve për të formuar lagje të integruara dhe të banueshme.</p>
 <p><b>11. Vlerat kulturore dhe natyrore: ruajtja e identitetit, përmirësimi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Lehtësimi i tensioneve sociale. Trashëgimia është pjesë e një të kaluare të përbashkët; është një burim i identitetit të komunitetit kur janë njohur shtresa të ndryshme historike dhe kulturore. Duke punuar në ruajtjen e të gjitha shtresave të trashëgimisë kontribuon në forcimin e mendimit praktik të identitetit brenda një komuniteti.</li> <li>➔ Rritja e nivelit kulturor. Ndikimi i trashëgimisë në komunitetet lokale nuk është vetëm material: mund të bëhet shumë konkret përderisa akterët vendorë janë të përfshirë në proceset e ruajtjes dhe promovimit.</li> <li>➔ Zhvillimi i ekonomisë lokale. Kur është i ngjitur me turizmin, trashëgimia mund të bëhet një burim direkt i të ardhurave.</li> </ul>

	<p><b>12. Rritja e vendbanimeve rurale për një zhvillim të ri të bujqësisë</b></p>	<p>Objektivat kryesore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>→ Mirëmbajtja e prezencës njerëzore në zonë, duke përmirësuar kushtet jetësore dhe duke siguruar mundësi të reja ekonomike;</li> <li>→ Zhvillimi i bujqësisë dhe pylltarisë multifunkionale (kujdesi për pyjet dhe ripyllëzimi)</li> </ul>
	<p><b>13. Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban</b></p>	<p>Qëllimet kryesore përgjithësisht janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>→ Përmirësimi i cilësisë së ujit</li> <li>→ Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave</li> <li>→ Rritja e efikasitetit dhe përdorimit të energjisë së rinovueshme;</li> <li>→ Reduktimi i emetimit të gazrave të serrave</li> <li>→ Përmirësimi i ajrit të jashtëm</li> <li>→ Përmirësimi i transportit urban</li> <li>→ Parandalimi dhe reduktimi i zhurmës dhe ruajtja e zonave të qeta;</li> <li>→ Qeverisje më e mirë lokale;</li> <li>→ Përdorim më efikas i vendit dhe planifikimi</li> </ul>
	<p><b>14. Nxitja e nisjes së ndërmarrjeve të reja</b></p>	<p>Kjo strategji fokusohet në të rinjtë: studentë, hulumtues dhe sipërmarrës të rinj. Ideja fokusohet në inkurajimin e të rinjve që të fillojnë biznes dhe kështu të arrihet kapital më i madh në treg për të ngjallur ekonominë në tërësi.</p>



### Përforcimi i aksit kryesor urban për rolin e kapitalit

Qëllimi kryesor është që të përforcohen roli funksional dhe figura urbane e qendrës së qytetit me organizimin e një aksi të fortë urban, i zhvilluar përgjatë linjës hekurudhore.

Përgjatë aksit, një sistem efikas ndërmodal duhet të organizohet për të siguruar qasjen për në qendrën e qytetit prej kontekstit të gjerë kombëtar/regjional

- Lidhjet me autostradë dhe me rrugët unazore;
- Krijimi i një sistemi tranzit regjional/urban përmes përmirësimit të linjës ekzistuese hekurudhore, duke lidhur pjesë të ndryshme të zonave urbane, zonës “trekëndëshe” (ZHEK), aeroportit.

Biodiversiteti , flora dhe fauna			Popullsia & shëndeti njerëzor			Toka dhe gjeologjia			Cilësia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet klimatike			Asetet materiale dhe energji			Trashëgimia kulturore			Peizazhi				
S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L		
0	0	+	0	+	++	0	-	-	0	+	++	0	+	++	0	+	++	0	-	-	0	0	0	0	0	0	?	?

### Komentimi

Krijimi i një aksi urban të fortë me sistem të transportit efikas ndërmodal në mes polariteteve të ndryshme urbane dhe “trekëndëshit” (ZHEK) dhe prezenca e rritur e funksioneve atraktive në nyjat e sistemit, është supozuar se do të paraqitet në fazat e mesme dhe afatgjatë. Rezultatet pozitive shqetësojnë popullsinë dhe cilësinë e jetës për përmirësimin e funksioneve rezidenciale dhe plotësuese (tregu dhe atraksionet), kualiteti dhe përshkimi i hapësirave publike, transporti publik, ashtu edhe ndërtimi i një kualiteti të ri të peizazhit urban. Vendosja e funksioneve të reja terciare dhe tërheqja e investitorëve të huaj do të inkurajojë përdorimin e transportit urban, me efekte pozitive në cilësinë e ajrit dhe reduktimin e emetimeve. Këto efekte pozitive do të theksohen në afat të gjatë kohor me kompletimin e aksit. Ruajtja e korridoreve të gjelbërta mund të ketë efekt pozitiv në biodiversitetin në zonat urbane, përderisa rehabilitimi dhe forcimi i rrjetit teknologjik do të ketë ndikim pozitiv në cilësinë e ujit.

Implementimi i akseve të forta urbane do të detyrojë konsumimin e tokave bujqësore, që mund të minimizohet (ripërdorimi i fushave të kafta), si produkt i harxhimit dhe konsumimit të burimeve energjetike, i cili gjithashtu mund të përfshihet.

Më pak të besueshme janë efektet në peizazhin urban, për shkak të llojllojshmërisë së ndërhyrjeve të propozuara dhe nevojës për të vlerësuar vendndodhjen e tyre.

### Një qytet i këndshëm për të gjithë qytetarët

Strategjia është e bazuar në:

- Përmirësimi i përhapur “themelor” i cilësisë urbane në termet e pajisjeve dhe hapësirave publike;
- Adaptim në standardet evropiane të rrugëve, me ndërtim të rrugëve të këmbësorëve dhe çiklistëve dhe parkingjeve për vetura;

- ➔ Rritje të rrjetit teknologjik;
- ➔ Rritje e pjesshme e vendbanimeve, të vendosura në atë mënyrë që të rritet dhe të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore dhe mbështetur gjithmonë nga zhvillimi i infrastrukturës, hapësirat publike dhe atraktive, lëvizshmëri të qëndrueshme, rrjetet teknologjike.

Biodiversiteti , flora dhe fauna			Popullsia & shëndeti njerëzor			Toka dhe gjeologjia			Cilësia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet klimatike			Asetet materiale dhe energji			Trashëgimia kulturore			Peizazhi		
S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L
?	?	?	+	++	++	-	-	-	+	++	++	?	?	?	?	?	?	-	-	-	0	0	0	+	+	+

#### Komentimi

Krijimi i linjave të reja për transport publik dhe mobilitet të këmbësorëve, kompletimi i sistemit të unazave rrugore, ndërtimi i qendrave të shërbimit dhe hapësirat për zhvillime shoqërore në të gjitha pjesët, do ta përmirësojë dukshëm cilësinë e jetës së banorëve.

Shpërndarja selektive e banimit të ri do të gjenerojë përfitime, edhe në ato me afat të mesëm dhe afatgjatë, drejt qasjes në banesa që mundësojnë jetë cilësore. Cdo zhvillim seriozisht atakon biodiversitetin. Edhe pse është vështirë për t'u parashikuar këto efektet për shkak të konsumit të tokës me destinim për ndërtim, duhet permanent të përcillen këto ndikime dhe të ndërmerren masa eadekuate në këtë drejtim.

Intervenimet në rrjetin teknologjik për asgjësimin e mbeturinave do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e ujit (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore).

Ndërrhyrjet në transportin publik dhe atë të këmbësorëve dhe të rrjetit të çiklistëve do të promovojnë përdorimin e mobilitetit të qëndrueshëm, me efekte pozitive në cilësinë e ajrit dhe në reduktimin e emetimeve, që gjithsesi do të kompensohet nga emetimet e rritura në atmosferë (për ngrohje dhe ftohje) prej popullsisë së re të vendosur aty. Prandaj efektet pozitive ose negative nuk mund të vlerësohen në këtë fazë.

Implementimi i vendbanimeve të reja do të rezultojë në prodhimin e mbetjeve dhe konsumimit të burimeve energjetike, të cilat mund të zbuten me përdorimin e proceseve të ndërtimit me kursim të energjisë dhe mbetjeve të vogla.

Më pak të besueshme janë efektet në peizazhin urban, për shkak të llojllojshmërisë së ndërhyrjeve të propozuara dhe nevojës për të vlerësuar vendndodhjen e tyre.

Në hartat e PZHK-së janë shënuar parqet ekzistuese me qëllim të forcimit apo të mos përfshirjes në proceset e ndërtimit; për më tepër, përparësi më e madhe iu është dhënë densifikimit të zonave ekzistuese urbane, me qëllim të kursimit të humbjes së tokës.

#### Zhvillimi policentrik

Qëllimi kryesor është të sigurohen mundësitë për një zgjerim urbanistik të balancuar dhe të qëndrueshëm, duke iu shmangur plandosjes së pakontrolluar dhe jokonsekuente, përderisa sigurohen hapësirat atraktive të nevojshme, objektet dhe zonat e aktiviteteve për të formuar lagje të integruara dhe të banueshme.

Banimi "multipolar" ose "policentrik" është investiguar për të siguruar nivel të lartë të pajisjeve dhe

prezencë të shpërndarë të aktiviteteve në “zonat urbane” më të mëdha, duke reduktuar kërkesën për mobilitet. Kjo padyshim se duhet të përmirësojë cilësinë aktuale urbane të vendbanimeve ekzistuese, e cila zakonisht është e dobët. Në anën tjetër ruajtja e tokës bujqësore dhe karakteristikave të peizazhit, do të rrisë cilësinë mjedisore të vendbanimeve të reja.

Biodiversiteti , flora dhe fauna			Popullsia & shëndeti njerëzor			Toka dhe gjeologjia			Cilësia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet klimatike			Asetet materialg dhe energji			Trashëgimia kulturore			Peizazhi		
S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L
0	+	+	0	+	+	0	-	-	?	?	?	0	+	+	0	+	+	?	?	?	0	+	+	0	+	++

#### Komentimi

Duke i forcuar, konsoliduar dhe përmirësuar vendbanimet ekzistuese policentrike, mund të përcaktohen efekte pozitive mbi cilësinë e jetës në këto qendra, në zona bujqësore dhe të peizazhit.

Afërsia e popullatës me pajisje kontribuon në reduktimin e kërkesave për mobilitet, me efekte pozitive në cilësinë e ajrit dhe në reduktimin e ndotjes.

Ruajtja e njohjes së qendrave të ndryshme do të ketë ndikim pozitiv në ruajtjen e vlerave kulturore dhe identitetin e komuniteteve lokale.

Jo të sigurt janë ende efektet në ujë, konsumimi i energjisë dhe prodhimi i mbetjeve, sikur do të jetë mbi PZHU dhe PRrU që t'i definojnë zonat e reja urbanistike dhe zonat e rigjeneruara në qytete më të vogla.

PZHK-ja shtjellon çështjen e zhvillimit të parqeve të reja brenda zhvillimeve policentrike përmes parashikimeve për një hapësirë standarde minimale të hapësirave gjelbëruese në vendbanime të reja. Për vendbanime rezidenciale 18 m2 për një banor. 18 m2 të përmendura më lart, janë të ndara sipas linjave të mëposhtme:

- 25% është e rezervuar për ndertimin e çerdheve dhe shkollave fillore;
- 11% për pajisje me interes të veçantë (kulturore, sociale, mirëqenie, administrative, etj);
- 50% për parqe publike dhe infrastrukturë sportive; 14% për parkingje publike (përveç për parkingje private të lidhura me zhvillimin e një ndërtese).

## **Vlerat kulturore dhe natyrore: ruajtja e identitetit, përmirësimi dhe vlerësimi**

### Trashëgimia kulturore

Strategjia integron qasjen ndaj trashëgimisë kulturore, që bën përzjerjen e ruajtjes dhe vlerësimit. Vlerësimi korrekt është çelësi që mund të ketë një vend për të shfaqur panoramën më të mbushur dhe më kompetitive të kulturës.

Veprimet kryesore të propozuara janë:

- Udhëzimet për mbrojtjen e tokave bujqësore;
- Zhvillimi i një katalogu të përditësuar i trashëgimisë kulturore lokale, përfshirë peizazhet kulturore dhe trashëgiminë e paprekur;
- Trajnimi i njerëzve profesionalë me kompetenca specifike në ruajtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore;

Për qendrën kulturore, definicioni për URP të specifikuar, bazuar në të dhënat nga analizat historike dhe dokumentacionet e arkivave.

Trashëgimitë natyrore,

Ruajtja e karakteristikave natyrore dhe gjysmënatyrore, pyjeve, liqeneve, lumenjve, parqeve në qytet mund të përbëjnë elementet kyçe për sigurimin e rrjetit ekologjik.

Veprimet kryesore të propozuara janë:

- Zhvillimi i mundësive për qasje dhe ndërgjegjësim të Gërmisë (shtigjet ekologjike);
- Ruajta dhe rritja e ujit të mbetur dhe/ose korridoreve të gjelbërta

Biodiversiteti , flora dhe fauna	Popullsia & shëndeti njerëzor			Toka dhe gjeologjia			Cilësia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet klimatike			Asetet materiale dhe energjia			Trashëgimia kulturore			Peizazhi				
	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L		
+	+	+	+	+	+	+	?	?	?	+	+	+	+	+	+	+	+	?	?	?	+	+	+	+	+	++

### Komentimi

Kjo strategji përfshin një numër të dobive për komponentët e ndryshëm që kemi marrë parasysh. Nëse nga pikëvështrimi i popullsisë rigjenerimi dhe vlerësimi i zonës qendrore të Prishtinës ose krijimi i korridoreve të qasshme të gjelbërta mund të rrisin cilësinë e kushteve jetësore duke krijuar mjedise komode, me një gamë të gjerë të vendeve komerciale, lokacione zejtare, etj., dhe duke përmirësuar hapësirat publike dhe duke rritur mundësitë për rekreacion, në anën tjetër mund të ketë efekte pozitive mbi biodiversitetin, cilësinë e ujit (rripa thithës të gjelbër që kontribuojnë në ruajtjen e kurseve të ujit gjithashtu luajnë rol pastrues), cilësinë e ujit (mbrojtjen e pluhurit dhe funksionin e ruajtjes së CO2).

Efektet pozitive ekonomike mund të paraqiten si lidhje për të rritur tërheqjen turistike të Prishtinës dhe si lidhje për zhvillimin e sektorëve ekonomikë kushtuar ekologjisë dhe përdorimit të zonave të gjelbërta.

Mjetet e njohurive të zhvillimit, veprimet dhe rregullat e ruajtjes për promovimin e trashëgimisë kulturore (përfshirë trajnimin) do të kontribuojnë dukshëm në arritjen e vlerave të identitetit të komuniteteve në Kosovë.

Më pak të sigurta janë efektet e tokës, konsumimi i gjeologjisë dhe burimeve, të cilat do të ekzaminohen në relacion me ndërhyrjet e transformimit përfundimisht të përfshira në plan për regjenerimin dhe vlerësimin e qendrës historike.

Pyjet dhe parqet në qytet gjithashtu mund të përbejnë elementet kyçe për implementimin e rrjetit ekologjik. Rrjeti ekologjik mund të ndikojë pozitivisht për kushtet e mbijetesës së llojeve të ndryshme të gjallesave në zonat e fragmentuara të natyrës dhe peizazheve të dominuara nga njeriu.

Së fundi, PZHK përkrah zhvillimin e pyjeve, me mbjelljen e pyjeve të reja dhe zhvillimin e industrisë së drurit.

PZHK-ja propozon krijimin e "korridoreve mjedisore" të peizazheve me kualitet të lartë, duke përfshirë lumenjtë dhe brigjet e tyre, hapësirat e gjelbërta dhe hapësirat e tjera publike për të formuar një sistem të vazhdueshëm urban.

PZHK-ja kërkon që përgjatë rrjedhave ujore të mbrohen bufer zonat, si dhe të puseve, përroskave dhe liqeneve.

Sa i përket Parkut të Gërmisë, në nivel kombëtar duhet të identifikohen strukturat menaxheriale të parkut. Në lidhje me parkun, PZHK-ja propozon zhvillimin e qasjeve në Parkun e Gërmisë (eko shtigje); konkretisht projekti për shtigjet ekologjike, veçanërisht për lidhjen në mes qendrës së qytetit dhe parkut të Gërmisë.

### **Rritja e modeleve të vendbanimeve rurale për një zhvillim të ri bujqësor**

Objektivat kryesore të kësaj strategjie janë:

- Mirëmbajtja e prezencës njerëzore në zonë, duke përmirësuar kushtet e banimit, zhvillimin e objekteve shërbyese dhe përmirësimin e rrjetit rrugor;
- Zhvillimi i bujqësisë dhe pylltarisë multifunksionale (kujdesi për pyjet dhe ripyllëzimi).

Lidhur me bujqësinë e re, në kontekstin e afërt me një qytet të madh, kjo do të thotë që nuk është e kufizuar për prodhimin e thjeshtë të lëndëve të para për ushqim, dhe që të integrohet në një kuadër më të gjerë një gamë e funksioneve dhe pajisjeve, të cilat mund t'i përfitojnë të gjithë qytetarët. Ky vizion i bujqësisë multifunksionale po del prej disa vitesh si një referencë kryesore për zhvillimin e ardhshëm të zonave rurale.

Biodiversiteti , flora dhe fauna			Popullsia & shëndeti njerëzor			Toka dhe gjeologjia			Cilësia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet klimatike			Asetet materiale dhe energjia			Trashëgimia kulturore			Peizazhi		
S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L
?	?	?	++	++	++	?	?	?	0	0	0	+	+	+	+	+	+	?	?	?	+	+	+	+	+	+

#### Komentimi

Riorganizimi i objekteve shërbyese themelore në rajon (siç është shkolla), duke përmirësuar transportin publik, sikur edhe përmirësimin e rrugëve për t'u shërbyer fshatrave dhe zhvillimit të bujqësisë multifunksionale, do të prodhojë efekte të mëdha në cilësinë e jetës dhe do të krijojë më shumë mundësi të të ardhurave për ndërmarrjet bujqësore (bujqësi multifunksionale). Një shpërndarje më e mirë e objekteve shërbyese do të ketë përfitim në kushtet e banorëve dhe do të rrisë mundësinë e të ardhurave në fshatrat rurale.

Në përgjithësi, sjellja e objekteve shërbyese të banorët dhe përmirësimi i zbatueshmërisë së rrugëve, do të ketë efekt pozitiv në cilësinë e ajrit dhe në reduktimin e ndotjes. Më pak të sigurta janë efektet mbi biodiversitetin, tokën dhe gjeologjinë, sikur do të varej nga vendndodhja e ndërhyrjeve individuale.

Efekte pozitive mund të ketë në trashëgiminë kulturore dhe peizazhin, si objektivi i strategjisë: të ruhet prezenca e njerëzve në zonat rurale, kështu duke favorizuar ruajtjen e peizazhit tradicional bujqësor.

Përderisa përdorimi i tokës së re do të jetë i nevojshëm për ndërtim, prodhimet dhe shërbimet publike nuk janë të kënaqshme në vendbanimet ekzistuese, në anën tjetër ne duhet të ruajmë tokën për qëllime agrikulturore të kapacitetit të lartë dhe ta mbrojmë tokën për furnizim adekuat të hapësirave gjelbëruese dhe mbrojtje të mjedisit.

#### Përmirësimi i cilësisë urbane dhe mjedisit rural

Qëllimet kryesore përgjithësisht janë:

- Përmirësimi i cilësisë së ujit
- Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave
- Rritja e efikasitetit dhe përdorimit të energjisë së rinovueshme;
- Reduktimi i emetimit të gazrave të serrave

- Përmirësimi i ajrit të jashtëm
- Përmirësimi i transportit urban
- Parandalimi dhe reduktimi i zhurmës dhe ruajtja e zonave të qeta;
- Qeverisje lokale më efikase;
- Planifikim dhe konsumim më efikas i tokës;
- Rritje e biodiversitetit dhe hapësirave të gjelbërta;
- Reduktimi i rreziqeve mjedisore.

Prioritetet e propozuara janë:

1. Identifikimi i zonave me faktorë rrezikues (Harta e rreziqeve: erozioni, rreziqet sizmike, etj.) në mënyrë që të definohen zonat ndërtimore dhe veprimet për të limituar vendbanimet ekzistuese
2. Forcimi i rrjeteve për monitorim mjedisor;
3. Përforcimi i rrjetit energjetik për nevojat e energjisë;
4. Riorganizimi i sistemit të të humburave;

Biodiversiteti , flora dhe fauna			Popullsia & shëndeti nierëzor			Toka dhe gjeologjia			Cilësia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet klimatike			Asetet materiale dhe energja			Trashëgimia kulturore			Peizazhi		
S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L
+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	0	0	0	?	?	?



### Komentimi

Kjo është strategjia e cila ofron përfitimet mjedisore më të mëdha në periudhë të shkurtër, të mesme dhe të gjatë kohore. Definicioni i kufizimeve në zhvillimin e vendbanimeve në hartën e rrezeve shkon në këtë drejtim, sikurse edhe linjat e veprimeve në lidhje me fortësinë e rrjeteve monitoruese, rritja e rrjetit energjetik, në të njëjtën kohë, fillimi i veprimeve për efikasitet më të madh të energjisë dhe për përdorim më të madh të burimeve të rinovueshme, duke synuar drejt ndalimit të varshmërisë së fortë nga përdorimi i linjtit, dhe, së fundi riorganizimi i menaxhimit dhe të të humburave.

Reduktimi i faktorëve rrezikues dhe i ndotjes mjedisore (ajri, uji, toka, etj.), do të gjenerojë në efekte indirekte mbi përmirësimin e cilësisë jetësore për banorët dhe bizneset, duke krijuar kushte të favorshme për t'i tërhequr investimet e huaja, duke kushtuar vëmendje edhe më të madhe në jetën dhe punën e mjedisit.

Më pak të sigurt janë efektet në peizazh për shkak të ndryshueshmërisë së ndërhyrjes së propozuar dhe nevoja për t'iu qasur vendndodhjes së tyre.

### Nxitja e nisjes së ndërmarrjeve të reja

Kjo strategji fokusohet në të rinjtë: studentë, hulumtues dhe sipërmarrës të rinj. Ideja fokusohet në inkurajimin e të rinjve që të fillojnë biznes dhe kështu të arrihet kapital më i madh në treg për të ngjallur ekonominë në tërësi. Universiteti mund të sigurojë një mjedis mbështetës për shpërdarje të dijes që të sigurojë themelin e kompanive produktive dhe fitimprurëse.

Strategjia propozon veprimet primare si më poshtë:

- Përcaktimi i lokacioneve të mundshme për BIC dhe inkubatorët
- Të ndihmojë shkëmbim me universitetet e huaja, auditimet e nivelit mësimor me kritika të huaja.
- Përcaktimi i strategjive regjionale inovative;
- Përcaktimi i strategjive të ndërmarrësisë regjionale
- Studimet para-fizibilitetike dhe fizibilitetike në themelimin dhe operimin e akseleratorëve dhe parqeve shkencore
- Studimet para-fizibilitetike dhe fizibilitetike në kapitalin rrezikues për krijimin e iniciativave për nisjen e ndërmarrjeve të reja
- Zhvillimi i pilot projekteve, duke mbështetur implementimin e veprimeve inovative dhe strategjive regjionale inovative
- Nisjen e objekteve shërbyese.

Biodiversiteti , flora dhe fauna			Popullsia & shëndeti njerëzor			Toka dhe gjeologjia			Cilësia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet klimatike			Asetet materiale dhe energji			Trashëgimia kulturore			Peizazhi		
S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L	S	M	L
0	0	0	+	+	+	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	?	?	?	0	0	0	?	?	?

### **Komentimi**

Kjo strategji përfshin aksionet kryesisht të paprekshme dhe prandaj vlerësimi i efekteve mjedisore të mundshme është vështirë të parashikohen ose janë të pa aplikueshme (pa bashkëveprim). Është e mundshme të thuhet se efektet mbi popullsi, edhe në afat të shkurtër, janë të konsiderueshme në termin e rritjes së mundësive të punësimit, nivelit të edukimit, dhe kryesisht në termin e cilësisë jetësore.

Të paparashikueshme në këtë fazë janë efektet në peizazh dhe në burimet e konsumuara, kushtuar mundësisë së rritjes së sistemit ekonomik. Në lidhje me ndikimet e tjera mjedisore është e mundshme që ato janë shumë të ulëta, në relacion me zhvillimin e aktiviteteve të ngjitura në dijen ekonomike dhe kreativitetin.

### **Propozimet e monitorimit**

Është kërkesë e Direktivës VSM për të hartuar efektet e rëndësishme të PZHK-së. Nuk është e nevojshme të monitorohen të gjitha ose të monitorohet një efekt në kohë të pacaktuar. Monitorimi nevojitet të fokusohet në efektet e rëndësishme e të qëndrueshme.

Monitorimi është i rëndësishëm për:

- ➔ Efekte të rëndësishme të identifikuara në vlerësimin që mund t'u japë rritje dëmtimeve të pakthyeshme, ku është i përshtatshëm implementimi i masave përkatëse lehtësuese përpara se të shkaktohen dëmtimet e tilla.
- ➔ Efekte të dyshimta ku monitorimi do të mundësonte masat parandaluese ose të lehtësuara për t'u ndërmarrë;

Duke marrë parasysh këtë, prej 10 temave të shqyrtuara në këtë raport, është propozuar se monitorimi duhet të fokusohet në:

<b>Temat e VSM</b>	<b>Treguesit e propozimit monitorial</b>
<b>Biodiversiteti, bota bimore dhe shtazore</b>	Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>→ Habitatet dhe speciet e rrezikuara</li> <li>→ Indikatorët biologjikë të ujërave sipërfaqësore</li> </ul>
<b>Shëndeti i popullsisë dhe njeriut</b>	Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>→ Shkalla e papunësisë</li> <li>→ Shkalla e lindjes së ndërmarrjeve</li> <li>→ Niveli i varfërisë</li> <li>→ Kushtet e banimit</li> <li>→ Qasja në objekte shërbyese dhe cilësia e mjedisit lokal;</li> </ul>
<b>Toka dhe gjeologjia</b>	Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>→ Humbja e tokës</li> <li>→ % e zonat e erozionit</li> </ul>
<b>Uji</b>	Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>→ Lumenjtë me gjendje të mirë ekologjike</li> <li>→ Disponueshmëria e burimeve të ujit për konsumim të ujit</li> </ul>
<b>Ajri</b>	Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>→ Niveli i ndotjes së ajrit;</li> </ul>
<b>Faktorët klimatikë</b>	Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>→ Emetimet e gazrave të serrave</li> </ul>
<b>Asetet materiale dhe energjia</b>	Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>→ % energjia e ripërtëritshme</li> <li>→ Ndërtimet me energji të vogël</li> <li>→ Mbeturinat e diferencuara</li> </ul>
<b>Trashëgimia kulturore, përfshirë edhe trashëgiminë arkeologjike dhe atë arkitektonike</b>	Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>→ % peizazh i degraduar</li> <li>→ Konservimi i peizazhit bujqësor</li> </ul>
<b>Mjedisi</b>	Vjetor (ku informatat lejojnë) janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>→ % peizazhit të degraduar</li> <li>→ Ruajtja e peizazhit bujqësor</li> </ul>

## 4. STRATEGJITË E ZBATIMIT DHE VEPRIMET

Secila nga shtatë strategjitë përfaqëson një paketë politikash, masash, aktiviteteve, nëpërmjet projekteve konkrete, që kanë si qëllim të arrijnë një sërë objektivash brenda një periudhe kohore të caktuar. Secila strategji mund të zbatohet nëpërmjet disa instrumenteve e mjeteve të ndryshme, si më poshtë:

- A. Të rikontrollohen PRrU ekzistuese
- B. PRrU të reja
- C. Plani urbanistik arkitektonik
- D. Projekte urbane të integruara
- E. Studim i fizibilitetit
- F. Plane të biznesit
- G. Inventorë
- H. Rrjet monitorues
- I. Ortakëri publike-private dhe/ose mes organeve publike
- J. Ortakëri mes organeve private
- K. Politikat e planit/sectorit
- L. Konkursat
- M. Pilot projektet

PZhK-ja propozon disa prej këtyre mjeteve e instrumenteve për çdo situatë; sidoqoftë vetëm gjatë zbatimit të planit do të jetë e mundur vlerësimi i mirëfilltë i veprimeve të ndërmarra.

Strategjia e përbërë kështu ka implikime financiare, që paraqesin burimet financiare të cilat do të financohen nga aktivitetet apo projektet për të arritur objektivat.

### 4.1. Strategjitë e zbatimit dhe planet e veprimit

#### 1.1.1 Strategjia 1: Aksi kryesor urban (për rolin e kryeqytetit)

Ndërhyrjet duhet të kenë të bëjnë me:

- Përmirësimi teknologjik dhe infrastrukturor i hekurudhës, për t'u përputhur me kërkesat e sistemit rregullues tranzit;
- Krijimi i një korridori mjedisor i një cilësie peizazhi të lartë, integrimi i lumenjve dhe shtretërit e tyre, zonat e gjelbërta dhe hapësira të tjera publike për të formuar një sistem të vazhdueshëm urban, mos të lejohet mbulimi i lumenjve;
- Forcimi ose krijimi i kulturës dhe institucioneve të hulumtimit me rëndësi kombëtare (muzetë, teatrot, salla të ekzibicionit, universitete dhe të ngjashme);
- Forcimi ose krijimi i qendrave të kongreseve, mjete për organizimin e panairove dhe aktivitete të ngjashme që të orientojnë drejt një klientelë ndërkombëtare dhe diplomatike/komerciale;
- Kompletimi/renovimi i strukturës urbane me ndërhyrje që mund të përdoren për qëllime të ndryshme (p.sh. rezidenciale + tregtare dhe/ose aktivitete të tjera që përshtaten), me dizajn të përshtatshëm që kanë si qëllim shtimin e vazhdimësisë dhe koherencën e hapësirës urbane, me hapësira të bollshme për këmbësorët, hapësira të gjelbërta dhe lehtësira të tjera që ndodhen afër.

Ndërhyrjet e mësipërme duhet të vendosen në kornizën e planifikimit të përshtatshëm dhe të detajuar. Për këtë qëllim PZhK-ja kërkon përgatitjen e studimeve teknike të fizibilitetit për të gjitha zonat në lidhje me “shtyllën”, që duhet të konsiderohet si prioriteti më i madh, bashkë me themelimin e sistemeve të duhura të menaxhimit, në mënyrë që të sigurohet koordinimi i nevojshëm për iniciativat e ndryshme relevante private ose publike.

***Veglat dhe instrumentet kryesore:***

- Studim teknik i fizibilitetit në lidhje me transformimin e hekurudhës (linjë e transportit publik dhe stacione që lidhen me to)
- Hartimi i një Plani urbanistik arkitektonik ose një Projekti të integruar urban për zonën që rrethon aksin kryesor urban dhe rishikimin e PRrU për koherencë (korridori infrastrukturor dhe zonat rrethuese)
- Konkurs ndërkombëtar për projektin e portave të qytetit (që është hyrja kryesore për në qytet, e përcaktuar nga një nivel i lartë funksionesh, arkitekturë dhe cilësi e hapësirës urbane).
- Përcaktimi i korridoreve dhe hapësirave publike për të bërë të mundur mundësitë e zhvillimit për të ardhmen

STRATEGJIA	VEPRIMET	MJETET												
		A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
<b>S1: Aksi kryesor urban</b>	Shtrimi i sistemit metropolitan të transportit publik, duke përdorur hekurudhën ekzistuese, me ndalesa të rregullta dhe të shpeshta			•		•								
	Zbatimi i ndalesave urbane si lehtësira publike dhe hapësira për ndërveprim social, në një distancë (300m) dhe me një nivel më të lartë të cilësisë së funksionalitetit dhe arkitekturës				•					•	•			
	Shtrimi i rrugës për këmbësorë dhe çiklistë	•	•										•	
	Ndërtimi i parkingjeve pranë linjave të transportit publik (për të përmirësuar transportin ndërmodal)					•					•	•		
	Ndërhyrje të mëdha për rigjenerimin e anëve të korridorit përgjatë hekurudhës	•	•		•									
	Planifikimi i “portave” të qytetit													•
	Realizimi i korridorit strategjik për të bërë të mundur mundësitë e zhvillimit të së ardhmes					•								
	Përmirësimi i rrjetit të shërbimeve					•								

### 1.1.2 Strategjia 2: Një qytet i kënaqshëm për të gjithë qytetarët

Sipas karakteristikave të qytetit, propozohet krijimi i dy linjave të forta të transportit publik në mënyrën e tyre, të mbështetura nga këmbësorët dhe shtigjet e çiklistëve. Përgjatë këtyre linjave duhet të bazohet niveli primar i lehtësirave urbane, dhe nëse është e mundur të ketë edhe qendra të shërbimit, në mënyrë që të krijohen hapësira vitale urbane, të reduktohen lëvizjet dhe të përmirësohet siguria. Rreth zhvillimit të lehtësirave kryesore urbane, si p.sh. gjimnaze, spitale, teatro, kinema, etj. Të gjitha këto aktivitete gjenerojnë trafik të madh, faktori kyç për vendndodhjen e tyre është mundësia e një sistemi të transportit efikas, të shpeshtë dhe të rregullt.

Gjithashtu duhet të zbatohet një përmirësim i gjerë i të mirave bazike dhe cilësia e hapësirës publike në të gjitha vendbanimet, të cilat do të vendosen në mënyrë të tillë që të arrihen në këmbë ose me biçikletë.

Për t'i arritur këto objektiva është e nevojshme që të rritet dendësia e banorëve/hektar në mënyrë që të mbështetet zhvillimi i lehtësirave të jetesës dhe të përmirësohet efikasiteti i transportit publik. Në disa vendbanime mund të lokalizohen funksione që i japin identitet periferisë.

Planet rregulluese urbane duhet të hartohen në përputhje me këto objektiva dhe do të rrisin përzierjen funksionale dhe dendësinë e banesave që mund të prodhojnë një "efekt urban" (një sens të urbanizmit). Në lidhje me zonat e përzgjedhura për zgjerim, mund të arrihet një dendësi e përshtatshme urbane me zgjidhje të ndryshme (ndërtesa të llojeve të ndryshme, nivele të ndryshme të konsumit të tokës). Siç tregohet në imazhet në vijim, zgjidhja e tretë duket më efektive në lidhje me dendësinë e banesave dhe cilësinë e hapësirës publike.




Fig. 16. Dendësitë e banesave prej 75 njësi/ha në 3 konfigurime të ndryshme (burimi: "Urban Renaissance", Urban Taskforce, Londër 1999)



Fig. 17. Procesi i mundshëm gradual i dendësimin të të njëjtës ngastër (Burimi: Kitayama/Tsuka "Tokyo metabolizing Analogical Townscape by Generations 2" 2010)

#### **Veglat dhe instrumentet kryesore:**

- Projekt për forcimin e transportit publik me zbatimin e rrugëve primare të transportit publik në korsi të rezervuara. Projekti duhet të mbështetet nga një **Plan urban i mobilitetit**, që merret me riorganizimin e trafikut në qytet.

- Hartimi i një Plani publik të shërbimeve të qytetit. Ky plan duhet të bazohet në një hulumtim të mirëfilltë të gjendjes ekzistuese të shërbimeve publike, në mënyrë që të identifikohen veprimet e nevojshme për të përmirësuar nivelin e cilësisë urbane. Plani i shërbimeve publike të qytetit është një mjet për t'i adresuar çështjet e rëndësishme, siç janë barazia rajonale, identiteti i vendeve, niveli i mirëqenies sociale, efikasiteti dhe qasja në shërbime. Plani duhet të zhvillohet me ndihmën e qytetarëve, pasi që është i rëndësishëm për të kuptuar perceptimin e tyre mbi mjedisin jetësor, problemet sociale dhe demografike, rrjeteve të marrëdhënieve, identitetin dhe vendet qendrore për zhvillim ose rindërtim, shërbimet (duke përfshirë ato private) dhe disponueshmëria e infrastrukturës.
- Kushtet për projektimin e PRrU në zonat e reja të zgjerimit me standarde të përdorimit të duhur të tokës për sa u përket objekteve dhe shërbimeve si dhe dendësisë së vendbanimeve.
- Rishikimi i PRrU ekzistuese për të arritur standardet e nevojshme për shërbimet publike dhe dendësinë.



STRATEGJIA	VEPRIMET	MJETET													
		A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	
<b>S2: Një qytet i këndshëm për qytetarët</b>	Zbatimi i linjave të forta të transportit publik, më mirë nëse janë me destinacion vektorial për korsitë të ndara të autobusëve (mundësisht korsitë tramvaje për të ardhmen?)												•		
	Rritja maksimale e pronës publike përgjatë korridoreve, në mënyrë që administratës vendore t'i sigurohet disponueshmëria e tokës për zona të gjelbërta, parqe, ndalesa, zona të pajisura për zbatimje dhe shërbime	•									•		•		
	Përkufizim dhe vendndodhje e mundshme përgjatë korsive të shërbimeve në nivelin e atraksionit urban	•	•		•								•		
	Rritja e dendësisë urbane	•	•												
	Rikualifikimi i hierarkisë rrugore, trotuareve, shtigjeve për çiklistë, sinjalizimit të rrugëve dhe ndërtimi i rrugëve të reja për këmbësorë dhe çiklistë	•											•		•
	Riorganizimi dhe fuqizimi i shërbimeve themelore publike dhe hapësira për ndërveprim social në përbërjen ekzistuese urbane.	•	•		•								•		•
	Ndërtimi/rikualifikimi i rrjeteve teknike të shërbimeve					•							•		

### 1.1.3 Strategjia 3: Një zhvillim urban policentrik

Siç është shkruar në prezantimin e strategjisë, zhvillimi policentrik urban hapësinor për territorin e Prishtinës është i aplikueshëm për qendrat e vogla pranë qytetit dhe për mundësinë e krijimit të një rrjeti qytetesh (fillimisht brenda zonës së kaltër), në gjendje që të ofrojnë shërbime dhe objekte në një mënyrë të koordinuar, duke rritur cilësinë e jetës..

Ofrimi i shërbimeve më të mira për banorë në tërë teritorin e komunës dhe zvoglimi i nevojës për lëvizje drejt qendrës së qytetit mund të arrihet me antë të shpërndarjes së funksioneve të centaritetit si në pjesën urbane ashtu edhe rurale. Zhvillimet planifikuara më parë në drejtim jugor dhe ato të riorientuara në veri imponon shpërndarjen e funksioneve të centralitetit në tri qendra: Qendra 1 (Qendra e Qytetit të vjetër), Qendra 2 (Qendra e Prishtinës së re në Jug) dhe Qendra 3 (Qendra e Prishtinës Veriore. Për të njëjtin qëllim, për efikasitet dhe zhvillim të qëndrueshëm janë planifikur edhe qendrat rurale në Mramor, Llukar, Koliq dhe Besi. ...

Kjo strategji siguron ndërlidhje të përmirësuara dhe funksionim më të lirë, më të shpejt dhe ndotje më të vogël të mjedisit. Në kombinim të pajisjeve digjitale siguron efikasitet dhe kërkon zhvillimin e kapaciteteve për të koordinuar këto politika.

Qështjet kyçe janë:

- përmirësimi i rrjeteve të prekshme dhe të paprekshme për lidhjen mes qendrave;
- përmirësimi i nivelit të cilësisë së jetës edhe në qendrat e vogla dhe të mesme, në mënyrë që të kufizohen flukset e migrimit drejt qendrave urbane dhe për të mbajtur marrëdhëniet e udhëtarëve me qytetin.
- zhvillimi i një aftësie koordinuese të politikave mes komunave, duke bërë marrëveshje dhe përmirësuar integrimin. Bashkëpunimit në planifikim dhe qeverisje, në planifikim e zhvillim sipas modelit me parë të studjuar të Regjionit Metropolitan të Prishtinës së bashku me tri komunat e tjera me të cilat Komuna e Prishtinës kufizohet dhe zhvillimi saj është i lidhur ngushtë sa i përket aktiviteteve të saja kryesore dhe të cilat i përkasin Prishtinës, duhet të menaxhohen në aspekt hapësinor së bashku me këto komuna janë: **Lipjan** – ANP /aeroporti dhe zhvillimi i hapësirës përreth; **Kastriot** – FMR dhe termocentrali dhe menaxhimi i hapësirës përreth; **Fushe Kosovë** – Stacioni i trenit dhe menaxhimi i Hekurudhave të Kosovës nga Prishtina.

Duke pasur parasysh se transporti publik, prej vetë faktit se tashmë se është bërë një zhvillim i konsiderueshëm i të trija komunave, duke integruar këto asete në ofertën e përgjithshme të mobilitetit të njerëzve dhe mallrave jo vetëm në nivel rajonal por në nivel të Republikës së Kosovës. Një qasje e tillë, qasje e zhvillimit Metropolitan është promovuar edhe në Planin Hapësinor të Kosovës.

#### **Veglat dhe instrumentet kryesore:**

- Planifikimi i zgjerimit të qyteteve të vogla për të rritur prezencën e popullsisë dhe shërbimeve
- Hartimi i një Plani të mobilitetit (për detaje të tjera shih E2.5)
- Projekt për rritjen e rrjetit digjital dhe mjeteve digjitale të komunikimit, kryesisht në sektorin publik
- Trajnime për tejkalimin e vështirësive digjitale

STRATEGJIA	VEPRIMET	MJETET													
		A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	
<b>S3: Një zhvillim policentrik urban hapësinor</b>	Përfundimi i autostradës dhe zbatimi i portës dalëse drejt qytetit, e lidhur me unazën e qytetit												•		
	Përfundimi/përshtatja e unazës së qytetit dhe pikat lidhëse me rrugën drejt zonës urbane												•		
	Përshtatja e rrugëve kryesore që hyjnë në qendrën e qytetit	•	•										•		
	Sistemi i kontrollit dhe i monitorimit të trafikut												•		•
	Riorganizimi i transportit publik												•		•
	Zbatimi i fazës së parë të programit mbi sigurinë rrugore												•		•
	Zhvillimi i Sistemit të transportit publik urban												•		•
	Masat rregulluese të trafikut dhe parkimit												•		
	Rehabilitimi i rrugëve	•	•										•		•
	Përfundimi i rrjeteve jomateriale					•						•			•
Sigurimi i një niveli të lartë shërbimesh dhe prezencë e përzier e aktiviteteve në “zonën urbane” më të gjerë, ndërsa reduktohet kërkesa për mobilitet										•	•	•		•	

#### 1.1.4 Strategjia 4: Përmirësimi dhe vlerësimi i identitetit nëpërmjet vlerave kulturore dhe natyrore

Rreth trashëgimisë, fjalët kyçe janë:

- Rritje e njohurisë dhe të kuptuarit nëpërmjet dokumentacioneve
- Promovimi i ndërgjegjësimit dhe ruajtja e të gjitha karakteristikave të trashëgimisë (arkeologjike, arkitekturore, urbane)
- Zbatimi i rehabilitimit dhe vlerësimit (trashëgimia si burim për të ardhura ekonomike dhe mundësi punësimi)

Veprimet kryesore me të cilat do të arrihen këto objektiva janë:

- Inventarizimi, hartimi dhe monitorimi i ruajtjes së karakteristikave të ndryshme të trashëgimisë;
- Krijimi i zonave të mbrojtura përreth monumenteve dhe vendeve të trashëgimisë kulturore
- Hartimi i politikave të integruara dhe planit për mbrojtjen si dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore
- Ndërtimi i planifikimit dhe menaxhimit të nevojshëm nëpërmjet programeve të kualifikimit të stafit

#### **Mjetet dhe instrumentet kryesore:**

- **Një projekt urban i integruar** i zonave urbane të lidhura me vlerat e identitetit, të fokusuara në studimin e evolucionit urban dhe elementeve akoma të lexueshme, me qëllimin specifik për të ruajtur dhe vlerësuar:

- Monumente
- Tipologji ndërtimesh që janë historike, materiale dhe teknika të ndryshme
- Struktura historike të rrugëve dhe struktura të ndarjes së tokës
- Aktivitete të orientuara drejt komunitetit (tregje, punëdore, festivale)

- Plani për mbrojtjen e qendrave arkeologjike: nënvizimi i kufirit të zonës dhe zonën e saj buferike, fushatat gjermimet dhe vlerësimi tyre, lidhur në mënyrë rigorozë me tiparet e veçoritë e trashëgimisë;

- Zhvillimi i një katalogu të azhurnuar mbi trashëgiminë kulturore, duke përfshirë peizazhin kulturor dhe atë të paprekshëm;

- Pilot projekti i gjurmëve kulturore

- Konkurrenca për zhvillimin e një plani të marketingut të trashëgimisë (logo, uebfaqe, shtigje, sinjalistikë, mobilim, etj)

- Kurse trajnimi për ekspertët në restaurimin dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore

- Projekti i rrjetit ekologjik mbi bazën e elementeve natyrore të pranishëm në territor, bën rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta dhe i lidh zonat ekzistuese të gjelbërta, duke përfshirë ato në zonat urbane. Një pikënisje e mirë është prania e rrjedhave ujore që shpesh përkrahin bimësi të rëndësishme. Ruajtja e këtyre elementeve është prioritet. Brenda këtij projekti duhet të përfshihet një projekt i shtigjeve ekologjike, sidomos për lidhjen në mes të qendrës së qytetit dhe Parkut të Gërmisë (qasje të shumta dhe të qarta / anketuar / prekshme / lexueshëm kufijtë).

STRATEGJIA	VEPRIMET	MJETET												
		A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
<b>S4: Përmirësimi &amp; vlerësimi i identitetit nëpërmjet vlerave kulturore dhe natyrore</b>	Rigjenerimi dhe vlerësimi i zonës qendrore historike të Prishtinës	•	•		•			•		•	•			•
	Ndërhyrje të mëdha për rikualifikimin e të mirave urbane (duke përfshirë periudhat e kohëve të fundit), duke ruajtur aspektet identifikuese	•	•		•					•	•			•
	Studimi, vendosja në katalog dhe fillimi i kampanjave të gërmimit në vendet arkeologjike si dhe vlerësimi i të gjeturave							•	•					•
	Ndërhyrjet për të përshtatur dhe vlerësuar trashëgiminë për kënaqësinë turistike				•		•							•
	Zhvillimi i ngjarjeve apo ndërhyrjeve për të shtuar ndërgjegjësimin e qytetarëve rreth trashëgimisë kulturore dhe natyrore				•		•			•	•			
	Ruajtja dhe konsolidimi i rrjeteve ekologjike nëpër qytet, veçanërisht krijimi i rrjeteve ekologjike përgjatë rrjedhave të ujit, mbjellja e pemëve përgjatë rrugëve, krijimi i brezave të gjelbër, duke i dhënë prioritet rregullimit të zonave ekzistuese	•	•										•	•
	Realizimi i gjurmëve kulturore													•
	Konkurrenca për zhvillimin e një plani të marketingut të trashëgimisë													•

### 1.1.5 Strategjia 5: Rritja e modeleve të vendbanimeve për zhvillimet e reja bujqësore

Në lidhje me vendbanimet rurale, fjalët kyçe janë:

- Rritja e cilësisë së jetës dhe reduktimi i besimit në zonën urbane nëpërmjet organizimit territorial të bazuar në zona. Këto janë të dizajnuara në lidhje me prezencën e qytetit të vogël drejt forcimit nëpërmjet shërbimeve bazike dhe sistemit të lëvizshmërisë për lidhjen mes qendrave;
- Zhvillimi i bujqësisë multifunksionale si një mundësi shumë e mirë për punësim dhe rritje të buxhetit



Veprimet që duhet të ndërmerren për të arritur këto objektiva janë:

- Zhvillimi i shërbimeve në zonat rurale dhe organizimi i territorit në lidhje me zhvillimin e rrjetit të lëvizshmërisë dhe forcimi i rrugëve ekzistuese si dhe sistemit të transportit publik
- Trajnimi i ekspertëve teknikë dhe stafit menaxhues dhe gjithashtu fermerë të rinj për të zhvilluar bujqësinë multifunksionale
- Hartimi i politikave të integruara për të promovuar produktet bujqësore në nivel vendor dhe kombëtar

#### ***Veglat dhe instrumentet kryesore:***

- Organizimi zyrtar i territorit në katër qarqe
- Plan i shërbimeve publike për organizimin e ofrimit të shërbimeve në çdo qark
- Studimi i fizibilitetit për përmirësimin e fshatrave me ujë, sistem të kanalizimit dhe për të rritur furnizimin me energji elektrike, duke u dhënë rëndësi të veçantë shërbimeve telefonike.
- Programe trajnimi për fermerët e rinj, mbështetje në përcaktimin e biznes planeve
- Konkurs për zhvillimin e produkteve bujqësore (logo, uebfaqe, mobilim, etj)
- Pilot projekt për kohën e lirë dhe shtigjet kulturore nëpër fshatra
- Projekt i strukturave banesore për studentët në Prishtinë që vijnë nga zonat rurale

STRATEGJIA	VEPRIMET	MJETET												
		A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
	Ndarje zyrtare e organizimit të territorit në 4 qarqe dhe organizimi i ofrimit të shërbimeve në çdo qark	•	•									•		
<b>S5: Rritja e modeleve të vendbanimeve rurale për një zhvillim të ri të bujqësisë</b>	Përmirësimi i sistemit rrugor											•		
	Krijimi i transportit publik për të gjithë studentët					•	•							
	Krijimi i një transporti publik në bazë të thirrjeve					•				•				
	Përmirësimi i furnizimit me ujë, hedhjes së mbeturinave, energjisë elektrike dhe shërbimeve të tjera nëpër fshatra					•								
	Organizimi i kampuseve me strehim për studentët (adoleshentët)						•			•				
	Zhvillimi i agrikulturës multifunksionale në Komunën e Prishtinës (inovacione teknologjike në bujqësi, diversifikimi i punës më intensive, zhvillimi i pyllëzimit duke mbjell sipërfaqe të reja, zhvillimi i industrisë që lidhet me dru)					•				•	•			•
	Programe trajnimi për fermerët e rinj, mbështetja për definicionin e biznes planeve									•	•			
	Zhvillimi i shtigjeve kulturore për kohën e lire në zonat rurale													•
	Mbështetja e krijimit të rrjeteve komerciale për të shfrytëzuar prodhimet vendore bujqësore										•			•

### 1.1.6 Strategjia 6: Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban dhe rural

Fjalët kryesore janë:

- forcimi i **rrjeteve mjedisore të monitorimit** dhe vendosja në hartë e zonave të ndjeshme;  
- promovimi i politikave për efikasitet në energji: Rezervat e mëdha të linjtit shihen si një burim afatgjatë, duke lejuar edhe eksportin e energjisë. Prodhimi i kësaj energjie nuk vjen pa problem, emetime të sasive të mëdha të tymit e pluhurit, gropa të hapura, depozitime të hirit, etj. Zvogëlimi i emetimeve duhet të shihet si strategji kryesore. Mënyra më e mirë për ta arritur këtë është duke reduktuar konsumin e energjisë dhe ngrohjes. Ngrohja që rezulton si produkt i prodhimit të energjisë nuk duhet të humbet kot. Ngrohja e qarqeve është një praktikë e vërtetuar që kjo nxehtësi, e ul përdorimin në shtëpi të lëndëve djegëse.

Cilësia e fasadave të ndërtesave të reja dhe çatave mund të zvogëlojë kërkesën për ngrohje në një faktor dhjetë; ndërhyrja në ngrohje dhe dritare mund të reduktojë 1/3 e konsumit. Shembujt e ndërtesave të qëndrueshme janë të shumta në vendet evropiane, kode të tilla të ndërtimit mund të gjinden në vendet Alpine (metoda të certifikuar Passivhaus, CasaKlima, Leed), që duhet të studiohen dhe të bëhen pjesë e rregulloreve të ndërtimit. Për shkak të volumit që ka, nuk mund të neglizhohet sasia që harxhohet për ngrohjen e shtëpive dhe prandaj kërkohen intervenime meremetuese.

-Përmirësimi i rrjeteve të energjisë elektrike:

- Në zonat urbane, është prioritet azhurnimi i linjave të rrymës, zhvillimi i qarqeve të reja me ngrohje qendrore dhe rrjete të ngrohjes
- Në zonat rurale, rritja e voltazhit për të rritur energjinë e transportueshme
- Në të dyja zonat që promovojnë aksion për zvogëlimin e kërkesës (ngrohje shtëpiake me ujë të nxehtë, ndriçim, shërbime elektrike) nëpërmjet zhvillimit të energjisë së ripërtëritshme (energji diellore në veçanti), zvogëlim i humbjeve në energji, përdorimi i poqëve që konsumojnë pak energji, përdorimi i aparateve me përdorim efikas të energjisë, promovimi i ndërtimit të gjelbër dhe teknologji ndërtimi të qëndrueshme.
- Përmirësimi i furnizimit me ujë dhe sistemi i mbledhjes së ujit të shiut, por gjithashtu promovimi i veprimeve që duhet të ndërmerren për të ruajtur ujin e pijshëm (në ndërtesat e reja është e mundur që të mblidhet uji i shirave dhe nëpërmjet një sistemi të përdoret si ujë për nevoja shtëpiake)
- Përmirësimi i sistemit të mbledhjes së mbeturinave:

Direktiva Evropiane për Kornizën e Mbeturinave (2008), duke filluar me një hierarki të mbeturinave, përcakton 5 hapat e hierarkisë evropiane:

- Parandalim: zvogëlim i gjenerimit të mbeturinave.
- Ripërdorim dhe përgatitje për ripërdorim (riciklim): dhënia e “një jete të dytë” për materialet që mund të riprocesohen
- Riciklim: çdo lloj veprimi sipas të cilit mbeturinat procesohen në produkte, materiale apo substanca, qoftë për t’i shërbyer qëllimit fillestar që ka pasur apo të tjera. Kjo përfshin kompozimin dhe jo djegien e mbeturinave.
- Rimëkëmbja: djegia e disa mbeturinave bazohet në një formulë politike joshkencore që përmirësojnë krematorët më pak efikas.
- Asgjësimi: procese që shërbejnë për shkatërrimin e mbeturinave janë groposja, djegia, piroliza, gazifikimi dhe të tjera.

**Veglat dhe instrumentet kryesore:**

- Përforcimi i sistemit monitorues dhe i cilësisë së mjedisit
- Hartë që identifikon faktorët e rrezikut



- Plani i sigurisë për të paraparë dhe përmirësuar rreziqet e ndryshme (si ato hidraulike dhe hidrologjike), duke pasur parasysh rreziqet afatgjate dhe afatshkurtra
- Plan për zhvillimin e rrjetit ujqor duke përcaktuar strategjitë dhe ndërhyrjet e kërkuara, investimet, tarifat e shërbimit, etj. Plani do të shërbejë si bazë për të tërhequr financime dhe bashkëpunime. Studimi gjithashtu do të gjenerojë një hulumtim të përgjithshëm të rrjeteve ekzistuese. Plani duhet të përcaktojë investimet që duhen, gjithashtu edhe mirëmbajtjen, menaxhimin, koston e energjisë, etj. Plani duhet të identifikojë lokacionet e mundshme për puse të reja dhe pompa elektrike. Do të trajtohet tema e humbjeve në rrjetet ekzistuese.
- Promovimi i pilot projekteve të bazuar në ndërtimin e shtëpive me përdorim efikas të energjisë (si reference shih vendet si Zvicra, Austria, Italia Veriore)
- Prezantimi i sistemeve të certifikimit të energjisë (p.sh. BE-ja deklaroi konsumin vjetor për metër katror. Direktiva 2010/31/BE, 19 maj 2010, mbi performancën e energjisë së ndërtesave)
- Udhëzime për kursimin e përdorimit të ujit
- Përpunimi dhe plani i riciklimit të mallrave të përdorura, zvogëlimi i kostove të materialit dhe konsumimi i lëndëve të para
- Seleksionim publik për riciklimin e të mirave (industrinë ricikluese, produkte të dorës së dytë) që kanë si qëllim reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe konsumit të burimeve natyrore
- Sistem i kontrollit të emetimeve mbi prodhimet e aktiviteteve ekzistuese

STRATEGJIA	VEPRIMET	MJETET												
		A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
<b>S6: Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban dhe rural</b>	Krijimi/përmirësimi i sistemit të mbledhjes së ujit të shiut dhe kanalizimit, zbatimi i depozitimit të ujërave nga stuhitë për urbanizimet e reja	•	•									•		•
	Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujit					•								
	Identifikimi i faktorëve të rrezikut dhe zhvillimi i veprimeve specifike për të paraparë dhe rregulluar rreziqe të ndryshme të sigurisë (si ato hidraulike), duhet të merren parasysh rreziqet afatshkurtra dhe afatgjatë						•	•	•	•	•	•		
	Zbatimi i sistemit të koleksionimit të ujërave në të gjitha vendbanimet	•	•				•							•
	Përforcimi i sistemit të monitorimit të cilësisë së mjedisit								•					
	Zhvillimi i një sistemi urban të furnizimit me ujë						•					•		
	Mbështetja e bizneseve që janë të përfshirë në riciklim apo ripërdorim të produkteve						•							
Zgjerimi i ngrohjes qendrore (projekt ekzistues i Kosova B në Termokos), promovimi i lidhjeve					•	•				•				
	Përpunimi i një programi të energjisë në nivel vendor për të promovuar ruajtjen e energjisë dhe përdorimin e burimeve të qëndrueshme, duke pakësuar humbjet nëpërmjet linjave me furnizim të dobët											•		•

### 1.1.7 Strategjia 7: Nxitja e aktivizimit të ndërmarrjeve të reja

Për sa u përket politikave të risive, do të propozohen veprimet e mëposhtme:

- Përcaktimi i politikave në nivelin qeveritar, të lidhura me njohurinë e ekonomisë dhe që u drejtohen kryesisht të rinjve
- zhvillimi i shkencës për të mbështetur risitë që do të zbulohen dhe hulumtimet
- zhvillimi i qendrave të shërbimit: nga bashkëpunimi mes sektorit publik dhe privat duhet të ofrohet:
  - Promovimi i ndërmarrësisë dhe rritjes së ndërgjegjësimit
  - Organizime të trajnimeve të ndërmarrësisë
  - Shërbimet t'i përkrahin idetë e biznesit dhe mundësitë e tregut
  - Shërbimet të përkrahin strukturimin e ndërmarrësive dhe fillimin e tyre
  - Shërbimet të përkrahin përshejtimin e ndërmarrësive
  - Kontrolli i risive
- përmirësim i ofertës së kulturës dhe cilësisë së jetës, për të tërhequr njerëz të rinj të talentuar (vendorë dhe të huaj).

Zhvillimet universitare në kontekstin urban mund të promovohen nëpërmjet:

- Përcaktimit të vendndodhjeve të mundshme për inkubatorët e biznesit. Eksperiencat ndërkombëtare të kohëve të fundit tregojnë se industritë kreative preferojnë të ripërdorin ndërtesa historike ose të vjetra, që janë të ndotura në kontekstin social. Ndërmarrjet inovative teknologjike shkojnë më shumë me ndërtesa të reja, të cilave mund t'iu qaset më lehtë populli dhe të ketë teknologji të avancuar;
- Rigjenerim i çdo lloj sektori urban nëpërmjet promovimit të sipërmarrjeve inovative

#### ***Veglat dhe instrumentet kryesore:***

- marrëveshje mes universiteteve dhe institucioneve shkencore për të promovuar zhvillimin
- Krijimi i inkubatorëve të biznesit
- Nxitja e të rinjve që të fillojnë ndërmarrësi inovative
- Promovimi i aktiviteteve kulturore dhe edukative
- Promovimi i ndërveprimit me universitetet e huaja
- Përmirësimi i komunikimit digjital

STRATEGJIA	VEPRIMET	MJETET												
		A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
<b>S7: Nxitja e aktivizimit të ndërmarrjeve të reja</b>	Promovimi i bizneseve të reja, që vijnë nga universitetet dhe bashkëpunimi midis tyre dhe sektorit privat					•	•			•				•
	Realizimi i qendrave inovative të biznesit dhe inkubatorëve						•			•				
	Mbështetja e sistemit të bizneseve vendore nëpërmjet përforsimit të lidhjeve me hulumtimet dhe universiteteve, për të prezantuar impulset e frontit të risive dhe transferimit të teknologjisë					•	•			•	•			
	Mbështetja e ndërmarrësive të reja					•	•			•	•			
	Përkrahja e marrëdhënieve ndërkombëtare mes sistemit akademik dhe ndërmarrësve të huaj dhe eksperiencave të hulumtimeve						•			•	•			•
	Përforsimi i tërheqjes së talentëve të rinj, që lidhin eksperiencat kombëtare dhe vendore si dhe tërheqin turizmin						•			•	•			
	Përmirësimi i kablove elektrike dhe komunikimit digjital					•	•							

## 4.2. Vlerësimi i strategjive

“Vlerësimi i strategjive bazuar në kriteret e vendosura nga parimet (art 2/2.2), politikat dhe ligjet”

Strategjitë janë në të njëjtën vijë me parimet, veçanërisht strategjitë 1, 2, 3 dhe 7, u japin një përgjigje parimeve në vijim: *Një zhvillim hapësinor kompakt, kriteret e zonimit të orientuara drejt mbrojtjes së mjedisit dhe kohezionit social, krijimi dhe sigurimi i hapësirave me cilësi të lartë, një lëvizshmëri e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe e shëndetshme, një qytet ku është e lehtë të shëtisësh dhe të arrish në të, rëndësia në rritje e sipër e planifikimit të periferisë urbane, drejt një “smart city”, qasja e integruar si vlerë e shtuar, rëndësia në rritje e qytetit në nivelin rajonal apo metropolitan si zhvillim i qytetit me rajonin e tij rrethues.*

Strategjitë 4, 5 dhe 6 japin gjithashtu një përgjigje për parimet në vijim: *Një përdorim shumëfunksional i territorit rural, një balancë me natyrën dhe traditën.*

Strategjitë kërkojnë politika sektoriale, plane dhe projekte dhe veçanërisht: Plani i mobilitetit urban, Studimi i fizibilitetit për përdorimin e hekurudhës si korsi metropolitane publike e transportit; Plani i shërbimeve publike për riorganizimin e shërbimeve kryesore dhe shërbimet e vendosura nëpër vendbanime apo fshatra.

Hartimi i Planit urbanistik arkitektonik për zonën që rrethon aksin kryesor urban dhe një Projekti të integruar urban të zonave urbane lidhet kryesisht me vlerat e identitetit; Plani për mbrojtjen e lokaliteteve arkeologjike, plani i sigurisë nga rreziqet e natyrës, plani për zhvillimin e rrjetit të ujit duke përcaktuar strategjinë dhe ndërhyrjet, investimet e duhura, tarifat e shërbimit, etj.

Në lidhje me efikasitetin e energjisë, është primare promovimi i pilot projekteve, duke u bazuar në ndërtimin e strehimit me shfrytëzim efikas të energjisë (si referencë mund të merren Zvicra, Austria, Italia Veriore), duke prezantuar sistemin e certifikimit të energjisë (p.sh. BE-ja shpreh konsumin vjetor për metër katror 2010/31/BE, 19 maj 2010, mbi performancën e energjisë dhe ndërtesave). Studimi i fizibilitetit për përmirësimin e furnizimit me ujë në fshatra, hedhja e mbeturinave, si dhe për të rritur furnizimin me rrymë duke u dhënë rëndësi të veçantë edhe shërbimeve të tjera.

Studimi i fizibilitetit për zhvillimin e bujqësisë multifunksionale në Komunën e Prishtinës dhe programet e trajnimit për fermerë të rinj, mbështetje për definicionin e biznes planeve.

Zhvillimi i ndërmarrësive inovative (strategjia 7) duhet të mbështetet nga hartimi i studimeve të fizibilitetit mbi kapitalin e rrezikut për krijimin dhe fillimin e iniciativave të ndërmarrësisë, zhvillimi i qendrave të shërbimit: bashkëpunimi mes sektorit privat dhe publik (Janë vënë në shënjestër trajnimet e ndërmarrësisë, shërbimet mbështesin identifikimin e ideve të biznesit dhe mundësive të ndryshme).

Strategjitë kërkojnë rregullime e ndryshime të ligjit, dhe veçanërisht është kryesore të hartohet ligji për Prishtinën si kryeqytet.

### 4.3. Afatet kohore, implikimet financiare dhe korniza institucionale

#### Korniza kohore

Kur merret parasysh koha e veprimit të një plani, veprimet zakonisht klasifikohen si “të shkurtra”, “mesatare” ose “afatgjatë”. Kjo reflekton qëllimin për të vënë re ndryshimet që mund të ngrihen nga plani për shkak të kohës dhe indikacionet janë që të merren parasysh sugjerimet, sepse vetëm gjatë procesit të aprovimit të planit është e mundur të dizajnohet një kornizë kohore e saktë.

Afati i shkurtër (S) përcaktohet si < 3 vjet;

Afati i mesëm (M) është më shumë se 3 vjet e më pak se 10 vjet;

Afati i gjatë (L) është më shumë se 10 vjet.

Strategjia 1			
Veprimet	Të shkurtra	Të mesme	Të gjata
Shtrimi i një sistemi publik metropolitan të transportit, duke përdorur hekurudhën ekzistuese, me ndalesa të rregullta dhe të shpeshta	● <sup>45</sup>	●	
Realizimi i ndalesave urbane si polaritete të shërbimeve publike dhe hapësirave për ndërveprim social, në distancë prej 300 m dhe me një nivel të lartë të funksionalitetit arkitekturor dhe funksional		●	●
Shtrimi i rrugëve për këmbësorë dhe çiklistë		●	
Ndërtimi i parkingjeve pranë linjave të transportit publik (për të përmirësuar transportin ndërmodal)		●	
Ndërhyrje të gjera për rigjenerimin e anëve të korridoreve përgjatë hekurudhës		●	●
Planifikimi i “portave” të qytetit			●
Realizimi i korridoreve strategjike për të mundësuar mundësitë e zhvillimit për të ardhmen			●
Përmirësimi i rrjeteve të shërbimit		●	●

Strategjia 2			
Veprimet	Të shkurtra	Të mesme	Të gjata
Organizimi i linjave të fuqishme të transportit publik, më mirë nëse janë me vektorët e destinacionit me korsi të ndara për autobusë (ndoshta në të ardhmen korsi të tramvajit?)	● <sup>46</sup>	●	●
Maksimizimi i pronës publike përgjatë korridoreve, në mënyrë që t’iu sigurojë administratorëve vendorë disponueshmërinë e zonave të gjelbërta, parqeve, ndalesave dhe shërbimeve.		●	●
Përcaktimi dhe vendndodhja e mundshme përgjatë korsive të		●	●

<sup>45</sup> Studimi i fizibilitetit

<sup>46</sup> Plani urban i mobilitetit

shërbimeve			
Rritja e dendësisë urbane		•	•
Rikualifikimi i hierarkisë së rrugës, shtrimi, shtigje për çiklistë, shenjëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i rrugëve të reja për këmbësorë dhe çiklistë	• <sup>47</sup>	•	•
Riorganizimi dhe fuqizimi i shërbimeve publike bazike dhe hapësirave për ndërveprim social në zonat ekzistuese urbane.	• <sup>48</sup>	•	•
Ndërtimi/rikualifikimi i rrjeteve të shërbimeve teknike		•	•

### Strategjia 3

Veprimet	Të shkurtra	Të mesme	Të gjata
Plotësimi i autostradës dhe zbatimi i portës dalëse drejt qytetit, e lidhur me unazën e qytetit		•	
Plotësimi/përshtatja e unazës së qytetit dhe pikat lidhëse me rrugën drejt zonës urbane		•	•
Përshtatja e rrugëve kryesore që hyjnë në qendrën e qytetit		•	
Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të trafikut.			•
Zbatimi i fazës së parë të programit të sigurisë në rrugë		•	•
Zhvillimi i riorganizimit të transportit publik		•	•
Masat e trafikut dhe rregullat e parkimit		•	•
Rehabilitimi i rrugëve		•	•
Përforcimi i rrjeteve jo materiale		•	•
Sigurimi i shërbimeve të nivelit të lartë dhe një prezencë e përzier e aktiviteteve në “zonën urbane” më të gjerë, ndërsa redukton kërkesën për mobilitet			•

### Strategjia 4

Veprimet	Të shkurtra	Të mesme	Të gjata
Rigjenerimi dhe vlerësimi i qendrave historike kryesore të Prishtinës	• <sup>49</sup>		
Ndërhyrje të gjera të rikualifikimit të tërësisë urbane (duke përfshirë edhe periudhat e kohëve të fundit), duke ruajtur aspektet identifikuese		•	•
Studimi, vendosja në katalog dhe fillimi i kampanjave të gërmimit në lokalitetet arkeologjike dhe vlerësimi i gjetjeve		•	
Ndërhyrje për të përshtatur dhe vlerësuar trashëgiminë për kënaqësinë e turistëve		•	•

<sup>47</sup> Plani urban i mobilitetit

<sup>48</sup> Plani i shërbimeve publike

<sup>49</sup> Projekt i integruar

Zhvillimi i evenimenteve dhe ndërhyrjeve për të rritur vetëdijen e qytetarëve mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore		•	•
Ruajtja dhe konsolidimi i rrjeteve ekologjike nëpër qytet, në veçanti krijimi i rrjeteve ekologjike përgjatë burimeve të ujit, mbjelljes së pemëve përgjatë rrugëve, krijimit të brezave të gjelbërta, duke u dhënë prioritet ndërhyrjeve që lidhin zonat e gjelbërta ekzistuese.		•	•
Realizimi i gjurmëve kulturore		•	
Konkurs për zhvillimin e planit të marketingut për trashëgiminë			•

### Strategjia 5

Veprimet	Të shkurtra	Të mesme	Të gjata
Vendosja zyrtare e organizimit të territorit në 4 qarqe dhe organizimi i ofrimit të shërbimeve në çdo qark	•		
Përmirësimi i sistemit rrugor		•	
Krijimi i sistemit të transportit publik për studentët		•	
Krijimi i një transporti publik sipas thirrjeve		•	•
Përmirësimi nëpër fshatra i furnizimit me ujë, hedhjes së mbeturinave dhe rritjes së furnizimit me ujë, duke u kushtuar vëmendje të veçantë shërbimeve të tjera		•	
Vendosja e kampusit me akomodim për studentë (adoleshentë)		•	•
Zhvillimi i bujqësisë shumëfunktionale në Komunën e Prishtinës (inovacionet teknologjike në bujqësi, diversifikimi i të mbjellave, zhvillimi i pyjeve duke mbjell pyje të reja, zhvillimi i industrisë në lidhje me drurët)		• <sup>50</sup>	
Programe trajnimi për fermerët e rinj, mbështetja për definicionin e biznes planeve			•
Zhvillimi i shtigjeve kulturore për kohën e lirë në zonat rurale			•
Mbështetja e krijimit të rrjeteve komerciale për t'i shfrytëzuar prodhimet vendore bujqësore			•

### Strategjia 6

Veprimet	Të shkurtra	Të mesme	Të gjata
Krijimi/përmirësimi i sistemit të mbledhjes së ujit të shiut dhe kanalizimit, zbatimi i depozitimit të ujërave nga stuhitë për urbanizimet e reja	• <sup>51</sup>	•	•
Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujit		•	
Identifikimi i faktorëve të rrezikut dhe zhvillimi i veprimeve specifike për të paraparë dhe rregulluar rreziqe të ndryshme të sigurisë (si ato hidraulike), duhet të merren parasysh rreziqet afatshkurtra dhe afatgjatë		•	•

<sup>50</sup> Feasability Study

<sup>51</sup> Plan



Zbatimi i sistemit të koleksionimit të ujërave në të gjitha vendbanimet		•	•
Përforsimi i sistemit të monitorimit të cilësisë së mjedisit		•	•
Zhvillimi i një sistemi urban të furnizimit me ujë		•	•
Mbështetja e bizneseve që janë të përfshirë në riciklim apo ripërdorim të produkteve			•
Zgjerimi i ngrohjes qendrore (projekt ekzistues i Kosova B në Termokos), promovimi i lidhjeve		•	•
Përpunimi i një programi të energjisë në nivel vendor për të promovuar ruajtjen e energjisë dhe përdorimin e burimeve të qëndrueshme, duke pakësuar humbjet nëpërmjet linjave me furnizim të dobët		•	•

<b>Strategjia 7</b>			
<b>Veprimet</b>	<b>Të shkurtra</b>	<b>Të mesme</b>	<b>Të gjata</b>
Promovimi i bizneseve të reja, që vijnë nga universitetet dhe bashkëpunimi midis tyre dhe sektorit privat		•	•
Realizimi i qendrave inovative të biznesit dhe inkubatorëve			•
Mbështetja e sistemit të bizneseve vendore nëpërmjet përforsimit të lidhjeve me hulumtimet dhe universiteteve, për të prezantuar impulset e frontit të risive dhe transferimit të teknologjisë		•	•
Mbështetja e ndërmarrësive të reja		•	•
Përkrahja e marrëdhënieve ndërkombëtare mes sistemit akademik dhe ndërmarrësve të huaj dhe eksperiencave të hulumtimeve		•	
Përforsimi i tërheqjes së talentëve të rinj, që lidhin eksperiencat kombëtare dhe vendore si dhe tërheqin turizmin		•	•
Përmirësimi i kablove elektrike dhe komunikimit digjital		•	

### **Korniza institucionale financiare**

Sipas një pamje afatgjatë, implikimet financiare të këtij plani do të varen nga vlerësimi i prituri i sistemit të mekanizmave burimore financiare; në të tashmen korniza institucionale financiare tregon një gamë të gjerë të instrumenteve vendore dhe ndërkombëtare që mbështesin shpenzimet e prekshme dhe paprekshme; në këtë kontekst donatorët kryesorë ndërkombëtarë sigurojnë ndihmën financiare që do të kenë një ndikim të konsiderueshëm të programit të shpenzimeve qeveritare kapitale.

Duke supozuar një proces afatgjatë nga konceptimi deri te zbatimi, veprimet e realizueshme të planit do të ndikohen që prej fazave të para, me një skenar financiar që ndryshon, si pasojë e prioriteteve strategjike të këtyre dy vjetëve; çështjet kryesore të kornizave financiare që duhet të merren parasysh janë si më poshtë:

#### ***Financimi vendor***



Sipas Kornizës afatmesme të shpenzimeve të Kosovës, shpenzimet e Qeverisë do të jenë të larta në një perspektivë afatmesme, deri në 40%.

Prioritetet kryesore në përputhje me parakushtet që duhet të përmbushen për përafrimin e Kosovës me BE-në, OKB-në dhe mekanizmeve të tjerë ndërkombëtarë, janë bazuar në shtyllat e mëposhtme: Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, qeverisja e mirë dhe fuqizimi i sundimit të ligjit, zhvillimi i burimeve njerëzore; rritja e mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët;

Shumica e strategjive të propozuara të këtij plani duhet t'i përkasin Sektorit të zhvillimit ekonomik/infrastrukturor, me shpenzime të kapitalit që do të jenë në raport proporcional me politikat zhvillimore dhe shpenzimeve totale të Komunës së Prishtinës; më saktësisht veprimet që duhen zbatuar mund të klasifikohen në prioritetet e mëposhtme sipas Kornizës afatmesme të shpenzimeve:

*Prioriteti 1: Krijimi i një ambienti të favorshëm për investime të brendshme dhe të jashtme*

*Prioriteti 2: Investim i vazhdueshëm në projektet madhore, nëpërmjet modernizimit dhe zhvillimit të infrastrukturës publike.*

*Prioriteti 3: Mbështetje e vazhdueshme për zhvillimin rural dhe agrikulturën për të rritur prodhimin vendor.*

*Prioriteti 4: Investimet e lidhura me menaxhimin e mjedisit dhe sigurimi i ujit të pijshëm*

Prioritetet e theksuara duhet të financohen nga Korniza e buxhetit qeveritar, shpeshherë në bashkëpunim me donatorë ndërkombëtarë; për më tepër, inkurajohet (aty ku mund të aplikohet) rritja e fondeve nga burime të tjera financiare, si p.sh. partneriteti publiko-privat, grantet, kreditë, etj.

Për më tepër, struktura e burimeve për financimin komunal përfshin edhe: burimet financiare të komunës, grantet operative të përgjithshme dhe specifike (nga buxheti i shpenzimeve qeveritare) dhe ndihma financiare nga komuniteti ndërkombëtar.

### ***Financimi ndërkombëtar***

Disa institucione ndërkombëtare janë angazhuar momentalisht në sigurimin e instrumenteve financiare të përgjithshme, kryesisht në lidhje me shpenzimet kryesore; institucionet e mëposhtme supozohet që të bëhen donatorët kryesorë në perspektivën afatgjatë.

## **Bashkimi Evropian**

### **1) Asistenca financiare e Kosovës:**

Instrumenti kryesor koherent me strategjitë e propozuara në planin tonë janë:  
**IPA Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarimit**



Është një instrument me qëllime të shumta të asistimit financiar; prioritetet kryesore përfshijnë:

- Ruajtjen e trashëgimisë kulturore – rehabilitimi i monumenteve të rëndësishme
- Përmirësimin e infrastrukturës sociale dhe ekonomike në komuna, veçanërisht shkolla, objekte që ofrojnë shërbime shëndetësore dhe rrugë.
- Përmirësimin e ambientit

### **Programi ndërkufitar Kosovë-Maqedoni**

Programi konsiston në 2 prioritete: Zhvillimi ekonomik-social, promovimi i burimeve natyrore dhe kulturore si dhe asistencë teknike

Rajoni qendror ekonomik dhe Komuna e Prishtinës nuk mund të zgjidhen, por mund të marrin pjesë në program si zonë në afërsi.

### **2) Institucionet financiare të BE-së: EBI; EBRD**

Kosova do të bëhet pjesë e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim si shtet marrës përpara fundit të vitit; banka do të mbështesë zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe do të sigurojë koordinimin e nevojshëm me institucionet e tjera financiare dhe donatorët ndërkombëtarë; kjo do të zgjerojë mundësitë e ngritjes së fondeve kryesisht në lidhje me zhvillimin e sektorit privat dhe do të jetë një mundësi e re për projektet që kanë një jetëgjatësi afatgjatë.

### **Kombet e Bashkuara – Banka Botërore**

(Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim, Korporata Ndërkombëtare Financiare, për Garantimin e Investimeve Multilaterale Agjencia)

Sipas procedurave të OKB-së, strategjia e bashkëpunimit mes shteteve është hapi i parë për mbështetjen e vendeve të shënuara; Strategjia e Kosovës për Partneritet përfundon në 2015 dhe është e para që duhet të përgatitet, qëkur Kosova e shpalli pavarësinë dhe u bë anëtare e Grupit të Bankës Botërore në vitin 2009; duhet të pritët që projektet e reja strategjike do të arrihen në dekadën tjetër në përputhje me kriteret e CPS-së dhe në mënyrë më specifike: përsheptimi i rritjes ekonomike dhe gjenerimit të punësimit si dhe përmirësimi i menaxhimit të mjedisit.

Tri nga programet kryesore të përkrahjes nën shtyllën e parë (përsheptimi i rritjes ekonomike dhe gjenerimit të punësimit) mund të jetë i përshtatshëm për sa u përket qëllimeve të disa veprimeve kryesore të planit, dhe veçanërisht

- *“Forcimi i infrastrukturës, duke u përqendruar te energjia dhe përmirësimi i klimës së biznesit”*
- *Mbështetja e sektorit privat dhe rritja e qasjes financiare*
- *Mbështetja e zhvillimit të bujqësisë*

Në lidhje me projektet e infrastrukturës së re potenciale, duhet të ceket se Banka dhe IFC do ta mbështesnin zhvillimin e infrastrukturës nëpërmjet studimeve dhe shërbimeve këshilluese që kanë si qëllim ofrimin e mbështetjes financiare, për firmat private të përfshira në projektet e infrastrukturës në Kosovë në fushat, si ujë, transport, largimin e mbeturinave dhe energjia.

Shtylla e dytë është fokusuar në mbështetjen specifike dhe të përgjithshme të rreziqeve mjedisore, duke shtuar furnizimin me ujë dhe përmirësimin e menaxhimit të mjedisit.

## Implikimet financiare

Tabela e mëposhtme tregon qasje të financimit të mundshëm për strategjitë e nënvizuara në plan.

STRATEGJIA	VEPRIMET
<u>1.1 Përforcimi i aksit kryesor për rolin e kryeqytetit</u>	<p>Shumica e veprimeve të përshkruara mund të konsiderohen si një ndërhyrje e madhe, e cila potencialisht plotëson kriteret prioritare për të pasur qasje.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria qendrore shpenzimet kapitale buxhetore (p.sh. siç përcaktohet aktualisht në kuadër të prioritetit</li> <li>- Bashkimi Evropian dhe mbështetja financiare</li> <li>- Projekte të reja që duhet t'i dorëzohen sistemit të financimit të Bankës Botërore</li> <li>- Mbështetja financiare e Bashkimit Evropian</li> </ul> <p>Në lidhje me forcimin e kriterit të institucioneve kulturore dhe të hulumtimit me rëndësi kombëtare (muzetë, teatro, salla të ekzibicionit, universitete e të ngjashme) dhe fuqizimi i krijimit të qendrave të kongreseve, mund të jetë e përshtatshme ngritja e fondeve shtesë nëpërmjet përfshirjes së ndërmarrësisë private në sektorët e biznesit, siç janë turizmi, kultura, argëtimi, restorimi etj. dhe nëpërmjet partneritetit publiko-private; në lidhje me kompletimin/renovimin e të mirave urbane, mund të jetë e përshtatshme përfshirja e ndërmarrjeve private edhe në sektorin e ndërtimeve dhe restaurimit</p>
<u>1.2 Një qytet i këndshëm për të gjithë qytetarët</u>	<p>Duke pasur parasysh se shumica e veprimeve të përshkruara janë asetë aktive jomateriale në fazën e hershme të projekteve, ato mund të gjejnë financimin e duhur brenda masave specifike të Bashkimit Evropian, për më tepër do të ishte e përshtatshme për të ndjekur procedurat e financimit të BB-së për përkrahjen e projekteve gjatë ciklit të jetës</p>
<u>1.3 Një zhvillim policentrik urban hapësinorë</u>	<p>Shumica e veprimeve të theksuara mund të konsiderohen si ndërhyrje madhore që i arrijnë kriteret fillestare për të pasur qasje në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Buxhetin e shpenzimeve të Qeverisë qendrore</li> <li>- Mbështetjen e përgjithshme financiare të Bashkimi Evropian (infrastruktura në komunat, përfshirë rrugët është një përparësi e madhe)</li> <li>- Projektet e reja duhet t'i dorëzohen sistemit të financimit të BB-së</li> </ul>
<u>1.4 Përmirësimi dhe vlerësimi i identitetit nëpërmjet vlerave kulturore dhe natyrore</u>	<p>Shumica e veprimeve të propozuara janë koherente me çështjet kryesore të nënvizuara në programet strategjike të BE-së dhe BB-së; një nga masat specifike të instrumenteve të IPA-së është "ruajtja e trashëgimisë kulturore – rehabilitimi i monumenteve të rëndësishme".</p> <p>Për më tepër, shumë masa të përgjithshme në të tashmen kanë lidhje me asetet e paprekshme të lidhura me trashëgiminë kulturore, siç janë studimet, provizionet e komferteve profesionale, trajnimet profesionale, etj.; në lidhje me investimet e prekshme, siç janë ruajtja, vlerësimi i trashëgimisë artistike dhe promovimi i ngjarjeve, duket e përshtatshme të ngrihen fonde shtesë private duke përfshirë donatorët nëpërmjet sponsorizimeve të fokusuara.</p>
<u>1.5 Rritja e vendbanimeve rurale për një</u>	<p>Të gjitha veprimet e nënvizuara mund të konsiderohen si ndërhyrje madhore që i arrijnë kriteret primare për të pasur qasje në masat e përqendruara:</p>

<p><u>zhvillim të ri bujqësor</u></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Buxheti i shpenzimeve i Qeverisë qendrore (p.sh. siç është nënvizuar në të tashmen me prioritet 3)</li> <li>- Mbështetja e përgjithshme financiare e Bashkimit Evropian (d.m.th. siç përcaktohet aktualisht në IPA)</li> <li>- Projektet e reja duhet t'i dorëzohen sistemit financues të BB-së (mbështetja e zhvillimit të bujqësisë si prioritet në strategjinë e BB-së në Kosovë)</li> </ul>
<p><u>1.6 Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban dhe rural</u></p>	<p>Të gjitha veprimet e cekura mund të konsiderohen si ndërhyrje madhore, duke i arritur kriteret prioritare për të pasur qasje në masat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Buxheti i shpenzimeve i Qeverisë qendrore (siç ceket në prioritetin 4)</li> <li>- Ndihma financiare e Bashkimit Evropian (siç ceket në të tashmen në IPA).</li> <li>- Projektet e reja duhet t'i dorëzohen sistemit financues të BB: Forcimi i infrastrukturës, me fokus kryesor në energji është një prioritet në strategjinë e Bankës Botërore</li> </ul>
<p><u>1.7 Promovimi i ndërmarrjeve inovative të reja</u></p>	<p>Kjo është një nga pikat kryesore prioritare për të mbështetur rritjen dhe qëndrueshmërinë e zhvillimit ekonomik; mund të përngjajë me kriteret prioritare momentale në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Buxhetin e shpenzimeve të Qeverisë qendrore</li> <li>- Bashkimi Evropian fokuson mbështetjen financiare për ekonomitë e vogla dhe të mesme</li> <li>- Projektet e reja duhet t'i dorëzohen sistemit financues të Bankës Botërore</li> </ul> <p>Disa masa të ndryshme në BE kanë si qëllim nxitjen e krijimit të ndërmarrësive dhe siguron mbështetje për të hapur dhe fazat e para të EMV-ve, nëpërmjet instrumenteve tradicionale si dhe inovative:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbështetje e drejtpërdrejtë dhe kontribute financiare për përfituesit e EMV-ve</li> <li>- Kontribute nëpërmjet inkubatorit të biznesit apo ndërmjetësve që ofrojnë komoditete profesionale, siç janë këshillimet menaxhuese, trajnime dhe marketing (një nga inkubatorët e Kosovës bazohet në Universitetin e Prishtinës)</li> <li>- Inkurajim i bizneseve për të promovuar komoditetet nëpërmjet sistemit të kuponëve</li> <li>- Trajnim dhe edukim i fokusuar</li> <li>- Mjete financiare të fokusuara për EMV-të nëpërmjet ndërhyrjes dhe mbështetjes së EBRD-së</li> </ul>

## 5. DISPOZITAT E ZBATIMIT

---

### 5.1. Udhëzimet dhe kushtet

Ligji mbi Planifikimin Hapësinor në nivelin komunal përcakton tri nivele të planit: Plani Zhvillimor Komunal (PZhK), Plani Zhvillimor Urban (PZhU) dhe Planet Rregulluese Urbane (PRrU).

Plani Zhvillimor Komunal përfshin një plan për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale dhe prandaj PZhK-ja është dokumenti udhëzues për zhvillimin e gjithë territorit. PZhU-ja në hartim do të përcaktojë kushtet e zhvillimit urban për zonat urbane dhe planet rregulluese urbane do t'i përcaktojnë kushtet për hapësirën rregulluese si dhe rregullat për vendndodhjen e banesave në tokën e zonës urbane. Për çdo plan hapësinor që shtrihet në një sipërfaqe më të madhe se 2 ha jashtë zonës urbane duhet të hartohen plane rregulluese. PZhU dhe PRrU nuk duhet të jenë në konflikt me PZhK. PZhK-ja do të jetë baza për çdo plan rregullues dhe për rishikimin e PRrU ekzistuese.

Pas aprovimit të Planit Hapësinor të Kosovës duhet të pasojnë një numër vendimesh nga autoritetet lokale, në bazë të Komunës së Prishtinës sipas vizionit të zonës së kaltër ose rregullit të ZHEK.

PZhK duhet të bazohet në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ i cili është miratuar në qershor të vitit 2010 dhe vendimet mbi zhvillimet e rëndësishme në nivel të Kosovës duhet të respektohen plotësisht.

Vendimet e PZhK-së kërkojnë rishikim të përshtatshëm dhe aprovim nga Asambleja Komunale.

### 5.2. Kushtet e përcaktuara nga Qeveria lokale

#### 5.2.1. Kushtet për përcaktimin e zonave në territorin e komunës

Për të përcaktuar destinacionin e zonave në territorin e komunës, PZhK siguron kriteret e mëposhtme:

#### **Përbërja urbane (e konsoliduar, për t'u densifikuar ose e re)**

Çështjet kryesore për përbërjen urbane janë:

- Promovimi i përzierjes urbane
- Përcaktimi i destinacioneve të përbalueshme (ndikimi mbi mjedisin dhe të qasurit)
- Njohja e elementeve të identitetit dhe vlerave mjedisore

Brenda zonave të përbërjes urbane PZhK-ja promovon zhvillimin e një përzierje urbane, ku funksionet rezidenciale dhe funksione të tjera ekzistojnë së bashku, duke pasur si qëllim krijimin e një jete, për të nxitur kohezionin social dhe promovuar sigurinë urbane.

Banimi, prodhimi, administrimi, tregtia, strehimi, rekreacioni dhe shërbimet sociale mund të jenë të përbashkëta, për sa kohë janë në madhësi të vogla. Për të vlerësuar përshtatshmërinë e ndonjë përdorimi në lidhje me kontekstin e veçantë në të cilin ndodhet Komuna e Prishtinës, PZhU duhet t'i përcaktojë kushtet e duhura për qëndrueshmërinë urbane dhe mjedisore. Për aktivitetet kulturore, sociale dhe rekreative do të vlerësohet ndikimi i zhurmës dhe ndikimi në trafik.

Aktivitetet e tjera përveç atyre të cekura më lart, si p.sh. aktivitetet më të mëdha në masë dhe objektet e përdorimit urban e tregtar, do të vendosen në zona specifike, ku mund të shkohet

nëpërmjet transportit publik dhe me një nivel të lartë të qasshmërisë, dhe jo në konflikt me funksionin rezidencial.

Në veçanti PZhK propozon vendosjen e funksioneve të rëndësishme shtetërore (Prishtina kryeqytet) përgjatë aksit kryesor urban dhe shërbimet përgjatë linjave kryesore të transportit.

### **Qendrat funksionale**

Në koherencë me përcaktimin e fjalorit, në kontekst të Komunës së Prishtinës, PZhK-ja identifikon një numër të qendrave funksionale (ekzistuese ose të propozuara) me aktivitete të specializuara, që tërheqin trafikun dhe prandaj është nevoja e linjave efikase të transportit publik.

Për më tepër, qendrat funksionale që ofrojnë aktivitetet e mëposhtme:

- a) Zyrat dhe qendrat e kongreseve;
- b) qendrat tregtare, parqet tregtare, me distribucion të madh tregtar dhe struktura të shumicës dhe pakicës;
- c) zonat logjistike (në lidhje me tregtinë dhe prodhimin);
- d) aeroportet, portet dhe stacionet kryesore hekurudhore;
- e) qendrat ndërmodale dhe zonat e pajisura të lidhura me sistemin e transportit rrugor;
- f) qendrat teknologjike, universitetet dhe qendrat e kërkimeve shkencore;
- g) parqet e lodrave;
- h) objektet për ngjarjet kulturore dhe sportive dhe shfaqjet me pjesëmarrje të madhe të audiencës.

Në lidhje me qendrat ekzistuese funksionale duhet të identifikohen rihvillimi dhe veprimet kualifikuese për karakteristikat funksionale, ndë

rtimore dhe të planifikimit urban, dhe duhet të caktohet niveli i performancës për të siguruar qasjen dhe qëndrueshmërinë mjedisore, duke identifikuar punët e nevojshme të infrastrukturës.

Në lidhje me qendrat e reja të funksionit në zonat e përshtatshme duhet të rregullohen organizimet morfologjike dhe funksionale, sistemi i infrastrukturës së mobilitetit dhe pajisjet territoriale.

### **Zonat industriale**

Në lidhje me lokalizimin e aktiviteteve industriale, që janë në përputhje me misionin e treguar në PHK për zonën e kaltër, PZhK-ja identifikon si vendndodhje të përshtatshme: ZHEK-në e kërkuar nga PHK;

-zonat që ndodhen pranë unazës së qytetit dhe autoudha (pjesa përfundimtare e komunës), e karakterizuar nga qasja që ka dhe që ndodhet larg rezidentëve.

Në çdo rast aktivitetet industriale nuk mund të ofrohen pranë vendbanimeve rezidenciale.

### **Zona rurale**

Plani ndjek objektivat e mëposhtme:

- Promovimi i bujqësisë shumëfunksionale dhe të qëndrueshme;

- Ruajtja e tokës me vlera të larta bujqësore (tokë bujqësore e kategorive I deri IV), duke lejuar konsumin e tyre vetëm në mungesë të vendeve alternative duke qenë të realizueshme ekonomikisht dhe teknikisht;
- Përmirësimi i kushteve jetësore të komunitetit rural si fortesë territoriale, e nevojshme për ruajtjen e territorit;
- Ruajtja dhe zhvillimi i aspekteve ekonomike, ekologjike dhe sociale të pylltarisë;
- Promovimi i sistemeve të ruajtjes së tokës, hidrologjike dhe gjeologjike si dhe ruajtja e sigurisë së tokës dhe burimeve natyrore e mjedisore;
- Forcimi i rolit të zonës rurale si element për balancën mjedisore dhe për zbutjen e ndikimeve negative të qendrave urbane.

Në zonat rurale PZhK-ja ndjek kryesisht renovimin e ndërtesave ekzistuese.

Ndërtimi i ndërtesave të reja lejohet vetëm nëse është e nevojshme për performancë e aktivitete bujqësore dhe pyjore dhe çfarëdo që lidhet me to; gjithashtu lejohet ndërtimi i komferteve publike me kusht që të jenë pranë objekteve ekzistuese.

Hapësirat për të jetuar dhe destinacionet e tjera, me përjashtim të agrikulturës, nuk mund të jenë tokë bujqësore e kategorisë I deri IV.

Hapësirat për jetesë dhe destinacionet e tjera nuk mund të jenë në zonat e mbrojtura. Ka përjashtime në disa hapësira të kufizuara për strehim të përkohshëm dhe rekreacion e aktivitete sportive të kufizuara.

## 5.2.2. Kushtet për rregullimin e hapësirës

### 5.2.2.a. Ndërtesat me rëndësi për Kosovën

Preferohet që zonat që destinohen për ndërtimin e objekteve të rëndësishme për Kosovën të caktohen nga potenciali i zhvillimit dhe faktorët natyrorë që ekzistojnë në këto hapësira.

- Të gjitha objektet e rëndësishme shtetërore duhet t'i nënshtrohen procesit të hulumtimit, që përfundon me arsyetimin për ndërtimin e ndërtesës në fjalë.
- Gjatë ndarjes së hapësirave ku do të ndërtohen rrugët me rëndësi kombëtare (autoudha, rrugë kombëtare), duhet të shmangen sa më shumë që është e mundur tokat bujqësore të kategorisë I deri IV dhe zonat me pasuri nëntokësore. Nuk lejohet që këto rrugë të rëndësishme të ndërtohen në zonat e ndërtuara me asete të rëndësishme nëntokësore që janë vitale për Kosovën, në parqe kombëtare, zonat speciale të mbrojtura, etj.
- Ndalohen ndërtimi i objekteve solide, ndërtesave të përhershme në hapësirat ku do të ndërtohen objekte të rëndësishme për Kosovën në të ardhmen.
- Lejohet që të ndërtohen ndërtesat me rëndësi të veçantë, në rastet kur e lejojnë faktorët natyrorë ekzistues. Zonat primare që konsiderohen të përshtatshme janë lokacionet me infrastrukturë ekzistuese, si: qasje e lehtë në rrugë, energji elektrike, telekomunikim, furnizim me ujë, kanalizim, etj.
- Në zonat me interes të veçantë për Kosovën dhe zonat e veçanta të mbrojtura (të përcaktuara nga pakoja e Ahtisarit) duhet të merren masa të veçanta zhvillimore. Këto masa përcaktohen nga planet hapësinore dhe rregulluese për këto zona dhe lidhen me caktimin e një regjimi të zhvillimit special që bazohet kryesisht në mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore; Për objektet që kanë rëndësi të veçantë për



Kosovën, si ndërtimi i telekomunikacionit dhe komunikacionit, objektet e energjetikës, ndërtesat industriale dhe objektet e hidroteknikës, ndërtesat me qëllime specifike, lejet e ndërtimit do të jepen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa për objektet e tjera do të jepet leja e ndërtimit nga komunat përkatëse.

- Prishtina si Kryeqytet i Republikës së Kosovës ka nevojë edhe për ndërtesa dhe komplekse të karakterit qendror sikur ambasada, ministri, kazerma, spitale, etj. Këto përmbajtje duhen marrë parasysh dhe sinkronizuar me MMPH si në fazën e zigurimit të lokacionit ashtu edhe në fazën e përpunimit të kushteve deri në dhënjen e lejes ndërtimore.

Për më tepër, në lidhje të fortë me rolin e Prishtinës si kryeqytet, PZhK-ja propozon që niveli më i lartë i komferteve dhe objekteve të lidhura me rolin kombëtar dhe ndërkombëtar të qytetit të vendosen në perspektivë funksionale me aksin urban që do të zhvillohet përgjatë linjës së hekurudhës.

#### 5.2.2.b. Zonat e ndërtimit për vendbanime

Në përcaktimin e vendbanimeve të reja ose rikualifikimin e këtyre ekzistuese, duhet të arrihen qëllimet e mëposhtme:

- a) përmirësimi i ekuilibrit hidrogjik dhe funksionalitetit të rrjetit të ujit sipërfaqësor. Ky qëllim do të arrihet duke kufizuar padepërtueshmërinë e tokave dhe duke paraparë furnizimin dhe trajtimin e ujit, nga ripërdorimi ose lëshimi në rrjetin e sipërfaqes ujore,
- b) stimulimi i rindërtimit të një habitati natyror të përmirësuar dhe ndërtimi i rrjeteve ekologjike në mjedisin urban dhe periferi;
- c) ruajtja dhe përmirësimi i karakteristikave meteoklimatike, që kanë si qëllim reduktimin e përqendrimit të ndotësve në atmosferë dhe një rregullim termal më të mirë të vendbanimeve urbane. Kjo mund të arrihet duke ofruar një kombinim të hapësirave të gjelbërta të mbjella, mirëmbajtjes ose krijimit të hapësirave të hapura.
- d) Përmirësimi i klimës akustike të territorit urban dhe ruajtja nga ndotja elektromagnetike, fillimisht nëpërmjet një ndarje racionale të funksioneve dhe gjetja e një lokacioni tjetër për aktivitet që prodhojnë zhurmë dhe burimet elektromagnetike ose receptorë veçanërisht të ndjeshëm – në rastin e fushave elektromagnetike që përfshin fëmijët.

Në vendbanimet e reja dendësia e shtëpive duhet të parashikohet për të përmirësuar efikasitetin e transportit publik dhe vendndodhjen e komoditeteve. Dendësia dhe përdorimi i veturave private dhe favorizimi i qarkullimit të këmbësorëve dhe çiklistëve nëpër lagje (dendësia territoriale e synuar 150 banorë për hektar).

#### Zonat e ndërtimit

Zonat e ndërtimit, ato ekzistuese dhe të reja, duhet të planifikohen për një vendndodhje të përshtatshme të infrastrukturës dhe shërbimeve, siç specifikohet më poshtë:

-infrastruktura urbane për vendbanimet:

- Uji i pijshëm, bimët, trajtimi dhe shpërndarja e tyre;
- rrjeti i kanalizimit, bimët filtruese, si dhe rrjet tjetër për ujin e reshjeve;
- hapësirat dhe objektet për grumbullimin e mbeturinave të ngurta;
- ndriçim publik, rrjete të shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit dhe formave të tjera të energjisë;

- rrjetet dhe objektet e telekomunikacionit;
- rrugët, hapësirat publike dhe rrugët e këmbësorëve, rrugët për çiklistë, stacionet dhe ndalesat e transportit kolektiv dhe parkimi publik drejtpërdrejt në shërbim të vendbanimeve.

-objektet dhe hapësirat e përbashkëta për:

- edukim;
- komfortet sociale, ndihmat dhe shërbimet sanitare apo higjienike;
- administrata publike, siguria publike dhe shërbimet e emergjencës;
- aktivitetet kulturore, në grup dhe politike;
- aktivitetet fetare;
- hapësira të gjelbërta për rekreacion, pushim dhe aktivitete sportive;
- hapësira të tjera të hapura për përdorim kolektiv shumëfunksional;
- parkim publik shtesë përveç atyre që ndodhen pranë banesave.

Meqenëse mungojnë normativat vendore, gjatë hartimit të planeve tjera duhet marr për bazë normativat e ndonjë shteti nga BE me parametra të ngjashëm si Republika e Kosovës.

PZhK propozon që të caktohen zona për objekte dhe hapësira kolektive në proporcion me programin e ndërtimit (standard):

a) për vendbanimet rezidenciale 18 m<sup>2</sup> për çdo banor efektiv dhe potencial të komunës në tërësi.

18 m<sup>2</sup> të përmendura janë të ndara si më poshtë:

- 25% është e rezervuar për ndërtimin e kopshteve dhe shkollave fillore;
- 11% për pajisjet me interes të përbashkët (kulturore, sociale, mirëqenie, administrative...);
- 50% për parqe publike dhe infrastrukturë sportive;
- 14% për parqe publike të automjeteve (si shtesë e parqeve private të lidhura me ndërtesat banesore)

b) për shumën e vendbanimeve rekreative, hoteleve, zyrave dhe ndërtesave tregtare, 100m<sup>2</sup> për çdo 100 m<sup>2</sup> të zonës;

c) për shumën e produkteve industriale, artizanale, dhe një pjesë e jo më pak se 15% të zonës së destinuar për këto lloj ndërtesash.

Parkingjet e automjeteve private të lidhura me zhvillimin e ndërtesave, duhet të parashihen në një proporcion minimal prej:

- Banim – 1 vendparking për banesë
- Shërbime komunale - 1 vendparking për 3 punëtorë;
- Restorante - 1 vendparking për 1 tavolinë;
- Hotele - 1 vendparking për dhomë;
- Zyra - 1 vendparking për 75m<sup>2</sup>;
- Dyqane – 1 parking për 50m<sup>2</sup>.

Në vendbanimet rurale qasja e rrugës dhe infrastrukturës në përgjithësi duhet të përmirësohet për të siguruar funksionalitetin dhe cilësinë higjienike-sanitare të vendbanimeve, impiantet e trajtimit të ujit dhe rrjeteve shpërndarëse; grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ngurta, ndriçime publik, energjia elektrike, objekte të telekomunikacionit, ndalesa të transportit publik.

Për impiantin e trajtimit të ujërave të zeza si makrolokacion i mundshëm konsiderohet Barileva. Në zonat rurale është parapare të aplikohen sisteme lokale për trajtimin e ujërave të zeza.

Zgjidhjet e rrjeteve do të jenë të preferueshme kurdo që është e mundur (instalimet e ripërtëritshme të energjisë).

Akterët e përgjegjshëm për ndërhyrjet kontribuojnë në zbatimin e komferteve territoriale, në formën dhe kufijtë e paraparë në pikat në vijim.

Secila ndërhyrje që ka si qëllim zbatimin e një vendbanimi të ri ose rigjenerimit të një vendbanimi, duke përfshirë edhe zgjerimin, duke mbindërtuar dhe duke ndryshuar destinimin, me ose pa punë, që përcakton një rritje domethënëse në ngarkesën urbane, dhe përfshin:

-të kujdesit e prokurimit dhe zonave për zbatimin e komoditeteve territoriale;

- të siguruarit e ndërtimit të infrastrukturës për urbanizimin e vendbanimeve, duke përfshirë lidhjet me rrjetet e interesit të përgjithshëm dhe eventualisht azhurnimi i nevojshëm për shkak të rritjes së banorëve;

### **Koncepti i ngrohjes dhe ftohjes qendrore për Prishtinën dhe vendbanimet rurale**

Parim prijës në zhvillimin e konceptit të ngrohjes dhe ftohjes qendrore për Prishtinën duhet bazuar në aplikimin e energjive të ripërtëritshme për të promovuar edhe trendët e BE-së si standard që edhe tërë Kosova duhet aplikuar në të ardhmen e saj të afërt.

Ngrohtorja e qytetit sot i mbulon gjithë lagjet Dardani, Qendër, Ulpianë, Kodra e Diellit dhe Qendra Klinika Universitare e Kosovës (QKUK). Kapaciteti aktual i instaluar i NP "Termokos" SH.A është rreth 134 MV. QKUK ka edhe ngrohtoren vetanake me kapacitet prej 15 MV.

Konsiderohet si domosdoshmëri përdorimi i energjisë për ngrohje, është kogjenerimi (Termocentrali Kosova B) në Obiliq që konsiderohet si zgjidhje e qëndrueshme për të ardhmen duke mos anashkalluar edhe derivatet e tjera aktuale (druri, vaji, gazi natyror).

Edhe pse një numër i madh i nënstacioneve termike janë rehabilituar me pajisje moderne për bartje të energjisë nga pajisjet gjeneruese nëpërmes nënstacionit termik deri te konsumatori).

Masat për të përmirësuar eficiencën e energjisë, heqja graduale e subvencioneve të energjisë/tarifave të ngritura të energjisë elektrike, përmirësimi i izolimit termik të ndërtesave të reja në krahasim me ato ekzistuese, dhe masat stimuluuese të tjera duhet të merren parasysh në të gjitha fazat e planifikimit dhe projektimit të mëtutjeshëm.

Parashikimi për lloje të ndryshme të lëndëve djegëse është bazuar në të dhënat e konsumit të ngrohjes të paraqitura në studimin e Bankës Botërore "Studimi i Tregut të Ngrohjes". Të dhënat për periudhën 2006-2009 janë llogaritur në bazë të të dhënave nga studimi i Bankës Botërore të rregulluara sipas zhvillimit në konsumin total të energjisë të regjistruar në Bilancin e Energjisë të Republikës së Kosovës për vitin 2009, përgatitur nga ish-Ministria e Energjisë dhe Minierave.

Kosova ka aprovuar cakun indikativ prej 9% për kursimin e energjisë deri në fund të vitit 2025. Këtë e ka paraqitur në Planin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë 2010-2025 (PKEE 2010-2025), krahasuar me skenarin që të mos bësh asgjë. Duke llogaritur reduktimin e paraparë 9% në PKEE, shkalla e ngritjes do të jetë 2,4% në vit.

Në zonat rurale planifikohet të bëhet ndarja sipas trajtimit të tyre. Në zonat rurale të cilat janë shumë të shpërndara, mund të bëhet ngrohja me dru, ndërsa në zonat rurale të dendura do të aplikohet sistemi i ngrohjes si në zonat urbane.

Nga këto obligime janë të përjashtuara:

- a) restaurimi dhe ripërdorimi i ndërtesave ekzistuese që nuk përfshijnë rritje të ngarkesës urbane;
- b) ndërhyrjet që duhet ndërmarrë në vende të zonave të komunës që janë tashmë të pajisura, në një pjesë të vendndodhjes të territorit ku nuk ka shërbime

Për më tepër:

- si prioritet për të gjitha vendbanimet urbane të vendosura në një zonë duhet të bëhet lidhja e trajtimit të kanalizimeve,
- në identifikimin e zonave për impiantet dhe rrjetet e komunikimit dhe telekomunikacionit dhe shpërndarjen e energjisë, duhet të jetë mbi të gjitha sigurimi i mbrojtjes së shëndetit dhe siguria e qytetarëve dhe mbrojtja e aspekteve mjedisore të peizazhit, përveç në vazhdim, racionalitetin funksionalitetin dhe efikasitetin e sistemeve.
- për reduktimin e ndikimit të mjedisit dhe për të lehtësuar riciklimin e mbeturinave shtëpiake, në të gjitha vendbanimet për zona të përshtatshme për grumbullimin dhe riciklimin e mbeturinave të ngurta.

Ndërtesat do të pajisen me një sistem për të mbledhur ujin që vjen nga çatitë që të përdoret për ujitjen e zonave të gjelbërta.

Në përgjithësi, hapësirat dhe mjetet publike në shërbim të vendbanimeve duhet të lokalizohen në një pozicion qendror në lidhje me rezidencat dhe mund të arrihen në këmbë (max 300 m nga stacioni i autobusëve)

Të gjitha aktivitetet publike duhet të arrijnë kërkesat e personave me vështirësi fizike të parapara me normat dhe standardet ndërkombëtare. Hapësirat publike duhet të përzgjidhen me kriterin e pjerrësisë së terrenit.

Mes komforteve të ndryshme, duhet t'u kushtohet vëmendje nevojave të asistencës dhe shërbimit të hapësirave për më të vjetrit dhe duhet të ofrohen hapësira për të rinjtë.

Duhet të kujdesemi edhe për këmbësorët dhe çiklistët, duhet të zbatohen me karakteristika të tilla që të mund të përdoren nga njerëzit me probleme të lëvizshmërisë.

Kujdes i veçantë duhet të tregohet ndaj dizajnit të hapësirës publike, duke ofruar sheshe dhe hapësira për mbledhje sociale.

Institucionet parashkollore dhe edukimi primar duhet të vendosen brenda hapësirave të dizajnuara për përdorim rezidencial. Hapësirat duhet të rregullohen nga rripat mbrojtës dhe të jenë të qasshme nga transporti publik, këmbësorët dhe shtigjet për çiklistë. Vendet ku do të vendosen këto ndërtime duhet t'i përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Institucionet parashkollore nga 20-40 m<sup>2</sup>/fëmijë
- Shkollat fillore nga 20-50 m<sup>2</sup>/fëmijë

Në lidhje me densifikimin e PZhU-së duhet të përcaktohen standardet në krahasim me mundësitë e përmirësimit të gjendjes momentale.

Ndërtimi i vendbanimeve të reja duhet të jetë në përputhje me cilësinë dhe disponueshmërinë e burimeve ujore, duhet të parashihet ndarja e kanalizimit fekal me kanalizimin atmosferik dhe menaxhimi duke ofruar ripërdorimin e ujit që mbledhet nga çatitë; ndërtesat banesore duhet të vendosen larg infrastrukturës së transportit madhor për mbrojtjen nga zhurmat, kriteri i efikasitetit dhe ruajtjes së energjisë duhet të përshtatet.

Për t'u caktuar si një zonë ndërtimi, duhet dhënë prioritet zonave me infrastrukturën e nevojshme teknike, si qasja në rrugë, energji, telekomunikacion, ujë dhe kanalizim. Nëse nuk ka infrastrukturë në afërsi, është e nevojshme që infrastruktura të ndërtohet përpara se një zonë të caktohet për ndërtim.

Asnjë ndërtim nuk mund të fillojë pa marrë paraprakisht kushtet urbanistike dhe lejen e ndërtimit.

### **5.2.2.c. Strukturat e ndërtuara jashtë vendbanimeve**

Vendbanimet e jashtme, si ato rurale po ashtu edhe ato urbane, PZHK i ndan në dy struktura:

#### **Hapësirat e prodhimit**

Në lidhje me lokalizimin e aktiviteteve industriale në përputhje me misionin e treguar nga PHK për zonën e kaltër, PZHK-ja i identifikon si vende të duhura TZHE (Trekëndëshi zhvillimor ekonomik) siç kërkohet nga PHK zonat kryesisht në mes të autostradës dhe unazave (pjesa perëndimore e komunës) për qasje më të madhe, dhe larg nga vendbanimet. Në çdo rast aktivitetet industriale nuk mund të sigurohen në afërsi të vendbanimeve të banimit.

#### **Qendrat funksionale**

Në përputhje me definicionin e fjalorit për qendrat funksionale në kontekst të Komunës së Prishtinës, këto qendra mund t'i përmbajnë pjesërisht këto aktivitete.

- a) qendra biznese, expo qendra, qendra për panairë, qendra konvencionale;
- b) qendra tregtare apo të ngjashme, për shitje me shumicë, si dhe lokacione fikse me shpërndarje të mëdha;
- c) hapësirat për logjistikë në shërbimet e prodhimit dhe shitjes.
- d) aeroportet, portet si dhe stacionet hekurudhore kryesore, të cilat mundësojnë qasje në sistemin nacional të hekurudhave.
- e) zonat dhe qendrat tranzitore dhe intermodelare për transport logjistik;
- f) qendrat teknologjike, universitetet dhe hapësirat për hulumtime shkencore;
- g) pajisje rekreacioni dhe parqet tematike;
- h) pajisje për ngjarje kulturore dhe sportive, si dhe shfaqje me pjesëmarrje të mëdha;

Për qendrat funksionale ekzistuese intervenimet duhet të identifikohen me transformimin ose funksionin, me klasifikimin urban dhe ndërtimor, me nivelet e qëllimit të performancës të vendosura për të siguruar qasjen, si dhe për të siguruar një ambient të qëndrueshëm, duke identifikuar përmirësimin e infrastrukturës së kërkuar.

Qendrat e reja funksionale të lokohen në zona të cilat janë të përshtatshme, si p.sh. organizime morfologjike dhe funksionale, do të ishin më të dobishme infrastruktura si dhe standardet e kërkuara për komoditet territorial.

Njëkohësisht me objektivat strategjike të treguar nga PZHK, Komuna e Prishtinës duhet të sigurojë:

- a) njohjen e qendrave ekzistuese funksionale të konsoliduara, të zgjeruara dhe të modernizuara;
- b) planifikimin e qendrave të reja funksionale, kërkimet për hapësirat e përshtatshme për lokacionet dhe definimin e zonave përmbledhëse për secilin lokacion, shkallën territoriale të

interesit, kualitetin e objektivave dhe gjendjen e ambientit si dhe qëndrueshmërinë e territoreve të vendbanimeve të reja.

### **5.2.3. Kushtet për krijimin e aktiviteteve ekonomike**

#### ***Agjencia e zhvillimit komunal***

Prakushtet për 'roll-out' të suksesshëm të këtij plani është Këshilli aktiv i komunës, i cili është lider në numrin e zhvillimeve të projekteve, duke konstruktuar rrugë dhe infrastrukturë tjetër dhe duke krijuar kushte të mira për shitjen e parcelave individëve privatë dhe bizneseve.

Qeverisë qendrore do t'i kërkohet që të largojë çdo ndalesë legale ose financiare.

Në kontekstin e Komunës së Prishtinës, është e mundur të identifikohen dy aktivitete ekonomike të ndryshme:

- Funksione ekonomike të qëndrueshme të shpërndara, të vendosura në gjithë zonën urbane. (në kushtet e pikës 2.1)
- Destinacione specifike industriale dhe komerciale të vendosen në TZHE (Trekëndëshi zhvillimor ekonomik), si dhe zonat me aktivitet industrial të vendosen afër unazës së qytetit, por larg funksionit rezidencial.

PZHU duhet t'i propozojë lokacionet e përshtatshme me aktivitete ekonomike, jo të shpërndara brenda zonës urbane.

Për funksione specifike janë qendrat funksionale.

Në përgjithësi aktivitetet ekonomike duhet t'i kenë të gjitha standardet për mbrojtjen e ambientit.

Zgjerimi i zonës industriale dhe biznese ekzistuese do të lejohet vetëm nëse zona e qëndrueshme është paraprakisht në rast të emergjencës dhe mungesës së hapësirës adekuate për alokim:

Eventualisht nëse realizohen parqet për biznes, duhet të bazohen në këto kriterie:

Qasje të mirë në korridore të rrugëve-jo përmes vendbanimeve.

Disponueshmëria e tokës së dobët,

- Minimizimi i efekteve të pafavorshme në habitat dhe natyrë.
- Potencial për zhvillim, tokë, infrastrukturë adekuate (kanalizim, ujësjellës, energji elektrike, komunikacion, nxehje qendrore).
- Përdorimi maksimal i indeksit të parcelave nuk duhet të tejkalojë 45% të parcelave dhe të paktën 20% të sipërfaqes duhet të jetë e gjelbër.

### **5.2.4. Kushtet për vendosjen e aktiviteteve publike**

Aktivitetet publike duhet të lokalizohen në mënyrë të tillë që të lehtësojnë qasjen për të gjithë qytetarët (edhe ato me pamundësi mobiliteti) dhe duhet të shërbehen nga transporti publik.

Në zonat urbane mund të identifikohen 3 nivele të shërbimeve urbane:

Shërbimet kombëtare: kulturore, administrative dhe funksione reprezentative, të lidhura me rolin e kryeqytetit. Për çdo rast këto duhet të krijohen në lëvizje dhe sforcime të tjerëve. Lokacioni ideal i tyre është lidhja me aksin kryesor urban.

Shërbimet kryesore urbane: spitalet, shkollat. Këto duhet të vendosen përgjatë linjës kryesore të transportit publik në rrugën e vet (max 300 metra larg nga ndalesa), me hapësira komerciale dhe asete të tjera të strukturës urbane, në një formë të përmbledhur për të ndërtuar një vend atraktiv dhe të gjallë.

Shërbimet lokale: Ato shërbejnë në esencë të fqinjësisë ku janë të vendosura, kështu që ato duhet të jenë të arritshme në këmbë.

Në zonat rurale shërbimet publike do të jenë të koncentruara në fshatra, të bazuara në Planin për shërbime publike për zona.

PZHK propozon ndarjen e territorit të komunës në 5 zona, për të organizuar grupet e shërbimeve duke u bazuar në infrastrukturën rrugore dhe në terren.

#### **5.2.5. Kushtet për vendosjen e korridoreve, zonave të komunikimit dhe sistemeve të tjera të infrastrukturës**

Sipas ligjit për rrugë Nr. 2003 / 11, ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për rrugë "Nr. 2003/11" Nr. 03/L-120, ligjin për hekurudhat e Kosovës Nr. 03/L-076 si dhe ligjet dhe rregulloret tjera tematike në fuqi, PZHK identifikon shërbimet e rrjetit mobil dhe infrastrukturor në nivel më të lartë, duke përfshirë linjën e transportit publik, zona të parkingut dhe parkingje me transfer intermodular; identifikon performancën e infrastrukturës që duhet ta ketë.

PZHK gjithashtu siguron zonën buferike për infrastrukturë mobile. Këto zona buferike janë identifikuar për të mbrojtur zonat nga konstruktimi i rrugëve të reja dhe korsitë e shërbimeve, zgjerimin e rrugëve automobilistike, zonat e parkingut të lidhura me siguri dhe funksionalitet të infrastrukturës, trotualet dhe shtigjet për çiklistë, planifikim ose intervenime në rinatyalizim, për qëllime të lehtësimit të impaktit infrastrukturor në zonën përreth dhe ambient.

Tabela pasuese tregon zonën buferike të ndërtesave të reja, rikonstruimin nga demolimi ose fasadat e mureve përballë rrugëve, në lidhje me rolin e caktuar për to nga PZHK.

Distanca të ruhet nga ndërtimet e reja (nga cepi në korsi) *) në rastin e rrugës D (Unazës së brendshme) distanca specifikohet nga qendra tek rruga				
	Klasifikimi	Klasifikimi	Zonat urbane	Zonat jashtë urbane
Aex –	Magjistrale ekstra urbane		30	80
B –	Primare ekstra urbane		-	60
C –	Rrugë sekondare ekstra urbane		-	20
D –	Autoudha Urbane	Unaza e brendshme dhe lidhjet	25*	-
E -	Rrugë distrikte			
Fex –	Lokal ekstra-urban		-	20
Furb -	Lokal urban			-

Përgjatë linjës hekurudhore është e ndaluar të ndërtohet, rindërtohet apo të zgjerohet ndërtimi apo çfarëdo lloj strukture, përveç atyre që kanë të bëjnë me operatorët e shërbimeve të hekurudhës, në distancë, të jenë të matura në projeksionin horizontal, më pak se 30 metra, i matur nga kufiri i zënë më i afërt hekurudhor.

Çfarëdo ndërtesë është e ndaluar në zonën ku plani hapësinor parasheh ndërtimin e rrugëve të reja automobilistike (autoudhat, rrugët kombëtare, regjionale, lokale) dhe sipërfaqja e këtyre rrugëve mbron breza; çfarëdo konstruksioni në zonat e mbrojtjes së brezave të rrugëve ekzistuese (autostradë, rrugë kombëtare, regjionale dhe lokale).

Shiriti i mbrojtjes prezanton sipërfaqen e rrugës në të dyja anët e autostradës, rrugëve kombëtare, regjionale dhe lokale.

Përfundimisht politikat e planit të lëvizshmërisë nuk janë menduar të punohen për PZHK. Plani i lëvizshmërisë duhet të jetë i draftuar si pjesë shtesë e PZHK-së.

Plani i lëvizshmërisë duhet të zhvillohet në referencë me orientim si më poshtë:

- Duke reduktuar zhurmën dhe ajrin e ndotur dhe duke promovuar energji të sigurt, duke përfshirë aksionet që i bëjnë të shtrenjta transportet që ndotin dhe inkurajimin e zëvendësimit të kamionëve privatë dhe publikë.
- Përmirësimin e sigurisë së rrugëve, në veçanti në mbrojtje të popullatës së “dobët” (fëmijët, të vjetrit, të paaftët, këmbësorët, çiklistët etj.)
- Sigurimin e përhapjes së qasjes së qëndrueshme në qytete, duke iu shmangur dëbimit social.
- Mbrojtjen e qyteteve historike, forcimin e lëvizjes së pajtueshme dhe zvogëlimin e pranisë dhe ndikimit të atyre të papajtueshme;
- Sigurimin e hierarkisë dhe specializimit të rrugëve, në mënyrë që të racionalizohet përdorimi i rrjetit, përmirësimin e fluksit të trafikut;



- rritjen e devijimit modal në favor të modës së parrezikshme (transport publik, çiklizëm, ecje);
- Sigurimin e integritit mes sistemeve të ndryshme dhe rrjeteve të ndryshme të transportit, përmes një niveli të lartë të dizajnit urban dhe zgjidhjeve të ndërtimit;
- përmirësimin e efikasitetit të transportit publik lokal dhe komformitetin e saj;
- Zhvillimin e sistemeve telematike për të mbështetur sistemet e lëvizshmërisë (ICS);
- Njohjen e masave në shënjestër të menaxhimit të kërkesës (menaxhimi i mobilitetit);

Ndërtimi i kapaciteteve të reja të prodhimit, rrjeteve të reja dhe gazit distributiv, linjave të reja të energjisë elektrike dhe tubacionet e drejtpërdrejta për tranzitin e drejtpërdrejtë të gazit natyror, në bazë të procedurave të autorizimit ose procedurave të tenderimit, pasi që ndërmarrja e energjisë, oferta fituese, do të sigurohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) me leje ndërtimi dhe leje të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë në fushën e energjisë.

### 5.2.6. Masat për mbrojtjen e peizazhit, vlerave natyrore dhe tërësive kulturore-historike

Në mënyrë që të mbrohen dhe vlerësohen trashëgimia kulturore dhe peizazhi në Komunën e Prishtinës, duhet të implementohen masat në vazhdim:

- Përpunimi i një zbulim të kujdesshëm të trashëgimisë arkeologjike, arkitektonike e peizazhore dhe elementeve të tjera të identitetit;
- Vendosja e tyre në hartë dhe në rast të zonave buferike;
- Lokalizimi i zonave sensitive për t'i mbrojtur dhe rritur;
- Zhvillimi i një strategjie vlerësuese, veçanërisht përmes përdorimeve publike;

Për me tepër, është e mundur të identifikohen kategoritë në vazhdim, të cilat kërkojnë matje të veçanta:

#### Vargmalet

Vargmalet, elementet morfologjike kryesore që kontribuojnë në peizazh dhe në karakteristikat mjedisore të një territori, duhet të ruhen duke respektuar profilin e tyre, konet vizuale dhe pikat e rëndësishme të shikimit.

#### Pyjet dhe zonat malore

Te pyjet dhe zonat malore, PZHK-ja duhet të njohë rolin prioritar në natyrë, ruajtjen e tokës dhe peizazhit, si dhe kërkimin shkencor, balancën klimatike, rekreacionin turistik dhe aktivitetet produktive.

Menaxhimi i tokës duhet të ndjekë objektivin e ruajtjes së maleve si male multifunksionale ekologjike. Ekskursionet dhe aktivitetet e kohës së lirë janë të lejuara nëse përputhen me synimet e ruajtjes së natyrës dhe peizazhit, gjithashtu edhe me veprimet e ndërtimit në objektet ekzistuese.

#### Lumenjtë dhe liqenet

Nuk janë aktivitete të pranueshme që mund të rezultojnë në një rrezik përmbytjeje të pronës dhe njerëzve, ose rrezik nga ndotja ose rrëshqitja e dheut.

Përgjatë rrugës ujore duhet të ketë bufer zona të mbrojtura (së paku 30 m në secilën anë nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve, sipas ligjit Nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës )

dhe ato duhet të mos shfrytëzohen për ndërtim ose urbanizim, në mënyrë që t'i mbajnë, ruajnë dhe rrisin funksionet hidraulike, peizazhore dhe ekologjike.

Duhet të identifikohen zonat buferike për qendrat grumbulluese të ujit të pijshëm (puset dhe burimet). Përreth brigjeve të lumenjve duhet të ketë mbrojtje të zonave buferike (së paku 200m në secilën anë) dhe ato duhet të mos jenë të përshtatshme për urbanizim e ndërtim, në mënyrë që t'i mbajnë, ruajnë dhe rrisin funksionet hidraulike, peizazhore dhe ekologjike.

### **Zonat e veçanta peizazhike dhe interesat mjedisore**

Janë të përcaktuara në lidhje me kushtet e veçanta morfologjike/bimore, karakteristikat e veçanta të llojllojshme natyrore dhe/ose biologjike, kushtet e reduktimit të aktivitetit njerëzor. Atyre u përket Parku i Gërmisë.

Qëllimi kryesor është mbajtja, ruajtja dhe rritja e karakteristikave peizazhore dhe ekologjike. Janë masa të mundshme të synuara gjatë mundësitë të përdorimit publik, krijimi i parqeve me elemente me mundësi të zhvendosjes apo largimit, rrugë dhe hapësira parkimi për këmbësorët dhe transportin motorik.

### **Shtigjet piktoreske**

Shtigjet piktoreske janë rrugë, në të cilat është i mundshëm shijimi i pamjeve të qytetit, luginave, maleve. Përgjatë shtigjeve piktoreske në vendbanimet jashtë zonave të urbanizuara është i ndaluar ndërtimi i elementeve që shpërndajnë gaz, përdorimi i elementeve reklamuese, instalimi i rrethojave ose pemëve të larta që mund të bllokojnë pamjen e vazhdueshme piktoreske.

### **Pjesët arkeologjike**

Nga inventari i vendeve arkeologjike duhet të derivojë identifikimi i zonave të mundshme me konsekuencë të dukshme arkeologjike, që është interes i zonave nga prezenca e materialeve dhe/ose strukturave arkeologjike, tashmë të zbuluara ose që ende nuk u janë nënshtruar gërmimeve të rregullta, por që sigurisht janë prezente, dhe zonat që mund të konfigurohen si vende me dokumentacion të rëndësishëm historik. Për këto zona të paidentifikueshme duhet të definohen zonat përkatëse. Gjithashtu është primare që këto zona të shpallen si zona të papërshtatshme për ndërtim dhe të definohet zona buferike. Për pamjet dhe të mirat arkeologjike, po ashtu, është e nevojshme të krijohen procedura specifike për aktivitete ndërtimore, në mënyrë që të garantohet një qasje korrekte në gërmadha të mundshme.

### **Ndërtimet e interesit historik dhe arkitektonik**

Për ndërtimet në interesin historik dhe arkitektonik, identifikuar nga PZHK-ja dhe/ose nga Plani për qendrën historike, qëllimi është ruajtja e vlerave të tyre në kontekstin urban dhe peizazhor. Ndërtimi i ndryshimit të punës dhe funksioneve të këtyre ndërtesave duhet të bazohet në kriterin e restaurimit dhe të përputhshmërisë me kufizimet e imponuara nga struktura ndërtimore.

## **Zonat e interesit historik dhe arkitektonik**

Këto janë një grup i ndërtimeve, rrugëve, sheshe dhe parqeve, me një zgjidhje historike ende të identifikueshme; qëllimi është të lejojë leximin e ndërtesës, marrëdhëniet e mprehta dhe funksionale në mes të ndërtesave, elementet infrastrukturore dhe hapësirat e brendshme të hapura.

Objektivat janë:

- Ruajtja e rolit simbolik dhe funksional të territorit;
- Përdorimi ndryshon ndërtesat drejt atyre rezidenciale, shërbimeve dhe aktiviteteve të përputhshme;
- Ruajtja dhe kualifikimi i ofertës kulturore dhe kohës së lirë
- Rizhvillimi i hapësirave publike.

### **5.2.7. Mjetet që do të merren me mbeturina**

Rreth asgjësimit të mbeturinave duhet të zhvillohen strategji të reja, në mënyrë që të reduktohet sasia e mbeturinave, dhe së dyti, për ta kthyer procesin linear të shfrytëzimit, konvertimit, përdorimit dhe asgjësimit, tipike për modelin tonë të zhvillimit ekonomik – në një proces i qarkullimit bazuar në riciklim edhe pse me vlerë ekonomike.

Gjatë hartimit të planeve rregulluese duhet trajtuar hedhja/mledhja e mbeturinave në mënyre selektiveme qëllim të krijimit të mundësisë për reciklimin e tyre. Kapacitetet rajonale të deponive të mbeturinave plotësojnë nevojat por duhet riorganizuar menagjimin e mbeturinave në këto deponi.

### **5.2.8. Masat për parandalimin e dëmtimit të ndikimeve të mjedisit**

Për rrjetin hipografik PZHK-ja propozon përmirësimin e cilësisë së ujit, me heqjen graduale të mbeturinave të cilat ende ndikojnë në disa pjesë, dhe të bankave, me një program të veprimeve për secilin kanal që siguron rehabilitim të vlerave mjedisore dhe natyrore, duke forcuar aktivitete rekreative, pasurim të biomasës buke mbjell pemë dhe shkurre për të kompletuar skajet e peizazhit bujqësor, duke ruajtur elementet e mbetura historike të peizazhit.

Matje të shumta kushtuar mbrojtjes së mjedisit (ruajtja e peizazhit, mbeturinat e ngurta dhe përpunimin i ujërave të humbura, politikat pylltarisë), janë përmendur në paragrafët e mëhershëm. Sidoqoftë, është e mundshme të radhiten matjet e veçanta si në vijim:

#### **Reduktimi i ndotjes akustike**

Për të reduktuar ndotjen akustike në zonat urbane, duhet të ndiqen veprimet e duhura, dhe përmes ndërhyrjeve kushtuar pajisjeve dhe performancës së infrastrukturës, si dhe nga ndërhyrjet direkte në burimet e zhurmës.

Për vendbanimet e reja, vlerësimi i ekspozimit të ndotjes akustike do të ndihmojë në qasje inovative në dizajn dhe konstruksion.

Matjet për zbutjen e zhurmës, ku është e nevojshme, duhet të integrohen me mjedisin dhe të kontribuojnë në cilësinë e hapësirave urbane.

## **Reduktimi i ndotjes së ajrit**

Për reduktimin e ndotjes së ajrit në ambientin urban, duhet të ndiqen veprimet e duhura. Ndërhyrjet në vendbanimet e reja duhet të sigurojnë rritje të biomasës në zonat e gjelbërta dhe të jenë në gjendje të absorbojnë ndotjen duke zvogëluar kështu përqendrimet.

## **Mbledhja dhe hedhja e ujit**

PRRU duhet të marrë në konsiderim ndërtimin e sistemit të dyfishtë për ndërtesat e reja.

Në veçanti, në zonat e zhvillimit të ri, lehtësimi dhe rehabilitimi duhet të jenë të ndarë në disa sisteme për mbledhjen e ujërave të zeza të kushteve atmosferike, me qëllim që të ripërdorohen në përputhshmëri edhe jashtë zonave në të cilat gjenden.

## **Ruajtja e ujit**

Për të reduktuar konsumim e ujit të pijshëm, shiu do të mbledhet dhe do të përdoret si ujë për ujitje. Reduktim i mëtutjeshëm mund të arrihet duke përdorur instalime sanitare që rrjedhin ngadalë, duke ripërdorur ujërat e hirta aty ku duhet dhe implementuar sisteme gjeotermale në vend të kullave tradicionale ftohëse, të cilat përdorin një sasi të madhe të ujit të pijshëm. Sipërfaqet tokësore dhe kulmore duhet të jenë të dizajnuara ashtu që të jenë të depërtueshme për menaxhim efikas të ujërave atmosferikë.

## **Ruajtja e energjisë**

PZhK-ja propozon hartimin e një plani për të përcaktuar ndërhyrjet për reduktimin e humbjes së nxehtësisë në ndërtesat ekzistuese dhe për të caktuar standardet e cilësisë për ndërtesat e reja, në linjë me udhëzimet evropiane.

Efikasiteti duhet të arrihet nëpërmjet strategjive të zgjuara dhe të thjeshta që nuk kanë nevojë për teknologji tërësisht të reja. Kërkesat e energjisë do të minimizohen nëpërmjet zbatimit të strategjive pasive që aty ku është e mundur të arrihen kërkesat e mbetura nëpërmjet ndërtimit të ndërtesave të integruara, aty ku është e mundur do të bëhet furnizimi me energji nga burimet e ripërtëritshme.

Strategjitë pasive përfshijnë:

- Fasada të izoluara me dritare
- Rregullimi i ndërtesave për verë dhe dimër me ngrohje dhe freskim për secilën stinë
- Shfrytëzim maksimal i dritës së diellit nëpërmjet ndërtimit të elementeve që tërheqin dritën
- Zonat buferike (si kopshtet dimërore) duhet të tërheqin energjinë diellore pasive dhe të lejojnë ventilim natyral nën kushtet dimërore
- Mbrojtje nga drita diellore e jashtme

Burimet e ripërtëritshme përfshijnë:

- Ventilim natyral për ajrin e freskët dhe/ose freskim
- Ngrohje gjeotermale ose ftohje (opsionale)
- Tub diellor për ngrohjen e ujit nëpër shtëpi
- Fotovoltaics

Teknologjia LED mund të përdoret si sistemi primar i ndriçimit në ndërtimin e interierëve. Kjo teknologji i redukton kërkesat për mirëmbajtje gjatë një jetëgjatësie më të madhe dhe reduktim të kostos nëpërmjet kostove më të ulëta të ndërtimit.

### 5.2.9. Masat për parandalimin e ndikimeve negative social

Planifikimi dhe dizajni i të gjitha zonave do të sigurojë një mjedis që mund të mirëpresë një shoqëri të hapur me një diversitet të banorëve, njerëzve që banojnë aty, vizitorëve të qytetit. Njerëzit do t'i takojnë fqinjët e tyre dhe do të ndiejnë se i përkasin këtij komuniteti.

\* Sigurimi i tipologjive të ndryshme të banimit

\* Sigurimi i banimit social duke afirmuar të drejtat e barabarta për të gjitha komunitetet dhe shtresat sociale (mos të ketë segregim)

\* Mbështetja e identiteteve të lagjeve të ndryshme

\* Një rrjet publik hapësirë, ku banorët duan të takohen me fqinjët dhe për të gjetur mundësi për të komunikuar

Programimi i hapësirave në natyrë do të sigurojë:

- Fushat për lojëra
- Ulëse publike
- Fushat për eventet në natyrë dhe tubime të mëdha
- Zonat e sigurta, të gjelbërta dhe të qeta të lagjeve

### 5.2.10. Masat për zbatimin e planit

#### 5.2.10.a. Obligimet për hartimin e planit

*Planet rregulluese*

Edhe pse hartimi i PRRU mbulon të gjithë zonën urbane dhe atë rurale, është e qartë që prioriteti duhet t'u jepet disa zonave ku problemet hapësirë duhet rregulluar urgjentisht.

Veçanërisht këto zona:

- aty ku qyteti po rritet në mënyrë të paorganizuar dhe pakontrolluar;
- që mund të konsiderohen si vendbanime joformale, që përmbajnë ndërtime me një status që nuk është i qartë;
- aty ku nevojitet një ridizajnim dhe rindërtim i hapësirave publike

Disa zona kanë nevojë që t'u jepet përparësi.

Këto zona me prioritet për të cilat planifikohet të fillojë menjëherë hartimi i PRRU, janë:

- Zonat përgjatë aksit kryesor urban
- Zonat përgjatë aksit urban me linja të fuqishme të transportit publik në mënyrën e tyre
- Qendrat funksionale
- Zonat e rregulluara nga PRRU, të pakompletuara dhe të përshtatshme në standarde dhe pajisje

Plani urbanistik arkitektonik / *Projektet urbane të integruara*

Për këto zona në qytet, që kanë nevojë për një proces më të thellë të vizionimit ose për të cilat parashihet një zhvillim aktiv, do të hartohet një plan urbanistik arkitektonik ose një projekt urban i integruar përpara PZhU-së.

### **Vendbanimet joformale**

Në Komunën e Prishtinës kanë qenë të identifikuar shtatë vendbanime joformale: Lagjja “Dodona” (ish “Moravska”), “Kodra e Trimave” (ish “Vranjevci”) dhe lagjja “Kolonja Ramiz Sadiku” Lagja e Kurrizit, etj. për të cilat janë punuar Planet rregulluese Urbane dhe më nuk mund të quhen vendbanime joformale.

Ndryshe nga PRRU, një plan urbanistik arkitektonik/projekt i integruar urban nuk ka fuqi rregulluese për qytetarët, por do të veprojë më shumë si një vizion mbi zhvillimin e një zone të caktuar dhe do të përdoret si bazë për hartimin e një PZhU-je ligjore.

Në procesin e hartimit të planit urbanistik arkitektonik/projektit të integruar urban do të bëhet investigim dhe propozim për zgjidhe në lidhje me:

- strukturën e pronave dhe mundësitë e investimit privat
- strehimin
- infrastrukturën (rrugë, energji, ujë, kanalizim, ngrohje qendrore, etj..)
- shërbime publike (komoditete)
- aktivitete ekonomike
- aspekte mjedisore
- hapësira të hapura, peizazh dhe vlera natyrore
- trashëgimi dhe arkeologji
- pjesëmarrje nga përdoruesit e së ardhmes

### **5.2.10.b. Aplikim i masave të zhvillimit dhe masave të tjera**

#### *Mbrojtja e tokës bujqësore dhe e zonave natyrore*

Për token bujqësore që rrethon kufijtë e zonës urbane, nuk është e nevojshme që të hartohet ndonjë PRRU. Megjithatë, këto zona bujqësore e natyrore planifikohet të mbrohen nga ndërtimet e papërshtatshme.

Në përgjithësi, zhvillimi i ndërtimit nuk do të lejohet jashtë kufijve të përcaktuar me këtë plan, si në zonat rurale ashtu edhe në zonën urbane.

### **5.2.10.c. Rindërtimi i ndërtesave të destinacioneve që janë në kundërshtim me destinacionet e planifikuara**

Prishja e ndërtimeve mund të merret parasysht në rast se ndërtimet e paligjshme nuk mund të legalizohen për shkak të kontradiktave të mëdha me planet hapësinore. Në këtë rast do t'iu ofrohet një vend tjetër për ndërtimin e një shtëpie atyre që do t'i lejojnë shtëpitë e tyre për t'u prishur.

Në rastin e konstruksioneve të ligjshme në kundërshtim me destinacionet e planifikuara (nga pikëpamja e funksionalitetit, mjedisit dhe ruajtjes së vlerave), PzhU-ja do t'i vendosë ato nëpër harta dhe do t'i identifikojë veprimet më të përshtatshme mes:

- Zbutjes;
- Konvertimit dhe ripërdorimit;
- Shkatërrimit.

Në fakt, në disa raste edhe ndërtimet ligjore mund të zhvendosen nga shpronësimi ose negocimi me pronarin. Në këtë rast komuna do të ofrojë kompensim të përshtatshëm.

Në rast se ndërtimet ekzistuese me leje ose pa leje ndërtimi bien në kundërshtim me planet hapësinore, mund të imponohen kufizime mbi zhvillimet e mëtejshme (si zgjerim i ndërtesës).

### **Kufijtë urbanë**

Trendët zhvillimorë të deritanishme në qytetin e Prishtinës (zona urbane), kanë qenë të orientuara kah densifikimi i sipërfaqeve të ndërtuara me banim individual. Një trend i tillë ka rezultuar para së gjithash me kosto më të lartë të 1/m<sup>2</sup> të banesave dhe në përgjithësi të ndërtimeve të reja. Po ashtu densifikimi është treguar si proces tejet i ngadalshëm e shumë shpesh si koncept i dështuar në tërësi. Banorët që kanë ndërtuar shtëpitë e tyre rishtazi nuk kanë shprehur gatishmëri t'i rrënojnë ato në kompensim të banesave. Sipas analizës së sipërfaqeve të ndërtuara, del që Prishtina ka kapacitete rreth 300.000 banorë<sup>24</sup>. Këto kapacitete dhe numri i parashikuar i banorëve në Prishtinë në dhjetëvjetëshin e ardhshëm prej 622.000 banorëve (2.1.1), ndërrimet territoriale të rezultuara nga "Pakoja e Ahtisarit", Zona urbane tashmë ka arritur kufijtë e saj administrativë me Graçanicën, Fushë-Kosovën dhe Obiliqin. Në anën lindore, zonën urbane të Prishtinës e kufizon Parku i Gërmisë dhe anën perëndimore Autoudha "Dr.Ibrahim Rugova". Prandaj, Prishtinës i mbetet vetëm një kah zhvillimor urban – zhvillimi drejt VERIUT. Një tendencë e zhvillimeve të paplanifikuara në veri vërehen edhe ditëve të sotme dhe mund të konstatohet se planifikimi duhet paraprirë zonës së veriut, para se ta përfshijë ndërtimi i paplanifikuar (ndërtimi ilegal).


Unaza e jashtme që në të vërtetë është autostradë e qytetit, që me profilin tërthorë që ka dhe elementet e saja përbërëse (udhëkryqet në 2 nivele, urat, nënkalimet, mbushjet dhe gërmimet) në disa raste i ndan disa vendbanime në dysh e në disa raste disa vendbanime i ka lënë jashtë zonës urbane. Kjo barrierë serioze në vendbanim (rasti i Hajvalisë, Zllatarit dhe Mramorit) bën që këto vendbanime të trajtohen në mënyrë specifike, e në disa raste të veçanta (rasti i Çagllavicës)

<sup>24</sup> Në këtë llogaritje janë përvetësuar 150 banorë për 1 ha në rastet e banimit individual dhe 500 banorë për 1 ha në rastet e banimit kolektiv

planifikohet të hartohen plane unike rregulluese urbane në bashkëpunim me komunën fqinje, duke sinkronizuar të gjitha planet dhe projektet e të gjitha niveleve (planet zhvillimore urbane, planet rregulluese urbane, projektet e unazave, 'bajpaseve', Autoudhave dhe të rrugëve magjistrale).

Zhvillimet e fundit në Prishtinë në fazën e tranzicionit kanë rezultuar me një numër të konsiderueshëm të ndërtimeve të paplanifikuara. Transformimi i kësaj kategorie të ndërtimeve është një proces i shtrenjte dhe shumë i kushtueshëm, gjë që është vërtetuar edhe në disa tentime në disa lagje të Prishtinës, ku transformimet e parapara ose nuk kanë ndodhur fare, ose kanë ndodhur në një masë tejet të vogël, gjë që i ka sjellë këto lagje në stad jo aq të mirë nga aspekti qoftë i funksionimit të lagjes, kualitetit të jetesës apo peizazhit urban. Prandaj zhvillimin e qytetit në veri – "Prishtina Veriore" krijon kushte për zhvillim të planifikuar urban, duke u krijuar kushte këtyre lagjeve që të eksploatojnë investimin (deri në një amortizim të konsiderueshëm) dhe transformim më të vonshëm në planifikimet afatgjatë. Në ndërkohë këto vendbanime mund të pasurohen me infrastrukturë teknike dhe sociale dhe shërbime specifike, me qëllim të ngritjes së cilësisë së banimit bazuar në projekte të veçanta dhe me investime publiko-private, sipas nevojave, kërkesave, organizimit të qytetarëve dhe prioriteteve të përcaktuara nga Komuna e Prishtinës.





Harta 19. Kufiri urban

Një zhvillim në drejtim të veriut korrespondon edhe me “Konceptin policentrik” dhe me “Linjën metropolitane”. Zhvillimet e fundit në tri zonat “Lindje”, “Qendër” dhe “Perëndim”, nuk krijojnë kushte për zhvillime afatgjata. Planet rregulluese urbane në proces të kësaj zone në jug të Prishtinës, nuk do të mund të marrin barrën e zhvillimeve afatgjata të Prishtinës. Bazuar në disa përmbajtje administrative (“Presidenca” dhe “Pallati i Drejtësisë”), kjo zonë mund të konsiderohet si vazhdim i boshtit urban dhe formimi i një qendre të dytë të Prishtinës. Kurse në veri planifikohet qendra e tretë, e cila mund të kompletohet me të gjitha funksionet e centralitetit (arsimi i lartë, kultura, sporti, biznesi, qendra tregtare, administratë, objekte fetare, parqe, stacion ndërrurban autobusësh me përmasa më të vogla, etj), që duhet definuar në fazën e hartimit të PZhU-së. Pra, boshti urban, i përkrahur me “linjën metropolitane” orientohet drejt veriut duke mundësuar zhvillime edhe në perspektiva afatgjatë.

### **Infrastruktura sociale**

**Institucionet shkollore** dhe **parashkollore** në pjesën urbane duhet të definojnë me PzhU. Duke pasur parasysh që pjesa më e madhe e territorit urban, përveç Planit Strategjik Zhvillimor Urban, tashmë i kanë edhe planet rregulluese, këto përmbajtje janë definuar. Prishtina-Veri është situatë e re dhe mund të ofrojë kushte tejet të volitshme për qytetarë, jo vetëm të kësaj zone. Qerdhet, institucionet parashkollore, shkollore, si bazike ashtu edhe të mesëm të lartë janë obliguese dhe si të tilla patjetër duhen konsideruar në PZhU. Por Prishtina-Veri do të mundësojë edhe vendosjen e **kampuseve universitare, kolegjeve** dhe **institucioneve të tjera arsimore** dhe **shkencore** si me karakter publik ashtu edhe me karakter privat.

Situatë tjetër konsiderohet çështja e **spitalit të qytetit**. Për shkak të infrastrukturës përcjellëse që ka Qendra ekzistuese Klinikave Universitare e Kosovës (QKUK), spitali i qytetit kishte qenë mirë të vendoset në apo afër QKUK-së. Afërsia e këtyre dy institucioneve do të mundësonte kompletimin e aseteve, shërbimeve dhe stafit profesional mjekësor.

Rehabilitimi shëndetësor është një komponent i mundshëm zhvillimor, në veçanti në zonat rurale (banjat termale, ajrore, natyrale, etj), të cilat në kombinim me zhvillimin e shërbimeve spitalore dhe pas-spitalore mund të merren në konsideratë në veçanti për sektorin publiko-privat.

**Varrezat** e qytetit paraqesin një çështje tejet delikate. Me gjithë faktin që varrezat ekzistuese i plotësojnë nevojat e parashikuara për 10 vjetshin e ardhshëm, “Prishtina Veri” do t’i ketë varrezat e reja që duhet definuar në fazën e hartimit të PZhU-së. Çështja e varrezave në përgjithësi kërkon një analizë gjithëpërfshirëse dhe diskutime me banorët, ekspertë të profileve të ndryshme (sociologë, psikologë, antropologë, etnologë, etj) për t’i rishqyrtuar disa kaptina tejet të rëndësishme, si ritualin e varrosjes (bazuar në religjionin, përkatësinë nacionale, etj.) dhe kërkesat specifike të individëve dhe grupeve. Shumë kryeqytete në regjion dhe më larg aplikojnë regjim të selektuar të varrezave, si në aspektin e trajtimit varreza-park<sup>25</sup>, ashtu edhe në aspektin e

<sup>25</sup> Në shumë qytete në botë varrezat i konsiderojnë si mundësi të rritjes së sipërfaqeve gjelbëruese duke ririfreskuar edhe koleksin e varrezave por edhe mjedisin se ku ato lokohen.

kohëzgjatjes së qëndrimit të varrit apo dukjes së tij me fokus të veçantë në mirëmbajtjen e tyre<sup>26</sup>. Me PZhU duhet krijuar mundësi edhe për varreza me karakter publiko/privat, nëse për një gjë të tillë shprehet interesim.

### **5.3. Dispozitat në lidhje me bashkëpunimin**

Për të koordinuar zbatimin e PZhK-së, komuna mund të promovojë arritjen e marrëveshjeve territoriale me komunat e tjera dhe me Qeverinë, për shkak të integritit të ngushtë dhe të ndërvarur të marrëveshjeve mbi vendbanimet dhe homogjenitetin e karakteristikave të natyrës, mjedisit dhe peizazhit të komunave.

#### *Përmirësimi i përfshirjes, pjesëmarrjes dhe ndërgjegjësimit*

Zbatimi dhe përforsimi i planeve zhvillimore dhe rregulluese do të jetë i suksesshëm vetëm kur komuna të mund të krijojë ndjenjën e mbështetjes dhe besimit mes banorëve të saj. Një kampanjë mediale do të organizohet për të forcuar ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe të rritë mbështetjen e tyre për planifikimin e aktiviteteve.

#### *Centralizimi i informacionit hapësinor*

Informacioni hapësinor i mundshëm do të qëndërzohet dhe integrohet në një sistem GIS, që do të jetë i qasshëm të paktën nga të gjitha drejtoritë e administratës komunale. Gjendja aktuale si në Komunën e Prishtinës dhe të gjitha komunat tjera është e disfavorshme për integrimin e informatave në sistemin GIS. Duhet të krijohet databaza e informatave bazë (hyrëse) si në nivelin lokal ashtu edhe qendror si dhe të trajnohet stafi në këtë drejtim.

#### *Lejet e ndërtimit*

Procesi i dhënies ose refuzimit të lejeve të ndërtimit, duke përfshirë garancitë për rolet transparente të të gjitha palëve të interesuara (aplikantë, rezidentë, palë të tjera dhe administratë), do të përmirësohen me marrëveshje të qarta.

### **5.4. Dispozitat mbi rendin kronologjik ose fazat e zbatimit**

Plani investitor komunal duhet të bëhet sipas veprimeve që kanë rezultuar si më të rëndësishme dhe urgjente sipas PZhK-së dhe PZhU-së.

Në një kohë të shkurtër pas aprovimit final të PZhK-së dhe PZhU-së (6 muaj), Asambleja Komunale duhet të aprovojë një plan buxhetor shtesë, në të cilin duhet të shprehet qartë se si do të financohet zbatimi i këtyre dy planeve për tre vjetët e para. Ky plan buxhetor shtesë duhet të përcaktojë, veç të tjerave, edhe hartimin e PRRU, duke zbatuar inventarin dhe hartimin e studimeve shtesë të fizibilitetit, planeve sektoriale dhe instrumenteve të tjera që duhet të financohen.

Pas aprovimit përfundimtar të PZhK-së dhe PZhU-së, komuna duhet t'i rishikojë politikat e sektorit ekzistues për t'i pasur të harmonizuara me komisionin e PZhK-së dhe PZhU-së.

<sup>26</sup> Numri i madh i varrezave gjithnjë e më shumë po gllabëron sipërfaqet e gjelbërta dhe ato bujqësore. Një numër i konsiderueshëm janë të lëna anash nga familjarët dhe miqtë (nuk vizitohen fare). Nëse për çfarëdo arsye varrezat mbeten pa përkujdesje nga anëtarët e afërt, mund të rikonsiderohet trajtimi i tyre pas një periudhe, p.sh.10-vjeçare.

### 5.5. Elementet dhe udhëzimet për hulumtime të mëtejme

- Studime dhe kërkime për identifikimin në kohë të zonave që duhet të mbrohen në lidhje me mbrojtjen e sipërfaqeve dhe burimeve me ujëra nëntokësorë dhe gjendjen hidrologjike. Duhet identifikuar zonat në rrezik për përmbytje.
- Definicioni i këtyre pjesëve të kodrës/malit për t'u ruajtur, për t'i parandaluar format e përdorimit të tokës që mund të shkaktojnë shqetësim publik në formën e shpyllëzimit, humbjes së stabilitetit ose përkeqësimi i sistemit ujqor.
- Do të identifikohen si zona të ndikuara nga mungesa e stabilitetit dhe fenomeni i erozionit (p.sh. rrëshqitjet e tokës ose faza e rregullimit, duke rezultuar në kushtet morfologjike dhe klimatike: një fenomen që ndodh për shkak të kushteve morfologjike dhe klimatike shumë të ngjashme me të tashmen, në dukje stabile por që e kanë ezauruar zhvillimin e tyre dhe mund të riaktivizohen).

Studime specifike janë zhvilluar rreth rrëshqitjes së tokës, erozionit, tërmetejeve dhe ndërlihdjeve të tyre me zgjerimin e zonës urbane.

- Studimet sistematike për identifikimin dhe analizën e situatave të ndryshme për ish-zonat industriale.

## A. FJALOR

---

**Alternativa strategjike:** Janë mundësi, opsione të ndryshme për zgjidhjen e një problemi.

**Analiza SWOT (Përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet):** Analizave e përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve lehtëson klasifikimin e çështjeve të identifikuara në një nga këto katër grupe dhe lehtëson menaxhimin gjatë procesit planifikues.

**Banorët aktualë dhe potencialë:** Do të thotë përqendrimi banorëve dhe njerëzve që gravitojnë në qytet për studime, punë, apo kënaqësi, ose për të pasur avantazhin e shërbimeve publike dhe komunale që janë të disponueshme, në hartimin e planit, si dhe popullsia potenciale e përbërë nga rritja e popullsisë që mund të pasojë me zbatimin e planit.

**Fizibiliteti dhe përfitimi i kostos:** E para është arsyeshmëria sociale dhe ekonomike e një analize të projektit, ndërsa e dyta kërkon balancën mes koston dhe përfitimit, zakonisht për një investim të propozuar.

**Fshati:** Është një vend ku popullata merret kryesisht me aktivitete bujqësore.

**Infrastrukturat për urbanizimin e vendbanimeve:** Do të thotë pajisjet dhe rrjetet e shërbimeve që sigurojnë funksionalitetin dhe cilësinë higjienike të vendbanimeve.

**Koncepte:** Një mënyrë e të menduarit drejt arritjes së një kondicioni të dëshiruar. Koncepti i idesë ndihmon kërkimin e zgjidhjes së problemit. Konceptet mund të jenë tema ose fraza të përshtatura që mund të sigurojnë një gjurmim më të përqendruar.

**Korridoret ekologjike vendore:** Ato janë elemente natyrore ose gjysmënatyrore, me performancë dhe masë të ndryshme, që konsistojnë në mbrojtjen e strukturave të ndryshme, pemëve, kanaleve, liqeneve, livadheve lineare, shpateve, të karakterizuara nga vlera specifike ekologjike, të cilat mund të merren si rezultat i nevojës së rikualifikimit. Ata mund të jenë ekzistuese ose të planifikuara dhe duhet të përcaktohen, strukturohen dhe të zhvillohen nga projekti.

**Monitorimi dhe vlerësimi:** Procesi i observimit dhe vlerësimit të realizimit të një detyre – veçanërisht KSP në këtë rast.

**Nyjat e thjeshta ekologjike:** Janë njësitë natyrore dhe gjysmënatyrore, që përgjithësisht janë të përbëra nga habitatet dhe zonat e tyre rrethuese, duke krijuar vlerat e tyre ekologjike.

**Objektivat:** Pjesët e qëllimit të deklaruar, më shumë një mënyrë e realizimit të qëllimeve.

**Pajisjet dhe hapësirat publike:** Pajisjet dhe hapësirat publike janë një tërësi objektesh, punës dhe hapësirash publike të pajisura, që kanë si qëllim ofrimin e shërbimeve publike, të nevojshme për të mbështetur komunitetin dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës individuale dhe kolektive.

**Pajisjet ekologjike dhe mjedisore:** Do të thotë tërësia e hapësirave, punëve dhe ndërhyrjeve që kontribuojnë me infrastrukturën për zhvillimin e vendbanimeve, për të përmirësuar cilësinë e mjedisit urban duke i reduktuar ndikimet negative. Shërbimet janë dizajnuar në veçanti për të mbrojtur dhe reklamuar ajrin dhe ujin për të parandaluar ndotjen e tyre; për të menaxhuar ciklin e ujit në një mënyrë të integruar, për të reduktuar zhurmën dhe ndotjen elektromagnetike; për të

ruajtur tokën dhe për të restauruar balancën mjedisore në zonën urbane; për të promovuar ndarjen e mbeturinave në kategori.

**Përdorimi i tokës:** Nënkupton përcaktimin ekzistues ose të propozuar të përdorimit të parcelave të tokës.

**Plan rregullues urban:** Një lloj plani i përshkruar në Artikullin 15 në Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor.

**Planifikimi strategjik:** Planifikim i orientuar drejt zgjidhjes së problemeve kyçe, planifikim të përqendruar për një sërë çështjesh, duke promovuar proceset proaktive në lidhje me zhvillimin, etj.

**Parimet:** Zakonisht janë vlera të propozuara që shpeshherë dakordohet që të respektohen në të ardhmen. Në rastin tonë, vlerat që duhen respektuar janë ato gjatë dhe pas aprovimit të planit, në fakt zbatimi i tij.

**Prioriteti:** Objektivi kryesor në këtë proces, vlerësohet si i rëndësishëm dhe shumë urgjent.

**Qendrat funksionale:** Qendrat funksionale, ekzistuese ose të planifikuara, janë zonat me funksione të specializuara, ku mund të lokalizohen shërbimet dhe aktivitetet me kompetenca specifike në fushën ekonomike, kulturore, sportive, të kënaqësisë dhe mobilitetit. Qendrat funksionale janë, po ashtu, të karakterizuara nga një tërheqje e fortë për njerëzit dhe të mirat, siç janë zonat jolokale të grumbullimit, për të pasur një ndikim të fortë mbi mobilitetin, mjedisin dhe cilësinë sociale të qytetit.

**Qyteti:** Nënkupton vendbanimet që janë të vendosura në një mënyrë të caktuar nga Asambleja Komonale, ndërtim, aktivitete dhe karakteristika të një karakteri urban.

**Raportet sektoriale:** Janë dokumente analitike, në të cilat shpjegohen pjesët kryesore të strategjive sektoriale, duke iu drejtuar aspekteve hapësinore të sektorit përkatës. Kjo përfshin sektorët që janë nën kompetencën e ministrisë.

**Rrjeti ekologjik:** Rrjeti ekologjik është një sistem me qëllime të shumta i përbërë nga nyjat dhe korridoret. Nyjat janë të përfaqësuara nga elementet e ekosistemit të karakterizuara nga masat ekologjike dhe strukturat, siç janë funksionimi i “rezervuarëve të biodiversitetit”. Korridoret janë ekosisteme lineare që lidhin nyjat përgjatë territorit dhe mbështesin ruajtjen dhe rritjen e biodiversitetit. Në veçanti, korridoret që përmbajnë funksionet e strehimit dhe ruajtjes së jetës së egër, ofrojnë rrugë tranzite dhe veprojnë si sensorë për speciet e reja.

**Standard për cilësinë urbane:** Do të thotë sasia dhe cilësia e infrastrukturës për vendbanimet, pajisjet dhe hapësirat publike dhe duhet të jenë të përshtatshme për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve. Standardet në veçanti janë: a) lloji dhe sasia e këtyre pajisjeve; b) karakteristikat e performancës së tyre në lidhje me qasjen e tyre, sigurinë dhe përdorshmërinë për të gjithë qytetarët; c) vendndodhja e tyre e balancuar dhe racionale brenda territorit; d) funksionaliteti i tyre dhe njohuritë teknike, menaxhimi i tyre i thjeshtë dhe i përballueshëm.

**Standardi për cilësinë ekologjike dhe mjedisore:** I referohet gradës së zvogëlimit të presionit nga sistemi i vendbanimeve në ambientin natyror dhe përmirësimit të shëndetshmërisë brenda ambientit urban. Standardet në veçanti: a) rregullorja e përdorimit dhe transformimet, që kanë si

qëllim kufizimin e konsumit të burimeve jo të ripërtëritshme dhe promovimit të parandalimit të integruar të ndotjes; b) zbatimi i veprimeve për të balancuar dhe zbutur ndikimet negative të aktivitetit njerëzor; c) forcimi i infrastrukturës dhe pajisjeve ekologjike e mjedisore.

**Strategji:** Një klasifikim i veprimeve për arritjen e një objekti.

**Synimet/Qëllimet:** Pjesë të vizionit, duke identifikuar fokusin e tendencave për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

**Tokë bujqësore cilësore:** Tokë bujqësore e klasifikuar në kategoritë 1-4 të cilësisë së tokave.

**Tokë bujqësore:** Është tokë e përcaktuar për kultivimin e produkteve bujqësore.

**Vendbanim:** Do të thotë një zonë me karakter urban, tokë bujqësore, qytet dhe vendbanime të tjera të proklamuar nga Kuvendi Komunal si zonë strehimi.

**Vendbanimet joformale:** Vendbanime të njerëzve që nuk i lejojnë banorët t'i shijojnë të drejtat e një banese standarde. Prandaj, vendbanimet joformale mund t'i kenë këto karakteristikat: posedim formal i pronës, privim ose qasje e papërshtatshme në shërbimet bazike, mospjesëmarrje në qeverisje, rrezik i lartë.

**Vizioni:** Një deklaratë mbi dëshirat e së ardhmes bazuar në gjendjen ekzistuese.

**Zonë e mbrojtur:** Është pjesa hapësinore, e cila është e paracaktuar për t'i ruajtur burimet natyrore, kulturore-historike dhe arkeologjike, mbrojtja e mjedisit ndaj ndotjes ose ofrimi i kushteve hapësinore për ushtrimin e papenguar të aktiviteteve, si dhe sigurinë e banorëve dhe hapësirës përreth.

**Zonë e mbrojtur:** Është zona e burimeve të mbrojtura natyrore dhe mjedisore, zonave bujqësore, si dhe ato me trashëgimi kulturore dhe arkeologjike.

**Zonë rurale:** Zona rurale është e përbërë nga territori i paurbanizuar dhe karakterizohet nga nevoja për t'i integruar dhe bërë më koherente politikën për mbrojtjen e vlerave natyrore, mjedisore, dhe peizazhore, me politika që do të sigurojnë zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme.

**Zonë urbane:** Është toka me kufij të caktuar, nëpër të cilin është i planifikuar ndërtimi urban.

**Zhvillim i qëndrueshëm:** Zhvillimi social, ekonomik dhe mjedisor që i konsideron përdorimin e burimeve si një aset që duhet të ruhet për gjeneratat e ardhshme.

**Zhvillim policentrik:** Zhvillimi që konsiston në zhvillimin e më shumë se një qendre të fortë në territor, dhe këmbëngul në shpërndarjen e barabartë të funksioneve kryesore të zhvillimit.

## Parametrat e zhvillimit të rrugëve

### 1. Objektivat

Klasifikimi i rrjetit të rrugëve është bazuar në Ligjin e Rrugëve të Transportit, Nr. 2004/1, dhe Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor Nr. 02/L-70


, konsistent me destinimin e rrugëve urbane dhe të parashikuar me rritjen urbane dhe territoriale. Ky klasifikim nuk është i kufizuar me limitin e kohës së implementimit të këtij Plani Zhvillimor Komunal, por gjithashtu është dizajnuar për projektimet në të ardhmen në periudhë kohore prej 50 vjetësh. Kjo pasi investimet e kërkuara në adaptimin e rrjetit të rrugëve, të bazuara në destinim të rrugëve dhe parametra gjeomekanikë të trafikut, janë shumë të larta. Kjo nevojitet të shpërndalet në periudhë relativisht të gjatë kohore, kështu që planifikimi është i realizueshëm. Në lidhje me këtë, dimensionet e seksioneve të planifikuara për secilën kategori të rrugëve të qytetit janë raportuar qartë në hartën e planit të zhvillimit. Bazuar në këtë, komuna ka përcaktuar qartë kufijtë e rrjetit rrugor të ardhshëm të Prishtinës, e cila nuk duhet modifikuar, pavarësisht nga koha kur këto rrugë do të ndërtohen në përputhje me seksionet e dhëna.

Plani më sipër mund të konsiderohet si plan i transportit urban të qytetit të Prishtinës, i përbërë nga ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe rehabilitimi në mënyrë që të ketë një plan të qëndrueshëm dhe afatgjatë i zhvillimit ekonomik dhe social. Ky plan duhet të zbatohet në mënyrë që të sigurojë pikat e mëposhtme në veçanti:

- Përmirësimi i kushteve të komunikacionit (zhvendosja dhe parkimi),
- Reduktimi i aksidenteve rrugore,
- Reduktimi i ndotjes atmosferike dhe zhurma,
- Respektimi i vlerave mjedisore,
- Reduktimi i shpenzimeve publike dhe private.

Megjithatë, Ligji i Transportit të Rrugëve dhe Ligji i Sigurisë së Trafikut nuk përmbajnë normat dhe standardet e kërkuara të nevojshme për Kosovën në fushën e ndërtimit të rrugëve në përgjithësi, dhe atë të ndërtimit të rrugëve urbane në veçanti. Këto ligje janë të bazuara në Euro-kodin e ri "Në transportin e rrugëve". Po ashtu, të gjitha aktet normative të planifikimit në Kosovë janë bazuar në normat e CNR, të cilat janë në përputhje me ato të Bashkimit Evropian.





Harta 20. Plani i rrugëve të Prishtinës me të gjitha kategoritë e rrugëve

### **Rrugët ekzistuese**

Sipas analizave të ekspertëve bazuar në inventarët dhe anketat e mëparshme, rrugët ekzistuese të qytetit të Prishtinës nuk i plotësojnë parametrat gjeometrikë për të përballuar nivelin aktual të trafikut. Mjafton të përmendim këtu se kërkesa për qarkullim automobilistik mes viteve 2011- 2025, pritet të rritet nga 399,073 udhëtime në ditë, prej të cilave 273,188 janë udhëtime jo të motorizuara dhe 125,885 udhëtime të motorizuara, në 1,256,850 udhëtime në ditë, nga të cilat 859,950 janë jo të motorizuara dhe 396,900 udhëtime të motorizuara. Pra, pritet të ketë një rritje prej 314%.

Në të njëjtën periudhë, rritja e nivelit të pronësisë dhe përdorimit të automjeteve, do të shkojë nga 133,000 automjete në vitin 2011, në vitin 199,000 automjete më 2020, që është një rritje prej 150%.

Bazuar në trendët aktualë të zhvillimit dhe në krahasimet ndërkombëtare, del se në një periudhë afatgjatë kohore rrjeti ekzistues rrugor i Prishtinës do të bëhet gjithnjë e më i papërshtatshëm.

### **Rrugët e reja**


Ndërtimi i një numri rrugësh të reja ka qenë i planifikuar për t'i përmbushur kërkesat në rritje të qarkullimit, si dhe me një pamje drejt zhvillimit potencial të qytetit. Kjo është në përputhje me përmbushjen e objektivave të Planit strukturor:

- Prishtina 'by-pass',
- programi i njave multinivele,
- Rregullorja e rrugëve urbane,
- Projekti i rehabilitimit të rrugëve,
- Projekti i përmirësimeve të kryqëzimeve,
- Programi i veprimt të transportit publik,
- Projekti i unazës qendrore,


- Projekti i unazës së brendshme,
- Rrjeti i korsive rrethore,
- Linjat hekurudhore vajtje-ardhje Prishtinë – Fushë Kosovë – Miradi – Aeroport,
- Linjat hekurudhore të lehta për vajtje-ardhje brenda qytetit të Prishtinës.

Të gjitha masat për ndërtimin e rrugëve të reja synojnë krijimin e infrastrukturës bashkëkohore për qytetin e Prishtinës, e cila gjithashtu përfshin autostradën urbane, siç parashikohet nga ndryshimet e fundit në Ligjin e Transportit Rrugor dhe Ligjin e Sigurisë së Trafikut, të bazuar në Kodin Rrugor Evropian.

- |   |                                   |
|---|-----------------------------------|
| 1. Nyjat multinivele                        | Aex – ekstra-urban autostradë     |
| 2. Nyjat multinivele ose kryqëzime me shteg | Aurb – autostradë urbane          |
| 3. Kryqëzime me shteg                       | B – ekstra urbane primare         |
| X kryqëzime të ndaluara                     | C – rrugë ekstra-urbane sekondare |
|   | D –rrugë urbane kolektuese        |



**Hierarkia e rrjetit rrugor dhe identifikimi i mundshëm ndërmjet rrugëve.**



### **Plani i trafikut**

Kriteret teknike të Rregullores së Trafikut Urban përcaktojnë drejtimet dhe kushtet për orientimin e Projektit të trafikut urban. Kjo ka për qëllim që të sigurojë organizim optimal si dhe nivel të lartë të sigurisë së transportit në zonat urbane, në pajtim me ligjet përkatëse. Në këtë kontekst, kriteret teknike luajnë rolin e kushteve teknike dhe janë të detyrueshme për të gjithë krijuesit e projekteve në këtë fushë. Planet urbane të trafikut duhet të përshtaten në tërësi me treguesit e fundit të planifikimit urban, dhe duhet të jetë vazhdimisht të risuar dhe në përputhje me kërkesat e transportit.

### **Plani i mirëmbajtjes së rrugëve**

Aktualisht, cilësia e rrjetit rrugor të Prishtinës nuk është e kënaqshme në lidhje me cilësinë e pistës dhe parametrat e tij gjeometrikë (gjerësia dhe gjatësia), krahasuar me nivelet e trafikut. Projekti konsiston në zhvillimin e rrjetit të rrugëve primare dhe sekondare të qytetit të Prishtinës (respektivisht, në gjatësi, ekzistuese 146.23 km, planifikuar 127,42 km të rrjetit të rrugëve sekondare), duke përfshirë tretmanin e sipërfaqeve të rrugëve (shtrirja e asfaltit) dhe rikonstruimin dhe renovimin e disa rrugëve. Ajo gjithashtu siguron themelet e sistemit të kanalizimit, gjendjen e kontigjentit për secilin segment apo kryqëzim. Të gjitha kryqëzimet në mes të rrugëve primare dhe sekondare do të përmirësohen funksionalisht dhe strukturalisht. Shenjat e rrugëve vertikale dhe horizontale ose do të restaurohen ose do të ngritën. Këto matje bashkërisht do të sigurojnë:

- Reduktim të kostos të mirëmbajtjes të automjeteve,
- Rritje të zëvendësimit të kapacitetit të transportit,
- Rritje të shpejtësisë mesatare të udhëtimit,
- Përmirësim të sigurisë në trafik,
- Përmirësim në kujdes për ambientin.

### **Gjelbërimi përskaaj rrugëve**

Së bashku me gjelbërimin, duhet të jetë një zbukurim në përputhje me të gjitha kategoritë e rrugëve. Rrugët lokale dhe të qarkut në veçanti mund të zbukurohen me orë, me fontanë dekorative si dhe me ulëse për pushim. Zbukurimi duhet t'i përfshijë ndalesat e autobusëve, kabinat publike të telefonit, ulëset, shportat e bërllokut për këmbësorë, parkingje për biçikleta, si dhe elemente të tjera që prezantojnë kulturë qytetare. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për qytete sikur Prishtina, ku turizmi është prioritet dhe rruga është elementi i parë ku turisti vjen në kontakt me qytetin.

### **Tipologjia e rrugëve**

Rrjeti i rrugëve paraqet pjesën më vitale të zonës urbane. Kjo konsiderohet si organizëm që jeton, kontinualisht "ushqehet" me njerëz, të mira material, energji dhe informacion. Infrastruktura teknike tradicionale është e shtrirë përgjatë rrjetit të rrugëve urbane dhe hapësirave publike, duke përfshirë furnizimin me energji (ujin, ndriçimin, gazin, ujën e nxehtë), infrastrukurën e komunikimit (rrjetin e telefonisë kabllore) dhe sistemin e kanalizimit. Rrjeti i rrugëve urbane duhet të ndahet në tri kategori të rrugëve: primare, sekondare dhe terciare.

### Normat e rrugëve kryesore

Kufiri i rrugës është përcaktuar si fundi i rrugëve private, që rezultojnë nga aktet e blerjes ose përvetësimit të tokës për qëllime civile. Në mungesë të këtyre rrethanave, kufiri është i përcaktuar nga cepi i jashtëm i barrierës së sigurisë, pengesë apo hendek, aty ku ekziston, ose nga cepi i jashtëm i trotuarit, në raste kur rruga është e ngritur mbi tokë, ose cepi i sipërm i ulur, në rastet kur rruga është nën nivelin e trotuarit (shih figurën më poshtë).

#### Hapësira e rrugëve

	<b>Tipi i rrugës A (Autoudha)</b>	<b>Tipi kryesor interurban i rrugës B</b>	<b>Tipi i rrugës C sekondare interurbane</b>	<b>Tipi i rrugës D primare urbane</b>	<b>Tipi i rrugës E sekondare urbane</b>	<b>Tipi i rrugës F lokale *</b>
<b>Rrugë njëkahëshe</b>	Të veçuara dhe të ndara nga parmacët	Të veçuara dhe të ndara nga parmacët	Të veçuara	Të veçuara dhe të ndara nga parmacët	Të veçuara	Të veçuara
<b>Korsi</b>	Së paku 2 në çdo drejtim të udhëtimit	Së paku 2 në çdo drejtim të udhëtimit	Së paku 2 në çdo drejtim të udhëtimit	Së paku 2 në çdo drejtim të udhëtimit	Së paku 2 në çdo drejtim të udhëtimit	
<b>Bankinat</b>	<b>Po</b> Eventualisht në të majtë, të lokalizuar në të djathtë (apo e lokalizuar me korsinë emergjente)	<b>Po</b> Të vendosura në të djathtë	<b>Po</b>	<b>Po</b> Të vendosura në të djathtë	<b>Po</b> Të vendosura	
<b>Trotuaret</b>	-	-	-	<b>Po</b>	<b>Po</b>	
<b>Korsia emergjente</b>	<b>Po</b> (në anën e kundërt të pendës)	-	-	-	-	
<b>Ndërprerja e traseve</b>	<b>Jo</b>	<b>Jo</b>	-	<b>Po</b> Me sinjal të trafikut	-	
<b>Qasja në anë apo private</b>	<b>Jo</b>	<b>Po</b> Koordinuar	-	-	-	
<b>Asistenca në rrugë</b>	<b>Po</b>	-	-	-	-	
<b>Destinimet</b>	Për disa	Për disa	-	-	-	

<b>e dobishme</b>	<i>kategori të automjeteve</i>	<i>kategori të automjeteve e motorike (kategoritë e tjera eventuale duhet të sigurohet në hapësirat e nevojshme)</i>				
<b>Sinjalet e dukshme</b>	<b>Po</b> <i>Në fillim dhe fund</i>	<b>Po</b> <i>Në fillim dhe fund</i>	-	-	-	
<b>Ndalesat</b>	<b>Po</b> <i>Zonat e shërbimit dhe zonat e parkimit të përshtatura me përshpejtimin dhe ngadalësimin e korsive</i>	<b>Po</b> <i>Zonat e shërbimit dhe zonat e parkimit të përshtatura me përshpejtimin dhe ngadalësimin e korsive</i>	-	<b>Po</b> <i>Zona të përshtatshme apo gjurmë të jashtme anësore në rrugët njëkahëshe me përqendrim të hyrjes dhe daljes së trafikut</i>	<b>Po</b> <i>Hapësirat e siguruara me manovrimin e korsive jashtë rrugës njëkahëshe</i>	
<b>Korsia e automjeteve për transport publik</b>	-	-	-	<i>eventualisht</i>	-	
<b>Shërbimi i rrugëve</b>	<b>Po</b>	<b>Po</b>	-	<b>Po</b>	-	
<b>Shpejtësia maksimale e lejuar</b>	130km/h	110km/h	90km/h	70km/h	50km/h	50/90km/h

\*Rrugët urbane dhe ndërurbane, të cilat nuk janë të përfshira në kategoritë e tjera të rrugëve

**Tabela e karakteristikave të rrugëve**

Emri	Tipi i rrugës njëkahëshe	Gjerësia e korsisë (m)	Numri i korsive për drejtimin e lëvizjes	Gjerësia minimale (m) e divizionit të trafikut	Gjerësia e korsisë emergjente (m)	Gjerësia e pendës (m)	Gjerësia minimale e trotuarit (m)	Gjerësia totale e rrugëve minimale (m)
	A	B	C	D	E	F	G	H
Rrugët primare	1-drejtimëshe me parrak	3.50	2 ose më shumë	1.60 (me taks)	3.00	-	-	20
Rrugët mledhëse	Të ndarata ku është e mundur	3.25	2 ose më shumë	1.10 (me taks)	-	1.00	3.00	15
Rrugët distrikte	Një rrugë 1-kahëshe me 1 ose 2 kors	3.00	1 ose më shumë	1.60 (me shenja)	-	0.50	4.00	12
Rrugët lokale	Një rrugë 1-kahëshe me 1 ose 2 kors	2.75	1 ose më shumë	-	-	0.50	3.00	5

**Karakteristikat gjeometrike minimale të gjerësisë së rrugëve urbane (sipas NRC)**

Emri	Shpejtësia minimale e projektit (km/hr)	Gradienti maksimal i kthesës (%)	Radiusi minimal i planifikuar (m)	Radiusi minimal altimetrik		Gradienti maksimal i gjatësisë (**)
				Convex (*)	Concave	
Rrugët primare	90	7.0	300	3.500	2.500	6
Rrugët urbane kryesore dhe rrethore	70	4.5	160	2.000	1.200	6 (4)
Rrugët urbane sekondare urbane	50	3.0	85	1.000	600	7 (5)
Rrugët lokale	25	-	25	300	200	10


**Karakteristikat e shtegut të rrugëve sipas shpejtësisë minimale (sipas NRC)**


Emri	Lloji i kryqëzimit	Minimim distancë (m) ndërmjet kryqëzimeve	Rregullat për kthim në të majtë	Hyrja e automjeteve	Tipi i kalimit të trotuarit	Kalimi i këmbësorëve: vendosja dhe distanca
	A	B	C	D	E	F
Rrugët primare	Kryqëzimi multiniveli	1 500	Me qasje në rampë	E paekzistuar	Me multinivel	-
Rrugët rrethore	Me multiniveli të mundshëm	300	Niveli i ndaluar	Rigrupimi	Me multinivel ose eventualisht me semafor	Në kryqëzimin
Rrugët distrikte	Të organizuara në nivel	100	E kontrolluar	Direkt	Me semafor ose eventualisht me kalim në zebra	Në kryqëzimin
Rrugët lokale	Të paorganizuara	-	Të lejuara	-	Kalim në zebra	100



Distanca dhe lokacioni i kalimeve për këmbësorë

Vija ndërtimore  
Hapësira e ndaluar  
Distanca  
Hapësira ndërtimore





Hapësirat e ndërlidhura dhe të ndaluara


## 1.1 Rrugët primare

Rrugët primare sigurojnë hyrje dhe dalje nga qyteti dhe do të shërbejnë si kryqëzime në disnivel të transportit midis zonave urbane dhe ekstra-urbane, dhe si transport tranzit për dhe nga zonat urbane. Në këtë kategori të rrugëve, të cilat për qytetet e mëdha gjithashtu përfshijnë autoudha urbane, do të vendosen automjetet e transportit publik, si dhe të gjitha automjetet e tjera, përveç atyre të cilat nuk udhëtojnë më shpejt se 50 km/orë. Në këto rrugë në vijim nuk do të lejohet: parking, ndalesa për mjetet e transportit publik, motoçikleta dhe këmbësorët; vetëm nëse në veçanti, korsi të dedikuar janë pajisur për përdorimin e tyre.


Ruga primare urbane përfshin këto kategori:

- Autoudha urbane – pjesë të cilat janë të rekomanduara për ndërtimin e ‘by-pass’ të qytetit të Prishtinës dhe një unazë të ndërmjetme të Prishtinës;
- Rrjedhja e rrugëve primare - pjesë të cilat janë propozuar për të gjitha rrugët kryesore që lidhin Prishtinën me qytetet e tjera të Kosovës dhe pikat e kalimit kufitar, të cilat kalojnë nëpër qytet.

Funksioni i rrugëve kryesore rrjedhëse është për të siguruar rrjedhshmërinë e lëvizjes së automjeteve në rrjetin e trafikut të brendshëm të qytetit. Ato mundësojnë një nivel të lartë të shërbimit për distanca më të mëdha brenda rrjetit urban. Kjo kategori përfshin shpejtësi të lartë të rrugëve urbane, rrugëve urbane me shpejtësi të kufizuar, rrugë me dedikim për automjetet e transportit publik, si dhe rrugë të tjera me korsi të dedikuar. Në rrugët rrjedhëse fillore pa korsi të dedikuar, të gjitha elementet e transportit janë të lejuara, me përjashtim të ndalim parkimit të automjeteve.



Rruga primare n.1 (Autoudha urbane apo rruga arterie)



Rruga primare nr.2 (Rruga mbledhëse)

Rrugët aktuale primare, kanë një gjatësi totale prej 25 790 metra ose 6,20% e gjatësisë së përgjithshme të rrjetit rrugor të qytetit. Ato përbëjnë një sipërfaqe totale prej 515,800 metra katrorë në rrjetin rrugor. Aktualisht asnjë nga rrugët primare ekzistuese nuk i përmbush standardet e kërkuara të një autostrade urbane. Ndërtimi i këtij lloji të autostradës për qytetin e Prishtinës për të ardhmen është projektuar në format e mëposhtme:

- Qyteti 'By-pass', me një gjatësi totale prej 26,623 metra. Ajo do të ketë katër korsi të trafikut normal, dy për secilin drejtim të udhëtimit. Rruga do të ketë dy rrugë njëdrejtimëshe kështu, një rezervë qendrore dhe një total prej dy korsi në çdo drejtim të udhëtimit.
- Unaza e ndërmjetme të qytetit, me një gjatësi totale prej 26 088 metra. Do të ketë katër korsi të trafikut normal dhe dy korsi të caktuara për automjetet e transportit publik, një për secilin drejtim të udhëtimit. Rruga do të ketë dy rrugë njëdrejtimëshe, një rezervë qendrore dhe një total prej tri korsish në çdo drejtim të udhëtimit.
- Unaza qendrore do të ndërtohet me një gjatësi totale prej 6 880 metra. Do të lëvizë vetëm në një drejtim (në kuptimin e kundërt me rrotullimin e akrepave të orës). Do të ketë katër korsi, dy për trafik normal, një për mjetet e transportit publik, si dhe një shtigje për biçikleta, e cila do të shkojë në të dy drejtimet në pjesën e jashtme të këtij rrethi, i mbrojtur nga trafiku.

Rrjeti rrugor si tërësi do të ketë një gjatësi totale prej 484 270 metra, një rritje prej vetëm 9,17%, por me një përmirësim të dukshëm të cilësisë. Rrjeti rrugor primar do t'i përfshijë rrugët urbane matëse 120 230 metra në gjatësi, një rritje prej 460% në krahasim me gjatësinë ekzistuese të rrugëve urbane, duke siguruar rrjedhshmëri më të mirë të trafikut të qytetit. Kjo do të mbajë nivele të rritura të motorizimit si dhe qarkullim në rritje në qytetin e Prishtinës.


## 1.2 Rrugët dytësore

Rrugët dytësore ose rrugë lokale: rrugët urbane me kapacitete të mesme, të cilat shërbejnë për mbledhjen/shpërndarjen e trafikut nga rrugët kryesore dhe nga rrugët me kapacitet të ulët të rjetit dhe për nënlidhjet ndërmjet njësive komunale të qytetit,


Rrugët lokale shërbejnë për t'i lidhur zonat fqinje (zhvendosje me distancë minimale, gjithmonë brenda qytetit), apo zona të mëdha urbane në zona periferike. Kjo kategori përfshin rrugë që shërbejnë për shërbimet kryesore urbane të zonave. Këto rrugë akomodojnë të gjithë komponentët e transportit, duke përfshirë edhe parking privat të automjeteve, me kusht që kjo të jetë e organizuar në zona të caktuara dhe në drejtim të kundërt me korsi manovrimi. Rrugët lokale janë në shërbim direkt të zonës në të cilën ato janë të vendosura. Kjo kategori përfshin rrugë të destinuara për këmbësorë dhe parkim. Qarkullimi i mjeteve të transportit publik nuk lejohet në këto rrugë. Klasifikimi i mësipërm funksional nuk e përjashton mundësinë e përcaktimit të rrugëve të veçanta dhe të rezervuara kur konsiderohet e nevojshme. Këto itinerare do të jenë të detyrueshme ose preferenciale dhe do t'u shërbejnë përdoruesve të kategorive të veçanta ose të komponentëve të tjerë të transportit rrugor, si: automjete - karroca për persona me aftësisë të kufizuara, mjetet komerciale apo emergjente të transportit. Ajo gjithashtu nuk e përjashton, por, në të kundërtën, kërkon studimin e ndërveprimit në mes të transportit rrugor dhe formave të tjera të transportit. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet klasifikimeve të bashkëveprimit funksional me stacionet hekurudhore, aeroportet, portet dhe teleferikët.

Vlerësimi i mëtejshëm i karakteristikave gjeometrike për kategoritë e ndryshme të transportit rrugor kërkon zbatimin e kriterit themelor, që përcakton se lidhja e rrugës duhet të jetë vetëm me të së njëjtës kategori, apo ato të mësipërm ose në kategorinë përcjellëse (kështu që një rrugë mund të jetë e lidhur vetëm me një rrugë tjetër me një kategori më të lartë ose më të ulët se klasifikimi i saj).

Gjatësia e rrugëve sekondare të Prishtinës aktualisht është 146,230 metra, e cila e përbën 30,35% e gjatësisë totale të rjetit rrugor. Gjithsej sipërfaqja e zonës së rjetit të rrugëve sekondare është 1 462 300 metra katrorë dhe gjerësia mesatare e saj është 10 m. Kjo mund të jetë e përshtatshme për periferinë e qytetit, por është e pamjaftueshme për qendrën e qytetit, aty ku gjatësia nuk mund t'i plotësojë kërkesat për parkim në rrugë, apo trafik për çiklistë dhe këmbësorë. Për këto arsye, rindërtimi dhe zhvillimi i rjetit të rrugëve të Prishtinës përfshin rrugët dytësore dhe rrugët e distriktit me gjerësi prej 12,5 metrash.




Rruga sekondare



Rruga sekondare

### 1.3 Rrugët terciare

Rrugët terciare janë rrugë me kapacitet të ulët që mundësojnë hyrje në njësitet administrative të qytetit. Për identifikimin e këtyre rrugëve, një raport ekzistues në volumn e trafikut, bazuar në nivelet aktuale të trafikut është përdorur. Kjo analizë ka përfunduar përmes vëzhgimit të vëllimit të trafikut dhe përmes një modeli të avancuar për llogaritjen e tij. Tërësia e rrjetit rrugor, e cila është klasifikuar si terciare përfaqëson si pjesë e të gjitha kategorive të hartës së rrjetit rrugor të Prishtinës, me gjatësi të përgjithshme prej 271 800 metrash, ose 69,71% e gjatësisë totale të rrjetit të rrugëve të qytetit. Ato përfshijnë një sipërfaqe totale rrugore prej 1 087 200 metrash katrorë. Gjerësia e tyre mesatare është 3,999 metra, në krahasim standardin e 9,50 metra të cilat një qytet modern duhet t'i ketë.



Rruga terciare

### 1.4 Kryqëzimet

Rrjeti i udhëkryqeve rrugore është përcaktuar (figura 9 -11), në varësi të hierarkisë (shih figurën 2 dhe 3) (Tipat A deri F). Është e qartë se aty ka dy lloje kryesore të kryqëzimeve: Niveli dhe nyjat multinivel. Në lidhje me planin e propozuar, Plani strukturor i qytetit të Prishtinës prej nesh, 8 kryqëzimet multinivel kanë qenë të propozuara në 'by-pass' (kryqëzimi nr. 1, 2, 3, 7, 8, 11, 13 dhe 14), 7 kryqëzimet multinivel janë propozuar në unazën e brendshme (kryqëzimi nr. 15, 27, 30, 32, 33, 36 dhe 37), dhe 3 kryqëzimet multinivel kanë qenë të propozuara në unazën qendrore (kryqëzimi nr. 39, 46 dhe 47) gjithsej me 18 kryqëzime (shih figurën poshtë). Projekti ka për qëllim

të zvogëlojë vonesën kohore të pritjes së makinave në disa nga kryqëzimet më të rënda të mbushura nga rrjeti i rrugëve primare. Në përfundimin e modelit tonë të trafikut stimulues, nyjat e kryqëzimeve multinivel në mes rrugëve kryesore, rrugëve qarkulluese dhe autostradës urbane ka qenë identifikuar si më parë:



1. By pass-i – shpejtësia e lartë e autostradës – (8 kryqëzime jo në kryqëzime në disnivel)
2. Unaza e brendshme - (7 kryqëzime jo në disnivel)
3. Unaza qendrore - (3 kryqëzime jo në disnivel)

Në të njëjtën kohë, studimi i metodës së rregullimit të trafikut, sipas vëllimeve përkatëse të shkëmbimit të trafikut, janë të nevojshme për secilin nivel kryqëzimi. Opsionet janë: rrethrotullimet, rregullimi i trafikut përmes dritave e trafikut (semaforët), dhe rregullimi i trafikut përmes shenjave rrugore. Fillimisht, shtatë kryqëzimet e zonës qendrore në unazën qendrore janë rekomanduar që të rregullohen me anë të shenjave rrugore (me prioritet), duke mundësuar hyrje dhe dalje të lirë të automjeteve që të rrjedhin në unazën qendrore dhe vetëm për këmbësorë që t'i kalojnë dritat e trafikut tek ato në të brenda unazës, e cila do të jetë vetëm për këmbësorë. Kjo është e bazuar në nivelet aktuale të ngjeshjeve të gjetura në këto kryqëzime, me qëllim të shkarkimit të qendrës së qytetit nga ngecjet e trafikut.


Kompletimi i nivelit të kryqëzimeve të rrjetit rrugor, dhe riklasifikimi i disa prej tyre, është dhënë në Raportin e planit strukturor (shih Projekti për përmirësimin e kryqëzimit), që duhet të bazohet në kritere standarde (ende mungon në Kosovë) dhe në udhëzimet e parashikuara në NË RRUGËN E TRANSPORTIT Ligji Nr. 2004/1, mars 24, 2005, SIGURIA NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR Ligji Nr. 02/L-7, Janar 11, 2007. Në këtë shembull, referenca duhet të jetë me normat relative të CNR, duke pasur parasysh që në Normat e BE si në EURO-KOD.


Kryqëzimet në nivelin në fjalë janë të karakterizuara nga kënde të ndryshme dhe rrezet kthyesë, të



cilat rezultojnë nga drejtime të ndryshme të kalimeve. Kështu, ata mund të jenë në konflikt me hapësirat ekzistuese përreth kryqëzimit. Mund të jenë të paktën tri raste të papajtueshmërisë së këtij lloji: komunikacioni i parregulluar i automjeteve, vendkalimet e shtrira të këmbësorëve (veçanërisht në zonat urbane) dhe zonat e papërdorshme të asfaltuara/zonat e asfaltuara.


Tri figurat e më poshtme tregojnë nivelin e kryqëzimeve dhe multinivelin e kryqëzimeve në një zonë në fqinjësi të disa rrugëve dhe të organizuara në mënyrë që të mundësojnë komunikacionin që të rrjedhë nga një rrugë në tjetrën.





**Kryqëzimi në katër anë të rrugës**

**Kryqëzimi në tri anë të rrugës**



## 1.5 Parkimi

Parkimi (komunikacioni në qetësi) planifikohet në të gjitha pikat hyrëse të qytetit dhe në udhëkryqet e rrugëve primare që çojnë në drejtim të qendrës dhe unazave. Pika qendrore e parkimit konsiderohet parkingu në kuadër të stacionit intermodal.

Siguria dhe rrjedhshmëria e trafikut në rrugët mbledhëse arrihet nëpërmjet ndarjeve fizike të automjeteve të parkuara nga ata që janë në lëvizje. Në këtë mënyrë, funksionet e ndryshme rrugore nuk janë në shërbim nga hapësirat e njëjta të rrugëve, të tilla si rrjedhja normale e automjeteve që janë në kundërshtim me hyrjet e parkimit dhe manovrat e daljes. Bashkëzistenca e funksioneve rrugore është e lejuar në rrugët e kategorive të ulët. Në rrugët lokale, me kusht që në anën e rrugës për parkim, në të cilën është i lejuar parkimi, ekziston një korsi e dedikuar për parkim, ose aty ku është e nevojshme, me treguesit vizualë, që është një pjesë e përcaktuar me qëllim të shtigjeve rrugore.

Në shembullin e rrugëve lokale, korsa më e afërt në korsinë e parkimit (korsia për manovrim), duhet të sigurohet me shenjat e dhura rrugore horizontale, si dhe duhet të ketë një gjerësi prej 3,50 metrash për parkim paralel ose 45 shkallë të parkimit, dhe një gjerësi prej 6,00 metra për parkim pingul me rrugë njëkahëshe. Gjithashtu, në korsinë e parkimit, hapësirat e parkimit duhet të tregohen me vijëzime horizontale 2.00 metra për parkim paralel dhe 4,50 metra për parkim 45 shkallësh dhe duke parkuar pingul me rrugë njëkahëshe. Në tabelën në vazhdim janë treguar 5 kombinime të mundshme (sipas kapacitetit të hapësirave të parkimit për metër) për korsi parkimi përkatëse në korsi manovrimi, d.m.th. rrugë njëkahëshe – parkim. Këto masa duhet të miratohen së bashku me anën e rrugës njëkahëshe ose veçmas (të ndara nga trotuari), në mënyrë që të

krijojë parkimi në rrugë. Këto korsi-parkimi, të përdorura si module përsëritëse, bëjnë organizimin e zonave të mundshme të parkimit. Në këtë kontekst, kombinimi më racional është llogaritur duke u bazuar në raportin e hapësirave të parkimit për metër katror. Dispozitat e zonave të parkimit treguar në figurat në vazhdim (me përjashtim të atyre të përcaktuara si rrugë-parkimi) referohen vetëm për parkim të shkurtër, me qarkullim të shpeshtë të automjeteve.

Gjerësia e rrugës njëkahëshe (në metra)		Kapaciteti (Numri i postimeve/metër gjatësia e rrugës njëkahëshe)
17.50 - 15.00		0.86 L
15.00 - 12.50		0.63 L
12.50 - 10.00		0.51 L
10.00 - 7.50		0.40 L
7.50 - 5.50		0.20 L

**Vendosja e postieve të parkimit të rrugës**

**ANEKSI I:**

**KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL – HARTAT**

---

## 6. ZONAT EKZISTUESE URBANE DHE ZONAT E NDËRTIMIT: FSHATRAT

### Zhvillimi i fshatrave dhe i lagjeve në zonën rurale

Është e dukshme që zhvillimi kryesor i Komunës së Prishtinës është i orientuar kah zona urbane. Në vitet e fundit është evidentuar një zgjerim i lehtë i zhvillimit në zonat rurale, ku përfshihen fshatrat përreth pjesës urbane të komunës.

Zhvillimet e deritanishme të fshatrave dhe lagjeve në zonat rurale janë bazuar në Planet Detale Urbanistike (PDU), të përgatitura në vitin 1986, për 13 fshatra (Nëntë Jugoviq, Barilevë, Drenoc, Bërnice e Epërme, Bërnice e Poshtme, Besi, Hajvali, Lebanë, Trudë, Shashkovc, Orlloviq, Prugovc dhe Uglarë). PDU-ja përcakton kufijtë për zonën e ndërtimit, prandaj ato plane si të tilla fillimisht janë konsideruar të mjaftueshme për monitorimin e ndërtimit.

Me mungesën e planeve tjera që nga viti 1986 në fshatrat që kanë qenë të paisura me PDU por edhe në fshatrat tjera kanë vazhduar ndërtime spontane. PZhK-ja ka marrë parasysh ndërtimet e gjertanishme dhe në shumicën e fshatrave ka planifikuar vetëm densifikim apo zgjerime minimale me qëllim të ruajtjes së tokës ndërtimore nga ndërtimet e mëtutjeshme.

Në mënyrë që të përcaktojë kufijtë e fshatrave dhe vendbanimeve në zonat rurale, gjatë zhvillimeve të PZHk-së janë marrë parasysh këto katër parime:

1. Respektimi i kufijve ekzistues të përcaktuara me PDU,
2. Respektimi i gjendjes ekzistuese të sipërfaqeve të ndërtuara,
3. Respektimi i parimit që të jenë minimum 15 ndërtesa të një fshati apo lagje të trajtuar,
4. Mbrojtjen e identitetit të fshatit apo lagjes.

Kufijtë ekzistues në fshatra të përcaktuar me PDU, janë mbajtur të njëjtat ose janë zgjeruar me synimin për t'i integruar ndërtesat e ndërtuar rishtazi. Nuk ka asnjë rast që kjo është zvogëluar. Për pjesën tjetër të fshatrave të cilat nuk janë të pajisura me PDU, kufiri është i përcaktuar në bazë të parimit 2, 3 dhe 4. Fshatrat e vogla dhe lagjet me më pak se 15 ndërtesa nuk janë trajtuar.

Përderisa procesi i densifikimit dhe në përgjithësi zhvillimit urban duhet trajtuar në PZhU, në këtë dokument trajtohen vendbanimet rurale.

Në PZHk fshatrat dhe vendbanimet janë vendosur në tri kategori:

- C1. Fshatrat të përkufizuara si një vendbanim me kufi të përcaktuar,
- C2. Fshatrat me dy ose më shumë vendbanime, bazuar kryesisht në zgjerimin e familjeve (një familje e krijuar në dy ose më shumë qeliza të reja të familjes), me 15 dhe më shumë shtëpi familjare.
- C3. Fshatrat të shpërndara gjithandej – të cilat nuk janë trajtuar.

Grupet e trajtuara të fshatrave, të cilat bëjnë pjesë në grupin C2 janë: Barilevë, Besi, Drenoc, Hajvali, Lebanë, Prugovc, Trudë, Busi, Grashticë, Llukar, Makoc, Mramor, Shkabaj, Siqevë, Slivovë, Vranidoll, Zllatar, Shashkovc, Koliq, Rimanishtë, dhe Teneshdoll.

Për fshatrat me tendencë të rritjes është e preferuar që të hartohen plane rregulluese.

### Zhvillimi i fshatrave

Në të kaluarën Komuna e Prishtinës i ka trajtuar disa fshatra (Nëntë Jugoviq, Barilevq, Drenoc, Bërnice e Epërme, Bërnice e Poshtme, Besi, Hajvali, Lebanë, Trudë, Llapnasellë, Shkabaj dhe Prugovc), duke i pajisur me plane detale urbane. Zhvillimet e pasluftës në zonat rurale të Komunës

së Prishtinës imponojnë më shumë trajtim të disa fshtrave. Kësaj liste i bashkohen edhe fshatrat Koliq, Llukar, Mramor dhe Besi, që duhen pajisur me plane rregulluese.

Fshatrat e tjera, me shtëpi të shpërndara gjithandej duhen drejtuar kah këto fshatrat e sipërpërmendura për nevojat shoqërore/sociale.

### **Kushtet për ndërtimin e objekteve nëpër fshatra**

Në tokat bujqësore, jashtë zonës së banimit mund të lejohet ndërtimi, por duke i plotësuar kushtet e parapara me këtë plan derisa të hartohet Plani zhvillimor urban i fshatrave apo edhe planet rregulluese. Duhet të bëhet ndarja e veprimtarive në kuadër të pronës së banimit (pastër) dhe pjesës ekonomike dhe ndihmëse (papastër). Nëse ende nuk ka një plan të tillë, atëherë distanca e vijës ndërtimore nga vija rregulluese për objektet individuale për banim në fshatra duhet të jetë 3-5 metra. Distanca në mes objekteve individuale për banim në fshatra është prej 5-10 metra, varësisht prej numrit të etazheve. Në këto fshatra lejohet ndërtimi me etazhitet maksimum P+1 (përdhese plus një kat) me koeficient të ndërtimit 30% për pjesën e dedikuar për banim.

Elementet ndërtimore të objekteve (konsollat, strehët e hyrjeve me dhe pa shtylla, etj.) në nivel të katit mund të kalojnë vijën ndërtimore duke llogaritur sipas gabaritit bazë të objektit, gjegjësisht vijës ndërtimore më së shumti 1.20 metra. Te fshatrat, të cilat janë trajtuar vetëm në pjesën tekstuale (fshatrat me shtëpi të shpërndara gjithandej), lejohet ndërtimi në një radius prej 50 metra nga objektet ekzistuese të banimit. Në këtë mënyrë do të evitohet rreziku nga shpërndarja e mëtutjeshme e objekteve nëpër territorin bujqësor.

Distanca e objektit individual për banim nga objektet ekonomike (shtallat, kotecet, etj.), apo objektet ndihmëse (fushore, depozitë e plehërave etj.) duhet të jetë minimum prej 25-30 metra. Me kushte urbanistike-teknike caktohet pozita e objekteve ekonomike dhe ndihmëse, në raport me vijën ndërtimore. Vendosja e objekteve ekonomike dhe ndihmëse në fshatra nuk mund të jetë në distancë më të vogël se 3 metra nga fqinji më i afërt ku është ndërtuar objekti ekonomik.

Në raste specifike, mund të ndërtohen objekte bujqësore dhe blegtorale edhe më thellë në zonat rurale (jashtë zonave të shënuara) me një trajtim të veçantë nga sektorët përkatës të Komunës së Prishtinës (Sektori për mjedis, Departamenti për ekonomi, etj).

Kujdes i veçantë në zonat rurale duhet t'i kushtohet trajtimit lokal të ujërave të zeza, duke aplikuar sisteme bashkëkohore të pastrimit me projekte të veçanta në secilin vendbanim veç e veç.

Parcelat në vendbanimet e fshatrave mund të rrethohen në anën kah rruga publike me mure në lartësi maksimale prej 1.20 metra apo me rrethojë transparente në lartësi maksimale prej 1.80 metra. Rrethojat nga parcelat fqinje mund të vendosen edhe në aksin e kufirit të parcelave fqinje nëse për këtë jepet pëlqimi nga fqinjët. Rrethojat mund të vendosen në vijën rregulluese në brendësi të parcelës.

Infrastruktura ekzistuese rrugore në zonat rurale planifikohet të përmirësohet me qëllim të ndërlidhjes së fshatrave mes veti dhe ndërlidhjes së tyre me linjën metropolitane, autostradën "Dr. Ibrahim Rugova" dhe 'by pass'-in e qytetit të Prishtinës (segmenti verior i 'by pass'-it). Prioriteti i nivelit të intervenimeve mbetet të përcaktohet varësisht nga dinamika e implementimit të

projekteve të tjera nga niveli qendror, prioriteteve zhvillimore komunale dhe buxhetit në dispozicion të Komunës së Prishtinës. (të prezantuara në pjesën grafike-Aneksi II).

Meqenëse në zonat rurale ekzistojnë resurse të konsiderueshme ujore, propozohet menaxhimi i tyre (përdorimi i kontrolluar) për banorët e fshatrave përkatës apo edhe kyçja në sistemet ekzistuese të furnizimit me ujë të pijshëm. Furnizimi i fshatrave përkaj qytetit (p.sh. Bardhosh, Llukar, Besi, Sharban, Siqevë, etj.) të planifikohet të bëhet nga sistemet ekzistuese.



**ANEKSI II:**

**KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL TË FSHATRAVE**

---